VENDIM
Nr. 51, datë 24.3.2022

MBI MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-s, "GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE VEPRIMTARIA E ERE-s GJATË VITIT 2021"

Në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.3.2022, mbasi shqyrtoi Relacionin e nr. 398 prot., datë 23.3.2022, përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë e kryetarit të grupit të punës së ngritur për përgatitjen e raportit vjetor të ERE-s, "Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s, 'Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2021'",

konstatoi:

- ERE, në zbatim të parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, paraqet në Kuvend raportin vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike, gazit natyror dhe veprimtaritë e ERE-s, për vitin paraardhës, brenda datës 31 mars".
- Grupi i Punës, i ngritur me urdhrin nr. 2, datë 13.1.2022, të kryetarit të ERE-s, mori masat për fillimin e punës për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura nga të licencuarit, me qëllim hartimin e raportit vjetor, brenda afatit të përcaktuar, datë 31 mars 2022.
- Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Energjisë pasqyron veprimtarinë e ERE-s, sa i përket monitorimit të ecurisë së sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, veprimtarinë e të licencuarve dhe mbikëqyrjen e të të drejtave të klientëve të energjisë, si dhe progresin e Entit Rregullator të Energjisë në hartimin e rishikimin e legjislacionit, me qëllim adresimin e detyrimeve ligjore të ERE-s, por edhe rregullimit të marrëdhënieve mes të licencuarve apo të licencuarve dhe klientëve në sektorin e energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s, "Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2021", që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
RAPORT VJETOR
Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2021
Tiranë, 2022

Përmbajtja

HYRJE

ECURIA E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE TË ERE-S PËR PERIUDHËN 2021 E NË VIJIM, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE TË ERE-S PËR PERIUDHËN 2021 – 2023 SI DHE MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË ERE-S TË RISHIKUAR PËR VITIN 2022 – 2023

MBI REKOMANDIMET E PROGRES RAPORTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1 Situata e Sektorit Elektroenergjitik Shqiptar

1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike

1.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2021.

1.2.2 Të dhënat teknike kryesore dhe prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2021

1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë

1.2.4 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi .

1.2.5 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021

1.2.6 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese

1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike

1.3.1 Bilanci energjitik

1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a

1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

1.3.2.2 Investimet në sistemin e transmetimit nga OST sh.a. gjatë vitit 2021

1.3.3 Gjendja e përgjithshme e Sistemit Elektroenergjitik referuar raportimit të OST sh.a., në zbatim të nenit 25, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar

1.3.3.1 Nivelet e tensionit

1.3.3.2 Kontrolli i frekuencës.

1.3.3.3 Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive

1.3.3.4 Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së .

1.3.3.5 Planifikimi afatgjatë

1.3.3.6 Planifikimi afatmesëm

1.3.3.7 Planifikimi afatshkurtër

1.3.3.8 Operimi në kohë reale

1.3.4 Protokolli i bashkëpunimit operativ për operimin në kohë reale ndërmjet OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

1.3.4.1 Sistemet e Kontroll - Monitorimit Automatik

1.3.4.2 Menaxhimi i fluksit të energjisë

1.3.4.3 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi.

1.3.4.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike

1.3.4.5 Tregu i balancimit të energjisë elektrike

1.4 Shpërndarja e Energjisë Elektrike.

1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.)

1.4.2 Konsumi i energjisë elektrike

1.4.3 Struktura e konsumit të energjisë elektrike

1.4.4 Profili i konsumit të energjisë elektrike.

1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe humbur, për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2021.

1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike.

1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

2.1 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike.

2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

2.1.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.

2.1.3 Monitorime të tjera të lidhura me veprimtarinë e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike

2.1.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a., OST sh.a. dhe FTL sh.a. në Treg të hapur (parregulluar) gjatë vitit 2021.

2.1.5 Rekomandime për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut nga monitorimet.

2.2 Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)

2.2.1 Detyrime që lindin nga Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT).

2.2.2 Monitorimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në treg në zbatim të rregullorës REMIT

3. BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE (ALPEX).

3.1 Hapat e para drejt tregut të organizuar..

4. LICENSIMI, MBIKËQYRJA DHE DHËNIA E AUTORIZIMEVE PËR VEPRIMTARINË E TË LICENSUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË..

4.1 Aplikimet për licencim të Trajtuara nga ERE gjatë Vitit 2021

4.2 Licensimi në aktivitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike

4.2.1 Licensimi në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

4.2.2 Licensimi në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike

4.3. Licensimi në aktivitetet e Gazit Natyror

4.4 Modifikimet e licencave të trajtuara nga ERE gjatë 2021 .

4.5 Aplikimet për rinovim të licencave të trajtuara nga ERE gjatë vitit 2021

4.6 Transferimet e licencave të trajtuara nga ERE gjatë vitit 2021

4.7 Kualifikimi dhe pajisja me Certifikatë të Garancisë së Origjinës gjatë vitit 2021

4.8 Dhënia e autorizimeve nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme, si dhe për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit

4.9 Trajtimi i kërkesave të ALBGAZ sh.a. për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve të licencimit

4.9.1 Mbikëqyrja e të licencuarve gjatë vitit 2021

4.9.2 Çertifikimet, ndjekja dhe zbatimi i kushteve respektive

5. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR.

5.1 Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorine energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2022 gjatë vitit 2021

5.1.1 Lidhur me aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin2022 dhe për periudhën 2022-2024

5.1.2 Lidhur me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave për vitin 2022

5.1.3 Lidhur me miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal

5.1.4 Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin2021

5.1.5 Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2022

5.1.6 Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020 dhe 2021

5.1.6.1 Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2020.

5.1.7 Në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2021

5.1.8 Aktiviteti i prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike & HEC Ashta për vitin 2021

5.1.9 Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2021

5.1.9.1 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a .

5.1.9.2 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021

5.2 Hartimi, Rishikimi dhe Miratimi i Metodologjive të llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror

5.2.1 Vijimi i proçesit të miratimit të Metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike

5.2.2 Rishikimi i Metodologjive ekzistuese të përllogaritjes së tarifave të rrjeteve

5.2.3 Mbi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për Operatorin e Sistemit të GNL-së

5.3 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE dhe çmimet e energjisë elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2021

5.3.1 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE

5.3.2 Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2021

6. RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

6.1 Korridori Jugor i Gazit (SGC) kriza e furnizimit me gaz në botë dhe pozicioni i strategjik i vendit tonë

6.2 Aksionerët e Kompanisë

6.3 TAP një projekt strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore

6.3.1 TAP është një OST plotësisht e ndërlidhur dhe transparente për tregun

6.3.2 TAP ka një rol strategjik dhe thelbësor për dekarbonizimin, sigurinë e furnizimit dhe ndërlidhjen në Shqipëri dhe Europën Juglindore

6.4 Zbatim i programeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit të TAP

6.5 Inspektimet, mbikqyrjet dhe kontrollet e kryera nga organet kompetente

6.6 Plotësimi i detyrimit për të informuar konsumatorët dhe masat e ndërmarra për të përmirësuar cilësinë e shërbimit

6.7 Zgjerimi dhe kontributi i TAP në mënyrë aktive në kalimin/tranzicionin e energjisë

6.8 TAP dhe synimi i mundësimit për vendosjen e kapacitetit të kabllove me fibra optike në Europën Juglindore dhe më gjerë

6.9 Ndryshimet në Licencën e Transmetimit

6.10 Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2021 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror

6.11 Performanca e ALBGAZ sh.a. për vitin 2021

6.12 Albania Gas Service Company

6.13 Objektiva për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror

6.14 Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare ne fushen e Gazit Natyror

7. MBI RAPORTIMIN E ERE NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË "REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2020"

8. AKTIVITETI I ERE NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE NDRYSHIME TE TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2021

8.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar

9. AKTIVITETI I ERE NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJES SË STANDARTEVE

9.1 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2021

9.1.1 Ankesa sipas rrugëve të ndryshme të komunikimit

9.1.2 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.

9.1.3 Ankesat për Energji e pamatur /Dëm Ekonomik

9.1.4 Ankesat për faturim aforfe

9.1.5 Faturimi i energjisë elektrike për matje jashtë kushteve teknike

9.1.6 Ankesat për keqtarifim

9.1.7 Ankesa të ndryshme

9.2 Dhënia zë e konsumatorit

9.3 Mbikëqyrja e shërbimit konsumator të furnizuesve në treg të lirë

9.4 Konsumatorët/Vetëprodhues

9.5 Legjislacioni sekondar për konsumatorin

9.6 Standardet për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike

9.7 Standartet e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes

9.8 Aksesi në Rrjetin e shpërndarjes dhe Rrjetin e Transmetimit

9.9 Monitorime të licencuarve në aktivitetet e shërbimit publik

9.10 Informacion lidhur me verifikimin e matësave

10. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE

10.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare

10.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare

10.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s

11. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERE DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

12. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE GJATË VITIT 2021

SHTOJCA 1. RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

SHTOJCA 2. RAPORTI I PERFORMANCËS

Tabela e Figurave

Figura 1 Skema e Sistemit Elektroenergjitik (Burimi: ERE)

Figura 2 Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar (Burimi: ERE)

Figura 3 Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2021

Figura 4 Prodhimi neto vendas për vitin 2021

Figura 5 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2021 (MWh)

Figura 6 Prodhimi mujor vendas për vitin 2021 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2021

Figura 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2021 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë

Figura 8 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Figura 9 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Figura 10 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2021 (Burimi: KESH sh.a.. , OST sh.a.)

Figura 11 Shkarkimet e Ujit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (2002-2021) (Burimi: KESH sh.a.)

Figura 12 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2021 (m) (Burimi: KESH sha)

Figura 13 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2021 (Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Figura 14 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2021

Figura 15 Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2021 krahasuar me mesataren historike

Figura 16 Rezerva Energjitike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2021 (Burimi: KESH sha)

Figura 17 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2021

Figura 18 Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2021

Figura 19 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2021

Figura 20 Impiantet fotovoltaikë viti 2021

Figura 21 Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021

Figura 22 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2021 (Burimi: FTL sh.a., OST sh.a.)

Figura 23 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2021 (Burimi: OST sh.a.; OSHEE sh.a.; FTL sh.a.)

Figura 24 Bilanci Energjitik i OST sh.a. për vitin 2021 krahasuar me atë të viteve 2015 - 2021 (MWh)

Figura 25 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenirgjitik shqiptar për vitin 2021

Figura 26 Linjat sipas nivelit te tensionit te Sistemit të Transmetimit

Figura 27 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë

Figura 28 Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar

Figura 29 Skema njëfazore e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar në nivelin 400/220/150/110kV

Figura 30 Nënstacionet e sistemit të transmetimit

Figura 31 Asetet kryesore të sistemit të transmetimit

Figura 32 Realizimi i Investimeve nga OST sh.a.

Figura 33 Rrjeti i Transmetimit 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV

Figura 34 Vlerat e ngarkesës për rajonin e Tiranës për datën 22 dhjetor 2021

Figura 35 Diagramë njëfazore e rajonit të Tiranës

Figura 36 Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për periudhën 2022 - 2026

Figura 37 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për përiudhën 2020-2040

Figura 38 Skenarët e parashikimit të kërkesës për energji elektrike

Figura 39 NTC për vitin 2021

Figura 40 NTC Modelet e pritshme të prodhimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit

Figura 41 Avaritë në sistemin e transmetimit

Figura 42 Treguesit kryesorë të OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a. gjatë vitit 2021 .

Figura 43 Konsumi total i energjisë elektrike në vend ndër vite

Figura 44 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës import-eksport në konsumin total të energjisë elektrike në Shqipëri

Figura 45 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2020 – 2021

Figura 46 Shpërndarja e klientëve të OSSH sh.a. sipas rajoneve dhe kategorive gjatë vitit 2021 (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 47 Shpërndarja e numrit të klientëve 2021 sipas kategorive (%) (Burimi: FSHU sh.a.)

Figura 48 Raportet e faturimit sipas kategorive të klientëve gjatë vitit 2021 (Burimi: FSHU sh.a.)

Figura 49 Klientët familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite (Burimi: FSHU sha)

Figura 50 Konsumi mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2021

Figura 51 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2021

Figura 52 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2021 (MW)

Figura 53 Profili dhe minimumi i ngarkesës në mars 2021 (MW)

Figura 54 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2021

Figura 55 Shpërndarja e furnizimit me energji elektrike sipas drejtorive rajonale (%)

Figura 56 Shpërndarja e humbjeve të energjisë elektrike sipas drejtorive rajonale (%)

Figura 57 Humbjet mujore dhe vjetore në sistemin e shpërndarjes, krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM nr. 758, datë 09.12.2021 në (%)

Figura 58 Sasia në furnizim dhe humbje të energjisë elektrike në rajonet dhe agjencitë e rrjetit të shpërndarjes (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 59 Bilanci Elektroenergjitik i vitit 2021 sipas raportimieve te OST dhe OSSH sh.a. .

Figura 60 Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes në periudhën 2009-2021. (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 61 Grafiku i humbjeve vjetore në sistemin e Sshpërndarjes në periudhën 2009-2021 (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 62 Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes në periudhën 2009-2021 (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 63 Niveli i arkëtimeve mujore në periudhën 2011-2021 (Burimi: FSHU sh.a.)

Figura 64 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (%) (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 65 Efektiviteti i shitjeve të FSHU sh.a. / OSHEE Group sh.a., 2009-2021 (Burimi: FSHU sh.a. / OSHEE Group sh.a.)

Figura 66 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik kundrejt konsumit

Figura 67 Faturimi/arkëtimi 2009-2021, me TVSH (Burimi: OSSH sh.a.)

Figura 68 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH sh.a.

Figura 69 Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2021

Figura 70 Disbalancat totale për vitin 2021 (MWh)

Figura 71 Treguesit e SEE për vitin 2021 sipas targetit dhe faktit

Figura 72 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2021 nga KESH sh.a. ; FTL sh.a. (OSHEE Group sha) dhe OST sh.a.

Figura 73 Sasia e energjisë elektrike të blerënë tregun e pa rregulluar dhe çmimi i mesatar i ponderuar

Figura 74 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite

Figura 75 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2021. Burimi OST sh.a.

Figura 76 Subjektet e licencuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2021

Figura 77 Të licensuarit në veprimtarinë e Tregëtimit të Energjisë Elektrike gjatë 2021

Figura 78 Subjektet e licensuar në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike, gjatë vitit 2021

Figura 79 Çmimi mesatar i tregut të ditës në avancë HUPX Dam, Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga FTL sh.a. për qëllime të mbulimit të humbjeve të operatorit të rrjetit të shpërndarjes, furnizimit universal dhe furnizimit të mundësisë së fundit, si dhe Çmimi i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021

Figura 80 Çmimet e shitjes dhe çmimi mesatar i ponderuar së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2020

Figura 81 Çmimet e shitjes dhe çmimi mesatar i ponderuar së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2021

Figura 82 Kurba levizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët të cilët furnizohen nga FMF, për vitet 2020-2021

Figura 83 Çmimi blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e nevojës së klientëve FMF për periudhën 2020 – 2021

Figura 84 Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuar nga ERE për vitet 2020-2021

Figura 85 Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2020 - 2021

Figura 86 Çmime te blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era

Figura 87 Ecuria e çmimeve të miratuara nga ERE për Prodhuesit me Përparësi

Figura 88 Ecuria e prodhimit në vite nga Prodhuesit me Përparësi dhe HEC ASHTA

Figura 89 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi

Figura 90 Struktura e sasisë së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit univesal për vitin 2020-2021

Figura 91 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2020-2021

Figura 92 Sasia e energjisë së shitur dhe të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike të FSHU sh.a. për periudhën 2020-2021

Figura 93 Struktura e sasisë së blerë për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2020-2021

Figura 94 Struktura e shpenzimve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2020 - 2021

Figura 95 Çmimi mesatar i 6 mujorit të dytë të vitit 2021 të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM)

Figura 96 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara nga ERE ndër vite

Figura 97 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike periudha 2008 - 2021

Figura 98 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2009 – 2021

Figura 99 Çmimi mesatar i realizuar i shitjes së energjisë elektrike për kategoritë e ndryshme të klientëve fundorë

Figura 100 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jofamiljarë në vendet e rajonit për vitin 2021

Figura 101 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2021

Figura 102 Të dhënat mbi konsumin dhe prodhimin e gazit natyror në botë sipas IEA

Figura 103 Tubacionet e gazit Nord stream 1 dhe Nord Stream 2 që lidhin Rusinë me Gjermaninë

Figura 104 Projekti i Tubacionit Trans-Saharian

Figura 105 Tubacionet e gazit natyror: Kaukaziane, TANAP dhe TAP

Figura 106 Rrjetet e tubacuineve TANAP – TAP - NABUKO

Figura 107 Trendi i çmimeve te gazit natyral sipas IEA ne vite

Figura 108 Pika e daljes e tubacionit të gazit TAP në Fier

Figura 109 Volumet e Gazit që transportohen nëpërmjet TAP

Figura 110 Pikat e lidhjes se TAP sipas Market Testit të vitit 2021 në vëndin tonë

Figura 111 Ankesat e regjistruara dhe te Zgjidhura

Figura 112 Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit

HYRJE

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror në Shqipëri, i cili funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar, Ligjin nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", si dhe akte të tjera ligjore të miratuara në zbatim të tyre.

ERE ushtron aktivitetin e saj në zbatim të ligjit me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të pjesëtarëve të tregut për të siguruar furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët të klientëve. Kjo, duke patur në konsideratë interesat dhe të drejtat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, ERE gjithashtu brenda verprimtarisë së vet kryen licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në sektor, monitoron tregun e energjisë, harton kuadrin rregullator, shqyrton në përputhje me metodologjitë respektive aplikimet e tarifave dhe çmimeve e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimmarrjeve të Bordit.

Bordi i ERE-s, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/5015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar është përgatitur ky raport mbi "Gjendjen e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2021".

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin 2021 si dhe krahasimet e disa prej treguesve kryesor të këtij viti me vitet parardhëse si dhe parashikon ndër të tjera:

a) sigurinë operative të rrjetit;
b) balancën e parashikuar të kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare;
c) nivelin e pritshëm të kërkesës dhe prespektivën e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetë vjeçare nga data e raportit;
d) kapacitetin shtesë prodhues të propozuar, të planifikuar apo në fazë ndërtimi;
e) parashikimin e investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit;
f) cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;
g) masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike;
h) masat e përshtatshme, në rast nevoje, të rritjes së sigurisë së furnizimit;
i) parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit;
j) modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës;
k) objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe europian;
l) informacionin e hollësishëm të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, për investimet e parashikuara për linjat e interkonjeksionit dhe për ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ndikojnë në linjat e interkonjeksioneve ndërkufitare.

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2021 është **8,962** GWh, nga i cili, **5,343** GWh ose 59.6% u prodhua nga centralet në zotërim të shoqërisë publike të prodhimit KESH sh.a., dhe **3,618** GWh ose 40.4% u prodhua nga centralet e tjera.

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezulton se viti 2021 me sasinë e prodhuar prej 8,963 GWh, është mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2021. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2021 është 6,076 GWh. Prodhimi i realizuar për vitin 2021 rezulton rreth 2,887 GWh ose 47.5% më i lartë se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2021.

Siç evidentohet në vijim në këtë raport niveli i prurjeve të ujit përgjatë vitit 2021 është i përafërt me mesataren historike në pjesën më të madhe të vitit dhe tre muajt e parë të vitit kanë shënuar një nivel të prurjes më të lartë se prurjet shumëvjeçare. Prurjet maksimale të ujit në Liqenin e Fierzës janë regjistruar në muajin janar 2021 me 685 m^3/s ndërsa ato minimale janë regjistruar në muajin gusht 2021 me 48 m^3/s.

Në këtë kuadër duke marrë në konsideratë nivelin e prodhimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2021 në sasinë **8,962** GWh, ky konsiderohet si një vit i mirë hidrologjik, pasi është viti me prodhimin më të lartë të energjisë elektrike të regjistruar në vendin tonë.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë deri në 31 dhjetor 2021 është **2,605** MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel në rritje në vitin 2021 me 97 MW, krahasuar me vitin 2020.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2021 është rreth 2,264 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 8,016 GWh.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2021 është rreth 341 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 945 GWh.

Konsumi total për energji elektrike në vitin 2021 arriti në vlerën 8,415 GWh. Krahasuar me vitin 2020 vërehet një rritje e ndjeshme e konsumit të energjisë elektrike në vend me 826 GWh. Rritja e konsumit të energjisë elektrike për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 shkon rreth 11%., në të njejtën kohë konsumi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2021 është rreth 20% më i lartë se konsumi mesatar shumëvjeçar për periudhën 2004 - 2021.

Kjo rritje e konsumit të enegjisë elektrike është edhe rezultat i ndryshimeve të strukturës së ekonomisë dhe hapjes së saj pas kushteve të pandemisë COVID – 19, për gjatë vitit 2021, fakt i njohur dhe në vendet e rajonit dhe më gjerë.

Humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2021, arrijnë në masën **20.62**%, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2020 prej 21.48%. Për vitin 2021 humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë 1,785 GWh. Krahasuar me vitin 2020, vihet re një rritje e humbjeve totale të energjisë elektrike me 155 GWh. Kjo rritje vjen për shkak të rritjes së konsumit të energjisë elektrike për vitin 2021, e cila krahasuar me vitin 2020 shkon në rreth 11%.

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSSH sh.a. është 97.4% kundrejt energjisë elektrike të faturuar. Ky tregues është i konsoliduar pasi vitet e fundit ka qenë në nivelin mbi 95%. Kjo shifër është një tregues kryesor që tregon për stabilitetin e operatorit në këtë aspekt.

Numri i përgjithshëm i klientëve të energjisë elektrike për vitin 2021 është 1,279,460 dhe krahasuar me vitin 2020 vihet re një rritje e numrit të përgjithshëm të klientëve me rreth 6,460. Dhe për vitin 2021 pjesën më të madhe të klientëve të FSHU sh.a. e zënë klientët familjarë që shkojnë në 86.17% të numrit total të klentëve të FSHU sh.a. Konsumi i klientëve familjarë për vitin 2021 zë rreth 36.6% të konsumit total, shifër më e ulët kjo krahasuar me konsumin për të njejtën kategori për vitin 2020, i cili ishte në masën 39%.

Në të njëjtën kohë klientët familjarë zënë pjesën më të madhe në FSHU sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2021 respektivisht 49.36% të faturimit të realizuar për vitin 2021, ku 36.92% e përbëjnë klientët privatë, dhe pjesën tjetër klientët buxhetorë me rreth 5.99% dhe jo buxhetorë 7.72%. Klientët buxhetorë dhe jo buxhetorë vazhdojnë të jenë problem përsa i takon pagesave të faturave të energjisë elektrike, duke akumuluar një borxh për shoqërinë FSHU sh.a. duke përfshirë dhe debinë e krijuar si Furnizues i Mundesisë së Fundit dhe duke krijuar edhe gjatë këtij viti vështirësi financiare për këtë të fundit.

Për sa i takon çmimeve të klientëve fundorë të furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal përgjatë vitit 2021 nuk pati rritje të tyre e gjithashtu janë ende në fuqi tarifat e vitit 2020 për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

Për vitin 2021 evidentohet një ulje e konsiderueshme e energjisë së furnizuar për klientët të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit në masën 20%, krahasuar me atë të vitit 2020, e cila ka ardhur si pasojë e lidhjes së kontratave të furnizimit në tregun e lirë nga një pjesë e klientëve të cilët furnizoheshin në kushtet e mundësisë së fundit në vitin e mëparshëm. Ndërkohë, pavarësisht uljes së sasisë së energjisë elektrike të furnizuar për klientët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, si pasojë e rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike për sasinë totale prej 20 GWh, vlera e faturuar prej 377 milion lekë rezulton në rritje në masën 30% krahasuar me vitin 2020. Çmimi mesatar vjetor i energjisë elektrike të shitur për klientët e Furnizuesit të Mundësisë se Fundit për vitin 2021 ka rezultuar 18.01 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2021, ka patur një rritje të konsiderueshme prej 62%, krahasuar me atë të vitit 2020 i cili ka qenë në vlerën 11.09 lekë/kWh.

Viti 2020 është një vit atipik lidhur me ecurinë e çmimeve në tregun e energjisë elektrike pasi në kushtet e ndikimit të pandemisë Covid – 19 dhe mbylljes së ekonomisë pati një ulje të kërkesës për energji elektrike që u shoqërua edhe me çmime të ulta të energjisë elektrike në tregun rajonal.

Përsa i përket çmimit vjetor që u është, paguar prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021, ai rezulton në vlerën **7.448 Lekë/kWh** i njëjtë me vitin 2020**.**

Një pjesë e rëndësishme e punës së ERE-s konsiston në zgjidhjen e ankesave të klientëve të energjisë ndaj të licencuarve, çka përfshin trajtimin e ankesave të regjistruara në ERE për zgjidhje apo trajtimin e ankesave dhe konflikteve direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klientëve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klienteve në aspektin individual dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Një pjesë e konsiderushme e ankesave që paraqiten në ERE, kanë si shkak kryesor mungesën e informacionit në lidhje me detyrimet e konsumatorëve ndaj shoqërive të licencuara, por edhe për rolin e ERE-s. Për të shmangur sa më sipër, gjatë vitit 2021, ERE duke konstatuar dhe ndonjëherë mungesën e informacionit nga konsumatorët ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të informuar konsumatorin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ndaj operatorëve të licencuar, por edhe për të drejtat e tyre në raport me ERE-n, me qëllim shmangien e konflikteve mes palëve.

Viti 2021 ka sjellë një sërë zhvillimesh të rëndësishme në tregun e energjisë elektike në vendin tonë. Që nga 1 prilli 2021 operon tregu i balancimit të energjisë elektrike bazuar në rregullat e miratuara nga ERE me vendimin nr. 106, datë, 02.07.2020. Operimi i plotë i Tregut të balancimit u mbështet edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, që e konsideronte këtë zhvillim si një hap të rëndësishëm në reformën e sektorit të energjisë në vendin tonë.

Po në vitin 2021 është miratuar Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT). Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese

të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikat abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

Bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave, respektivisht nr. 322, datë 15.05.2019 "Mbi themelimin dhe përcaktimin e formës ligjore të strukturës së pronësisë të kapitalit aksionar të operatorit të tregut" dhe atë nr. 609, datë 11.09.2019 "Mbi përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në kapitalin aksionar të operatorit të tregut", në Tetor të vitit 2020 u themelua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) si një Shoqëri Aksionare, në bashkëpronësi të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSTT).

Në fund të vitit 2021 u arrit përzgjedhja e Ofruesit të Shërbimit, bashkimi i operatorëve të udhëhequr nga Bursa e Athinës "Hellenic Exchanges - Athens Stock Exchange S.A.", Grupi i bursës së energjisë elektrike të Greqisë me dy kompanitë e saj "Hellenic Energy Exchange S.A." dhe "Enex Clearing House S.A. Përzgjedhja e Ofruesit të Shërbimit është një hap i rëndësishëm për funksionimin dhe futjen në operim të Bursës Shqiptare të energjisë elektrike.

Në kuadër të funksionimit të tregut dhe Bursës Shqiptare të energjisë elektrike në datën 21 tetor 2021 u nënshkrua Marrëveshja Kornizë midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST), Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut te Kosovës (KOSTT), ERE dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRE) për bashkimin e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike dhe brenda së njëjtës ditë, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Në po këtë aspekt me datë 07.12.2021 u nënshkrua dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit midis ERE dhe ZRRE për njohjen reciproke të licensave midis të dy vendeve.

Në Sektorin e Gazit Natyror, përgjatë vitit 2021 ka vijuar puna për miratimin e akteve rregullatore në këtë sektor. Po ashtu duke nisur nga data 15 nëntor 2020 e në vazhdim përgjatë vitit 2021, TAP operon si Operator i Pavarur i Sistemit të Transmetimit (OST) me të drejta të plota.

Viti 2021 shënon edhe fillimin e periudhës së përjashtimit 25-vjeçar nga aksesi i palëve të treta, rregullimi i tarifës dhe veçimi i pronësisë, që i është dhënë TAP nga Komisioni Europian dhe nga Autoriteti Rregullator Shqiptar – ERE së bashku me Autoritetet Rregullatore Greke dhe Italiane (respektivisht RAE dhe ARERA).

Që nga fillimi i vendosjes në funksion më datë 15 nëntor 2020, falë bashkëpunimit të fortë ndërmjet Dispeçerimit Komercial dhe Fizik, nominimet e transportuesve për gazsjellësin TAP janë përpunuar menjëherë dhe dërgesat e gazit janë sjellë me sukses deri në pikat e interkonjeksionit me sistemin e transmetimit kombëtar në Itali dhe Greqi, deri tani (rrjetet SRG dhe DESFA).

Si rrjedhojë, TAP ka transportuar rreth 8 miliardë m^3 gaz nga kufiri Grek-Turk në Kipoi, ku 6.8 miliardë m^3 gaz janë transportuar në Itali përmes Shqipërisë dhe 1.2 miliardë m^3 gaz të cilat furnizohen në Greqi.

Në datën 6 korrik 2021, TAP AG, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri dhe Albgaz sh.a. nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Dorëzimi për Objektin e Seksionit Jugor në Fier. Sipas marrëveshjes, pasi të përfundojë Objekti në Seksionin Jugor në Fier, ai do t'i dorëzohet Shtetit Shqiptar dhe do të zotërohet, menaxhohet dhe do të vendoset në funksion nga Qeveria Shqiptare.

Në të njëjtën kohë ka filluar Testimi i Tregut për zgjerimin e kapacitetit. Ky mekanizëm synon zgjerimin dhe për t'i dhënë mundësinë çdo pale të interesuar për të paraqitur një kërkesë për lidhje me gazsjellësin TAP duke përfshirë edhe territorin e Shqipërisë. TAP-i ka organizuar Testimin e parë të Tregut në korrik 2019 dhe ka filluar një tjetër Testim Tregu në korrik 2021.

Në vijim të testimit të tregut të vitit 2021, gjatë fazës jo detyruese të shprehjes së interesit, TAP-i ka marrë një interes të konsiderueshëm me kërkesa për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri. Përgjatë vitit

2021 me vendimin nr. 198, datë 01.10.2021, Bordi i ERE-s dha opinion pozitiv mbi kërkesën e subjektit GEK TERNA GROUP për lidhjen në rrjetin e TAP në Shqipëri si dhe me vendimin nr. 212, datë 08.10.2021, ka vendosur dhënien e opinionit pozitiv mbi kërkesën e subjektit DEPA COMMERCIAL S.A.

Pavarësisht arritjeve dhe performancës së sektorit të energjisë përfshirë sektorin e gazit natyror për vitin 2021 dhe në planin e përgatitjes së legjislacionit sekondar dhe rregullator, vlen të theksohet se ndër fushat të cilat do të jenë objektiv kryesor i punës së ERE-s për vitin në vijim është rishikimi dhe miratimi i akteve rregullatore për t'i paraprirë zhvillimit të tregut të energjisë në vendin tonë. Për këtë qëllim ERE me vendimin nr. 74, datë 12.03.2021 ka miratuar Objektivat Strategjike për periudhën 2021-2023.

ECURIA E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE TË ERE-S PËR PERIUDHËN 2021 E NË VIJIM, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE TË ERE-S PËR PERIUDHËN 2021 – 2023 SI DHE MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË ERE-S TË RISHIKUAR PËR VITIN 2022 - 2023

Me vendimin e Bordit nr. 74, datë 12.03.2021 u miratuan Objektivat Strategjike të ERE-s për vitet 2021-2023. Ky dokument i rëndësishëm vendos objektiva strategjikë të cilat ERE synon të realizojë në 3 (tre) vjeçarin në vijim, me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore sipas kompetencës që ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ligji nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe ligji nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", përcakton. Ndër të tjera është vendosur miratimi i kalendarit të masave për zbatimin e Objektivave Strategjike të ERE-s për periudhën 2021 – 2023.

Ky kalendar i masave do të jetë objekt vlerësimi dhe rishikimi jo më vonë se data 30 janar i çdo viti kalendarik, deri në implementimin e plotë të tij.

Objektivat Strategjike dhe masat respektive të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 74, datë 12.03.2021 përfshijnë:

Mbrojtja e konsumatorëve përmes ndërgjegjësimit;

Ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe transparenca në vlerësim të shërbimit;

Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë;

Ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe transparencë për vlerësim të shërbimit;

Zhvillimi i tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror gjithnjë e më efikas dhe të integruar;

Integrimi rajonal;

Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proçeseve të tregut;

Racionalizimi dhe thjeshtimi i rrjedhës të informacionit për të vlerësuar funksionimin e proçeseve të tregut;

Realizimi i bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë;

Transparenca dhe integriteti në veprimitarinë administrative;

Promovimi i zvogëlimit të barrierave rregullatore dhe shkurtimi i kohës së proçedurave rregullatore;

Promovimi i rregullave në përputhje me zhvillimin e kuadrit ligjor të Komunitetit të Energjisë dhe në vlerësim të specifikave të sistemit energjitik në vendin tonë.

1. **Realizimi i rubrikës informative mbi ofertat e tregut të furnizimit me energji elektrike (price comparison tool).**

Gjatë vitit 2021 është negociuar me konsulencën e angazhuar nga USAID/NARUC për realizimin dhe implementimin e platformës në të cilën të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit që do të ushtrojnë këtë aktivitet për furnizimin e klientëve në treg të lirë, do t'iu mundësohet të hedhin të dhëna në lidhje me çmimin e ofruar për furnizimin me energji elektrike në treg të lirë. Në këtë kuadër sipas rekomandimeve të bëra nga konsulenti i USAID është përshtatur dhe faqja elektronike e ERE-s për të mundësuar zhvillimin e platformës së PCT.

Gjatë vitit 2022 do të vijojë puna me qëllim realizimin e platformës dhe adresimin nëpërmjet një rregulloreje mbi modalitetet e aksesit në platformë me qëllim hedhjen e të dhënave nga furnizuesit në kohë reale.

2. **Përgatitja e broshurave informative për konsumatorin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve të energjisë**

Gjatë vitit 2021 janë përgatitur dhe miratuar në Bord rreth 30 broshura informative për konsumatorin. Broshurat janë publikuar në faqen zyrtare të ERE www.ere.gov.al, janë shpërndare në rrjetet sociale të ERE si Facebook, Instagram dhe Linked-in, janë përcjellë në format elektronik në shoqatat e konsumatorit si dhe janë printuar për të qënë të disponueshme për konsumatorët që paraqesin anekesa në ERE.

3. **Komunikimi me MIE-n për hartimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit**

ERE ka vijuar komunikimin me MIE-n nëpërmjet të cilit ka kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e procesit të miratimit të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit.

4. **Ndjekja e nivelit të interesit në vend, mbi vetëprodhimin e energjisë**

Në lidhje me këtë detyrë EREka zhvilluar disa korrespondenca me OSSH sh.a. me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme në lidhje me integrimin e kësaj kategorie prodhuesish në tregun e energjisë elektrike. ERE me qëllim analizimin e të dhënave që lidhen me interesin apo edhe impaktin që kjo kategori prodhuesish të energjisë elektrike kanë në Shqipëri, ka kërkuar informacion nga OSSH sh.a. në lidhje me numrin e kërkesave të klientëve të cilët kanë aplikuar për lidhje të re në cilësinë e vetëprodhuesve të energjisë elektrike të cilët mund të instalojnë një kapacitet total deri në 500 kWp nga dielli në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", numrin e klientëve aplikues që e kanë këtë status aktualisht, si dhe sasinë mesatare dhe atë totale të energjisë të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish.

Ka vijuar komunikimi me OSSH sh.a. duke i kërkuar informacion të detajuar për saktësimin e sasisë së energjisë së prodhuar në bazë mujore nga secili vetëprodhues, krahasuar me konsumin mujor të secilit referuar të dhënave të matjes së OSSH sh.a. Aktualisht po vijohet me përpunimin e të dhënave të përcjella nga komunikimet me OSSH sh.a.

Përvec sa më sipër, ERE ka patur komunikim edhe me shoqëritë tregëtare që ushtrojnë aktivitetin e importit dhe instalimit të paisjeve fotovoltaike të cilëve u ka dhënë shpjegimet e nevojshme në lidhje me mënyrën e veprimit sa i përket kuadrit ekzistues ligjor dhe nevojës për plotësimin e tij me metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetë prodhuesit.

5. **Komunikim publik mbi interesin për teknologjinë e makinave elektrike**

Me qëllim përmbushjen e kësaj detyre nga ERE është vendosur vijimi i komunikimit me këto subjekte të identifikuara si palë interesi siç janë: (i) Bashkia Tiranë (ii) OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., (iii)

shoqëria Lux Taksi, (iv) Shoqata e Bashkive, (v) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, (vi) ZRRE, (vii) Agjencia për Eficiencën e Energjisë ku ndër të tjera është kërkuar informacion në lidhje me zhvillimet në këtë fushë apo nëse ka iniciativa, me qëllim mbështetjen e përdorimit të teknologjive të reja, për makinat elektrike, Numrin aktual të njësive të karikimit elektrik të automjeteve, të ngritura nga ana e bashkisë; Modalitetet e sigurimit të këtij shërbimi si dhe faturimit për subjektet publike apo private; Të dhëna në lidhje me numrin e subjekteve (publike apo private) që përdorin këtë lloj teknologjie, nëse i disponojnë: Planet e zhvillimit të këtyre njësive në të ardhmen.

6. Trajnimi i stafit të ERE-s mbi këtë teknologji të re

Nga ana e specialistëve të ERE-s janë ndjekur trajnime me qëllim kualifikimin e stafit dhe njohjen me praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Po ashtu me urdhrin nr. 75, datë 09.11.2021 të Kryetarit të ERE-s është ngritur grupi i punës për vlerësimin e kuadrit rregullator dhe ligjor me qëllim përdorimin e teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike, përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbimi.

7. Studim i legjislacionit ndërkombëtar për politikat e ngjashme rregullatore në vendet e rajonit e me gjerë

Nga ERE është punuar në thellimin e njohurive sa i përket politikave të ngjashme rregullatore në vendet e Bashkimit Europian si dhe adresimit të incentivave sensibilizuese për konsuamtorin sa i përket përdorimit eficient të energjisë brenda kuadrit ligjor aktual, por edhe nëpërmjet adresimit në institucionet e kompetencës të propozimeve konkrete që do të adresojnë iniciativa të tilla nga ERE-s. Kështu janë studiuar praktikat më të mira në këtë fushë, të ndjekura veçanërisht nga rregullatorë si ai i Italisë.

Politika e përdorimit racional të energjisë dhe e përdorimit racional të lëndëve të para energjitike përcakton një sërë veprimesh organike që synojnë nxitjen e kursimit të energjisë, përdorimin e duhur të burimeve të energjisë, përfshirë ato konvencionale, përmirësimin e proçeseve teknologjike që përdorin energjinë, zhvillimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, deri te zëvendësimi i lëndëve të para të energjisë së importuar.

8. Komunikim me insitucionet përgjegjëse për eficiencën

ERE ka komunikuar me Agjencinë e Efiçencës me ftesën për bashkëpunim dhe vendosjen e urave të komunikimit midis dy institucioneve, me qëllim adresimin më të shpejtë e eficient të çështjeve të interesit për konsumatorin apo informimin e tyre në lidhje me synimin tonë të përbashkët, mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe përdorimin eficient të energjisë ç'ka përkthehet në më pak kosto për vetë konsumatorin.

9. Sensibilizimi i konsumatorit mbi përdorimin eficient të energjisë elektrike

Në lidhje me këtë objektiv, strukturat përgjegjëse do të duhet të sigurojnë një panoramë më të qartë të adresimit të kësaj praktike nga vendet fqinje, siç parashikuar në detyrën 8 të kësaj pike, e më tej të ndërmarrin fushatat e nevojshme sensibilizuese.

10. Vënia në funksion e numrit të gjelbër për informimin e konsumatorit

ERE ka vendosur gjatë vitit 2021 në funksion të dedikuar të konsumatorit numrin telefonik 0684023016. Nëpërmjet këtij numri vendoset rregullisht komunikimi me konsumatorët për t'i njoftuar në lidhje me pyetje që kanë mbi statusin e ankesës së tyre, por edhe njoftohen rast pas rasti konsumatorët të cilët për shkak të depozitimit të të dhënave të adresës jo të saktë si në FSHU sh.a., ashtu edhe në ERE të cilët e mund ta kenë të pamundur të marrin dijeni në lidhje me ecurinë e ankesës së tyre.

11. Organizim trajnimi nga ERE për grupet e interesit me objekt "Informimin mbi të drejtat e konsumatorit"

Gjatë vitit 2021, ERE ka prezantuar për shoqatën "Qendra e Konsuamtorit Shqiptar", kuadrin ligjor rregullator të sektorit të energjisë elektrike, të drejtat e detyrimet që burojnë nga ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si për operatorët e tregut ashtu edhe për konsumatorët.

Me qëllim përmbushjen e sa më sipër, ERE ka miratuar nënshkrimin e disa memorandume bashkëpunimi me Universitete si: Fakulteti i Drejtësisë, Albania University, Epoka University, Aleksander Moisiu Durrës, Universiteti i Inxhinierisë, Fakulteti i Ekonomisë, etj.

Ndër të tjera për implementimin e këtyre marrëveshjeve është parashikuar edhe organizimi i takimeve me studentët e këtyre fakulteteve me qëllim prezantimin e kuadrit ligjor rregullator të ERE-s si dhe të drejtat e detyrimet që burojnë nga ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si për operatorët e tregut ashtu edhe për konsumatorët.

12. Konsultë me Ministritë përgjegjëse dhe propozime konkrete për përcaktimin e kritereve për marrjen e statusit të klientit në nevojë

Në lidhje me sa më sipër është kërkuar informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, mbi ecurinë e punës për hartimin dhe miratimin e kritereve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 97.1 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar si dhe nenit 95 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshsuar. Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është bërë me dije se janë në pritje të përgatitjes dhe draftimit fillestar të projekt-aktit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me urdhërin nr. 97 datë 15.12.2021, në EREështë ngritur grupi i punës me qëllim përgatitjen e vlerësimit lidhur me praktikat më të mira rregullatore për mbrojtjen e klientëve në nevojë sipas praktikave të vendeve të BE-së.

13. Mbikqyrjen e shërbimit të FSHU-së për kushtet e ndërprerjes për klientët në nevojë

Gjatë vitit 2021 ERE ka kërkuar nga ana e FSHU sh.a. informacion në lidhje me evidentimin e rasteve të ankimimit të "klientëve në nevojë" për rastet kur nuk janë respektuar kushtet e përcaktuara në rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 246, datë 11.12.2018 nga ana e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe informacion të detajuar lidhur me regjistrin e të dhënave të "klientëve në nevojë", apo procedurat e ndjekura per çrregjistrimin e klientëve në nevojë të energjisë elektrike si dhe të dhëna krahasimore e statistikore të këtij rregjistri gjatë 2 viteve 2019-2020 dhe kemi rekomanduar që të mbahet regjistri i përditësuar i klientëve që marrin ndihmë ekonomike sipas parashikimeve të rregullores së ERE-s miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 246/2018 "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë".

14. Përgatitjen e takimeve informative me përfaqësues të shoqatave për mbrojtjen e kategorisë së konsumatorëve në nevojë, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet

Në kushtet e përhapjes së pandemisë Covid – 19, ERE ka përcjellë pranë shoqatave për mbrojtjen e konsumatorit si dhe në shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuar broshurat informative mbi të drejtat e konsumatoritdhe veçanërisht atyre në nevojë për furnizimin me energji elektrike pranë këtyre strukturave.

Së bashku me broshurat e printuara për këtë qëllim u është dërguar edhe linku i faqjes zyrtare të ERE-s në të cilin mund të aksesohen informacionet në lidhje me çështje interesi për konsuamtorin.

15. Krijimi i portaleve të furnizuesve në treg të lirë për promovimin e aktiviteveteve të tyre si dhe njohjen e konsumatorit me të drejtat dhe detyrimet e tyre si klient të tregut të lirë

Me qëllim përmbushjen e kësaj detyre ERE është duke vlerësuar nëse faqja elektronike e krijuar prej saj së fundmi mund të garantojë promovimin e aktiviteteve të tyre si dhe njohjen e konsumatorit me të drejtat dhe detyrimet e tyre si klient të tregut të lirë dhe nëse jo është duke marrë informacion në lidhje mundësitë dhe specifikimet që duhen për ndërtimin e këtij portali si derivat i faqes elektronike të ERE-s. Duhet mbajtur në konsideratë që ndërtimi i një platforme të tillë kërkon masa të larta sigurie sa i përket cybersecurity duke patur parasysh të dhënat sensitive e ato personale që do të ngarkohen në këtë platformë, ndaj është e rëndësishme që ky proçes të mos jetë i nxituar me qëllim që të garantojë në përputhje me standartet kombëtare dhe ato ndërkombëtare bazën e të dhënave që do të ruajë.

16. Azhornimi periodik i statusit të ankesave të konsumatorit të adresuara nga ERE për ndjekjen e tyre dhe ankesës nëpërmjet faqjes së ERE-s (me kod aksesi unik)

Përditësimi i regjistrit të ankesave sipas Programit të Transparencës është kryer brenda 24 orëve nga regjistrimi i ankesave të reja apo marrja e përgjigjes nga ana e të licencuarve me qëllim gjurmimin e ankesës në kohë sa më të shkurtër nga ana e konsumatorëve. Informacioni në lidhje me ankesat përditësohet (dhe në rrjetet sociale) në mënyrë periodike. Vlen për t'u theksuar se databasa e mësipërme, shërben aktualisht si një portal bazik i cili gjeneron mjaftueshëm të dhëna për konsumatorët të cilët parqesin një ankesë në ERE me qëllim gjurmimin e statusit të ankesës. Në të hidhen të dhëna të rifreskuara në lidhje me trajtimin nga ERE të ankesës, si numrin e protokollit e datën e shkresës së adresuar nga ERE, statusin e përgjigjes së të licencuarit në lidhje me ankesën si dhe statusin e kërkesës sa i përket pranimit apo refuzimit të saj nga ana e të licencuarit mbështetur në provat dokumentare të gjeneruara, apo edhe statusin e pranimit apo rrëzimit të kërkesës në rastet kur është ERE që i jep zgjidhjen apo rekomandimin për zgjidhje të licencuarit ndaj të cilit është ushtruar ankim.

17. Përcaktimi i standardeve të cilësisë së shërbimit

- Me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020 mbi propozimin e OST sh.a., për treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021, Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit.

- Me vendim nr. 97, datë 07.04.2021 i cili mbetet në fuqi dhe për vitin 2022, mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021, Bordi i ERE-s ka vendosur: të miratojë treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes.

- Me vendim nr. 244, datë 02.12.2021 mbi propozimin e OST sh.a., për treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022, Bordi i ERE-s ka vendosur miratimin e treguesve të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike.

18. Monitorime për FSHU dhe furnizuesit në treg të lirë

Përgjatë vitit 2021 në varësi edhe të kushteve të krijuara nga gjendja e pandemisë COVID-19, janë ushtruar monitorime dhe komunikime nga raportimet e operatorëve dhe pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike përfshirë edhe furnizuesit e energjisë elektrike. Po ashtu janë ushtruar monitorime në terren me objekte specifike sipas urdhërave përkatës, përmendim këtu monitorimet, "Për Monitorimin e Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a,"; "Mbi Monitorimin e Veprimtarisë së Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a në lidhje me raportimet periodike si dhe mbikëqyerjen e zbatimit të detyrave që rrjedhin për të licencuarit sipas vendimit të Bordit nr. 201/2008, rishikuar me vendimin nr. 217/2020 "Mbi rishikimin e planit të masave për OSHEE sh.a. për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike"; "Për Monitorimin nga data 24.11.2021-10.12.2021 të shoqërive Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHU sh.a, dhe Furnizuesi

i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., në lidhje me përcaktimin e çmimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit nga FSHU në përputhje me Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, si dhe procedurën e blerjes së energjisë elektrike nga FTL sh.a. sipas kërkesës së FSHU – së, me qëllim mbulimin e nevojave të klientëve që furnizohen nga FMF". Të dhënat e marra nga këto monitorime po analizohen dhe gjetjet respektive që do të shqyrtohen dhe do të bëhen të ditura në vijim.

19. Analizë e plotë e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjive të tarifave të Shpërndarjes dhe Transmetimit të energjisë elektrike dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim në bashkëpunim me insitucionet ndërkombëtare

Në lidhje me këtë pikë, ERE ka kërkuar asistencë teknike nga Banka Botërore lidhur me rishikimin e Metodologjive të llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpëndarjes dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, të cilat duhet të vlerësoheshin njëkohësisht në një afat kohor 3 (tre) mujor në mënyrë që procesi të ishte gjithëpërfshirës me të gjitha palët e interesit siç dhe evidentuar në kërkesën e hartuar. Ky proces u realizua vetëm për Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Shpërndarjes me asistencën e Bankës Botërore dhe në bashkëpunim me MIE-n, si dhe u fokusua në analizën e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjisë së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes i cili u diskutua gjerësisht me MIE-n, OSSH-në, konsulentët e ngarkuar nga Banka Botërore, por edhe me RIO (Reform Implementation Office) e Expertise France në kuadër të axhendës së miratuar lidhur me reformën në sektorin e energjisë elektrike me qëllim rishikimin e metodologjisë në fjalë.

Më tej, në kuadër të mbështetjes nga Agjensia Franceze për Zhvillim (AfD) dhe miratimit të planit të punës së paraqitur nga Expertise France, u planifikua zhvillimi i një takim pune 2-ditore e stafit të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE).

Qëllimi i këtij takimi pune ndër të tjera ishte dhe rritja e kapaciteteve dhe shkëmbimit të eksperiencave në kuadër të procesit të shqyrtimit të aplikimeve për tarifë nga ana e ERE-s si dhe metodat e procedurat e ndjekura prej Rregullatorit të Kosovës për vlerësimin e tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në këtë kuadër do vijojë bashkëpunimi ndërmjet dy rregullatorëve përgjatë vendimmarrjes për aplikimet e tarifave për të cilat nevojitet vendimmarrja e ERE-s.

20. Monitorimi i zhvillimit të vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator të tregut rajonal

Nëpërmjet takimeve të përbashkëta të Shoqatës së Regullatorëve të Mesdheut (MEDREG), Bashkimi i tregjeve të Shqipërisë, Italisë, Malit të Zi dhe Serbisë (AIMS) apo dhe Grupeve të punës së ECRB-së janë marrë informacione lidhur me zhvillimet në tregjet rajonale dhe inisiativat për bashkimin e tregjeve siç janë ajo midis Maqedonisë së veriut dhe Bullgarisë, Serbisë dhe Rumanisë, Sllovakisë, Hungarisë dhe Çekisëe (projekti 4MMC) apo dhe iniciativa të tjera rajonale që lidhen me krijimin e bursave si ajo e Malit të Zi apo dhe e Maqedonisë së Veriut.

21. Miratimi i proçedurave të përbashkëta dhe efikase të vendimmarrjes që do të ndihmojë në krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë

ERE ka marrë pjesë në takimet e përbashkëta të grupeve të punës me përbërjen e Rregullatoreve, Ministrive dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për përgatitjen e kuadrit ligjor, regullator dhe teknik për krijimin e tregjeve të përbashkëta. Në vijim të këtyre diskutimeve u përpiluan draft marrëveshjet që u finalizuan në muajin Tetor dhe Dhjetor të vitit 2021 midis palëve.

22. Përpilimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve midis OST-ve dhe Rregullatorëve për implementimin e bashkimit të tregjeve

Në datën 21.10.2021 në Tiranë u nënshkrua marrëveshja kuadër midis Enteve Regullatore të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit midis dy vendeve e cila vendosi bazat për krijimin e tregut të përbashkët.

Me ndihmën e USAID-it u zhvillua në Prishtinë me pjesëmarrjen dhe promovimin e të dy rregullatoreve dhe aktoreve të tjerë të tregut, një seminar mbi efikasitetin e integrimit të tregjeve të energjisë elektrike të të dy vendeve si dhe masat që janë marrë dhe sfidat që do të lindin në vijim në këtë drejtim.

Në datën 07.12.2021, ERE dhe ZRRE nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave në veprimtarinë e tregëtimit dhe furnizimit, mes Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë Memorandum të dy rregullatorët dakordësuan mbi njohjen reciproke të licencave të tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, fakt i cili do të ulë kostot administrative dhe financiare të të licencuarve në të dy vendet për të operuar në të dy tregjet dhe do t'i hapë rrugë lehtësimeve në operimin e një tregu të përbashkët.

23. Kontrolli dhe azhornimi i legjislacionit në fuqi nëse ka pengesa ligjore në procesin e bashkimit të tregut

Sa i përket Kontrollit dhe azhornimit të legjislacionit në fuqi nëse ka pengesa ligjore në proçesin e bashkimit të tregut, përfaqësues të ERE-s janë anëtarë të grupeve të përbashkëta të punës të ngritura me pjesëmarrje të rregullatorëve dhe OST-ve të Shqipërisë dhe Kosovës dhe gjatë vitit 2021 janë angazhuar në proçesin e diskutimit në këto grupe me qëllim evidentimin e pengesave që mund të paraqesë kuadri nënligjor ekzistues, punë e cila do tëvijojë dhe përgjatë vitit 2022.

24. Përditësimi i kuadrit ligjor, sa i përket identifikimit të ndryshimeve të nevojshme në rregulloret dhe proçedurat e licencimit për njohjen reciproke të licencave

Në lidhje me përditësimin e kuadrit ligjor, sa i përket identifikimit të ndryshimeve të nevojshme në rregulloret dhe proçedurat e licencimit për njohjen reciproke të licencave në vijim të sa adresuar dhe miratuar me ndryshimet e regullores së licencimit me vendimin e bordit të ERE-s nr. 215, datë 20.12.2019, ka vijuar puna edhe me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në datë 07.12.2021, për njohjen reciproke të licencave të tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, në kuadër të implementimit të një tregu të përbashkët rajonal dhe të harmonizimit të legjislacionit të përbashkët midis dy vende.

25. Nomonimin e NEMO-s së përbashkët me Kosovën

ERE ka marrë pjesë në grupet e punës në projektin KEP/AIMS për krijimin e tregut të përbashkët midis Shqipërisë, Italisë, Malit të Zi dhe Serbisë.

Në po këtë prizëm njohja e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në komitetet e bursave të vendeve të BE-së lidhet me bërjen operacionale të Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) që do krijonte kushtet për përmbushjen e plotë të kësaj detyre; bursë e cila do të aplikonte për njohjen si operator i tregut në Shqipëri dhe Kosovë.

Aktualisht sipas informacioneve të përcjella, nga ana e ALPEX ka përfunduar tenderi dhe është përzgjedhur ofruesi i shërbimit të operimit të bursës. Fillimi i operimit të bursës pritet të jetë gjatë tre mujorit të fundit të vitit 2022.

26. Analizimi i nivelit të implementimit të Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët si dhe shtrirja e saj edhe në sektorin e gazit natyror

Raportimet periodike të infrastrukturave kritike për Cybersecurity nga ana e kompanive pjesë e rregullores dhe në bashkëpunim dhe me USAID/NARUC i cili aktualisht ka angazhuar asistencë

teknike për ERE-n lidhur me këtë rregullore po punohet mbi përpunimin e të dhënave apo dhe mundësinë e përmirësimeve në Rregullore sipas eksperiencës së krijuar.

Po në këtë kuadër është e rëndësishme të theksohet se dhe gjatë takimeve me USAID është vendosur theksi në marrjen e masave të rregullatorëve përveç analizimit dhe mbikqyrjes së të licencuarve dhe mbajtja e standardeve të Cybersecurity për vetë Rregullatorin. Gjatë vitit 2022 do të punohet për hartimin e një rregulloreje të brendshme dhe parashikimin në buxhet të realizimit të një testi për Cybersecurity në sistemin IT të ERE-s.

Termat tona të Referencës (TOR) rreth cybersecurity u përzgjodhën nga NARUC për raundin e parë të asistencës teknike afatshkurtër për sigurinë kibernetike. NARUC synon të mbështesë ERE-n në lidhje me vlerësimet rregullatore të përgatitjes së infrastrukturave kritike duke patur si synim në përfundim këto dokumenta si më poshtë:

- Udhëzues të personalizuar për të vlerësuar investimet kibernetike duke përdorur rezultatet e një modeli maturimi.
- Modeli i personalizuar i vlerësimit të rrezikut dhe udhëzimi.
- Axhendë e personalizuar dhe Planifikim për përditësime të vazhdueshme të proceseve dhe raportimit të incidenteve.

Nëpërmjet Asistencës Teknike që do të ofrohet nga USAID-i, stafi i ERE-s do të marrë eksperiencë dhe do të jetë më i aftë për të vlerësuar planet e gatishmërisë kibernetike të paraqitura nga shoqëritë dhe më i përgatitur për të monitoruar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit elektroenergjitik shqiptar për të avancuar me praktikat më të mira të sigurisë kibernetike, gjë e cila do të mundësojë monitorimin efektiv të mbrojtjes të infrastrukturës kritike të rrjetit elektrik.

ERE ka marrë pjesë në grupet e punës të ngritura nga ECRB në të cilat janë diskutuar problematikat e hasura nga implementimi i Regullores së Sigurisë Kibernetike në vendet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe vendet e Detit të Zi.

ERE ka vijuar komunikimin me NARUC lidhur me implementimin e plotë të rregullores për sigurinë kibernetike dhe Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë.

Janë plotësuar pyetësorët e dërguar nga NARUC në të cilët është evidentuar dhe realizimi një seminari me përfshirje të gjerë të ERE-sdhe operatorëve që zotërojnë infrastruktura kritike siç janë OST sh.a. OSSH sh.a. dhe KESH sh.a.

Seminari me pjesëmarrësit e tregut dhe përfaqësues të NARUC është parashikuar të realizohet në tre mujorin e parë të vitit 2022.

27. Realizimi i procesit të konsultimit të draftit të Rregullave për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT)

Përsa i takon zbatimit të rregullores së REMIT-it është ERE ka marrë pjesë aktive në grupet e punës së Sekretatriatit të Komunitetit të Energjisë si dhe në trajnimet e përbashkëta midis Sekretariatit dhe ERRA-s lidhur me zbatimin e rregullores dhe detyrat që i lindin palëve përfshirë këtu dhe ERE-n për zbatimin e saj si dhe në shkollat rregullatore të organizuara po nga Sekretariati lidhur me këtë tematikë. Po ashtu është menduar që me ndihmën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të zhvillohet një seminar me pjesëtarët e tregut për të shkëmbyer eksperienca dhe për të shpjeguar mënyrën e funksionimit të Rregullores dhe detyrat e palëve që lindin gjatë zbatimit të saj.

28. Monitorimi i sjelljes së operatorëve të tregut, veçanërisht në zbatimin e Rregullores Evropiane për Transparencën në tregun me shumicë të energjisë REMIT

Në fund të vitit 2021, është zhvilluar një trajnim i gjerë me përfaqësuesit e Rregullatorit Francez si pjesë e programit të bashkëpunimit me Agjencinë Franceze të Zhvillimit, gjatë të cilit u shkëmbyen

eksperienca me përfaqësuesit e rregullatorit Francez lidhur me masat e marra për monotorimin e tregut, kushtet që duhet të plotësojnë të licencuarit apo dhe mënyrat e investigimit në tregun vendas dhe në tregjet e përbashkëta. Në përfundim të trajnimit nga përfaqësues të Regullatorit të Francës u përpilua një raport i cili do t'iu shërbejë specialistëve të ERE-s në vijim për përmirësimin e punës në drejtim të monitorimit të tregut.

29. Analizimi i të dhënave lidhur me detyrimet e raportimit, metodat dhe kohën e vënies së tyre në dispozicion, përdorimi i të dhënave për palët e interesuara dhe në veçanti për pjesëmarrësit e tregut

Në këtë kuadër është e domosdoshme dhe do shihet mundësia e automatizimit nëpërmjet platformave online nga faqja e internetit të ERE-s ose link-u i saj ku pjesëmarrësit e tregut mund të plotësojnë formularët e regjistrimit në REMIT apo dhe të hedhin të dhënat e nevojshme për zbatimin e rregullores apo dhe të dhëna të tjera të cilat nevojiten për raportimet periodike që kryen në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen ngushtësisht me monitorimin e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Për realizimin e këtij funksioni është e nevojshme përshtatja e faqes së internetit të ERE-s apo dhe krijimi i një databaze për monitorimin e tregut. Përgjatë vitit 2022 do të shihet mundësia e financimit të tij nëpërmjet buxhetit të ERE-s.

30. Identifikimi i pjesëve të Rregullores për Alokimin dhe Menaxhimin e Konxhestioneve (CACM) që mund të transpozohen në kornizën ligjore aktuale

ERE ka marrë pjesë aktive në takimet e grupeve të punës (ligjore) të ngritura ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për identifikimin e pengesave ligjore për të mundësuar bashkimin e tregjeve midis dy vendeve tona. Në kuadër të projektit AIMS për bashkimin e tregjeve të Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Italisë, ERE ka marrë pjesë në grupet e punës të krijuara dhe pritet që gjatë vitit 2022 të vijohet me konsultimet për transpozimet në rregulloret kombëtare.

31. Përfshirja e palëve të interesuara në përcaktimin e strategjive dhe politikave rregullatore

ERE ka identifikuar disa akademikë ekspertë në përputhje dhe me Memorandumet e nënshkruara me Universitetet të cilat do të shërbejnë si një stukturë konsultative për t'u përdorur përgjatë përpilimit dhe miratimit të rregulloreve dhe akteve nga ERE sipas fushave të ekspertizës së tyre.

ERE është përpjekur të identifikojë një numër gjithmonë e më të madh të palëve të inteteresit, duke u fokusuar kryesisht në shoqatat për mbrojtjen e konsumatorit, me qëllim përfshirjen sa më të gjerë të tyre në praktikat vendimmarrëse të ERE-s që që kanë impakt për konsumatorin.

32. Publikimi i vendimeve, relacioneve të akteve dhe aplikimeve

Sa i përket publikimit të vendimeve, relacioneve të akteve dhe aplikimeve që janë paraqitur në ERE gjatë vitit 2021, ashtu si edhe më herët puna ka vijuar me publikimin e vendimeve të ERE-s në Fletoren Zyrtare, si një kërkesë ligjoresi dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të internetit të ERE-s www.ere.gov.al. Gjithashtu është vijuar me publikimin e njoftimit në mediat e shkruara të të gjitha aplikimeve për licenca në ERE. Sa i përket aplikimeve për Tarifa, ato janë publikuar në faqen zyrtare të ERE-s të plota, së bashku me çdo informacion shtesë që është paraqitur nga aplikuesit për qëllim të këtyre praktikave. Sa i përket publikimit të Relacioneve ato janë duke iu nënshtruar një procesi verifikimi nga ERE, lidhur me përmbajtjen e të dhënave konfidenciale, personale apo tregëtare me qëllim plotësimin e kritereve ligjore të parashikuara në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

33. Identifikimi i ndryshimeve të nevojshme në rregulloret dhe procedurat e licencimit për njohjen reciproke të licencave

Sa i përket Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e Licencave në sektorin e energjisë elektrike (miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.

109, datë 29.06.2016, e ndryshuar), me vendimin nr. 138, datë 07.06.2021 Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për rishikimin e saj.

Ndryshimet e propozuara në këtë akt janë të nevojshme në kuadër të përmirësimit të saj, si dhe janë bërë unifikime pagesash në Aneksin A të Rregullores për disa nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, duke u bazuar në faktin që procedura dhe volumi i dokumentacionit që shqyrtohet deri në miratimin e licencimit është e njëjtë.

ERE është anëtare dhe pjesëmarrëse aktive në takimet e grupeve të punës të organizuara nga MedReg dhe ERRA apo dhe trajnimeve të organizuara nga këto organizma për çështje që kanë të bëjnë me sektorin energjitik.

Së fundi, me vendimin nr. 20, datë 04.02.2022, Bordi i ERE-s pasi ka shqyrtuar ecurinë e zbatimit të objektivave strategjikë të ERE-s për vitin 2021, sipas planit të masave për zbatimin e objektivave strategjikë të ERE-s për periudhën 2021 – 2023 është shprehur me vendimin nr. 20/2022 "Për përditësimin e planit të masave për objektivat strategjikë të ERE-s për vitet 2022 – 2023".

MBI REKOMANDIMET E PROGRES RAPORTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Rekomandimet e progres raportit të BE-së për vitin 2021 lidhur me kapitullin 15 "Energjia" janë si më poshtë vijon:

1) Vijimi i diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë elektrike përtej burimeve hidrike dhe ngritja e Bursës Shqiptare të Energjisë dhe tregut të organizuar të energjisë elektrike të ditës në avancë.
2) Finalizimi i ndarjes funksionale së shoqërive publike në sektorin e energjisë elektrike, kompletimi i ndarjes funksionale të kompanive të energjisë, heqja e pengesave ligjore për të drejtën e konsumatorëve për të ndryshuar furnizuesin e tyre të energjisë elektrike dhe sigurimi i aksesit të plotë në tregun e lirë të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët e lidhur në tensionin 20 kV.
3) Implementimi i legjislacionit sekondar lidhur me Direktivën e Performancës Energjitike të Ndërtesave, përshpejtimi i trajnimeve dhe certifikimeve të audituesve dhe menaxherëve të energjisë, miratimi i incentivave dhe mekanizmave financues për eficiencën e energjisë dhe rritja e financimeve të projekteve të eficiencës energjitike.
4) Miratimi i Planit Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2020-2030 dhe krijimi i një Agjencie të energjisë plotësisht funksionale, në përputhje me ambiciet e PKEK, duke mbuluar burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë, e pajisur me stafin e duhur dhe me burime buxhetore.

Lidhur me sa parashtruar në këto rekomandime, bëjmë me dije se ERE gjatë vitit 2021 ka miratuar fillimin e proçedurave për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Nga komunikimet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka rezultuar se për vitin 2021 ka marrë miratimin përfundimtar vetëm 1 (një) subjekt, i autorizuar për ndërtimin e një centrali eolik me kapacitet 2MW, i cili është ftuar të paraqesë dokumentacionin përkatës.

Për rrjedhojë, ERE ka mbyllur procedurën e nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 09.11.2021, për sa i përket përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe është në proçes të finalizimit të përcaktimit të çmimit për nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021 dhe ka filluar proçedurat për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë

elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.

Përsa i përket ngritjes së Bursës Shqiptare të Energjisë, në zbatim të VKM-së nr. 322 datë 15.05.2019 dhe nr. 609 datë 11.09.2019 është përcaktuar struktura dhe kapitali i saj, janë përcaktuar aksionerët dhe pas disa tentativash është mbyllur faza e tenderimit të platformës elektronike si dhe është nënshkruar marrëveshja me Ofruesin e Shërbimit, të cilët në vijim do të ofrojnë Platformën e Tregtimit dhe Shërbimeve për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda të Njëjtës Dite, e nevojshme për operimin e Tregut te Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë. Kalimi në Go-Live i bursës është planifikuar për tre-mujorin e fundit të vitit 2022.

Finalizimi i ndarjes funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrikeështë tashmë një proces i përmbyllur me sukses dhe gjatë vitit 2021. Shoqëritë OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. përgjatë vitit 2021 kanë vijuar të zhvillojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra veprimtarinë përkatëse, sipas licencave që ato mbajnë përkatësisht sipas vendimit nr. 2016/2018 dhe nr. 2015/2018 të ERE-s.

Pikat 3 dhe 4 të rekomandimeve të progres raportit të vitit 2021 për kapitullin 15 "Energjia", nuk lidhen me aktivitetin dhe fushën e veprimtarisë së ERE-s, por me institucione të tjera të cilat veprojnë në sektorin e energjisë.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se aktiviteti i ERE-s gjatë vitit 2021 është zhvilluar në përputhje me rekomandimet e progres raportit të vitit 2021 për Shqipërinë, të miratuar nga Komisioni Evropian.

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1 Situata e Sektorit Elektroenergjitik Shqiptar

Sistemi elektroenergjitik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, tregtimi me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike. Këto veprimtari ushtrohen nga subjekte të licencuara në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar. Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a., dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a. të cilat jan shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, si dhe nga subjektet private të licencuara në këtë aktivitet si: Prodhuesit me Përparësi, Prodhuesit e Pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike.

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore. Në përputhje me nenin 58 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është certifikuar dhe licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria "Operatori i Sistemit te Shpërndarjes" sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, e krijuar si rezultat i ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. dhe është licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë ERE në mbështetje të neneve 16 dhe 72, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka vendosur miratimin e Programit të Pajtueshmërisë të shoqërisë OSSH sh.a.

Më poshtë paraqitet Skema e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar si dhe Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare.

Evidentojmë se si pasojë e vijimit të gjendjes së pandemisë globale COVID-19 edhe përgjatë vitit 2021 është vështirësuar procesi i verifikimit dhe monitorimeve në terren i të dhënave të përdoruara në hartimin e këtij raporti, këto të dhëna janë siguruar nga raportimet periodike të pjesmarrësve të tregut të energjisë dhe të të licencuarve në sektorin e energjisë, por verifikimi dhe monitorimi i tyre mbetet në fokusin e ERE-s përgjatë vitit 2022, në përputhje me udhëzimet përkatëse që lidhen me ecurinë e pandemisë COVID-19 .

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK



Figura 1 Skema e Sistemit Elektroenergjitik (Burimi: ERE)



Figura 2 Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar (Burimi: ERE)

Skema e fluksit të energjisë dhe tregtar në sektorin e energjisë elektrike bazohet në përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar. Duke filluar nga muaji tetor 2021 Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 584,

datë 08.10.2021, vendosi, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", deri në datën 15 prill 2022.

Vendimi për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike ka ardhur si rezultat e një situate të përgjithshme të rritjes së çmimit të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare. Ky vendim i jep qeverisë mundësinë që të ndërhyjë me instrumenta financiare, qoftë edhe me instrumenta të natyrës administrative për përballimin dhe parandalimin e kësaj situate.

1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a. dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a. të cilat janë shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, nga subjektet private të licencuara në këte veprimtari si: Prodhuesit me Përparësi, Prodhuesit e Pavarur dhe Vetëprodhuesit e Energjisë Elektrike, që zhvillojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike bazuar në Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndyshuar dhe Ligjin nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

Aktualisht prodhimi i energjisë elektrike përbëhet nga dy komponentë kryesor: prodhimi që realizohet nga Shoqëritë me kapital shtetëror KESH sh.a. dhe Lanabregas sh.a., si dhe prodhimi që realizohet nga subjektet e tjera Prodhuesit me Përparësi, Prodhuesit e Pavarur dhe vetëprodhuesit e Energjisë Elektrike.

KESH sh.a është shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri, me kapital tërësisht shtetëror. KESH sh.a. bazuar në VKM-në nr. 244 datë 30.03.2016, e ndryshuar është e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me energji elektrike të Furnizuesit Universal sh.a. dhe mbulimin e një pjese të humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e Shpërndarjes, me shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike me VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021. Për periudhën që mbulon ky vendim parashikohet që shoqëria e prodhimit publik e energjisë për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klienteve në treg të rregulluar kryen procedurat sipas këtij vendimi, për depozitimin dhe shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Bazuar në këtë vendim, tepricë e energjisë së prodhuesit publik është sasia e energjisë që mbetet pas furnizimit të plotë të nevojave të Furnizuesit Universal të Energjisë dhe të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Gjithashtu siç përcakton ky vendim, shoqëria e prodhimit publik e energjisë ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cënon sasitë e nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

Prodhuesit me përparësi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike janë subjekte të licencuara në vite nga ERE që shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të privatizimit, marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të energjisë elekrike. Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 dhjetor 2021 është **2,605** MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2021 prej 97 MW, krahasuar me vitin 2020.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1448 MW dhe përbën rreth 56% të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1157 MW dhe përbën rreth 44% të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

1.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2021

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2021 është **8,962,699** MWh, nga i cili:

- **5 343 974** MWh u prodhua nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a.
- **3 618 725** MWh u prodhua nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2021 nga KESH sh.a. zë 59.6% të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 40.4%.

Për vitin 2020 prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. zë 58% të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 42%.

Sikurse evidentohet për vitin 2021 ka një rritje të kontributit të KESH sh.a. në prodhimin e energjisë elektrike të realizuar me rreth 1.6% krahasuar me vitin 2020.

Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2021 është rreth 2,264 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 8,016,713 MWh.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2021 është rreth 341 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 945,986 MWh.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2021		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2021 (MWh)
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	5,343,974
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	1,425,989
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	48	380	1,246,750
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	129	167	318	905,230
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	12	12	23	40,756
			178	239	2,605	8,962,699

Figura 3 Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2021.

Në figurën më sipër paraqiten të dhëna mbi prodhimin e energjisë elektrike për gjithë kategoritë e prodhuesve të cilët janë në operim.

Në të njetën kohë në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2021, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjisë elektrike të KESH sh.a., si prodhues publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a., ka patur peshën kryesore në prodhimin vendas edhe përgjatë vitit 2021.

PRODHIMI NETO VENDAS 2021 (MWh)	2021
HEC-et / PPE ne rrjetin e OSSH sha	877,726
HEC-et / PPE ne rrjetin e OST sha	951,505
HEC-et e pavarur IPP ne rrjetin e OST sha	1,425,989
HEC Lanabregas	27,504
HEC Ashta	295,245
Centralet Fotovoltaike	40,756
Prodhimi nga HEC-et e KESH sha	5,343,974
TOTAL VENDAS 2021	8,962,699

Burimi OST sh.a.; KESH sh..a; FTL sh.a.



Figura 4 Prodhimi neto vendas për vitin 2021



	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR
Impiante Fotovoltaike	1,754	2,488	3,779	3,708	4,674	4,737	4,844	4,888	3,754	3,024	1,615	1,812
Prodhimi Neto KESH.	648,222	651,567	590,022	521,278	553,158	482,334	492,645	355,192	199,273	201,067	195,849	453,367
HEC Mejdhe	85,215	77,641	60,572	41,383	40,480	13,093	28,487	21,703	21,076	9,270	20,517	45,564
HEC Bunje	37,952	43,734	31,179	27,035	23,482	11,455	14,200	10,858	6,732	5,551	9,387	36,317
HEC Fierza	49,111	39,767	28,039	25,490	17,071	13,227	8,029	6,406	11,050	7,798	5,043	23,973
HEC Peshqesh.	10,063	16,059	12,828	15,694	9,016	3,105	1,083	945	222	52	4,209	16,451
HEC Ashta	36,275	35,478	31,720	28,965	31,404	24,725	23,679	16,911	11,127	11,902	13,549	31,550
Prodhimi Neto Kurum	53,110	51,670	40,597	40,167	44,666	24,747	21,514	13,033	12,524	14,091	10,945	52,061
HEC Lanabregas	3,249	2,958	2,527	2,483	2,707	2,334	2,591	2,154	1,413	1,306	1,404	2,098
Hec-et Private/Kons.rrjeti OST	147,202	137,659	98,116	147,878	130,049	51,266	18,998	7,102	8,574	24,008	36,489	143,303
Hec-et Private/Kons.rrjeti OSHEE	119,778	124,138	103,941	134,026	112,533	40,065	18,549	10,179	10,206	31,195	35,741	127,557
PRODHIMI VENDAS TOTAL	1,150,680	1,181,417	1,011,999	998,906	979,779	680,967	635,339	449,955	285,952	310,942	342,708	934,054

Figura 5 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2021 (MWh)

Figurat më poshtë paraqesin krahasimin e prodhimit mujor neto të energjisë elektrike përgjatë vitit 2021 me mesataren e prodhimit të periudhës 2009 – 2021.



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Mesatar	636,041	628,747	649,980	606,130	621,162	485,867	415,160	381,906	307,359	357,754	403,182	582,348
2021	1,150,680	1,181,417	1,011,999	998,906	979,779	680,967	635,339	449,955	285,952	310,942	342,708	934,034

Figura 6 Prodhimi mujor vendas për vitin 2021 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2021



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
PRODHIMI	5,158,602	7,702,478	4,158,076	4,722,126	6,956,507	4,724,431	5,865,670	7,136,352	4,524,977	8,552,152	5,206,046	5,313,164	8,962,699
MESATAR	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635	6,075,635

Figura 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2021 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezulton se viti 2021 me sasinë e prodhuar prej 8,963 GWh është mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2021. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2021 ka rezultuar 6,076 GWh. Prodhimi i realizuar për vitin 2021 është rreth 2,887 GWh ose 47.5% më i lartë se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2021.

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për vitin 2021 është shënuar në muajin shkurt me sasinë **1,181,417** MWh. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri **57%**, ndërkohë që prodhimi minimal mujor i energjisë elektrike gjatë vitit 2021 rezultoi në muajin shtator në sasinë **285,952** MWh.

Në grafik evidentohet se viti 2021 konsiderohet si një vit i mirë hidrologjik dhe prodhimi i energjisë elektrike për këtë vit ka rezultuar në sasinë **8,963** GWh, pra 2,887 GWh më shumë se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2021. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet e mira hidrologjike ku bën pjesë edhe viti 2021, prodhimi i energjisë elektrike është më i lartë se mesatarja shumëvjeçare në periudhën 2009 – 2021.

Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2020 ka rezultuar në sasinë 5, 313,033 MWh, pra më i ulët se mesatarja shumëvjeçare dhe ndjeshëm më i ulët se prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2021. Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2021 ka rezultuar në sasinë prej 3,830 GWh më shumë se ai i realizuar përgjatë vitit 2020.

1.2.2 Të dhënat teknike kryesore dhe prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2021

Shoqëria publike KESH sh.a. ka në zotërim tre hidrocentralet e kaskadës së Lumit Drin si dhe termocentralin e Vlorës. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a. dhe kapaciteti i instaluar i secilit prej tyre është paraqitur në të dhënat më poshtë ku evidentohet numri i agregateve , kapaciteti i instaluar për çdo agregat dhe fuqia e instaluar për çdo central.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC V.Dejës	TEC Vlorë
Nr. Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70 + 28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	1,448			

Figura 8 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Kapaciteti total i instaluar në zotërim nga KESH sh.a., arrin në 1,448 MW, nga të cilat kapaciteti i instaluar i HEC-ve në kaskadën e lumit Drin është 1,350 MW dhe e TEC Vlorë 98 MW.

KESH sh.a. raporton se, fillimi i vitit 2021 u karakterizua nga kushte meteorologjike mjaft të favorshme me reshje intensive, të cilat u reflektuan në rritje të prodhimit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit. Periudha e reshjeve të konsiderueshme që filloi në fund të dhjetorit 2020, duke vazhduar gjatë periudhës janar - shkurt 2021, krijoi një situatë optimale hidrike duke reflektuar prodhim të lartë të energjisë elektrike nga KESH sh.a., gjatë periudhës përkatëse.

- Sasia e reshjeve të rëna të regjistrua në basenin e lumit Drin për muajin janar 2021 ishte 579 mm, ose gati 3.3 herë më e lartë se mesatarja shumëvjeçare për këtë muaj;
- Prodhimi i energjisë për periudhën 2 mujore janar - shkurt 2021, ka regjistruar vlerën mbi 1,312 GWh, ose rreth 60% më shumë se mesatarja shumëvjeçare e prodhimit për periudhën respektive;
- Prurjet mesatare në kaskadë, gjatë janarit arritën 1,271 m3/s, më të lartat të regjistruara që nga viti 1990;

- Frekuencë e lartë me prurje më të mëdha se 1,800 m3/s, vetëm në muajin janar rezultuan plotë 8 (tetë) të tilla;
- Piku i prurjeve natyrore në kaskade 4,673 m3/s, më i larti i rregjistruar ndonjëherë.

Ndërkohë përveç gjenerimit, KESH sh.a. gjithashtu raporton se ka realizuar administrim më efektiv dhe të kujdesshëm të prurjeve të mëdha, duke treguar vëmendje maksimale për shmangien e përmbytjeve në zonën e ultësirës Shkodër-Lezhë.

Si rezultat është arritur që mbi 1 (një) miliard m^3 ujë (ose 34% e prurjeve), të mbahen në kaskadë si rezervë energjitike. U shkarkuan vetëm 20% e prurjeve pik natyrore në kaskadë dhe shkarkimet nga portat e HEC-it të Vaut të Dejes rezultuan jo më shumë se 900 m3/s, duke eliminuar impaktin mjedisor në zonat e banuara të ultësirës Shkodër - Lezhë.

Prodhimi neto nga centralet prodhuese të KESH sh.a. për vitin 2021 rezulton të jetë 5,343,974 MWh, e cila përbën rreth 60% të prodhimit neto total vendas përgjatë këtij viti. Ky prodhim është realizuar në masën 2 416 GWh nga HEC Koman, 1 790 GWh nga HEC Fierza dhe 1 137 GWh nga HEC Vau i Dejës. HEC Koman rezulton të jetë kontribuesi më i madh në prodhimin e energjisë elektrike në kaskadën e lumit Drin.



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
V.Dejës	1,082	1,507	815	973	1,314	805	933	1,106	681	1,233	727	702	1,137
Koman	2,062	2,873	1,602	1,828	2,444	1,548	1,883	2,134	1,364	2,425	1,415	1417	2,416
Fierzë	1,541	2,634	1,238	1,228	2,054	1,055	1,636	1,851	872	2,193	845	978	1,790
Kaskada	4,686	7,014	3,655	4,029	5,812	3,409	4,452	5,092	2,917	5,851	2,987	3,097	5,343

Figura 9 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.).

Prodhimi maksimal i enegjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. për periudhën 2009 – 2021 është arritur në vitin 2010 në sasinë 7 014 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike i vitit 2010 është 1,671 GWh më i lartë se prodhimi i energjisë elektrike i arritur në vitin 2021 i cili rezulton në sasinë 5,343 GWh. Ky tregues, paraqet në mënyrë të qartë shkallën e lartë të varësisë nga kushtet hidrologjike dhe për rrjedhojë ekzistencën e riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë. Varësia e prodhimit të energjisë elektrike për shkak se ky prodhim bazohet kryesisht në burime hidrike bën të nevojshëm diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar prodhimi mujor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin në administrim të shoqërisë KESH sh.a.



	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR
HEC Vau Dejes	131,872	123,479	123,171	112,666	123,985	98,569	97,344	68,697	41,652	42,965	49,389	123,918
HEC Koman	345,675	310,902	237,358	220,557	247,542	208,157	201,491	147,271	89,320	87,284	98,453	221,864
HEC Fierze	170,676	217,186	229,493	188,055	181,631	175,608	193,810	139,225	68,301	70,817	48,007	107,585
Kaskada Drinit	648,222	651,567	590,022	521,278	553,158	482,334	492,645	355,192	199,273	201,067	195,849	453,367

Figura 10 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2021 (Burimi: KESH sh.a.. , OST sh.a.).

Prodhimi maksimal i KESH sh.a. është regjistruar në muajin shkurt me sasinë 651,567 MWh dhe minimal në muajin nentor me sasinë 195,849 MWh. Sikurse evidentohet diferenca ndërmjet prodhimit maksimal të realizuar në sasinë 651,567 MWh dhe atij minimal të realizuar në sasinë 195,849 MWh për vitin 2021 vijon të jetë e konsiderueshme respektivisht në sasinë 455 718 MWh. Edhe ky tregues identifikon varësinë e prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë nga burimet hidrike.

Në figurën 11, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e KESH sh.a. në Kaskadën e lumit Drin, për secilin vit në periudhën 2002 - 2021.



	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Fierzë	0	0	1,000	111	348	0	0	0	1,958	0	0	141	0	50	242	0	473	0	0	0
Koman	13	403	2,433	798	1,293	0	0	43	4,285	0	0	1,502	0	127	1,330	73	1,468	24	64	0
Vau Dejës	80	830	2,803	2,392	2,703	0	0	153	5,044	0	0	1,411	26	184	1,607	52	2,170	0	150	0

Figura 11 Shkarkimet e Ujit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (2002-2021) (Burimi: KESH sh.a.).

KESH sh.a. raporton se viti 2021 u karakterizua në tërësinë e tij nga një situatë e favorshme hidrike si pasojë e reshjeve më intensive dhe prurjeve më të mëdha në historinë e operimit të kaskadës. Ne total, prurjet mesatare në Fierzë gjatë vitit 2021 ishin 233 m^3/s ose 29.8% më shumë se mesatarja 15 vjeçare (2006-2020) prej 179 m3/s.

Në janar 2021 u regjistrua edhe piku i prurjeve rekord prej 4,670 m^3/s, më e larta e regjistruar ndonjëherë. Ndërkohë, shkarkimet e regjistruara nga portat e HEC-it të Vaut të Dejës nuk e kaluan asnjëherë vlerën 900 m^3/s, më të ultat deri më sot, duke rezultuar 54% më pak se në vitin 2018 dhe 58% më pak se në 2010, si periudha të ngjashme në situata me vitin 2021.

Efektet e faktorëve kryesorë si reshjet intensive dhe prurjet e shumta në Fierzë u reflektuan në prodhimin total bruto të kaskads prej 5,393 GWh ose 26% më të lartë se mesatarja 15 vjeçare (2006-2020) prej 4,281 GWh.

Sikurse edhe evidentuar më sipër, fillimi i vitit 2021 u karakterizua nga reshje të shumta të cilat bënë që prurjet mesatare të muajve të parë të ishin më të mëdha në krahasim me mesataren shumëvjeçare, ku në veçanti në muajt janar dhe shkurt kishin respektivisht 240% dhe 122% më shumë prurje se mesatarja shumëvjeçare (2006 - 2020).

Ndërsa për 6 (gjashtë) mujorin e dytë (korrik - dhjetor) të vitit 2021, prurjet mesatare rezultuan afërsisht në 105 m3/s ose rreth 9% më të ulta se mesatarja shumëvjeçare për të njejtën periudhë me 115 m3/s.

Përsa i përket nivelit të shfrytëzimit të kaskadës, niveli në fund të qershorit rezultoi 291.69 metër ose rreth 1.9 metër më i lartë se mesatarja shumëvjeçare (1990 - 2020). Ndërsa në fund të muajit dhjetor niveli ishte rreth 275.13 metër ose rreth 2.7 metër më i ulët se niveli mesatar prej rreth 277.83 metër.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi nivelin në metra të Liqenit të Fierzës për vitin 2021 në fund të çdo muaji.



Figura 12 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2021 (m) (Burimi: KESH sha).

Baseni i HEC-it të Fierzës është baseni më i madh ujor në kaskadën e Lumit Drin dhe shërben si rregullator vjetor i rezervës hidrike të kaskadës së lumit Drin. Niveli i i ujit në basenin e Fierzës ndikon drejtpërdrejtë në shfrytëzimin e gjithë kaskadës mbi lumin Drin. Sikurse evidentohet nga të dhënat më sipër në fundin e muajit maj 2021 niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qënë në kuotën maksimale 296,7 metër. Në të dhënat historike për periudhën 1991 – 2021 evidentohet se niveli i arritur në fund të muajit maj 2021 rezulton të jetë më i lartë vetëm në fundin e muajit maj 2013, vit i cili ka arritur të ketë nivelin e ujit në liqenin e Fierzës 296, 9 metër.

Arritja e një niveli të tillë të ujit në fundin e muajit maj i cili shkon në kuotën maksimale të liqenit të Fierzës është një tregues i rëndësishëm për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike në vendin tonë, kjo për faktin e evidentuar se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike në burimet hidrike dhe në vijim janë muajt e verës.

Në vitin 2020 niveli i ujit në liqenin e Fierzës në fundin e muajit maj ka rezultuar 293, 6 metër pra rreth 3,1 metër më i ulët se viti 2021. Në fund të muajit gusht 2020 niveli i ulët në liqenin e Fierzës rezulton 276, 5 metër ose 2.2 metër më i lartë se niveli i ujit në fundin e muajit gusht 2021.

Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2021 paraqiten më poshtë duke evidentuar kuotat minimale dhe kuotat maksimale.

	NIVELI I FIERZES 1991-2021											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.4	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	267.7	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	281.5	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	277.5	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
2015	288.7	289.4	292.2	296.3	296.1	293.3	287.5	280.1	272.1	275.4	278.9	275.9
2016	289.9	292.4	291.8	296.5	296.2	295.6	290.5	285.4	283.3	288.4	288.9	281.6
2017	271.5	277.7	280.9	278.7	281.6	272.4	270.2	268.0	271.0	264.6	269.6	289.9
2018	289.7	292.0	295.0	296.5	296.4	296.0	294.0	287.5	277.9	270.2	266.5	267.3
2019	267.3	268.2	272.7	279.9	289.9	292.7	287.6	278.5	274.2	268.6	273.2	275.6
2020	271.62	271.98	283.50	288.55	293.6	291.7	284.6	276.5	273.5	274.1	268.7	272.7
2021	291.70	294.10	292.60	294.30	296.7	291.7	282.7	274.3	271.3	267.7	267.8	275.1

Figura 13 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2021 (Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.).

Më poshtë paraqitet grafikisht niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës për çdo muaj të vitit 2021, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore për periudhën 1991– 2021.



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2021	291.7	294.1	292.6	294.3	296.7	291.7	282.65	274.27	271.34	267.7	267.8	275.1
Mesatarja	274.9572043	276.3249854	279.3965591	286.2184763	290.4814516	289.4568258	285.0612043	279.4186774	275.4591333	273.5244086	274.7416556	277.604129
Minimumi	245.3	247.1	252.6	264	268.6	271.3	270.1	261.1	253.6	248.4	249.3	252.1
Maksimumi	291.7	294.1	294.4	296.9	296.9	296.2	294.3	291.5	289.4	288.3	289.2	288

Figura 14 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2021

Sikurse shihet deri në muajin maj 2021, niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qënë afërsisht në vlerat maksimale historike. Në vijim niveli i ujit në liqenin e Fierzës për një periudhë 5 (pesë) mujore qershor – tetor rezulton në ulje të vazhdueshme duke e çuar nivelin në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2021 siç evidentuar në grafik nën nivelin mesatar shumëvjeçar të periudhës 1991 – 2021.
Mesatarja shumëvjeçare e nivelit të ujit në liqenin e Fierzës është një tregues kryesor në planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e Lumit Drin.
Nga të dhënat historike të evidentuara në figurën më poshtë rezultoi se niveli i prurjeve të ujit përgjatë vitit 2021 ishte i përafërt me mesataren historike në pjesën më të madhe të vitit dhe në tremujorin e parë të vitit rezultuan më të larta, çka mundësoi ruajtjen e nivelit të ujit në liqenin e Fierzës në mesataren shumëvjeçare.
Në Figurën në vijim paraqiten prurjet mesatare të ujit për vitin 2021 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike për çdo muaj.



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Prurjet mesatare 2021	685	495	261	300	292	98	61	54	62	61	83	283
Prurjet mesatare historike (1991-2019)	211	234	273	308	253	130	66	48	76	107	173	233

Figura 15 Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2021 krahasuar me mesataren historike

Gjatë vitit 2021 prurjet mesatare të ujit janë përgjithësisht të përafërta me mesataren historike përveç tremujorit të pare i cili është karakterizuar nga prurje më të larta se mesatarja shumëvjeçare ku më të lartat rezultojnë në muajin janar dhe shkurt.

Në grafikun e figurës që vijon është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjitike në Kaskadën e lumit Drinit gjatë vitit 2021.



Figura 16 Rezerva Energjitike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2021 (Burimi: KESH sha).

Rezerva hidroenergjitike e kaskadës së lumit Drin duhet të administrohet nga KESH sh.a. bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Optimizim i portofolit të KESH sh.a., dhe të sektorit në përgjithësi.
- Operim në nivele optimale të HEC-it dhe shfrytëzimim sa më të mirë të baseneve.
- Operim sipas përcaktimeve të rregullores së sigurisë së digave.
- Të gjenerojë në mënyrë të qëndrueshme e me cilësi, duke garantuar furnizim me energji elektrike të sigurtë dhe me kosto sa më të ulët për konsumatorët fundorë.
- Të ofrojë në kohën dhe masën e duhur shërbimet ndihmëse, për të garantuar operim të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjitik.

Sikurse evidentohet edhe rezerva energjitike në fundin e muajit maj 2021 ka rezultuar në nivelin maksimal prej 1520 GWh dhe në fund të muajt gusht kjo rezervë energjitike ka shkuar në 628 GWh, duke shënuar një rënie të ndjeshme dhe të shpejtë. Ruajtja dhe menaxhimi i duhur i rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin është një garanci e shtuar për sigurinë energjitike të vendit tonë.

1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë

Shoqëria KESH sh.a. është aksionere e vetme e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.), shoqëri kjo e cila ka në administrim asetin gjenerues TEC Vlora.

Edhe përgjatë vitit 2021, shoqëria TEC Vlora sh.a., ka kryer aktivitetin e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të problematikave të shfaqura që nga viti 2012.

Meqë TEC Vlora sh.a. ndodhet në kushte konservimi, konsumi vetjak i TEC Vlorës garantohet nëpërmjet linjës së furnizimit 220 kV, N/Stacioni Babicë dhe mbulohet nga vetë KESH sh.a.

Në të njëjtën kohë VKM – ja nr. 244/2016 e ndryshuar, në nenin 6 ndër të tjera përcakton se, çmimi i rregulluar për furnizimin e klientëve nga Furnizuesi i Shërbimit Universal merr në konsideratë edhe koston e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria shtetërore e prodhimit, që përmban koston financiare të TEC Vlora sh.a.

1.2.4 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese të pavarur dhe ato me përparësi për vitin 2021 është 3,618,725 MWh ose rreth 40% e prodhimit total vendas.

Për vitin 2021, numri i centraleve prodhuese të pavarur dhe ato me përparësi të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 235, 8 prej të cilëve janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të licencuara, kurse pjesa tjetër prej 226 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 174 subjekte në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në këtë listë është përfshirë edhe HEC Lanabregas me kapacitet të instaluar 5 MW dhe prodhim vjetor për vitin 2021 prej 27 504 MWh, aksionet e të cilit sikurse sipërcituar janë 100% shtetërore. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese të pavarur dhe prodhuesve me përparësi është 1,157 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, kurse 721 MW i përket centraleve të prodhuesve më përparësi të energjisë elektrike perfshirë dhe HEC-in Lanabregas.

Të dhënat mbi grupimet e prodhuesve janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2021		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2021 (MWh)
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	5,343,974
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	1,425,989
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	48	380	1,246,750
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	129	167	318	905,230
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	12	12	23	40,756
			178	239	2,605	8,962,699

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR DHE ATO ME PËRPARËSI 2021		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2021 (MWh)
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	1,425,989
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	48	380	1,246,750
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	129	167	318	905,230
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	12	12	23	40,756
			173	235	1,157	3,618,725

Figura 17 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2021

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR 2021					
	HECET	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Prodh.2021
P.Pav	HEC "Ulez"	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	406,632
P.Pav	HEC "Shkopet"	24.000		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 1"	22.500		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 2"	5.000		110 kV	
P.Pav	HEC"Peshqesh"	27.940	"Ayen As Energji"sh	220 kV	99,316
P.Pav	HEC"Fangu"	74.600		220 kV	236,767
P.Pav	HEC "Banje"	73.000	"Devoll Hydropow	110 kV	258,632
P.Pav	Hec "Moglice"	184.000		111 kV	424,642
		436.240			1,425,989

Figura 18 Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2021

TË DHËNA MBI PRODHUESIT ME PËRPARËSI 2021		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2021 (MWh)
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	48	380	1,246,750
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	129	167	318	905,230
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	12	12	23	40,756
			170	227	721	2,192,736

Figura 19 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2021

	PRODHIMI GJATE VITIT 2021 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2021
	UKKO (pa sistemuarne sistem)	1	"UKKO"sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		
PPE	Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	4,021
PPE	Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,001
PPE	Topojë 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,001
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,990
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,049
PPE	Seman1solar	2	" SEMAN1SOLAR " sh.p.k	35 kV	3,950
PPE	FV Lugano	2	ES 2019 sh,p,k	35 kV	4,304
PPE	FV SMART WATT	2	SMART WATT sh,p,k	35 kV	4,290
PPE	Tren Bilisht	2	" RTS " sh.p.k	35 kV	3,668
PPE	STATKRAFT Renewbles albani PV Lundrues banje	2	"STATKRAFT"	35 kV	13
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	4,469
PPE		23			40,756

Figura 20 Impiantet fotovoltaikë viti 2021

1.2.5 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021

Prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet të cilat kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021 paraqitet në Figurën në vijim. Siç shihet përgjatë vitit 2021 kanë hyrë në prodhim gjithsej 18 impiante me një kapacitet të instaluar prej 97 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2021 sasinë prej 79,971 MWh. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021 zë rreth 0.9% të prodhimit total vendas të energjisë elektrike për këtë vit.

PRODHUES QË KANË HYRË NË PRODHIM GJATË VITIT 2021 (MWh)																	
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Transmetimit																	
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH. 2021
PPE	HEC ARSTI	3.13	Hec Arsti shpk	110 kV	1,483	2,362	1,573	2,204	1,070	198	16	11	208	490	787	2,426	12,829
PPE	HEC KASKADA GJADER T1/344	24.9	S.P.E. Gjader shpk	110 kV	-	-	-	1,358	1,343	(23)	-22	-21	311	900	1,373	4,946	10,164
PPE	HEC-et Dragobia&Ceremi/686	21.9	Dragobia Energy shpk	110 kV	-	-	(6)	(16)	971	2,834	598	258	203	165	83	5,648	10,737
PPE	HEC Veleshica 1,2	13.9	"Kalisi Hydropower"shpk	110 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-5	989	984
					1,483	2,362	1,566	3,546	3,384	3,008	593	248	722	1,554	2,237	14,009	34,714
		64															34,714
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Shpërndarjes																	
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH. 2021
PPE	Hec Muras	2	Mateo& Co shpk	10	156	676	816	1,244	1,168	1,048	76	0	-	-	372	956	6,512
PPE	Hec Trojet	0.9	Trojet Energji shpl	10	113	436	364	468	234	20	0	0	-	6	38	389	2,068
PPE	Hec Deri	0.85	ASI TRE shpk	35	380	374	225	413	166	37	32	11	2	35	50	458	2,182
PPE	Hec Kamican	1.86	IGI 2005 shpk	35	-	100	691	1,277	705	219	18	0	-	100	277	930	4,317
PPE	Hec Vardar	1.97	Gerti shpk	35	-	-	-	977	1,273	226	15	0	-	140	175	1,123	3,928
PPE	Hec Stavec	6.5	Koka Ergi Stavec shpk	35	-	-	-	2,065	3,050	1,279	353	331	404	610	845	4,645	13,583
PPE	Hec Kalis	2.13	ERDY Energy shpk	35	-	-	-	-	223	466	254	128	116	233	331	1,078	2,830
PPE	Hec Gjinar	0.83	Erdi Gas shpk	10	-	-	-	-	38	69	33	13	15	37	41	215	461
PPE	Hec Backa 1	3.36	Kroi Mbret shpk	35	-	-	-	-	811	644	3	-	-	184	261	2,260	4,163
PPE	Hec Plepi	2.28	Domi Tec shpk	35	-	-	-	-	154	41	4	-	-	-	41	56	297
PPE	Hec Zall Xhuxhe	4.7	Hec Zall Xhuxhe	35	-	-	-	-	267	461	237	13	12	33	192	1,171	2,385
PPE	Hec Pisha	1.9	Green TECH energy systems	35	-	-	-	-	-	-	2	0	4	75	81	322	483
PPE	Hec Lingjanca1&2	2.2	"Rei-Energji" shpk	35									36	303	423	1,012	1,774
PPE	Hec Guri i Zi	1.7	"Aris Albania" shpk	35										64	4	206	274
		33			649	1,585	2,095	6,444	8,090	4,512	1,028	495	589	1,818	3,132	14,821	45,257

Figura 21 Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021

1.2.6 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhur në sistemin e transmetimit për vitin 2021 është 2,265 MW. Prodhimi total i energjisë elektrike nga këto centrale është 951,505 MWh. Prodhimi i detajuar për secilin nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2021 paraqitet në tabelën në vijim:

	PRODHIMI GJATE VITIT 2021 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)				
	HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2021
P.Pub	Hec "Fierze" me fuqi 500 MW	500.000		220kV	
P.Pub	Hec "Koman" me fuqi 600 MW	600.000	"KESH" sha	220kV	5,343,974
P.Pub	Hec "V. Dejes" me fuqi 250 MW	250.000		220kV	
P.Pub	Tec Vlora me fuqi 98 MW	98.000	"KESH" sha	220kV	
					5,343,974
P.Pav	Hec "Ulez" me fuqi 25,2 MW	25.200		110kV	
P.Pav	Hec "Shkopet" me fuqi 24 MW	24.000	"Kurum International" sh.a.	110kV	406,632
P.Pav	Hec "Bistrica 1" me fuqi 22,5Mw	22.500		110kV	
P.Pav	Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110kV	
P.Pav	Hec"Peshqesh"me fuqi 27,94 MW;,	27.940	"Ayen As Energji"sha	220kV	99,316
P.Pav	Hec"Fangu"me fuqi 74.6 MW;,	74.600		220kV	236,767
P.Pav	Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110kV	258,632
P.Pav	Hec "Moglice" me fuqi 184 MW	184.000		111kV	424,642
					1,425,989
P.Pav	Hec "Ashta" me fuqi 48,2 MW	48.200	"Energji Ashta" shpk	110kV	295,245
					295,245
PPE	Hec "Bishnica 2" me fuqi 2.5 MW	2.500	"HEC Bishnica 1,2 "shpk	110kV	11,845
PPE	Hec "Dardhe" me fuqi 5,8 MW	5.800	"Wenerg " shpk	110kV	16,960
PPE	Hec"Truen" me fuqi 2,5 MW	2.500	"TRUEN" shpk	110kV	
PPE	Hec"Ternove" me fuqi 8.385 Mw	0.921	"TEODORI 2003" shpk	110kV	12,192
PPE	Hec"Gjorice" me fuqi 4.18 Mw (+h/c ne prodhim)	29.610	"DITEKO" shpk	110kV	125,775
PPE	Hec "Sllabinje" me fuqi 13,8 MW	13.800	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110kV	74,350
PPE	Hec"Bele 1"me fuqi 5 MW ;	5.000	"Euron Energy" shpk		
PPE	Hec"Topojan 2" me fuqi 5,8 MW,	5.800			
PPE	Hec"Bele 2"me fuqi 11 MW ;	11.000	"Alb-Energy" shpk	110kV	125,626
PPE	Hec"Topojan 1" me fuqi 2,9 MW,	2.900			
PPE	Hec"Orgjost I Ri" me fuqi 4,8 MW	4.800	"Energal" shpk		
PPE	Hec "Cerunje-1" me fuqi 2.3 MW;	2.300			
PPE	Hec "Cerunje-2" me fuqi 2.8 MW;	2.800	"Energy partners AI" shpk	110kV	20,393
PPE	Hec "Rrupe" me fuqi 3.6 MW;	3.600			
PPE	Hec "Rapuni 1,2" me fuqi 4 dhe 4.1 MW	8.100	"C & S Construction Energy" shpk	110kV	33,362
PPE	Hec "Rapuni 3,4" me fuqi 8.857 MW	8.850	"C & S Energy" shpk	110kV	33,158
PPE	Hec"Llapaj" me fuqi 13,62 MW	13.620	"Gjo.Spa.POWER"shpk	110kV	47,070
PPE	Hec"Lengarice" me fuqi 8.94 MW	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110kV	31,583
PPE	Hec"Lura 1" me fuqi 6,54 MW	6.540		110kV	
PPE	Hec"Lura 2" me fuqi 4,02 MW	4.020	"Erdat Lura" shpk	110kV	48,247
PPE	Hec"Lura 3" me fuqi 5,66 MW	5.660		110kV	
PPE	Hec"Malla" me fuqi 5,455 MW	5.455	"Gjure Rec" shpk	110kV	17,074
PPE	Hec Prella me fuqi 14.97 MW	14.970	"Prelle Energji"	110kV	43,066
PPE	HEC Cemerica 1	0.88		110kV	
PPE	HEC Cemerica 2	1.08	"REJ ENERGY" shpk	110kV	16,457
PPE	HEC Cemerica 3	2.1		110kV	
PPE	HEC TUÇ	4.47	MC Inerte Lumzi	110kV	35,136
PPE	HEC Lumzi	11		110kV	
PPE	Hec Denas	14.5	"Denas Power" shpk	110kV	43,701
PPE	Llënga 1	1.73		110kV	
PPE	Llënga 2	0.3	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110kV	9,243
PPE	Llënga 3	1.5		110kV	
PPE	HEC Shpella Poshte 2	2.3	Liria Energji shpk	110kV	11,567
PPE	HEC Germani 1	4.8	SA'GA-MAT shpk	110kV	13,149
PPE	HEC Germani 2	1.5		110kV	
PPE	Hec Lashkiza 1	4.076	HEC Lashkiza shpk	110kV	6,545
PPE	Hec Lashkiza 2	0.882		110kV	
PPE	Hec Seta 1+2	7.454		110kV	
PPE	Hec Seta 3	2.722	"Hydro Seta" sh.p.k	110kV	41,470
PPE	Hec Seta 4	4.724		110kV	
PPE	HEC Darsi 1,2,3	12.7	Henz Energy shpk	110kV	32,409
PPE	HEC Egnatia	5.1	REMI shpk	110kV	14,289
PPE	HEC Seka & Zais/684	14.96	SEKA Hydopower shpk	110kV	52,123
PPE	HEC ARSTI	3.13	Hec Arsti shpk	110kV	12,829
PPE	HEC KASKADA GJADER T1/344	24.9	S.P.E. Gjader shpk	110kV	10,164
PPE	HEC-et Dragobia&Ceremi/686	21.9	Dragobia Energy shpk	110kV	10,737
PPE	HEC Veleshica 1,2	13.9	"Kalisi Hydropower"shpk	110kV	984
		2,265			951,505

Figura 22 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2021 (Burimi: FTL sh.a., OST sh.a.)

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është 341 MW. Kapaciteti i instaluar i centraleve në rrjetin e shpërndarjes përbëhet nga 318 MW fuqi e instaluar në burime Hidrike dhe 23 MW fuqi e instaluar në impiante fotovoltaike. Prodhimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2021 është në sasinë 905,230 MWh, ndërsa prodhimi i realizuar nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 40,756 MWh. Në mënyrë të detajuar prodhimi i tyre paraqitet në tabelën në vijim:

PPE	Hec Zerec 1	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	**6,262**
PPE	Hec Zerec 2	1.315			
PPE	Hec Shëngjon 1	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	**2,582**
PPE	Hec Shëngjon 2	0.356			
PPE	HEC Blaç	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	**174**
PPE	HEC Qarrishtë	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	**1,143**
PPE	HEC Vendresh	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	**831**
PPE	HEC "Antena"	1.105	"DERBI-E" shpk	35kV	**2,984**
PPE	HEC "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	**3,016**
PPE	HEC "Qytezë"	0.9	Muso hec Qytezë	10	**2,136**
PPE	HEC Marjan Gura e Vesheve	0.63	Marituda Shpk	10	**1,596**
PPE	HEC Skatinë	2.677	Skatina Hec Shpk	10	**5,710**
PPE	HEC Kaparjel	0.2	ABV Konstruksion Shpk	10	**419**
PPE	HEC Letaj	0.54	Asi-Tre Shpk	10	**1,140**
PPE	HEC Nice	2.133	MP-HEC Shpk	35	**2,470**
PPE	HEC Meshurdhe	1.8	SIMA-Com Shpk	10	**7,202**
PPE	HEC Thanez	1.95	AFRIMI K Shpk	35	**8,188**
PPE	HEC OSOJE	1.9	OSOJA HPP shpk	35	**10,950**
PPE	Hec Voskopoje	1.9	FAVINA 1 shpk	35	**7,589**
PPE	Hec Nderfushas	1.34	SGD Energji shpk	35	**2,250**
PPE	Hec Rreshen	0.38	Nikolli Energy shpk	10	**1,378**
PPE	Hec Gurra	0.5	Uleza Ndertim shpk	6	**1,294**
PPE	Hec Vile	1.994	Hydro Power Panariti shpk	35	**6,287**
PPE	Hec Dukona	0.800	Dukona shpk	20	**1,303**
PPE	Hec Prevalli	1.750	Gega-G shpk	35	**7,527**
PPE	HEC Camerice	0.800	Rei Energy shpk	35	**4,130**
PPE	Hec Stror	2.000	Era Hydro shpk	35	**10,447**
PPE	Hec Mivas	1.940	Elva 2001 shpk	35	**5,375**
PPE	Hec Spathare	1.038	Lucente concensionare shpk	10	**3,748**
PPE	Hec Miraka	0.600	Kuarci Blace shpk	10	**1,392**
PPE	Hec Shegjun	2.000	Irarba Energji shpk	10	**2,660**
PPE	hec Dobrunje	0.840	W.T.S. Energji shpk	10	**2,283**
PPE	Hec Muras	2	Mateo& Co shpk	10	**6,512**
PPE	Hec Trojet	0.9	Troijet Energji shpl	10	**2,068**
PPE	Hec Deni	0.85	ASI TRE shpk	35	**2,182**
PPE	Hec Kamican	1.86	IDI 2005 shpk	35	**4,317**
PPE	Hec Vardar	1.97	Gerti shpk	35	**3,928**
PPE	Hec Stavec	6.5	Koka Ergi Stavec shpk	35	**13,583**
PPE	Hec Kalis	2.13	ERDY Energy shpk	35	**2,830**
PPE	Hec Gjinar	0.83	Erdi Gas shpk	10	**461**
PPE	Hec Backa 1	3.36	Kroi Mbret shpk	35	**4,163**
PPE	Hec Plepi	2.28	Dorni Tec shpk	35	**297**
PPE	Hec Zall Xhuxhe	4.7	Hec Zall Xhuxhe	35	**2,385**
PPE	Hec Pisha	1.9	Green TECH energy systems	35	**483**
PPE	Hec Lingjanca1&2	2.2	"Rei-Energji"shpk	35	**1,774**
PPE	Hec Guri i Zi	1.7	"Aris Albania"shpk	35	**274**
		318			**905,230**

PPE	Hec"Kozel" me fuqi 0,5 MW	0.500		10kV	**1,023**
PPE	Hec"Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0.800	"E.T.H.H. "shpk	10kV	**2,245**
PPE	Hec"Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0.500		10kV	**1,192**
PPE	Hec"Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Caushi Energji" shpk	10kV	**3,350**
PPE	Hec"Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1.775	"SA.GLE.Kompani "shpk	10kV	**4,121**
PPE	Hec"Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0.600	"Energji Xhaci" shpk	10kV	**998**
PPE	Hec"Tucep" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Tucep" shpk	10kV	**2,917**
PPE	Hec"Treska4" me fuqi 3,6 MW	3.600		35kV	**9,723**
PPE	Hec"Treska3" me fuqi 0.3 MW	0.300	"Hec-Treske"shpk	35kV	**1,322**
PPE	Hec"Treska 2T" 5 me fuqi 0.62 MW	0.620		35kV	**2,540**
PPE	Hec"Sotire1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2.200	"Hidro Energy Sotire"shpk	35kV	**6,527**
PPE	Hec"Shutine" me fuqi 2,4 MW	2.400	"Shutina energji"shpk	10kV	**3,700**
PPE	Hec"Cekrez 1,2" me fuqi (0,23 MW; 0.43 MW)	0.660	"Zall Herr Energji 2011"shpk	6kV	**4,329**
PPE	Hec"Qarr" me fuqi 1 MW	1.000	"Hec Qarr & Kaltanj"shpk	35kV	**5,039**
PPE	Hec"Bisak" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Bardhgjana" shpk	6kv	**3,756**
PPE	Hec"Shales" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Gjoka Konstruksion Energji" shpk	35kV	-
PPE	Hec"Strelce" me fuqi 1,174 MW	1.174		35kV	**4,778**
PPE	Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0.400	"Sarolli" sh.p.k	10kV	**1,437**
PPE	Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0.130	Star NRG sh.p.k	10kV	-
PPE	Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	3.100	"EN-KU" sh.p.k	10kV	-
PPE	Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	1.072	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	**367**
PPE	Hec "Leskovik 2" me fuqi 1100 kW	1.100		10kV	**490**
PPE	Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	**1,409**
PPE	Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0.750	"WTS Energji" shpk	10kV	-
PPE	Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	1.000	"Marjakaj" shpk	6kV	**1,373**
PPE	Hec "Vithkuq" me fuqi 2,715 MW	2.715	"Favina 1" shpk	35/10kV	**10,168**
PPE	Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	1.600	"Selca Energji" shpk	10kV	**4,843**
PPE	Hec" Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0.830	"DN & NAT Energy"shpk	6kV	**1,924**
PPE	Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8.600	"Energo – Sas" shpk	35kV	**25,735**
PPE	Hec "Tervol" me fuqi 10.6 MW	10.600	"Hec i Tervolit" shpk	35kV	**34,539**
PPE	Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"MTC Energy" shpk	10kV	**10,078**
PPE	Hec"Gurshpat 1"me fuqi 0,84 MW,	0.840	"Gurshpat Energy" shpk	10kV	**4,188**
PPE	Hec"Gurshpat 2"me fuqi 0,83 MW	0.830		10kV	**4,285**
PPE	Hec"Bistrica 3"me fuqi 1,57 MW,	1.570	"Bistrica 3 Energy" shpk	6kv	**9,061**
PPE	Hec"Hurdhas 1"me fuqi 1,71MW,	1.710	"Komp Energji" shpk	6kV	**8,718**
PPE	Hec"Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0.500	"Fatlum" shpk	10kV	**977**
PPE	Hec"Koxheraj" me fuqi 0,62 MW	0.620	"Koxherri Energji" shpk	10kv	**1,824**
PPE	Hec"Kacni" me fuqi 3,87 MW	3.870	"Kisi-Bio-Energji" shpk	20kV	**6,424**
PPE	Hec"Lena 1"me fuqi 1,95 MW;,	1.950	"Gama Energy" shpk	35kv	**8,082**
PPE	Hec"Lena 2" me fuqi 2,3 MW	2.300		35kv	
PPE	Hec"Lena 2A" me fuqi 0,25 MW	0.250		35kv	
PPE	Hec "Driza" me fuqi 3,408 MW	3.408	"Mesopotam Energy" shpk	35kv	**4,033**
PPE	Hec Strelca 1,2,3 (1.504 MW, 0.325 MW, 3.52 MW)	5.349	"Strelca Energy" shpk	35kv	**14,312**
PPE	Hec "Ujanik 2" me fuqi 2,5 MW	2.500	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kv	**6,673**
PPE	Hec "Nishove" me fuqi 1,36 MW	1.360	"Nishova Energy" shpk	35kv	**663**
PPE	Hec "Shtika" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Perparimi SK" shpk	10kv	**3,242**
PPE	Hec "Ballenje" me fuqi 1,9 MW	1.900	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kv	**3,943**
PPE	Hec Gavran 1	0.998	"Gavran Energy" shpk	35kv	**2,948**
PPE	Hec Gavran 2	1.215	"Gavran Energy" shpk	35kV	**2,824**
PPE	Hec Kasollet e Selces 1	4.000	"Xhango Energji" shpk	35kV	**11,455**
PPE	Hec Holta Kabash	2.200	HEC Kabash Porocan shpk	35kV	**13,224**
PPE	Hec Holta Poroçan	3.300		35kV	
PPE	Hec Lusen 1	0.315	"Eurobiznes" shpk	35kV	**643**
PPE	Hec Ura e Fanit	1.000	"Ayen As Energji"sha	35kV	**5,610**
PPE	HEC Gorice	1.747	"THE BLUE STAR" sh.p.k	35kV	**5,106**
PPE	HEC Kabash 1&2	5.800	"Univers Energji" shpk	35kV	**6,200**
PPE	HEC "Tucep 2"	1.7	"DUKA T2" shpk	35kV	**3,146**
PPE	Hec Dobrenje Tomorrice	2.4	DAAB Energy Group shpk	35kV	**4,781**
PPE	Hec Razdoll	0.765	Hidro Vizion shpk (I pa licens nga ER	35kV	**1,979**
PPE	Hec Dragostunje	3.1	"HEC-i Dragostunje" shpk	35kV	**19,564**
PPE	Hec Stebleve	3.4	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	35kV	**2,669**

PPE	Hec Zerec 1	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	6,262
PPE	Hec Zerec 2	1.315			
PPE	Hec Shëngjon 1	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	2,582
PPE	Hec Shëngjon 2	0.356			
PPE	HEC Blaç	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	174
PPE	HEC Qarrishtë	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	1,143
PPE	HEC Vendresh	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	831
PPE	HEC "Antena"	1.105	"DERBI-E" shpk	35kV	2,984
PPE	HEC "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	3,016
PPE	HEC "Qytezë"	0.9	Muso hec Qytezë	10	2,136
PPE	HEC Marjan Gura e Vesheve	0.63	Marituda Shpk	10	1,596
PPE	HEC Skatinë	2.677	Skatina Hec Shpk	10	5,710
PPE	HEC Kaparjel	0.2	ABV Konstruksion Shpk	10	419
PPE	HEC Letaj	0.54	Asi-Tre Shpk	10	1,140
PPE	HEC Nice	2.133	MP-HEC Shpk	35	2,470
PPE	HEC Meshurdhe	1.8	SIMA-Com Shpk	10	7,202
PPE	HEC Thanez	1.95	AFRIMI K Shpk	35	8,188
PPE	HEC OSOJE	1.9	OSOJA HPP shpk	35	10,950
PPE	Hec Voskopoje	1.9	FAVINA 1 shpk	35	7,589
PPE	Hec Nderfushas	1.34	SGD Energji shpk	35	2,250
PPE	Hec Rreshen	0.38	Nikolli Energy shpk	10	1,378
PPE	Hec Gurra	0.5	Uleza Ndertim shpk	6	1,294
PPE	Hec Vile	1.994	Hydro Power Panariti shpk	35	6,287
PPE	Hec Dukona	0.800	Dukona shpk	20	1,303
PPE	Hec Prevalli	1.750	Gega-G shpk	35	7,527
PPE	HEC Camerice	0.800	Rei Energy shpk	35	4,130
PPE	Hec Stror	2.000	Era Hydro shpk	35	10,447
PPE	Hec Mivas	1.940	Elva 2001 shpk	35	5,375
PPE	Hec Spathare	1.038	Lucente concensionare shpk	10	3,748
PPE	Hec Miraka	0.600	Kuarci Blace shpk	10	1,392
PPE	Hec Shegjun	2.000	Irarba Energji shpk	10	2,660
PPE	hec Dobrunje	0.840	W.T.S. Energji shpk	10	2,283
PPE	Hec Muras	2	Mateo& Co shpk	10	6,512
PPE	Hec Trojet	0.9	Troijet Energji shpl	10	2,068
PPE	Hec Deni	0.85	ASI TRE shpk	35	2,182
PPE	Hec Kamican	1.86	IGI 2005 shpk	35	4,317
PPE	Hec Vardar	1.97	Gerti shpk	35	3,928
PPE	Hec Stavec	6.5	Koka Ergi Stavec shpk	35	13,583
PPE	Hec Kalis	2.13	ERDY Energy shpk	35	2,830
PPE	Hec Gjinar	0.83	Erdi Gas shpk	10	461
PPE	Hec Backa 1	3.36	Kroi Mbret shpk	35	4,163
PPE	Hec Plepi	2.28	Domi Tec shpk	35	297
PPE	Hec Zall Xhuxhe	4.7	Hec Zall Xhuxhe	35	2,385
PPE	Hec Pisha	1.9	Green TECH energy systems	35	483
PPE	Hec Lingjanca1&2	2.2	"Rei-Energji" shpk	35	1,774
PPE	Hec Guri i Zi	1.7	"Aris Albania" shpk	35	274
		318			905,230

	PRODHIMI GJATE VITIT 2021 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2021
	UKKO (pa sistemuame sistem)	1	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		
PPE	Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	4,021
PPE	Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,001
PPE	Topojë 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,001
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,990
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,049
PPE	Seman1solar	2	" SEMAN1SOLAR " sh.p.k	35 kV	3,950
PPE	FV Lugano	2	ES 2019 sh,p,k	35 kV	4,304
PPE	FV SMART WATT	2	SMART WATT sh,p,k	35 kV	4,290
PPE	Tren Bilisht	2	" RTS " sh.p.k	35 kV	3,668
PPE	STATKRAFT Renewbles albani PV Lundrues banje	2	"STATKRAFT"	35 kV	13
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	4,469
PPE		23			40,756
	Kapaciteti Instaluar i gjithe prodhuesve	2,605	MW	Prodh	8,962,699

LEGJENDA	
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)

Figura 23 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2021 (Burimi: OST sh.a.; OSHEE sh.a.; FTL sh.a.)

1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike

Transmetimi i Energjisë Elektrike në Shqipëri kryhet nëpërmjet rrejtit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV.

Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, përcakton se: "Sistemi i Transmetimit" është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

1.3.1 Bilanci energjitik

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin energjitik të OST sh.a. për vitin 2021 krahasuar me periudhën 2015 – 2020.

Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (GWh)	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,830	8,462	7,577	9,848	7,943	8,130	10,685
1	- Prodhimi vendas	5,475	6,636	4,174	8,076	4,767	4,892	8,432
2	- Energji në marrje (import ne interkoneksion)	2,355	1,827	3,403	1,772	3,177	3,238	2,253
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	7,672	8,272	7,419	9,606	7,775	7,958	10,685
1	- Energji në dhënie (eksport ne interkoneksion)	956	1,869	488	2,685	770	963	2,800
2	- Energji e transmetuar për OSSH sh.a.	6,106	5,901	6,148	5,963	6,137	6,184	6,606
3	- Energji transmetuar për klientëte lidhur në rrjetin e transmetimit	610	503	781	957	867	811	1,049
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake	159	190	158	242	169	172	228
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake (%)	2.03	2.25	2.08	2.46	2.12	2.12	2.13

Figura 24 Bilanci Energjitik i OST sh.a. për vitin 2021 krahasuar me atë të viteve 2015 - 2021 (MWh)

Niveli i Humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2021 është 227,918 MWh ose 2.13% e energjisë elektrike të transmetuar. Ky nivel humbjesh i energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për vitin 2021 mbetet pothuajse i njejtë me atë të viteve 2020 dhe 2019 prej 2.12%. Niveli i humbjeve në Sistemin e Transmetimit është i lidhur me sasinë e energjisë elektrike të transmetuar si dhe me nivelin e prodhimit të HEC-eve të lidhura në Sistemin e Transmetimit.



Figura 25 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenirgjitik shqiptar për vitin 2021

Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar jepet në mënyrë të detajuar në figurën më sipër. Sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në sistemin e transmetimit për vitin 2021 është 10,685 GWh. Sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në sistemin e shpërndarjes është 7,137 GWh.

Energjia elektrike në sistemin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit injekton në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 6,606 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura direkt në rrjetin e shpërndarjes injektojnë në këtë rrjet sasinë neto të energjisë elektrike prej 530.5 GWh.

1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit bazuar në përcaktimet e Nenit 54 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar. Në vendin tonë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore, i themeluar ne 14 korrik 2004. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë

e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligj.

OST sh.a. aktualisht kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Tregut si dhe Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit të sistemit.

OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
- Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
- Tranzitimin dhe shkëmbimin e nevojshëm me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër OST sh.a. zhvillon Sistemin e Transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje. OST sh.a. dispeçeron sistemin Elektroenergjitik Shqiptar nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera fqinje.

1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV,150 kV, 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit sipas nivelit të tensionit janë:

- Linjat e transmetimit 400 kV 445.7 km
- Linjat e transmetimit 220 kV 1,250 km
- Linjat e transmetimit 150 kV 34.4 km
- Linjat e transmetimit 110 kV 1,701 km

Në përbërje të linjave të mësipërme janë pjesë e sistemit të Transmetimit dhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinje si:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplik (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linjë e interkonjeksionit 150 kV Bistricë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).



Figura 26 Linjat sipas nivelit te tensionit te Sistemit të Transmetimit

Kapaciteti teknik i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë, megjithatë në periudha të caktuara ka konxhestion të kapaciteteve transmetuese në interkonjeksion.



Figura 27 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë



Figura 28 Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar



Figura 29 Skema njëfazore e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar në nivelin 400/220/150/110kV

Në tabelën më poshtë janë listuar nënstacionet kryesore të sistemit të transmetimit dhe fuqia e instaluar për secilin nënstacion.

Nr	Nënstacioni		Fuqia e instaluar (MVA)
1	400 kV	N/st 400/220kV Koman	345
2		N/st 400/220kV/110kV Tirana 2	840
3		N/st 400/220kV Elbasan 2	600
4		N/st 400/110kV Zemblak	300
5	220 kV	N/st 220/110kV V.Dejës	240
6		N/st 220/110kV Fierzë	120
7		N/st 220/110kV Koplik	90
8		N/st 220/110kV Burrel	120
9		N/st 220/110kV/20kV Tirana1	486
10		N/st 220/110kV Sharrë	190
11		N/st 220/110kV Rrashbull	200
12		N/st 220/110kV Elbasan 1	330
13		N/st 220/110kV Fier	360
14		N/st 220/110kV Babicë	200
15	150 kV	N/st 110/150kV Bistrica 1	80
Total			**4501**

Figura 30 Nënstacionet e sistemit të transmetimit



Figura 31 Asetet kryesore të sistemit të transmetimit

1.3.2.2 Investimet në sistemin e transmetimit nga OST sh.a. gjatë vitit 2021

Në total vlera e investimeve e realizuar për vitin 2021 është gati **2 miliard e 633 milionë** lekë, ose 43% e planit, nga të cilat: gati 1 miliard e 942 milionë lekë me fondet e OST sh.a. dhe rreth 690 milionë lekë me financimet e huaja.



Figura 32 Realizimi i Investimeve nga OST sh.a.

Investimet me fondet e OST sh.a. dhe me fondet e huaja

Investimet e realizuara me fondet e OST sh.a., për vitin 2021, kanë rezultuar rreth 1,942 milionë lekë, ose rreth 74%, nga 2,610 milionë lekë të parashikuara,.

Investimet e realizuara me fondet e huaja për vitin 2021, kanë qenë rreth 690 milione lekë, ose rreth 20 % e parashikimit, nga 3,520 milionë lekë të parashikuara.

Në lidhje me realizimin e investimeve, evidentojmë faktin se Qeveria Shqiptare, me anë të VKM-së nr. 584, datë 08.10.2021 "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 90 të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, mes të tjerave ka vendosur:

"Shoqëritë "KESH" sh.a., "OST" sh.a., dhe "OSHEE Group" sh.a., të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Këto shoqëri të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike, deri më 15 Prill 2022".

1.3.3 Gjendja e përgjithshme e Sistemit Elektroenergjitik referuar raportimit të OST sh.a., në zbatim të nenit 25, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar

OST sh.a, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi është përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit. OST sh.a. realizon këto detyra duke u bazuar në kërkesat dhe parimet e sigurisë operative, dhe garantimin e funksionimit të sistemit të transmetimit në nivel të lartë koordinimi, besueshmërie, cilësie dhe qëndrueshmërie.

a) Siguria operative e rrjetit

Siguria operative e rrjetit është aftësia e sistemit të transmetimit për të qëndruar në gjendje normale dhe/ose aftësia për t'u kthyer në gjendjen normale sa më shpejt që të jetë e mundur. Siguria operative karakterizohet nga limitet e sigurisë së operimit. Si rrjedhojë, sistemi i transmetimit konsiderohet në gjendje normale kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Nivelet e tensionit dhe flukset e fuqisë janë brenda limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuara në nenet 111 dhe 113, në përputhje me nenin 109(5) të Kodit të Transmetimit edhe brenda intervalit të përcaktuar në "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe

performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 .

- Frekuenca e sistemit duhet të jetë brenda diapazonit +/- 200mHz, të përcaktuar në Kodin e Transmetimit dhe në "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 .
- Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive duhet të jenë të mjaftueshme për të përballuar ngjarjet e paplanifikuara, pa cënuar kufijtë e sigurisë operacionale.
- Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së të mbetet brenda kufijve të sigurisë operative edhe pas aktivizimit të veprimeve korrigjuese, pas ndodhjes së një kontigjence.

Për sa më lart parashtruar, duke analizuar çdo proçes që konsiderohet thelbësor për të menaxhuar funksionimin e sistemit të transmetimit dhe për të ruajtur sigurinë operative të rrjetit, OST sh.a. ka raportuar për vitin 2021 dukë përfshirë sa vijon:

- planifikimin operacional;
- skedulimin;
- operimin në kohë reale,
- alokimin dhe planifikimin e rezervave dhe shërbimeve ndihmëse;
- masat për mbrojtjen dhe restaurimin e sistemit.

1.3.3.1 Nivelet e tensionit

Sistemi i transmetimit përbëhet në tërësinë e tij nga linjat e transmetimit dhe nënstacionet transformuese. Aktualisht ky rrjet përbëhet nga 21 nënstacione dhe afërsisht 3360 km linja të tensionit të lartë, për të gjitha nivelet e tensionit 400 kV, 220 kV, 154 kV, dhe 110 kV.

Sistemi i transmetimit paraqitet në mënyrë skematike të thjeshtuar në grafikun në vijim:



Figura 33 Rrjeti i Transmetimit 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV

Në dispozitat e Kodit të Transmetimit, të "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, si dhe në "Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit për vitin 2021", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2020, përcaktohet se, OST sh.a. duhet të respektojë diapazonet e tensioneve sipas këtyre niveleve:

Për nivelin 400 kV diapazoni i lejuar është -10% ; +5% (nga 360 kV deri 420kV)

Për nivelin 220 kV diapazoni i lejuar është -10% ; +10% (nga 198 kV deri 242kV)

Për nivelin 110 kV diapazoni i lejuar është -10% ; +10% (nga 99 kV deri 121 kV)

Niveli i tensionit në rrjetin e transmetimit varet nga zhvillimi i rrjetit, tipologjia e tij, si dhe shpërndarja e gjenerimeve dhe e konsumit në këtë rrjet. Pjesa më e madhe e njësive gjeneruese të sistemit energjitik shqiptar është instaluar në veri të vendit, nga ku injektohet energjia në rrjet dhe për pasojë, shfaqen dhe tensione relativisht të larta. Ndërsa në jug të vendit, ku është përqëndruar një pjesë e ngarkesës shfaqen tensione relativisht të ulëta.

Për shkak të amortizimit të rrjetit unazor 110 kV, në periudhat me shumë reshje, kur dhe gjenerimi i centraleve është maksimal, shfaqen mbingarkime të palejuara të linjave 110 kV. Në rajonin veri-lindor, në sezonin e pikut të gjenerimit, rrjeti i transmetimit është përballur në segmente të caktuara me nivele të larta tensioni. Duke pasur parasysh dhe kushtet e vështira të motit dhe të terrenit ku kalojnë linjat, ndërprerjet kanë qenë prezente dhe kjo gjë ka sjellë disa herë probleme në operimin optimal të burimeve hidrike të zonës. Kjo situatë është prezente tashmë dhe për normalizimin e saj, OST sh.a. vijon të realizojë investime në rehabilitimin e rrjetit 110 kV.

Investimet e realizuara gjatë vitit 2021 në rrjetin e transmetimit janë:

- rikonstruksioni i anës 110 kV të nënstacionit Ibë;
- punimet për përfundimin e linjës kabllore 110 kV Tiranë-Selitë dhe lidhja me nënstacionin 110/20 kV Kombinat;
- spostimi i linjës ajrore 220 kV dopjo qark Tirana 2 – Elbasan 2;
- zgjerimi dhe rritja e kapaciteteve të transmetimit mbi rrjetin OPGW;
- rikonstruksioni i linjës Dopjo qark Lac 2-Ura e Matit Skuraj;
- zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e tensionit të lartë.

Gjithashtu janë në proces implementimi investimet me fondet e OST sh.a. si më poshtë vijon:

- ndërtimi i nënstacionit 220/110/35 kV, Shumat, si dhe i traktit 220 kV, në nënstacionin 220/110/10 kV, Komsi;
- linja e re me dy qarqe 220 kV Komsi – Shumat;
- furnizim dhe vendosje shunt reaktor 400 kV në nënstacionin Tirana 2;
- ndërtimi i linjës me dy qarqe 110 kV Fibër-Librazhd dhe traktet e linjave përkatëse në nënstacionin Fibër e Librazhd;
- ndërtimi i linjës së re 110 kV, me një qark Cerrik – Kajan – Kuçovë – Jagodinë dhe rehabilitimi i trakteve dalëse të linjave 110 kV të n/s Cerrik dhe Kuçovë;
- punime primare, furnizim dhe vendosje i TR 63 MVA, 220/20 kV, në n/stacionin Tirana 1, si dhe punime sekondare për përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese;
- ndërtimi i bazamentit të AT 110 MVA 220/110/35 kV në n/stacionin Sharrë.

Lidhur me ruajtjen e gjendjes normale të sistemit nga shqyrtimi i raportimeve të OST sh.a. rezulton se gjatë vitit 2021, personeli operativ në qendrat dispecer përkatëse, të OST sh.a. dhe OSSH sh.a. ka qenë në çdo moment në gjendje gatishmërie, duke koordinuar kryerjen e veprimeve operative në kohën me të shkurtër të mundshme, si dhe duke kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ngarkesat e linjave në tërësi, por me përparësi linjat 110 kV, si pjesa më e ngarkuar dhe më problematike e sistemit.

OST sh.a. raporton se gjatë vitit 2021, pavarësisht tipologjisë së sistemit dhe problemeve të konstatuara në rrjetin 110 kV, vlerat e tensionit kanë qënë brenda diapazoneve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, në "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, si dhe në "Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit për vitin 2021", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2020.

1.3.3.2 Kontrolli i frekuencës

Çdo OST në një zonë sinkron është përgjegjëse për ta mbajtur frekuencën e qëndrueshme. Koncepti i kontrollit fuqi-frekuencë merr parasysh Rezervën për Mbajtjen e Frekuencës (FCR), Rezervën për Rivendosjen e Frekuencës (FRR) dhe Rezervën Zëvendësuese (RR), të cilat pjesërisht aktivizohen automatikisht ose manualisht. Veprimet e mundshme për mbajtjen e frekuencës i ndajmë në dy kategori: parandaluese dhe kuruese. Veprimet parandaluese i referohen masave, të cilat aktivizohen për të mbajtur frekuencën në intervalin standard të frekuencës. Veprimet kuruese lidhen me devijimet më të mëdha të shkaktuara për shëmbull nga avari në centrale.

Duke filluar nga data 01.04.2021, kontrolli i frekuencës për sistemin e transmetimit menaxhohet në mënyrë të automatizuar nga FCR dhe aFRR. Nëse është e nevojshme, rezervat shtesë aktivizohen ndonjëherë manualisht (mFRR ose RR). Veprimet parandaluese, FCR dhe aFRR janë vazhdimisht aktive për të kundërvepruar në rast të imbalancave të sistemit. Veprimet kuruese mFRR dhe RR aktivizohen në mënyrë manuale nga operatorët e QKD.

Për sa më lart, në zbatim të kërkesave dhe përcaktimeve për operimin e integruar dhe funksionimin e qëndrueshëm të Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar, sipas ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike",i ndryshuar, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.186, datë 10.11.2017, i ndryshuar, "Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr.106 datë 02.07.2020, edhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 275 datë 28.12.2021, i cili ka miratuar Rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike të cilat kanë hyrë në fuqi më 01.04.2021. OST sh.a. i ka marrë shërbimet balancuese nga përdoruesit e kualifikuar si Ofrues të Shërbimit të Balancimit: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a., Ayen as Energji sh.a., Devoll Hydropower sh.a., dhe pjesërisht për Rezervat e Rivendosjes Manuale të Frekuencës dhe Rezervat Zëvendësuese nga Kurum International sh.a.

1.3.3.3 Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive

Gjatë procesit të vlerësimit të mjaftueshmërisë në zonën e përgjegjësisë, OST sh.a. ka vlerësuar mundësinë e plotësimit të kërkesës totale të vendit, duke konsideruar gjenerimin disponibël nga të gjithë gjeneruesit, në kombinim me aftësinë e linjave të interkoneksionit, me skenarë të ndryshëm operacionalë, duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive dhe reaktive.

Vlerësimi i rezervave kryhet në përputhje me metodën deterministike dhe duke observuar vlerat historike. Në bazë të Kodit të Transmetimit, Manualit të Operimit të ENTSO-E (SO-GL) dhe Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.106, datë 02.07.2020, OST sh.a. ka prokuruar rezervën balancuese të nevojshme për ruajtjen e balancës së zonës së kontrollit në mënyrë të vazhdueshme.

1.3.3.4 Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së

Planifikimi

OST planifikon zhvillimin e sistemit të transmetimit në përputhje me kriterin (N-1) të Sigurisë Operacionale. OST sh.a. bashkëpunon me OST fqinje për të koordinuar zhvillimin e rrjetit të

interkoneksionit e në të njëjtën kohë merr në konsideratë zhvillimin e rrjetit/objekteve të përdoruesve të sistemit të transmetimit në planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

1.3.3.5 Planifikimi afatgjatë

Qëllimi kryesor i planifikimit afatgjatë është të identifikojë konxhestionet e ardhshme strukturore në rrjet, zakonisht falë analizave të sigurisë N-1 ose N-k dhe më pas të gjejë mënyrën më të mirë për t'i zgjidhur ato. Dy mekanizmat kryesorë për studime të tilla të rrjetit janë:

- studimet ad-hoc të rrjetit (horizonti kohor < 5-10 vjet): nxitur nga modifikimet lokale të rrjetit, për shembull në rast të një kërkese të re për kyçje në rrjet ose çaktivizimit të një elementi kryesor të rrjetit;
- planet afatgjata të zhvillimit (horizonti kohor > 5-10 vjet): studime globale dhe strategjike të kryera në baza të rregullta, duke marrë parasysh zhvillimin kombëtar dhe ndërkombëtar të rrjetit.

Tradicionalisht zgjidhja kryesore për të eleminuar pikat e dobëta është zhvillimi i rrjetit, duke ndërtuar linja të reja transmetimi kabllo ose duke instaluar transformatorë. Sidoqoftë, meqënëse është më e vështirë të zbatohen zgjidhje të tilla (kosto të larta, kohëzgjatje të gjatë të projektit) nga OST merren parasysh edhe zgjidhje të reja dhe inovative, siç janë skemat e veçanta të mbrojtjes ose vendosja e pajisjeve të kontrollueshme.

1.3.3.6 Planifikimi afatmesëm

Planifikimi afatmesëm mbulon aktivitetet që fillojnë nga viti në vazhdim. Në këtë hark kohor, OST fokusohet në planifikimin e ndërprerjeve, të cilat duhet të koordinohen nëse ndikojnë në funksionimin e sistemeve fqinje. Kjo përfshin asetet e veta, si dhe njësitë gjeneruese ose objekte të tjera të rëndësishme. Rëndësia e aseteve të nevojshme për t'u koordinuar rrjedh në bazë të një metodologjie, e cila përfshin aspekte cilësore dhe sasiore, si afërsia me kufijtë e një zone kontrolli ose efekti në vlerat elektrike nga simulimet e fluksit të energjisë.

1.3.3.7 Planifikimi afatshkurtër

Planifikimi afatshkurtër përfshin disa nënproçese. Proçesi i një javë në avancë merret me planifikimin e ndërprerjeve me një njoftim të shkurtër (kërkesa për javën në vazhdim) dhe aktivizimin e centraleve shtesë, të cilat janë të nevojshme për të ruajtur sigurinë e sistemit.

Alokimi i kapaciteteve fillon dy ditë përpara dhe përcakton kapacitetet maksimale të transferimit ndërmjet zonave të ndryshme të ofertave. Vlerësimi përsëritet një ditë para dhe brenda ditës.

Proçesi i ditës në vazhdim përqëndrohet në planifikimin e veprimeve përmirësuese për të parandaluar të gjitha konxhestionet, të cilat mund të ndodhnin ditën e nesërme. Në mënyrë tipike, veprimet korrigjuese planifikohen në bazë kombëtare dhe më pas koordinohen me të gjithë fqinjët përkatës. Rezultatet nga planifikimi i ditës në vijim përditësohen brenda ditës, bazuar në parashikimet e reja. Analizat në planifikimin e ditës në vijim bazohen në modele të gjendjes së qëndrueshme.

1.3.3.8 Operimi në kohë reale

Në operimin në kohë reale, operatori i OST monitoron dhe vlerëson sigurinë e sistemit të transmetimit me anë të analizave të gjendjes së qëndrueshme. Gjithashtu verifikohen veprimet parandaluese korrigjuese të përcaktuara nga planifikimi operacional. Nëse identifikohen konxhestione të mundshme ose shkelje të niveleve të tensionit, operatori duhet të marrë veprime të arsyeshme korrigjuese për të zgjidhur problemet. Për shkak të kufizimeve kohore, operatori duhet të bëjë vlerësimin pa mbështetjen e një mjeti optimizimi. Nëse ndodh një kontingjencë reale, operatori duhet të rivendosë sigurinë N-1 sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rast të situatave emergjente zbatohen

veprimet nga plani i mbrojtjes. Kontrolli i frekuencës është i automatizuar. Veprimet manuale nga operatori janë të nevojshme nëse ndodhin devijime më të mëdha të frekuencës ose nëse rezervat për kontrollin e frekuencës janë pothuajse të shteruara.

Një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV, që furnizon me energji elektrike nënstacionet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës është ndërtuar përpara 40 vitesh dhe përbëhet nga linja ajrore të amortizuara, ndaj propabiliteti i dëmtimit është tepër i lartë, ndërkohë kapaciteti transmetues i tyre është drejt ezaurimit të plotë. Aktualisht vlerat e ngarkesës për rajonin e Tiranës për datën 22 dhjetor 2021 paraqiten në tabelën më poshtë:

22.12.2021	1.0	2.0	3.0	4.0	5.0	6.0	7.0	8.0	9.0	10.0	11.0	12.0	13.0	14.0	15.0	16.0	17.0	18.0	19.0	20.0	21.0	22.0	23.0	24.0	MAX
Selita	63	50	43	40	40	43	61	92	110	116	113	109	108	107	109	110	114	119	119	120	116	110	99	80	120
Traktora	54	43	37	35	35	40	58	82	93	94	89	86	87	89	89	91	96	104	107	108	107	102	89	70	108
Kombinat	13	11	9	9	9	11	16	22	24	25	24	24	23	24	24	25	27	30	30	30	29	27	23	17	30
Qender	24	20	19	18	18	18	23	33	43	49	50	50	46	46	45	44	44	46	46	46	46	41	36	30	50
Farka	21	18	16	16	16	17	22	28	31	32	31	30	29	28	29	30	33	36	36	36	35	34	30	25	36
Ibe	-2	-2	-2	-2	-2	-2	-1	-1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0	0	1	1
Kashar	41	35	33	32	32	37	50	69	84	87	84	81	77	77	78	78	82	87	85	83	80	74	62	52	87
Tir1(220/20kV)	42	33	29	28	28	34	51	70	78	78	74	72	72	72	73	74	80	85	86	87	86	81	70	55	87
TOTAL	256	208	184	175	175	199	280	394	462	480	464	451	442	443	448	452	476	507	511	510	501	469	407	330	511

Figura 34 Vlerat e ngarkesës për rajonin e Tiranës për datën 22 dhjetor 2021

Në skemën e mëposhtme mund të vihet re se kriteri N-1 nuk plotësohet për këtë rajon, gjithashtu në gjendje N linjat janë të ngarkuara pranë limitit termik. Veçanërisht L110 kV Sharrë - Selitë dhe L110 Tirana1 - U.Traktora.



Figura 35 Diagramë njëfazore e rajonit të Tiranës

Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike të rajonit të Tiranës lidhet me realizimin e projektit nga OST sh.a. për ndërtimin e N/stacionit Tirana 3 dhe linjat e reja 110kV me n/stacionin Selitë dhe N/stacionin U.Traktora. Ky projekt përfshin:

- ndërtimin e nënstacionit të ri 400/110 kV, me fuqi 2x150 MVA (Tirana 3);
- demontimin e linjave ekzistuese dhe ndërtimin e linjave të reja 110 kV Tiranë – U.Traktora, dhe U.Traktora – Selitë;
    - Linja kabllore 110 kV Tirana1 – U. Traktora

- Linja ajrore 110 kV U.Traktora – Tirana 3
- Linja 110 kV Tirana 3 – Selitë

- lidhjen e nënstacionit të ri me rrjetin ekzistues të transmetimit.

Ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110 kV (Tirana3) dhe fuqizimi i rrjetit 110 kV do të rrisë cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe sigurinë e operimit të rrjetit të transmetimit në rajonin e Tiranës për situatën aktuale dhe në vazhdimësi për vitet e ardhshme.

1.3.4 Protokolli i bashkëpunimit operativ për operimin në kohë reale ndërmjet OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

OST sh.a. dhe OSSH sh.a. do të angazhohen që të dy qendrat dispecer të OST, dhe OSSH të monitorojnë parametrat kryesore të Sistemit Elektronergjitik, si rryma, tensione në linja dhe transformatorë, veçanërisht në linjat e rajonit të Tiranës, respektivisht secili në zonat e veta të vëzhgimit.

Në rast avarie, operatorët e n/stacionit (OST, OSSH) duhet marrin menjëherë dhe pa vonesë sinjalet e veprimit të mbrojtjeve dhe të raportojnë në qendrat dispecer përkatëse. Mbi bazën e vlerësimit të tyre, kur gjykohet e arsyeshme, Dispeceria OST dhe OSSH do të bashkëpunojnë për rikyçjen pa vonesë të elementit të stakuar.

Në funksion të zvogëlimit të kohës së ndërprerjes, vlerësohet çdo informacion tjetër që merret në rrugë operative në lidhje me elementin e stakuar.

Në rastet kur prova e rikyçjes rezulton e pasuksesshme, të dy qendrat dispecer marrin masa për rikonfigurimin përfundimtar të skemës, sipas regjimeve të vendosura pas avarisë, si më sipër, me kufizimet e detyruara të energjisë, deri në normalizimin e gjendjes.

1.3.4.1 Sistemet e Kontroll - Monitorimit Automatik

Për të përmbushur objektivat, OST mundëson kontrollin automatik të rrjetit të transmetimit nepërmjet sistemeve të kontrollit lokal (sisteme të a në nënstacione), si dhe nëpërmjet sistemeve SCADA/EMS, sisteme në operim nga operatorët e dispecerisë. Këto sisteme mundësojnë monitorimin dhe operimin në kohë reale të të gjitha nënstacioneve 220/400kV, si dhe pjesës më të madhe dhe më të rëndësishme të nënstacioneve 110kV. Krahas tyre, monitorohen dhe operohen centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit. Aktualisht, OST sh.a. monitoron në kohë reale në sistem këto të dhëna:

a) flukset e fuqisë aktive dhe reaktive;
b) tensioni në zbara;
c) rrymat në linja, transformatore dhe elementë të tjerë të sistemit të transmetimit;
d) frekuenca dhe gabimi i kontrollit të rivendosjes së frekuencës në zonën e vet të LFC;
e) monitorimi dhe kontrollit i Bllokut AK (OST-KOSTT);
f) rezerva e fuqisë aktive dhe reaktive;
g) gjenerimi dhe konsumi.

Krahas operimit në kohë reale të sistemit të transmetimit, në sistemin SCADA/EMS janë të implementuara aplikacionet e rrjetit EMS, ku ky i fundit është paketa e aplikacioneve të rrjetit, e cilat nëpërmjet studimeve të brëndshme të sistemit, bazuar në gjendjen aktuale të tij dhe në paramentrat e çdo elementi të sistemit energjitik të përfshirë në SCADA, optimizon gjendjen e sistemit. Ndër funksionet e tjera, EMS mbulon:

- suportin në vendimmarrje;
- kontrollin mbi gjenerimin;
- planifikimin e energjisë;
- analizat e sigurisë;
- suport për manovrime të mundshme;
- monitorimin e rrjetit energjitik.

Moduli EMS përbëhet nga disa aplikacione të cilat bashkëveprojnë në rrjet me njëra-tjetrën dhe në të njëjtën kohë mund të menaxhohen individualisht nga njëra-tjetra. Secili nga aplikacionet e rrjetit të përfshira në paketën EMS është i implementuar si paketë software-ike, e ndarë nga aplikacionet e tjera, por që ndërfaqësohen mes tyre me anë të bazës së të dhënave në kohë reale. Modularizimi në këtë mënyrë ofron lehtësira në menaxhimin e paketës EMS në tërësi. Përveç studimeve mbi stacionet nga të cilat monitorohen në kohë reale, EMS, duke u bazuar në të dhëna referuese kryen studime edhe për nënstacionet e tjera të cilat nuk janë përfshira në monitorim.

Në qendrën e kontrollit të OST sh.a. është implementuar paketa AGC (Automatic Generation Control), modul i cili rregullon prodhimin e gjeneratorit në mënyrë që të mbajë frekuencën dhe shkëmbimin në vlerat e skeduluara. Ky modul është konfigururar duke iu përmbajtur manualeve operacionale të publikuara nga ENTSO-E.

Moduli kryesor i paketës AGC është LFC (Load Frequency Control), aplikacion i cili mbledh, analizon dhe përgatit të dhëna hyrëse, llogarit gabimin e kontrollit të zonës (devijimin nga vlerat e planifikuara - ACE) dhe nga ajo llogarit ndryshimin total të kërkuar të energjisë të OST-së në Shqipëri. Devijimi nga vlerat e planifikuara i dërgohet si kërkesë për kontribut të gjitha njësive që janë në kontrollin e LFC.

OST sh.a. disponon rrjet telekomunikacioni të dedikuar për operimin e sigurt të sistemit. OST sh.a ka një qendër rezervë të kontrollit të lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë e cila është e pajisur me pajisje kontrolli. Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren apo përftohen dhe përpunohen në mënyrë të dyfishtë me anë të kanaleve të ndryshme.

1.3.4.2 Menaxhimi i fluksit të energjisë

Menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operacionale për të mbajtur rrjedhën e flukseve të energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operacionale është i nevojshëm një informacion i saktë mbi gjendjen e sistemit dhe vlerësimit të tij. OST sh.a. kontrollon parametrat operacionale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operativë nga zona e observimit që përfshin pjesë të OST-ve fqinje.

Çdo element i sistemit të transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të sistemit të transmetimit, duke marrë parasysh kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetrimin e parakohshëm të paisjes.

1.3.4.3 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi

OST sh.a. përfiton analiza sigurie nga Qendra e Koordinimit të Sigurisë, SCC Ltd. Belgrade (Regional Security Coordinator for SEE), nëpërmjet një kontrate si përdorues i shërbimeve të SCC Ltd. Belgrade. Kjo kontratë përfshin 5 shërbimet e mëposhtme:

i. vlerësimin dhe përmirësimin e modelit të rrjetit individual/të përbashkët (IGM/CGM);

ii. llogaritja e koordinuar e kapacitetit (ndërkufitar);

iii. koordinimi i analizës së sigurisë (përfshirë masat përmirësuese, parandaluese);

iv. mjaftueshmëria, besueshmëria e punës në terma afatshkurtër/mesëm;

v. koordinimi i planifikimit të remonteve.

Siguria e operimit të sistemit është shkaku i realizimit të analizave të kontigjencës, të cilat OST sh.a. i realizon duke simuluar stakim të elementeve të sistemit të transmetimit. Kjo analizë kryhet duke përdorur modelin individual të OST sh.a. dhe modelin e përbashkët të rrjetit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës. Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, janë:

- sigurimi i parandalimit dhe/ose përmirësimit për sa i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në sistemin e transmetimit;
- koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në sistem dhe në interkoneksion;
- mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohë reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të përbashkët të rrjetit rajonal dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST sh.a., OSHEE sh.a. dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.

  Vërehet nga Raportimi se nga ana e OST-së nuk është cenuar në asnjë rast siguria e operirmit pergjatë vitit 2021 në rrejtin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

1.3.4.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike

OST monitoron qëndrueshmërinë dinamike të sistemit të transmetimit në termat e tensionit, frekuencës dhe qëndrueshmërisë së këndit të rotorit, me studime off-line, me matje në zonë të gjerë, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave relevante me OST-të e tjera kur është e nevojshme, në mënyrë që të jetë në gjendje për të marrë masat e nevojshme korrigjuese kur siguria operative e sistemit është në rrezik. Qëllimi i studimeve dinamike off line është të sigurojë ndërgjegjësimin e operatorit të OST-së në lidhje me gjendjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së sistemit në lidhje me qëndrueshmërinë në situatën (N) dhe në atë të mundshme (N-1). Përveç kësaj, studime të tilla ndihmojnë në vendimmarrjen për veprime përmirësuese sa më efikase, për parandalimin e incidenteve, nëse ato ndodhin, ose korrigjimin e pasojave të tyre.

Për sa më sipër, pavarësisht sfidave dhe çështjeve të sipërcituara, OST sh.a. ka arritur të menaxhojë situatat, si rrjedhojë, siguria operative e rrjetit si edhe parametrat e cilësisë së furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2021 kanë qënë në përputhje me kriteret dhe përcaktimet e Kodit të Transmetimit dhe"Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, si dhe brenda kufijve të caktuar te "Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit për vitin 2021", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2020.

Gjatë vitit 2021 në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nuk janë shënuar ngjarje apo cënuar kufijtë e sigurisë operacionale, sistemi i transmetimit ka funksionuar në mënyrë të qëndrueshme dhe në kushte normale operimi.

b) Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë 5-vjeçare

Në bazë të të dhënave historike të OST sh.a., duke marrë në konsideratë rritjen potenciale të gjenerimit të PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve joteknike në rrjetin e shpërndarjes është pranuar që rritja e pritshme e vëllimit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST sh.a., të jetë e rendit 1%. Mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesorë energjitikë dhe sigurimi i balancës së sistemit për 5-vjeçarin në vijim, 2022 - 2026, sikurse paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2022
I.	**Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST**	GWh	946	815	858	770	695	739	808	791	658	837	730	903	9,550
a)	Prodhim vendas	"	617	589	655	609	542	451	459	462	357	389	419	505	6,054
b)	Energji ne marrje	"	329	226	203	161	153	288	349	329	301	448	311	398	3,496
II.	**Energjia totale e transmetuar**	GWh	927	799	841	754	679	722	790	773	643	821	712	884	9,345
a)	Energji elektrike e dhene	"	180	160	165	125	115	145	125	105	85	225	95	100	1,625
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	657	564	586	524	454	477	565	578	473	501	512	659	6,550
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	90	75	90	105	110	100	100	90	85	95	105	125	1,170
III.	**Humbjet ne rrjetin e transmetimit**	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	19	16	17	16	16	17	18	18	15	16	18	19	205
b)	Humbjet ne %	%	2.01%	1.96%	1.98%	2.08%	2.30%	2.30%	2.23%	2.28%	2.28%	1.90%	2.45%	2.15%	2.15%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2023
I.	**Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST**	GWh	879	797	853	806	811	702	703	728	616	787	883	1050	9,615
a)	Prodhim vendas	"	570	580	680	610	555	450	390	360	300	400	450	610	5,955
b)	Energji ne marrje	"	309	217	173	196	256	252	313	368	316	387	433	440	3,660
II.	**Energjia totale e transmetuar**	GWh	860	780	835	790	795	685	685	710	600	770	865	1,030	9,405
a)	Energji elektrike e dhene	"	95	125	140	170	240	120	20	35	40	165	235	225	1,610
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	670	570	600	530	470	485	580	590	480	510	520	680	6,685
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	95	85	95	90	85	80	85	85	80	95	110	125	1,110
III.	**Humbjet ne rrjetin e transmetimit**	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	19	17	18	16	16	17	18	18	16	17	18	20	210
b)	Humbjet ne %	%	2.16%	2.13%	2.11%	1.99%	1.97%	2.42%	2.56%	2.47%	2.60%	2.16%	2.04%	1.90%	2.18%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2024
I.	**Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST**	GWh	900	808	933	866	796	712	713	709	637	797	889	1065	9,825
a)	Prodhim vendas	"	615	585	685	615	595	460	400	370	310	410	460	620	6,125
b)	Energji ne marrje	"	285	223	248	251	201	252	313	339	327	387	429	445	3,700
II.	**Energjia totale e transmetuar**	GWh	880	790	915	850	780	695	695	690	620	780	870	1,045	9,610
a)	Energji elektrike e dhene	"	105	120	220	230	220	125	15	5	55	170	240	235	1,740
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	675	580	600	530	470	485	590	595	480	510	520	685	6,720
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	100	90	95	90	90	85	90	90	85	100	110	125	1,150
III.	**Humbjet ne rrjetin e transmetimit**	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	20	18	18	16	16	17	18	19	17	17	19	20	215
b)	Humbjet ne %	%	2.22%	2.23%	1.93%	1.85%	2.01%	2.39%	2.52%	2.68%	2.67%	2.13%	2.14%	1.88%	2.19%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2025
I.	**Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST**	GWh	914	872	944	814	785	757	829	792	675	755	836	942	9,915
a)	Prodhim vendas	"	600	605	710	640	615	480	420	390	330	430	480	640	6,340
b)	Energji ne marrje	"	314	267	234	174	170	277	409	402	345	325	356	302	3,575
II.	**Energjia totale e transmetuar**	GWh	893	854	926	798	769	739	810	772	658	738	817	921	9,695
a)	Energji elektrike e dhene	"	108	174	221	168	204	164	125	82	88	128	182	106	1,750
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	675	580	600	530	470	485	590	595	480	510	520	685	6,720
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	110	100	105	100	95	90	95	95	90	100	115	130	1,225
III.	**Humbjet ne rrjetin e transmetimit**	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	21	18	18	16	16	18	19	20	17	17	19	21	220
b)	Humbjet ne %	%	2.30%	2.06%	1.91%	1.97%	2.04%	2.38%	2.29%	2.53%	2.52%	2.25%	2.27%	2.23%	2.22%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2026
I.	**Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST**	GWh	921	818	943	877	802	723	760	800	697	808	909	1077	10,135
a)	Prodhim vendas	"	635	645	745	705	650	545	455	440	355	375	435	625	6,610
b)	Energji ne marrje	"	286	173	198	172	152	178	305	360	342	433	474	452	3,525
II.	**Energjia totale e transmetuar**	GWh	900	800	925	860	785	705	740	780	680	790	890	1,055	9,910
a)	Energji elektrike e dhene	"	105	120	220	230	220	125	45	75	105	170	240	235	1,890
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	680	580	605	535	470	485	595	600	485	520	530	690	6,775
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	115	100	100	95	95	95	100	105	90	100	120	130	1,245
III.	**Humbjet ne rrjetin e transmetimit**	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	21	18	18	17	17	18	20	20	17	18	19	22	225
b)	Humbjet ne %	%	2.28%	2.20%	1.91%	1.94%	2.12%	2.49%	2.63%	2.50%	2.44%	2.23%	2.09%	2.04%	2.22%

Figura 36 Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për periudhën 2022 - 2026

c) Niveli i pritshëm i kërkesës dhe prespektivës së sigurisë së furnizimit për një periudhë 5 deri në 15-vjeçare nga data e raportit

Në kuadër të studimit "Plani i investimeve dhe zhvillimit të rrjetit për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri 2018-2033", të finalizuar përgjatë vitit 2021 nga OST sh.a., rezulton se kjo e fundit ka realizuar parashikimin afatgjatë të kërkesës për një periudhë kohore deri në vitin 2040 (përiudhë 20-vjeçare) sipas skenarëve të ndryshëm të përzgjedhur.

Metodologjia e përdorur është parashikimi fillimisht i kërkesës totale të vendit për energji dhe më pas specifikisht i kërkesës për energji elektrike, nëpërmjet aplikimit të modelit të përdoruesve fundorë (*end-use model*), i cili vlerëson kërkesën e ardhshme për energji për çdo sektor të ekonomisë bazuar në skenarët afatmesëm deri në afatgjatë të zhvillimeve social-ekonomike, teknologjike dhe demografike. Parashikimi i kërkesës është realizuar për katër skenarë të përcaktuar si më poshtë:

- *skenari i lartë* – bazohet në modelimin që nuk përfshin gazin natyror (nuk parashikon gazifikim shtesë në Shqipëri);
- *skenari i moderuar* – paraqet skenarin ku infrastruktura e furnizimit me gaz natyror është e disponueshme si një nga format e energjisë për konsum;
- *skenari i ulët* – supozohet se rritja e ekonomisë do të jetë më e ngadaltë (migrimi do të jetë më i lartë dhe rritja e popullsisë më e ngadaltë);
- *skenari i lartë me popullsi më të ulët* – paraqet një skenar të lartë me rritje më të ngadaltë të popullsisë, ulje proporcionale të PBB-së dhe pa gazifikim të vendit.

Pra, si përfundim kemi dy skenarë pa gazifikim me popullsi të lartë dhe të ulët dhe dy skenarë me gazifikim të vendit me popullsi të lartë dhe të ulët, rezultatet e të cilëve paraqiten në tabelë dhe grafikisht si në vijim:

Parashikimi i Kërkesës për Energji Elektrike (TWh) 2020-2040								
	2020	2023	2025	2028	2030	2033	2035	2040
Skenari i Lartë	7.17	8.17	8.48	9.3	9.86	10.9	11.58	13.44
Skenari i Moderuar	7.17	8.07	8.32	8.92	9.34	10.07	10.55	11.91
Skenari i Lartë me popullsi të Ulë	7.17	8.05	8.28	8.93	9.37	10.23	10.8	12.39
Skenari i Ulët	7.17	7.89	8.02	8.41	8.69	9.23	9.585	10.44

Figura 37 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për përiudhën 2020-2040



	2020	2023	2025	2028	2030	2033	2035	2040
Skenari i Lartë	7.168	8.168	8.476	9.299	9.861	10.897	11.584	13.436
Skenari i Moderuar	7.168	8.068	8.315	8.921	9.34	10.067	10.549	11.914
Skenari i Lartë me popullsi të Ulët	7.168	8.05	8.283	8.928	9.373	10.233	10.803	12.392
Skenari i Ulët	7.168	7.888	8.018	8.414	8.694	9.23	9.585	10.438

Figura 38 Skenarët e parashikimit të kërkesës për energji elektrike

Siç vërehet nga tabela më lart, parashikimi i kërkesës për energji elektrike realizohet për periudha 2-vjeçare për periudhën 2020 – 2035 dhe për periudhën 5-vjeçare në vijim 2035 – 2040. Për vitin 2020, në skenarin e lartë të marrë në konsideratë nga OST sh.a. (7,168 TWh), rezulton me një diferencë prej 977 GWh më i ulët se fakti i vitit 2021 prej 8,145 TWh.

d) Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi

Të dhënat e mëposhtme paraqesin centrale të energjisë elektrike të cilat janë lidhur në rrjetin e transmetimit në vitin 2021, janë në fazë ndërtimi ose kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit, si vijon:

- Centrale që kanë nënshkruar marrëveshje për lidhje deri në vitin 2021 dhe pritet të energjizohen gjatë viteve 2022-2023:
  1. HEC-et Stavec (14.77 MW) – KOKA&ERGI sh.p.k.
  2. HEC-et Kalivarë (5.597 MW) – BE-IS ENERGY sh.p.k.
  3. HEC-et Gostimë (48.864 MW) – Egnatia Hydropower sh.p.k.
  4. HEC-et Bushtrica (10.03 MW) – ELENERGJI sh.p.k.+BUSHTRICA 2017 sh.p.k.
  5. Impianti Fotovoltaik në digën e Qyrsaqit (5.14 MWp) – KESH sh.a.
  6. Park Fotovoltaik Karavasta (140 MWp) – KARAVASTA SOLAR sh.p.k.
- Centrale që kanë nënshkruar marrëveshje lidhjeje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2021:
  1. HEC-et Dragobia & Ceremi (22 MW) – Dragobia Energy sh.p.k.
  2. Impianti Fotovoltaik në digën e Qyrsaqit (5.14 MWp) – KESH sh.a.
  3. Park Fotovoltaik Karavasta (140 MWp) – KARAVASTA SOLAR sh.p.k.

- Centrale që kanë marrë miratim në parim për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2021:
    1. Park Fotovoltaik Karavasta (140 MWp) – KARAVASTA SOLAR sh.p.k.
    2. Park Fotovoltaik Blue1 (57.6 MWp) – SPV Blue1 sh.p.k.
    3. Park Fotovoltaik Blue2 (57.6 MWp) – SPV Blue2 sh.p.k.
    4. Park Fotovoltaik ALB-Solar1 (50 MW) - INFO-Telecom sh.p.k.
    5. Impianti Fotovoltaik në digën e Qyrsaqit (5.14 MWp) – KESH sh.a.
    6. Park Eolik Karaburun (3 MW) - NIKOLICA SKI RESORT sh.p.k.
    7. Park Eolik Karaburun (3 MW) - RENEW POWER ALBANIA sh.p.k.
    8. Park Eolik Karaburun (3 MW) - SunPro sh.p.k.
    9. Park Eolik Karaburun (3 MW) – Suntech Power sh.p.k.
    10. Park Eolik Karaburun (3 MW) - A.Great Company sh.p.k.
- Centrale që kanë marrë opinion paraprak për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2021:
    1. Park Fotovoltaik Akerni (150 MWp) – EDIL-AL-IT sh.p.k.
    2. Park Fotovoltaik ARSOL SOLAR PARK1 (50 MWp) – ARSOL ENERGY sh.p.k.
    3. Park Fotovoltaik PREMIUM SOLAR PARK1 (30 MWp) – PREMIUM ENERGY sh.p.k.
    4. Park Fotovoltaik SHARP SOLAR PARK1 (20 MWp) – SHARP ENERGY sh.p.k.
    5. Park Fotovoltaik Seman (275 MWp) – GREENCELLS GMBH
    6. Park Fotovoltaik AGA SOLAR (150 MWp) – AGA SOLAR sh.p.k.
    7. Park Eolik Dropull (69.3 MW) – EU GREEN ENERGY sh.p.k.
    8. Park Eolik Karaburun (10 MW) – BRD Energy sh.p.k.
    9. Park Eolik Karaburun (10 MW) – GMT INVESTMENT sh.p.k.
    10. Park Eolik Karaburun (10 MW) – GRS Energy sh.p.k.
    11. Park Eolik Karaburun (10 MW) – MGN Energy sh.p.k.
    12. Park Eolik Karaburun (10 MW) – ORT INVESTMENT sh.p.k.
    13. Park Eolik Zona Lasare (3 MW) – M&K Energy Trading Co sh.p.k.

Për periudhën janar-dhjetor 2021 janë vënë në operim katër burime gjeneruese, centrale hidrike të lidhura në rrjetin e transmetimit 110 kV, si vijon:

- HEC-et Dragobia & Ceremi, lidhur në N/Stacionin 110/20 kV B.Curri;
- HEC-et Gjadër, lidhur në N/Stacionin 220/110/10 kV V.Dejës;
- HEC Arsti, lidhur në linjën 110 kV Fierzë-Dardhë;
- HEC-et Veleshica, lidhur në linjën 110 kV Lapaj-Seta.

e) **Parashikimi i investimeve për 5 (pesë) vitet e ardhshme, që OST sh.a. apo çdo palë tjetër planifikon të realizojë në lidhje me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkoneksionit**

Nga ana e OST sh.a. me anë të një konsulence të financuar nga ana e bankës Gjermane kfW është duke u përgatitur plani i zhvillimit të rrjetit të Transmetimit për një periudhe 15 vjeçare (2018-2033) i cili përgjatë vitit 2021 u konsultua me palët dhe me donatorët dhe pritet që të përcillet për miratim pranë ERE-s brenda vitit 2022.

1. **Parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit**

OST zbaton "Parimet e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar", që kanë të bëjnë me barrierat në shkëmbimin e energjisë, të cilat shkaktohen kryesisht nga kapaciteti i limituar i rrjetit interkonektiv, që nënkupton jo vetëm interkonektorët (linjat ndërkufitare), por çdo element të rrjetit të brendshëm që bëhet shkak për limitimin e transaksioneve apo transmetimit të energjisë nga një zonë në një tjetër.

Siguria e punës së Sistemit Elektroenergjitik është e lidhur ngushtësisht me vlerësimin dhe përcaktimin e kapacitetit transmetues. Gjatë vitit 2021, në sistemin e transmetimit është arritur plotësimi i kriterit të sigurisë N-, kryesisht për të gjitha regjimet e punës, dhe nuk janë hasur probleme të kufizimit të kapaciteteve transmetuese, me përjashtim të disa rasteve sporadike, të shfaqura në rrjetin 110kV, si pasojë e shpërndarjes se gjenerimeve dhe e konsumit në rrjet.

Përcaktimi i kapacitetit transmetues ndërkufitar, NTC, aktualisht bëhet sipas marrëveshjeve dypalëshe, të cilat janë nënshkruar mes OST sh.a. dhe OST-ve fqinje, dhe bazohet në marrëveshjen SAFA (Synchronous Area Framework Agreement for Continental Europe), dhe anekset e saj. E rëndësishme është të theksohet dallimi i qartë ndërmjet vlerave komerciale dhe atyre fizike, pasi siç dihet, ekzistojnë dy përcaktime, një i lidhur me vlerat e programit (skedulimit) dhe tjetri me fluksin fizik të energjisë elektrike, që në shumicën e rasteve nuk përputhen kur merret në konsideratë një interkonektor i veçuar nga pjesa tjetër e rrjetit. Kompleksiteti i anës fizike të fluksit të energjisë trajtohet nga OST. Pjesëtarët e tregut nuk përfshihen në këtë proces. Lidhur me menaxhimin e kapaciteteve ndërkufitare, në zbatim të rregullave të ENTSO-E, zbatohet procedura si në vijim.

Periudhat kohore të përcaktimit të kapacitetit transmetues ndërkufitar

Përcaktimi i NTC realizohet për periudhat kohore: vjetore, mujore, javore, një ditë përpara (D-1) dhe brenda ditës.

Të dhënat për modelin individual të rrjetit

Bazuar në dispozitat e Kodit të Transmetimit, përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit i mundësojnë OST-së informacionin e nevojshëm për përcaktimin e kapacitetit transmetues. Ky informacion përfshin, por nuk kufizohet në:

- informacionin lidhur me të dhënat teknike;
- informacionin lidhur me disponueshmërinë e pajisjeve dhe elementëve të rrjetit;
- informacionin lidhur me skedulimin e njësive gjeneruese.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, çdo njësi gjeneruese apo ngarkese i mundëson OST-së të gjitha të dhënat e specifikuara dhe ndërkohë operatori i sistemit përgatit modelin e rrjetit të zonës stonë të kontrollit, të cilit i vlerësohet konvergjenca para se t'i dërgohet OST-së koordinatore të rajonit, në mënyrë që të mundësojë llogaritjen e flukseve të fuqisë aktive, reaktive dhe tensionit, në analizat e qëndrueshmërisë statike që duhet të performohen.

Elementi kryesor për llogaritjen e NTC-së (Net Transfer Capacity) është dokumenti për përgatitjen e modelit rajonal të rrjetit "SEE regional common grid model for different time horizons", i përgatitur

nga Grupi Rajonal i Evropës Juglindore, nën Komitetin e Tregut të ENTSO-E. Ky dokument ofron dy elemente themelore për procesin e llogaritjes së NTC:

- tabelën e harmonizuar të rastit bazë të shkëmbimit (BCE);
- modeli i bashkuar i Rrjetit Rajonal për periudha kohore të ndryshme.

Alokimi i kapacitetit ndërkufitar për pjesëmarrësit e tregut në rajonin tonë bëhet nga Zyra e Ankandit të Koordinuar SEE CAO në Podgoricë.

Përllogaritja e NTC bëhet sipas rregullave dhe metodologjive në fuqi, ku NTC për sistemin tonë, sipas kufijve gjatë vitit 2021, rezulton si vijon:

Kufiri	NTC (MW/h)
AL->GR	400
AL->KS	400
AL->ME	300-400
Total	1100 -1200

Figura 39 NTC për vitin 2021

Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, dhe marrja e masave për menaxhimin e kërkesës për energji elektrike

Sikurse është paraqitur më sipër, OST sh.a. ka parashikuar kërkesën për energji elektrike, mbulimin e saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për 5 vitet e ardhshme 2022 - 2026. Ky parashikim është realizuar mbi bazën e të dhënave historike për 10 vitet e fundit, duke marrë në konsideratë konsumin mesatar ditor për çdo muaj, ku përllogaritet gradienti mesatar i rritjes së kërkesës për energji elektrike, që transmetohet nëpërmjet rrjetit për OSSH sh.a. dhe konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit për çdo vit.

Mënyra e mbulimit të kërkesës së pritshme është bërë në bazë të eksperiencës tashmë shumëvjeçare, duke marrë në konsideratë prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen potenciale të numrit dhe volumit të gjenerimit të PVE-ve dhe PPE-ve, eksportin e mundshëm nga ana e tyre në varësi të kushteve të tregut të brendshëm të energjisë dhe importit të energjisë që bëhet nga ana e FTL(OSHEE) dhe konsumatorëve të kualifikuar.

Importi i energjisë nga OSHEE sh.a., për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe nga furnizuesit për konsumatorët respektivë është llogaritur në mënyrë komplementare me probabilitetin e përzgjedhur të prodhimit nga hidrocentralet e vendit. Ndryshimi i sasisë vjetore të importit që mund të diktohet nga ndryshimi i prodhimit të vendit, si rrjedhojë e ndryshimeve të situatës hidrike, siç e ka treguar përvoja e deritanishme, nuk e ndryshon planifikimin e kërkesës për energji elektrike.

Modelet e pritshme të llogaritura nga OST sh.a., të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, jepen të grupuara në tabelën e mëposhtme. Këto vlerësime japin të dhëna indikative të ecurisë së këtyre parametrave për periudhën 5-vjeçare dhe shërbejnë për efekte të planifikimit që realizon OST sh.a.

Viti	2022	2023	2024	2025	2026
Gjenerimi [GWh]	6054	5955	6125	6340	6610
Shkëmbimi [GWh]	1871	2050	1960	1825	1635
Konsumi [GWh]	7925	8005	8085	8165	8245

Figura 40 NTC Modelet e pritshme të prodhimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit

2. **Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të rrjetit të transmetimit në nivel kombëtar, rajonal dhe europian**

OST sh.a. kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergjitik shqiptar me sistemet e vendeve fqinje. Studimet më të rëndësishme dhe që kanë rëndësi të veçantë kryhen në bashkëpunim me institucionet studimore ndërkombëtare në kuadrin e WBIF.

Gjatë fazave të planifikimit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me qëllim: (i) Rehabilitimin dhe fuqizimin e rrjetit të transmetimit; (ii) krijimin e nyjeve të reja lidhëse; (iii) përmirësimin e proçesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj., OST sh.a. merr në konsideratë zhvillimin kombëtar dhe rajonal në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E.

Projektet në proçes implementimi dhe ato të planifikuara synojnë rritjen e cilësisë së shërbimit të sistemit të transmetimit, e cila mund të garantohet plotësisht nëpërmjet realizimit të investimeve të nevojshme për fuqizimin dhe modernizimin e tij.

Investimet e parashikuara nga OST sh.a. për linjat e interkoneksionit dhe për ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në eleminimin e konxhestioneve në linjat e interkoneksionit.

- **Ndërtimi i linjës së interkoneksionit 400 kV Elbasan 2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan 2 – Fier, si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan 2 dhe Fier**

Financimi i këtij projekti realizohet nga Bashkëpunimi Gjermano - Shqiptar i Zhvillimit.

Ky projekt përforcon lidhjet interkonektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon. Në të njëjtën kohë, projekti zhvillon rrjetin 400 kV në zonën jugore të Shqipërisë ku parashikohet të ndërtohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike që do të jenë pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian.

Projekti përfshin:

- Ndërtimin e një linje të re transmetimi 400 kV me një qark, ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe për të përforcuar linjen ekzistuese të transmetimit 220 kV Elbasan – Fier. Traseja e Linjës Elbasan - Bitola do të ketë një gjatësi 56 km, ndërsa linja Elbasan – Fier 74 km.
- Ndërtimin e nënstacionit të ri Elbasan 3, përforcimin dhe zgjerimin e nënstacionit ekzistues të Fierit. Nënstacioni i ri Elbasan 3 do të zgjerojë nënstacionin ekzistues 400/220 kV Elbasan 2, me një impiant në nivelin 400 kV për të lidhur linjat Tiranë 2, Zemblak, Fier dhe Maqedoni e Veriut, si dhe instalimin e një shunt reaktori. Gjithashtu, nënstacioni Fier do të zgjerohet dhe pajiset me transformatorë 400/220 kV dhe një impiant në nivelin 400 kV për të mundësuar lidhjen e linjës se re 400 kV qe vjen nga Elbasan 3.
- **Rikonstruksioni i linjës së interkoneksionit 220 kV Vau i Dejës (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)**

Ndërtimi i kabllit HVDC midis Italisë dhe Malit të Zi do të mundësojë shitjen e tepricave të gjenerimit të ardhshëm në zonën e Ballkanit dhe në të njëjtën kohë do të sjellë forcimin e mëtejshëm të rrjetit të transmetimit në rajon.

Shumë nisma të reja për ndërtimin e centraleve të burimeve të rinovueshme po zhvillohen në veri të Shqipërisë dhe për këtë arsye, nevojiten përforcime të linjave ekzistuese të interkoneksionit për të siguruar shkëmbimet ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Linja ajrore aktuale e interkoneksionit Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi) është ndërtuar në vitin 1972 dhe ka një kapacitet të fuqisë së transmetueshme rreth 278 MVA.

Projekti përfshin:

Rikonstruksionin e linjës ajrore 220 kV Vau i Dejës - Koplik (AL) – Podgoricë, me një linjë të re ajrore me qark të dyfishtë, afërsisht 45 km e gjatë me përcjellës të llojit alumin-çelik 490/65 mm2.

Përfitimet që arrihen nga kryerja e këtij investimi janë:

- rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së rrjetit shqiptar dhe të Malit të Zi;
- rritja e shkëmbimit ndërkufitar midis dy vendeve;
- rritja e Kapaciteteve Neto të Transferimit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, duke marrë në konsideratë shkëmbimet e energjisë elektrike midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë;
- reduktimi i konxhestioneve të rrjetit;
- përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike;
- një ulje të humbjeve teknike;
- reduktimin i niveleve të CO^2;
- **Ndërtimi i linjës së re 110 kV Ulqin (Mali i Zi) -Velipojë (Shqipëri)**

Ndërtimi i linjës 110 kV Kufi – Velipojë është pjesë e linjës së re që është konceptuar të ndërtohet dhe do të lidhë N/stacionin e Ulqinit (Mali i Zi) me N/stacionin e Velipojës së re (Shqipëri).

Aktualisht projekti është në fazat fillestare dhe për realizimin e tij do të vendoset bashkëpunimi ndërmjetdy operatorëve të transmetimit të dy vendeve, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ulqini dhe Velipoja janë dy zona me potencial shumë të madh turistik dhe sigurimi i infrastrukturës energjitike do të garantonte ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm turistik të zonave në fjalë.

Gjithashtu, zonat e Ulqinit, Bushatit dhe Velipojës kanë potencial për zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike, kryesisht nga era.

Linja 110 kV që do të ndërtohet, do të jetë afërsisht 8 km e gjatë, nga kufiri deri në nënstacionit të Velipojës, me përcjellës ACSR-240m^2.

- **Ndërtimi i një linje të re ajrore 110 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës**

Duke marrë në konsideratë potencialin e lartë gjenerues hidrik, por dhe të burimeve të tjera të rinovueshme që pritet të realizohen dhe të lidhen në rrjetin e transmetimit në zonën verilindore të vendit, po studiohet mundësia e lidhjes më një linjë interkoneksioni 110 kV, në formë unaze, nga kjo zonë e Shqipërisë [(N/stacioni Bajram Curri dhe N/stacioni Kukës) drejt zonave me konsum të lartë të Kosovës, si Deçani, Dragashi, Prizreni etj.

Në këtë mënyrë do të shfrytëzohet fakti i diversifikimit të prodhimit të energjisë kur dihet se Kosova bazohet mbi prodhimin me linjat.

Potencialisht, kjo do të sjellë ulje të mundshme të kostove të prodhimit nga gjeneruesit e të dy vendeve dhe blerjen e humbjeve nga operatorët e sistemit të transmetimit me kosto sa më të ulët. Diversifikimi do të bëjë të mundur administrimin më të mirë të shërbimeve ndihmëse, duke balancuar më mirë sistemin për shkak të disbalancave që mund të vijnë nga shtimi i burimeve të rinovueshme.

Ky projekt do të rrisë gjithashtu sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët, por në të njëjtën kohë do të ketë ndikim pozitiv dhe për gjeneruesit, duke përmirësuar nivelet e tensionit.

f) Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit

Gjatë muajve janar – dhjetor 2021, OST sh.a. ka ndjekur në vazhdimësi realizimin e punimeve të planifikuara (remontet e planifikuara), problemet dhe avaritë që janë ndeshur gjatë operimit të sistemit të transmetimit, duke bërë ndërhyrjet e nevojshme rast pas rasti.

Me gjithë vështirësitë dhe problematikat që krijohen, kryesisht në stinën e dimrit, OST sh.a. ka raportuar se për vitin 2021 ka realizuar të gjitha remontet e planifikuara dhe ka marrë masa për eleminimin në kohë të avarive që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe.

Punimet për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit që realizohen nga OST sh.a. klasifikohen në tri kategori:

- punime të planifikuara në përputhje me grafikun vjetor të remonteve;
- punime jashtë radhe (të paplanifikuara);
- punime për eleminimin e avarive të shfaqura në sistem.

Rezultati i punimeve të realizuara për mirëmbajtjen e rrjeteve jepet edhe nga treguesit e pasqyruar në tabelën në vijim, të cilët paraqesin situatën në rrjetin e transmetimit. Sikurse evidentohet në tabelë, problematika dhe stakimet më të mëdha të elementëve të rrjetit të transmetimit janë në rrjetin 110 kV.

Emertimi	Stakime gjithsej	Tranzi tore	Qendru eshmerie	Kushte atmosf.	Defekte linje	Paisje primare	Paisje sekondare	SHAM SHAF	OSSH sha	Te tjere
Linja 400kV	17	7	6	3	0	0	0	1	0	0
Linja 220kV	85	44	17	8	7	1	4	1	0	3
Linja 110kV	456	201	49	59	33	13	80	12	0	9
Linja gjithsej	558	252	72	70	40	14	84	14	0	12

Figura 41 Avaritë në sistemin e transmetimit

g) Masat e marra nga OST sh.a. për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, si dhe për rritjen e sigurisë së furnizimit në rast nevoje

Në kuadër të rritjes së sigurisë së furnizimit dhe për menaxhimin e situatës energjitike në nyjet kritike të sistemit, për përiudha të caktuara kohore, kryesisht gjatë sezonit të verës dhe gjatë sezonit të dimrit (gjatë përiudhës së festave të fund vitit), OST sh.a. ka ndërmarrë masa shtesë për përballimin e situatave dhe për bashkëveprim me OSHEE sh.a./OSSH sh.a. Këto masa kanë garantuar një operim më eficient në kuadër të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit dhe sigurisë së tij.

Masat shtesë të ndërmarra përfshijnë si vijon:

- plan masash veprimi sipas situatave të paraqitura;
- ngritje të grupeve të përbashkëta pune me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes se Energjisë Elektrike;
- analizë të detajuar të ngarkimit të rrjetit të transmetimit të Rajoneve të përcaktuara si kritike;
- analizë dhe renditje të veprimeve operative për regjim normal dhe stakim të mundshëm të linjave apo autotransformatorëve sipas rastit të trajtuar si më problematike;

- mbajtja në gatishmëri të vazhdueshme e brigadave të linjave dhe të brigatave të remonteve të OST sh.a. për të mundësuar normalizimin e skemave të furnizimit, në kohën më të shkurtër të mundshme, në rast stakimi të linjave në gjendje avarie të zgjatur, apo çdo anomali tjetër që ndikon në gjendjen e paisjeve komutuese;
- nxitje të strukturave përgjegjëse direkt të angazhuara në shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit për rritjen e angazhimit si dhe të qenit të përditësuar me problematikat që ndodhin në rrjetin e OST-së;
- mirë organizim i strukturave dhe shtimin e kapaciteteve njerëzore nëse është e nevojshme për mbarëvajtjen e rrjetit në këto periudha;
- komunikim dhe bashkëveprim i vazhdueshëm me dispeçerinë e OSSH-së.

Në kushte normale operimi, Siguria Operacionale nënkupton aftësinë për të siguruar funksionimin normal të sistemit, për të kufizuar kohëzgjatjen dhe numrin e çrregullimeve, për të parandaluar shqetësime të mëdha dhe për të kufizuar pasojat e një shqetësimi të madh, në rast se kjo ndodh.

Plani i mbrojtjes së sistemit është i rëndësishëm në kuadër të marrjes së masave të menjëhershme për normalizimin e gjendjeve të sistemit dhe gjithashtu, me qëllim për të lehtësuar Rivendosjen e Sistemit pas një shqetësimi të madh (black-out), për kthimin e sistemit në funksionim normal.

h) Plani i sistemit të mbrojtjes së OST sh.a. në rast të një situate emergjente

Plani i mbrojtjes së sistemit është i lidhur me një gjendje emergjente dhe përbëhet nga një sërë masash të koordinuara, të cilat synojnë të garantojnë integritetin e sistemit, në rast të kushteve që rezultojnë nga defekte të rënda. OST sh.a. është në Gjendje Emergjence nëse ka së paku një devijim nga Limitet e Sigurisë Operacionale dhe kohëve të përcaktuara në nenin 109 (1) të Kodit të Transmetimit dhe operatorët nuk kanë në dispozicion masa përmirësuese për të rivendosur sistemin në Gjendje Normale.

Në planin e mbrojtjes së sistemit, të hartuar nga OST sh.a. janë të përmbledhura të gjitha masat teknike dhe organizative të marra, për të parandaluar përhapjen apo përkeqësimin e një incidenti në sistemin e transmetimit, me qëllim shmangien, zgjerimin e avarisë dhe rënien e sistemit; Plani i Mbrojtjes së Sistemit, i hartuar nga OST sh.a. përfshin:

- skemën e kontrollit automatik nga mbi/ nën-frekuenca;
- skemën e kontrollit automatik nga kolapsi i tensionit.

i) procedurat që ndiqen gjatë aktivizimit të planit të mbrojtjes, si dhe kushtet e aktivizimit të veprimeve përmirësuese.

j) Masat e Planit të Mbrojtjes të Sistemit

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit paraqiten si veprime emergjente përmirësuese, me qëllim kthimin e sistemit në kushte normale. Në vijim jepen shembuj të masave të aplikueshme të Planit të Mbrojtjes së Sistemit në rastet e kufizimeve për ngarkesën, frekuencën, flukset e energjisë dhe të tensionit.

- kufizime të ngarkesës/frekuencës;
- lëshimi ose ndalimi i njësive të prodhimit të energjisë;
- rritja ose zvogëlimi (automatikisht ose me kërkesë) i nivelit të prodhimit të njësive gjeneruese;
- përshtatja e mënyrës së kontrollit të LFC aktive;
- përdorimi manual apo automatik i reduktimeve, shkarkimit të ngarkesës;

- ndryshimet e pikave të punës të rregullatorëve të tensionit të transformatorëve në nivelin e shpërndarjes;
- kufizime të flukseve të energjisë elektrike;
- anulimi i remonteve të elementëve të rrjetit dhe vënia në punë sa më urgjentisht që të jetë e mundur;
- stakimi automatik i njësisë (gjeneruese), që aktivizohet nga stakimi i një linje relevante të transmetimit;
- tregtimi në kah të kundërt me zonat fqinje të përgjegjësisë;
- ndalimi i shkëmbimeve të planifikuara;
- reduktimi i programit të shkëmbimit;
- reduktimi i kapaciteteve të interkoneksionit;
- shkarkimi manual i ngarkesës i objekteve me marrëveshje për ndërprerje;
- shkarkimi automatik i objekteve me marrëveshje për ndërprerje, shkaktuar nga stakimi i një linje transmetimi;
- shkarkimi i mëtejshëm i ngarkesës në varësi të situatës.

Kufizimet tensionit

- kërkesa për vlera maksimale apo minimale të gjenerimit të fuqisë aktive dhe reaktive;
- zvogëlimi i fuqisë aktive në favor të prodhimit shtesë të fuqisë reaktive;
- parandalimi i njësive me ofrimin, injektimin e energjisë reaktive shtesë;
- ndalimi i mirëmbajtjes dhe kyçja e elementeve që më parë ishin në remont;
- bllokimi i pozicionit të rregullatorëve të tensionit në transformatorët me rregullim nën ngarkesë.

1.3.4.5 Tregu i balancimit të energjisë elektrike

Në prill të vitit 2021 u u krijua Tregu i Balancimit të energjisë elektrike, i cili funksionon duke u bazuar te Rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106 datë, 02.07.2020. Nga data 1 prill 2021, me bërjen funksional të tregut balancues, shërbimet balancuese janë siguruar në treg, në mënyrë transparente, konkurruese dhe jodiskriminuese.

Krijimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike është kusht i domosdoshëm për liberalizimin e tregut të energjisë në vendin tonë, pasi ky treg krijon mundësi për integrim me tregjet e vendeve rajonale nëpërmjet balancimit ndërkufitar dhe duke u bërë pjesë e platformës Paneuropiane të Balancimit.

Ky treg përfshin të gjitha veprimet, produktet dhe shërbimet e përdorura nga OST për të garantuar përputhjen e vazhdueshme të furnizimit dhe kërkesës, menaxhimin e konxhestioneve, menaxhimin e frekuencës dhe veprimet e tjera të kërkuara që sigurojnë integritetin e funksionimit të sistemit energjitik.

Energjia elektrike, si çdo produkt, ka një vlerë të lidhur me kohën "kur" dhe vendin "ku" dorëzohet. I vetmi "çmim" i vërtetë i energjisë elektrike është në kohë reale kur produkti dorëzohet fizikisht, dhe në mënyrë ideale duhet të pasqyrojë vlerën e vërtetë të nevojave të sistemit. Eshtë e domosdoshme që balancimi të operojë si një treg dhe që OST të përdorë parimet e tregut të hapur, transparent dhe

jodiskriminues në vendimet e tij se si të zgjedhë, prokurojë dhe kryejë shërbimet e ndryshme që i nevojiten për të mbajtur sistemin e energjisë brenda kufijve normalë të operimit. Këta mekanizma do të bëjnë të mundur transparencën mbi tregun, me kosto sa me të ulëta të transaksioneve, si dhe rritjen e mbikëqyrjes të tregut në tërësi. Tregu i ri balancues shqiptar ka mundësuar kalimin përfundimtar nga një mekanizëm i rregulluar me entitete publike, në një liberalizim të tregut të energjisë balancuese, ku çdo palë ofruese e shërbimeve të balancimit mund të marrë pjesë dhe të bëhet konkurruese me produktet e saj për shërbimet e balancimit.

Si Ofrues të Shërbimit të Balancimit (OSHB) janë kualifikuar këto 4 subjekte: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a., Ayen as Energji sh.a.; Devoll Hydropower sh.a., dhe Kurum International sh.a. pjesërisht për Rezervat e Rivendosjes Manuale të Frekuencës dhe Rezervat Zëvendësuese.

Tregu i balancimit të energjisë elektrike i krijon mundësi prodhuesve të energjisë elektrike të diversifikojnë portofolin e tyre, duke hyrë në tregun e energjisë në përputhje me aftësitë teknike të njësive gjeneruese. Me rritjen e numrit të burimeve të tjera të rinovueshme (RES), të lidhura në rrjetin e transmetimit apo të shpërndarjes, bëhet gjithnjë e më thelbësore që edhe keto burime të jenë ofruese të shërbimeve të balancimit të sistemit.

Në të njëjtën kohë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Vienë, në qëndrimin e shprehur në datën 12 prill 2021, ka vlerësuar operimin e plotë të tregut të energjisë balancuese nga 1 prilli 2021 si një hap të rendësishëm në reformen e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri. Sekretariati thekson se ky treg do të krijojë mundësi që pjesëtarët e tregut të ofrojnë shërbimin e balancimit dhe të jenë përgjegjës për balancimin e tyre, duke krijuar grupe balancimi. Ky element është veçanërisht i rëndësishëm për prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, që do të jenë përgjegjës për disbalancat që shkaktojnë dhe grupimi i tyre në grupe balancimi do t'i lejojë ata të optimizojnë kostot e balancimit.

1.4 Shpërndarja e Energjisë Elektrike

1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.)

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), i licencuar nga ERE sipas dispozitave të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët. Kufiri i sistemit të shpërndarjes me sistemin e transmetimit është i përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike, si mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes, OSSH sh.a. prokuron energji elektrike në tregun e hapur dhe nga burimet e rinovueshme, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) është organizuar në 11 zona shpërndarjeje dhe 42 agjenci.

Sipas të dhënave të OSSH sh.a., energjia totale e hyrë në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021 është 7,136,935 MWh, nga e cila 1,556,953 MWh janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Duke filluar nga 1 janari 2021, furnizimi i shërbimit universal për klientët fundorë është realizuar nga FSHU sh.a.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat mbi treguesit kryesorë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2021.

TABELA ME TE DHENA PERIODIKE (MUJORE) TE OSHEE Sh.a 2021			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Progresive
A	**Energji Totale e Hyrë në OSHEE Sh.a (MWh)**	A=A.1+A.3-A1.7	**724,554**	**629,962**	**662,183**	**590,810**	**504,970**	**519,576**	**591,485**	**603,872**	**485,288**	**523,606**	**552,840**	**747,790**	**7,136,936**
A.1	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	A.1=Sum(A.1.1,A1.6)	599,793	531,361	562,967	489,782	469,536	480,507	565,502	586,951	469,914	488,002	514,080	616,323	6,374,719
A.1.1	Nga KESH-Gen nepermjet OST		410,055	354,097	425,947	306,064	300,752	396,549	457,254	310,593	173,935	188,231	181,107	427,044	3,931,629
A.1.2	Nga OST si import i OSHEE Sh.a		1,488	1,344	1,486	1,440	1,488	1,440	58,577	245,448	271,448	258,470	278,673	10,120	1,131,422
A.1.3	Energji e transmetuar per klientet, 35kV (te dal ne treg te parregulluar furnizues te tjere)		4,713	4,782	5,699	5,435	5,842	6,527	6,993	6,897	4,828	4,592	4,302	4,305	64,916
A.1.4	Nga OST per llogari te klienteve te OSHEE Sh.a prodhuar nga HEC-et ne rrjetin e transmetimit		183,538	171,138	129,835	176,843	161,453	75,990	42,678	24,013	19,703	36,710	49,998	174,853	1,246,751
A.1.5	Nga TEC VLORA nepermjet OST		n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
A.1.6	Nga Bistrica 1,2 nepermjet OST		n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
A.1.7	Export OSHEE Group Sh.a			30,980	11,050	40,190	84,480	17,070	-	-	-	-	-	-	183,770
A.2	Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et Lokale	A.2	61,299	66,197	46,597	74,064	61,795	14,939	1,909	665	937	8,966	11,675	66,389	415,433
A.3	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	A.3=Sum(A.3.1, A.3.3)	124,761	129,581	110,266	141,218	119,914	56,139	25,982	16,921	15,374	35,604	38,759	131,467	945,988
A.3.1	HEC Ulez, Lana bregas		3,249	2,958	2,527	2,683	2,707	2,334	2,591	2,154	1,413	1,386	1,404	2,098	27,504
A.3.2	Impjantet Private/me Koncesion		119,778	124,135	103,961	134,826	112,533	49,068	18,548	10,179	10,207	31,195	35,741	127,557	877,727
A.3.3	Burimet e Rinovueshme Fotovoltaik (BRE)		1,734	2,488	3,779	3,708	4,674	4,737	4,844	4,588	3,754	3,024	1,615	1,812	40,756
B	**Energji Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)**	B=A-A.1.5+A.2	**785,853**	**696,159**	**708,781**	**664,873**	**566,764**	**534,516**	**593,394**	**604,537**	**486,226**	**532,572**	**564,515**	**814,179**	**7,552,369**
C	**Humbjet Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)**	C=C.1+C.2+C.3	**219,024**	**139,953**	**183,717**	**140,125**	**101,574**	**98,061**	**111,285**	**108,398**	**78,880**	**98,820**	**112,237**	**164,879**	**1,556,953**
C.1	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)		9,713	9,094	9,360	10,648	9,398	9,847	8,130	8,658	7,091	7,222	9,534	8,644	107,340
C.2	Humbje Teknike ne Zona (MWh)		133,183	83,159	108,467	82,462	56,007	54,131	64,751	66,257	45,205	57,510	63,547	106,650	921,330
C.3	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)		76,128	47,699	65,890	47,015	36,169	34,083	38,404	33,482	26,583	34,089	39,156	49,585	528,283
C.1	**Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)**	C.1=C/B	**27.87%**	**20.10%**	**25.92%**	**21.08%**	**17.92%**	**18.35%**	**18.75%**	**17.93%**	**16.22%**	**18.56%**	**19.88%**	**20.25%**	**20.62%**
C.1.1	Humbje Teknike njesite e TL (%)		1.24%	1.31%	1.32%	1.60%	1.66%	1.84%	1.37%	1.43%	1.46%	1.36%	1.69%	1.08%	1.42%
C.2.1	Humbje Teknike ne Zona (%)		17.17%	12.11%	15.52%	12.61%	10.05%	10.32%	11.07%	11.12%	9.44%	10.95%	11.48%	13.25%	12.38%
C.3.1	Humbje JoTeknike ne Zona (%)		9.69%	6.85%	9.30%	7.07%	6.38%	6.38%	6.47%	5.54%	5.47%	6.40%	6.94%	6.09%	6.99%
D	**Energjia e përdorur në Rrjetin e Shpërndarjes**	D=Sum(D.1:D.7)	**558,828**	**553,799**	**522,603**	**523,383**	**462,433**	**433,833**	**480,055**	**493,402**	**403,343**	**424,763**	**447,938**	**644,377**	**5,948,754**
D.1	Shitur Klienteve FMF (MWh)	D.1=D.1.1+D.1.2	**2,350**	**1,572**	**1,555**	**1,424**	**1,631**	**1,896**	**1,850**	**2,283**	**1,749**	**1,670**	**1,526**	**1,440**	**20,945**
D.1.1	Shitur Klienteve FMF Privat (MWh)		192	18	18	13	7	64	124	541	151	143	134	129	1,534
D.1.2	Shitur Klienteve FMF JoBuxhetore(MWh)		2,158	1,554	1,537	1,411	1,624	1,831	1,727	1,741	1,598	1,527	1,392	1,310	19,411
D.2	Shitur Klienteve Private (MWh)	D.2= D.2.1+D.2.2+D.2.3	**132,045**	**130,668**	**133,656**	**131,218**	**128,633**	**151,025**	**179,886**	**180,009**	**143,292**	**137,749**	**140,898**	**167,066**	**1,756,143**
D.2.1	Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te OSHEE Sh.a		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
D.2.2	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a		703	606	593	542	392	374	427	501	373	525	534	658	6,229
D.2.3	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevojat te veta dhe Ne TL)		131,341	130,062	133,063	130,676	128,240	150,651	179,459	179,508	142,919	137,224	140,364	166,407	1,749,914
D.3	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)		25,919	24,687	27,142	26,930	26,786	28,452	31,143	33,233	28,663	29,816	29,436	32,949	**345,158**
D.4	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)		26,459	24,961	24,144	21,244	17,185	18,372	19,620	19,685	18,691	20,399	23,008	30,774	**264,542**
D.5	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	D.5=D.5.1+D.5.2	306,044	300,930	283,810	263,089	220,561	212,621	238,652	250,630	205,182	221,571	237,092	341,454	**3,081,617**
D.5.1	Shitur Klienteve Familjare (MWh)		299,586	294,646	277,594	256,955	214,242	206,043	231,736	243,682	198,244	214,554	230,017	333,867	3,001,166
D.5.2	Shitur Klienteve Familjare per Ambjentet e Perbashketa		6,458	6,285	6,216	6,114	6,319	6,578	6,916	6,947	6,938	7,017	7,076	7,587	80,451
D.6	Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et Lokale	D.6=A.2	61,299	66,197	46,597	74,064	61,795	14,939	1,909	665	937	8,966	11,675	66,389	**415,433**
D.7	Energji elektrike e perdorur nga klientet ne treg te parregulluar	D.7	4,713	4,782	5,699	5,435	5,842	6,527	6,993	6,897	4,828	4,592	4,302	4,305	**64,916**
E	**Faturuar muaji Parardhes (000/leke)**		**6,641,071**	**6,400,370**	**6,245,453**	**6,158,373**	**5,817,548**	**5,190,837**	**5,548,298**	**6,377,974**	**6,554,952**	**5,401,032**	**5,544,032**	**5,794,416**	**71,674,355**
F	**Arketimet e muajit aktual (000 leke)**	G=F.1+F.2+F.3+F.4	**5,737,532**	**5,691,538**	**6,378,961**	**5,604,601**	**5,886,818**	**5,746,417**	**5,377,882**	**6,001,630**	**5,945,864**	**6,192,739**	**5,374,118**	**5,833,170**	**69,821,270**
F.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual		4,135,705	3,770,254	4,067,618	3,860,196	3,707,556	3,268,937	3,525,299	3,847,865	3,788,897	3,312,001	3,356,121	3,775,325	44,415,778
F.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual		15,512	12,369	1,622,906	1,442,620	1,850,582	2,148,521	1,527,971	1,800,534	1,898,864	2,427,825	1,724,632	1,807,861	18,280,198
F.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara		1,586,315	1,908,915	688,438	301,785	328,680	328,959	324,612	353,231	258,102	452,913	293,364	299,984	7,125,296
F.1	**Arketimet e muajit aktual (%)**	F.1=F/E	**86.4%**	**88.9%**	**102.1%**	**91.0%**	**101.2%**	**110.7%**	**96.9%**	**94.1%**	**90.7%**	**114.7%**	**96.9%**	**101.5%**	**97.4%**
F.1.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual (%)	F.1.1=F.1/E	62.3%	58.9%	65.1%	62.7%	63.7%	63.0%	63.5%	60.3%	57.8%	61.3%	60.5%	65.2%	62.0%
F.1.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual (%)	F.1.3=F.3/E	0.2%	0.2%	26.0%	23.4%	31.8%	41.4%	27.5%	28.2%	29.0%	45.0%	31.1%	31.2%	25.5%
F.1.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara (%)	F.1.4=F.4/E	23.9%	29.8%	11.0%	4.9%	5.6%	6.3%	5.9%	5.5%	3.9%	8.4%	5.3%	5.2%	9.9%
G	**Faturuar muaji Raportues (000/leke)**		**6,400,370**	**6,245,453**	**6,158,373**	**5,817,548**	**5,190,837**	**5,548,298**	**6,377,974**	**6,554,952**	**5,401,032**	**5,544,032**	**5,794,416**	**7,572,744**	**72,606,028**
1	Nr. Konsumatoreve gjithsej (Nr.)		1,266,089	1,266,734	1,268,062	1,270,888	1,273,899	1,275,201	1,277,741	1,285,188	1,274,559	1,276,585	1,278,259	1,279,460	**1,278,259**
2	Fatura te emetuara me lexim konsumi (Nr.)		976,680	958,732	941,330	957,668	970,818	991,655	1,006,358	1,028,187	1,024,058	1,022,100	1,008,414	1,014,176	**11,900,176**
3	Sasia e energjise se faturuar me lexim konsumi (MWh)														-
4	Fatura te emetuara me lexim "0" (Nr.)		289,389	282,144	326,732	313,220	303,081	283,546	271,383	257,001	262,152	267,819	284,865	280,068	**3,421,400**
5	Nr.Faturave te emetuara pa lexim (energji e pa matur) (Nr.)														-
6	Sasia e energjise se faturuar si energji e pamatur (MWh)		-	-	-	-		-							-
7	Nr.Faturave te emetuara pa lexim (dem ekonomik) (Nr.)		794	303	102	197	355	342	244	360	238	603	282	581	**4,401**
8	Sasia e faturuar si dem ekonomik (MWh)		7,189	1,563	1,619	391	1,657	1,773	1,019	1,708	1,075	6,089	1,697	2,975	**28,756**
9	Nr.Faturave per te cilat eshte arketuar kamat vonese (Nr.)		12,717	320,816	391,076	323,599	404,245	416,309	458,982	526,159	392,009	447,603	398,290	426,854	**4,518,659**
10	Vlera e Kamat vonesave te arketuara (000/leke)		1,343	48,333	84,054	54,180	78,083	76,947	100,067	98,694	75,675	70,075	94,123	87,632	**869,207**

Figura 42 Treguesit kryesorë të OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a. gjatë vitit 2021

(Raportuar nga OSHEE Group sh.a.)

1.4.2 Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi total vjetor i energjisë elektrike në vendin tonë (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar), për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2021, paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:



Figura 43 Konsumi total i energjisë elektrike në vend ndër vite

Siç vërehet në paraqitjen grafike, konsumi më i ulët i energjisë elektrike i regjistruar në vendin tonë është në vitin 2007, me 5,767,652 MWh, ndërsa konsumi më i lartë i energjisë elektrike është ai i regjistruar në vitin 2021, me 8,414,836 MWh, ku ky i fundit përbën dhe konsumin më të lartë historik në vendin tonë. Krahasuar me vitin 2020, vërehet një rritje e ndjeshme e konsumit të energjisë elektrike në vend, me 826,066 MWh.

Rritja e konsumit të energjisë elektrike total në vend për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, shkon në rreth 11%. Në të njëjtën kohë, konsumi i energjisë elektrike total i realizuar për vitin 2021 është rreth 20% më i lartë se konsumi mesatar i treguar në tabelë.

Kjo rritje e konsumit total të energjisë elektrike është reflektuar për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, por veçanërisht për konsumatorët që furnizohen në tregun e parregulluar, të cilët për vitin 2020 kanë konsumuar rreth 870 GWh energji elektrike, ndërsa për vitin 2021 këta konsumatorë kanë konsumuar rreth 1 114 GWh energji elektrike. Kjo rritje e konsumit ka ardhur si rrjedhojë e hapjes, zhvillimit dhe ndryshimit të strukturës së ekonomisë, pas kushteve të pandemisë COVID-19, pas vitit 2020.

Konsumi i energjisë elektrike total në vend përgjatë vitit 2021 është mbuluar nga gjenerimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, si dhe nga importi i energjisë elektrike.



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Balanca Imp-Eks	1,428	-732	3,050	2,895	898	3,067	1,399	-42	2,915	-913	2,406	2,276	-548
Prodh Neto Vendas	5,159	7,702	4,158	4,722	6,957	4,724	5,866	7,136	4,525	8,552	5,206	5,313	8,963
Konsumi Total	6,587	6,970	7,208	7,617	7,855	7,791	7,265	7,094	7,440	7,639	7,612	7,589	8,415

Figura 44 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës import-eksport në konsumin total të energjisë elektrike në Shqipëri

Në tabelën e mësipërme evidentohet prodhimi neto vendas dhe balanca import – eksport. Sikurse paraqitet në të dhënat e mësipërme, prodhimi neto vendas për vitin 2021 rezulton të jetë 8,963 GWh, ndërkohë që konsumi total i vendit rezulton të jetë 8,415 GWh, me një balancë neto në drejtimin eksport 548 GWh.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për vitin 2021 prej 548 GWh, rezulton si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 2 800 GWh dhe importit të realizuar në vlerën 2 252 GWh. Kjo për faktin se sistemi elektroenergjitik shqiptar e bazon prodhimin e energjisë elektrike në burimet hidrike, ku për periudhat me reshje arrin të eksportojë energji elektrike dhe në periudhat e thata gjatë vitit realizon import të energjisë elektrike për të mbuluar kërkesën në vend, thënë ndryshe profili i prodhimit në vendin tonë nuk përkon gjithmonë për të njëjtat periudha me profilin e konsumit në vend, gjë për të cilën do të kontribuonte pozitivisht diversifikimi i burimeve gjeneruese të energjisë elektrike.

KONTRIBUESIT PËR MBULIMIN E KONSUMIT 2020				
SI SIGUROHET ENERGJIA E PËRDORUR				
Prodhimi Publik (KESH)	Prodhues me përparësi	Prodhues në Treg të Hapur	Ballanca në Interkoneksion	
3,090,199	1,367,526	855,441	2,275,604	
		7,588,770	hyrje	

KONTRIBUESIT NË KONSUMIN E ENERGJISË S'ËSIGURUAR 2020				
KU KONSUMOHET ENERGJIA E SIGURUAR				
Konsumi ne treg të rregullluar (shitje+humbje)	Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")	Konsumuar nga Klientët e lidhur në 35kv	Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)	Konsumuar me furnizues FTL
6,537,820	811,356	61,116	172,198	6,010
		7,588,770		

KONTRIBUESIT PËR MBULIMIN E KONSUMIT 2021				
SI SIGUROHET ENERGJIA E PËRDORUR 2021)				
Prodhimi Publik (KESH)	Prodhues me përparësi	Prodhues në Treg të Hapur	Ballanca në Interkoneksion	
5,343,974	2,192,736	1,425,989		547,896
		8,414,803	dalje	

KONTRIBUESIT NË KONSUMIN E ENERGJISË S'ËSIGURUAR 2021				
KU KONSUMOHET ENERGJIA E SIGURUAR 2021				
Konsumi ne treg të rregullluar (shitje+humbje)	Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")	Konsumuar nga Klientët e lidhur në 35kv	Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)	Konsumuar me furnizues FTL
7,054,114	1,049,953	64,916	227,918	17,935
		8,414,836		

KONTRIBUESIT PËR MBULIMIN E KONSUMIT 2020 (%)				
SI SIGUROHET ENERGJIA E PËRDORUR				
Prodhimi Publik (KESH)	Prodhues me përparësi	Prodhues në Treg të Hapur	Ballanca në Interkoneksion	
40.72	18.02	11.27	29.99	-

KONTRIBUESIT NË KONSUMIN E ENERGJISË S'ËSIGURUAR 2020 (%)				
KU KONSUMOHET ENERGJIA E SIGURUAR				
Konsumi i OSHEE (shitje+humbje)	Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")	Konsumuar nga Klientët e lidhur në 35kv	Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)	Konsumuar me furnizues FTL
86.15	10.69	0.81	2.27	0.08

KONTRIBUESIT PËR MBULIMIN E KONSUMIT 2021 (%)				
SI SIGUROHET ENERGJIA E PËRDORUR 2021				
Prodhimi Publik (KESH)	Prodhues me përparësi	Prodhues në Treg të Hapur	Ballanca në Interkoneksion	
63.51	26.06	16.95	-	6.51

KONTRIBUESIT NË KONSUMIN E ENERGJISË S'ËSIGURUAR 2021 (%)				
KU KONSUMOHET ENERGJIA E SIGURUAR 2021				
Konsumi i OSHEE (shitje+humbje)	Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")	Konsumuar nga Klientët e lidhur në 35kv	Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)	Konsumuar me furnizues FTL
83.83	12.48	0.77	2.71	0.00









Figura 45 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2020 – 2021

1.4.3 Struktura e konsumit të energjisë elektrike

SHPËRNDARJA E KONSUMATORËVE SIPAS RAJONEVE DHE KATEGORIVE 2021 (%)						
	Buxhetor	Familjare	Jo-Buxhetore	Konsum vetjak	Privat	2021
Berat	0.08	7.11	0.03	0.00	1.12	8.33
Burrel	0.05	4.32	0.02	0.00	0.50	4.90
Durres	0.07	11.98	0.03	0.00	1.51	13.59
Elbasan	0.08	7.57	0.04	0.00	1.04	8.72
Fier	0.05	5.81	0.02	0.00	0.80	6.69
Gjirokaster	0.10	5.53	0.02	0.00	0.79	6.45
Korce	0.08	6.50	0.02	0.00	0.76	7.36
Kukes	0.03	1.47	0.01	0.00	0.18	1.69
Shkoder	0.08	7.86	0.03	0.00	1.12	9.08
Tirane	0.12	22.29	0.04	0.00	4.10	26.56
Vlore	0.04	5.72	0.02	0.00	0.86	6.64
TOTAL	0.78	86.17	0.26	0.02	12.77	100.00

Figura 46 Shpërndarja e klientëve të OSSH sh.a. sipas rajoneve dhe kategorive gjatë vitit 2021 (Burimi: OSSH sh.a.)



Figura 47 Shpërndarja e numrit të klientëve 2021 sipas kategorive (%) (Burimi: FSHU sh.a.)

Të dhënat e paraqitura më sipër për vitin 2021 tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2021 është 1,279,460 dhe pjesën më të madhe të klientëve të FSHU sh.a. për këtë vit e zënë klientët familjarë, që përbëjnë 86.17% të numrit total të klientëve të FSHU sh.a.

Në shpërndarjen demografike të klientëve të FSHU sh.a. edhe për vitin 2021 pjesa më e madhe është në Tiranë, me rreth 26.5% të të gjithë klientëve që ka FSHU sh.a.

Struktura e klientëve të FSHU sh.a. reflektohet dhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2021. Klientët familjarë zënë pjesën më të madhe në FSHU sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2021, respektivisht 49.36% të të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2021.



Figura 48 Raportet e faturimit sipas kategorive të klientëve gjatë vitit 2021 (Burimi: FSHU sh.a.)

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve familjarë.



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Konsumi Total	6,587	6,970	7,208	7,617	7,855	7,791	7,265	7,094	7,440	7,639	7,612	7,589	8,415
Konsumi Familiar	2,423	2,588	2,588	2,068	2,261	2,502	2,522	2,587	2,655	2,682	2,750	2,957	3,082

Figura 49 Klientët familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite (Burimi: FSHU sha)

Konsumi i klientëve familjarë zë rreth 36.6% të konsumit total, shifër kjo më e ulët krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2020, i cili ishte në masën 39%.

1.4.4 Profili i konsumit të energjisë elektrike

Profili vjetor i konsumit të energjisë elektrike karakterizohet nga simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme edhe këtë vit vërehet e njëjta dukuri, ajo e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër, por edhe për sistemet ftohëse në verë, elemente të cilat çojnë në simetrinë e konsumit të energjisë elektrike, si në periudhën e dimrit dhe atë të verës. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë

elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimit ose mospërdorimit të ngrohjes/ftohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt korrik dhe gusht, prirja e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më i dukshëm dhe lidhet me ndryshimet klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, që po çon në përdorimin gjithnjë e më të madh të pajisjeve klimatizuese gjatë muajve të nxehtë.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2021, krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2009 - 2020.



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Mes 09-20	23,337	22,095	20,145	17,869	16,941	17,382	18,532	19,224	17,547	17,689	19,759	23,170
2021	24,592	23,367	22,303	21,435	18,395	19,517	21,981	22,847	19,341	19,436	21,066	25,157

Figura 50 Konsumi mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2021

Në grafikun më poshtë jepet profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2021.



	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
Mesatare	658	597	572	563	570	614	736	910	1014	1047	1040	1036	1035	1035	1023	1007	1023	1066	1103	1119	1121	1044	916	768
Max	730	655	670	615	620	672	817	1018	1133	1181	1185	1190	1193	1194	1179	1160	1180	1227	1252	1256	1256	1171	1026	856
Min	591	543	523	515	522	560	641	762	872	916	911	901	895	890	867	850	871	912	955	986	992	921	809	685

Figura 51 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2021



	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
Mesatare	732	639	597	580	590	651	811	1048	1192	1238	1217	1200	1197	1209	1215	1224	1297	1363	1359	1343	1308	1209	1059	877
Max	832	700	647	614	627	707	916	1,223	1,379	1,404	1,403	1,385	1,369	1,357	1,340	1,351	1,443	1,540	1,536	1,531	1,501	1,400	1,206	969
Min	662	591	565	551	557	605	703	867	1,029	1,116	1,095	1,095	1,105	1,112	1,103	1,102	1,165	1,193	1,181	1,170	1,140	1,051	942	796



	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
Mesatare	665	596	566	556	569	632	784	1005	1139	1178	1159	1147	1147	1156	1140	1145	1217	1292	1284	1259	1214	1111	970	796
Max	698	626	591	583	594	662	853	1,101	1,209	1,243	1,220	1,224	1,251	1,263	1,219	1,225	1,312	1,398	1,362	1,350	1,309	1,194	1,024	876
Min	614	545	523	517	527	577	698	862	1,011	1,090	1,080	1,056	1,060	1,065	1,053	1,064	1,166	1,235	1,216	1,178	1,137	1,003	889	714

Figura 52 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2021 (MW)



	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
Mesatare	704	621	584	571	577	630	769	986	1143	1209	1220	1219	1222	1223	1200	1195	1232	1311	1328	1315	1282	1175	1030	846
Max	801	694	655	644	653	723	922	1,20	1,36	1,42	1,41	1,40	1,41	1,42	1,39	1,37	1,42	1,50	1,55	1,53	1,50	1,37	1,19	962
Min	588	513	475	460	462	492	547	658	810	913	952	939	921	910	889	894	946	1,03	1,03	1,02	1,00	931	822	688

Figura 53 Profili dhe minimumi i ngarkesës në mars 2021 (MW)

Sikurse vihet re në paraqitjet grafike më sipër, piku i ngarkesës është në datën 22.12.2021, ora 18:00, në vlerën 1540 MW, kurse ngarkesa minimale është regjistruar në datën 02.01.2021, ora 04:00, në vlerën 460 MW.

1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe humbur, për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2021

Më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe humbur (në MWh), për çdo zonë dhe agjenci të OSSH sh.a. gjatë vitit 2021.

Drejtoria Rajonale/Agjensia	VITI 2021			
	Energjia e Hyre MWh	Energjia e Shitur MWh	Humbjet MWh	Humbjet ne %
Tirana1	949,830	828,892	120,938	12.7
Tirana2	866,870	746,836	120,034	13.8
Tirana3	699,659	601,538	98,122	14.0
Dr. Rajonale Tirane	2,516,360	2,177,266	339,094	13.5
Durres	422,675	357,787	64,889	15.4
Kavaje	175,124	148,044	27,080	15.5
Kruje	155,480	102,752	52,728	33.9
Shijak	203,015	150,650	52,366	25.8
Dr. Rajonale Durres	956,295	759,233	197,062	20.6
Ballsh	45,321	40,613	4,708	10.4
Fier	355,555	306,875	48,680	13.7
Patos	69,997	56,082	13,915	19.9
Dr. Rajonale Fier	470,874	403,570	67,303	14.3
Elbasan	353,270	307,841	45,429	12.9
Gramsh	27,121	23,004	4,117	15.2
Librazhd	97,517	83,912	13,605	14.0
Peqin	41,117	32,948	8,169	19.9
Dr. Rajonale Elbasan	519,025	447,706	71,319	13.7
Bilisht	42,392	36,460	5,932	14.0
Kolonje	34,591	30,250	4,340	12.5
Korce	248,869	209,959	38,909	15.6
Pogradec	81,538	71,382	10,156	12.5
Dr. Rajonale Korce	407,390	348,052	59,338	14.6
Delvine	18,304	15,267	3,037	16.6
Gjirokaster	109,031	86,511	22,520	20.7
Permet	25,951	21,841	4,110	15.8
Saranda	124,852	105,173	19,679	15.8
Tepelene	33,935	21,766	12,170	35.9
Dr. Rajonale Gjirokaster	312,073	250,558	61,516	19.7
Koplik	77,596	37,101	40,495	52.2
Lezhe	180,253	120,730	59,523	33.0
Puke	31,234	18,150	13,084	41.9
Shkoder	426,779	277,512	149,267	35.0
Dr. Rajonale Shkoder	715,862	453,492	262,369	36.7
Berat	131,088	109,247	21,841	16.7
Kuçove	71,990	61,261	10,729	14.9
Lushnje	209,284	172,531	36,753	17.6
Skrapar	66,934	60,609	6,324	9.4
Dr. Rajonale Berat	479,295	403,648	75,648	15.8
Has	33,973	17,130	16,844	49.6
Kukes	111,097	68,084	43,013	38.7
Tropoje	69,986	31,819	38,167	54.5
Dr. Rajonale Kukes	215,056	117,032	98,024	45.6
Bulqize	66,966	59,704	7,262	10.8
Diber(Peshkopi)	80,935	53,266	27,668	34.2
Lac	206,900	138,650	68,250	33.0
Mat (Burrel)	64,596	43,574	21,022	32.5
Mirdite	58,325	42,505	15,819	27.1
Dr. Rajonale Burrel	477,722	337,700	140,022	29.3
Himare	28,813	26,153	2,660	9.2
Selenice	48,830	22,405	26,425	54.1
Vlore	293,123	244,325	48,798	16.6
Dr. Rajonale Vlore	370,766	292,883	77,883	21.0

Figura 54 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2021

Humbjet më të larta i takojnë drejtorive rajonale në Tiranë dhe Shkodër, ndërsa nivelin më të ulët të humbjeve gjatë vitit 2021 e kanë pasur agjencitë në Përmet, Gramsh e Himarë. Edhe përgjatë vitit 2020, humbjet më të larta të energjisë elektrike janë hasur në drejtoritë rajonale në Tiranë dhe Shkodër, ndërsa nivelin më të ulët të humbjeve e kanë patur po ashtu agjencitë në Përmet, Gramsh e Himarë.



Figura 55 Shpërndarja e furnizimit me energji elektrike sipas drejtorive rajonale (%)

Sikurse evidentohet edhe në figurë, pjesën më të madhe të konsumit të energjisë elektrike në vend për vitin 2021 e zë Drejtoria Rajonale Tiranë, ndërkohë që pjesën më të vogël të konsumit e zë Drejtoria Rajonale Kukës.



Figura 56 Shpërndarja e humbjeve të energjisë elektrike sipas drejtorive rajonale (%).

Në tabelën e mëposhtme jepet një krahasim i nivelit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, me targetat e vendosura në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 09.12.2021, "Për një ndryshim në vendimin nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik".

Sikurse evidentohet, humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2021 janë 20.62%, me një rritje të lehtë prej 0.12% mbi targetin e vendosur në VKM nr. 758, datë 09.12.2021, "Për një ndryshim në vendimin nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik"".



	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR
Humbje në shpërndarje 2021	27.87%	20.10%	25.92%	21.08%	17.92%	18.35%	18.75%	17.93%	16.22%	18.56%	19.88%	20.25%
Humbje Vjetore 2021	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%	20.62%
Targeti 2021	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%	20.50%

Figura 57 Humbjet mujore dhe vjetore në sistemin e shpërndarjes, krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM nr. 758, datë 09.12.2021 në (%)

Paraqitja e kontributit në furnizim dhe në humbjet respektive sipas agjencivetregohet në figurën më poshtë, në të cilën evidentohet sasia e energjisë elektrike e furnizuar për çdo agjenci dhe humbjet e energjisë elektrike respektive.

Figura 58 Sasia në furnizim dhe humbje të energjisë elektrike në rajonet dhe agjencitë e rrjetit të shpërndarjes (Burimi: OSSH sh.a.)

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë është ndërtuar Bilanci Energjitik për vitin 2021 si më poshtë:



Figura 59 Bilanci Elektroenergjitik i vitit 2021 sipas raportimieve te OST dhe OSSH sh.a.

1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike

Gjatë vitit 2021, efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura, duke iu referuar gjithnjë faktorëve përcaktues në nivelin e eficiencës së konsumit të energjisë elektrike, të cilët janë:

1. niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje;
2. niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2021 arrijnë në **20.62%**, duke shënuar kështu ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2020.

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSSH sh.a. është 97.4% kundrejt energjisë elektrike të faturuar (shih tabelën e faturim – arkëtimeve më poshtë). Ky nivel arkëtimesh për vitin 2021 rezulton me rritje, krahasuar me nivelin e arkëtimeve të realizuara për vitin 2020, prej 95.8%. Këto vlera të arkëtimeve përfshijnë edhe arkëtimet e prapambetura, të cilat janë realizuar në vitin respektiv.



Figura 60 Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes në periudhën 2009-2021. (Burimi: OSSH sh.a.)



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
HUMBJE TEKNIKE NE TL (N/ST)	178,738	163,846	170,937	161,831	201,684	193,208	162,728	186,629	141,707	128,974	117,729	103,729	107,340
HUMBJE TEKNIKE NE ZONAT E OSSH	1,015,450	908,535	814,826	879,616	884,360	908,416	1,203,793	1,190,872	1,106,007	944,987	836,561	828,906	921,330
TOTALI I HUMBJE VE TEKNIKE OSSH	1,194,188	1,132,081	985,763	1,041,447	1,086,044	1,101,624	1,366,518	1,346,501	1,247,714	1,070,560	984,300	932,635	1,028,670
HUMBJE JOTOKNIKE OSSH	922,954	778,815	1,020,432	2,039,227	2,110,575	1,520,312	668,900	447,952	468,802	467,943	528,661	525,106	528,283
TOTALI I HUMBJE VE OSSH	2,117,142	1,910,896	2,006,195	3,080,674	3,196,618	2,621,936	2,035,418	1,794,453	1,716,516	1,538,503	1,482,961	1,457,741	1,556,953

Figura 61 Grafiku i humbjeve vjetore në sistemin e Sshpërndarjes në periudhën 2009-2021 (Burimi: OSSH sh.a.)



Figura 62 Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes në periudhën 2009-2021 (Burimi: OSSH sh.a.)



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2011	2,795,367	2,988,857	4,167,734	3,094,055	3,861,601	3,180,000	3,125,240	3,320,682	3,544,505	3,415,000	2,890,000	3,805,907
2012	3,219,851	3,497,033	3,567,717	3,908,236	3,485,316	3,095,872	3,208,757	3,541,445	2,902,556	3,576,101	2,843,466	3,104,644
2013	2,661,163	3,180,000	3,632,233	3,498,228	3,163,722	2,536,344	3,192,674	3,414,288	3,346,193	3,202,196	2,990,258	3,677,650
2014	3,889,070	3,778,119	3,971,150	3,972,164	3,719,457	3,360,657	3,489,991	3,426,607	4,413,100	4,104,334	4,363,624	6,350,653
2015	5,618,588	6,686,289	5,797,438	4,837,198	4,739,629	4,391,053	4,618,755	4,836,347	4,993,295	4,850,612	4,318,698	5,028,688
2016	5,407,628	5,199,755	5,204,630	4,965,408	4,781,174	4,449,663	4,621,375	5,067,095	4,858,541	4,685,278	4,363,587	5,063,116
2017	5,463,201	5,424,919	5,625,505	4,857,514	5,133,217	4,286,856	4,901,744	5,295,261	5,333,323	5,007,534	4,543,379	5,530,070
2018	6,118,178	5,683,429	6,016,056	5,618,824	5,214,970	4,738,737	5,224,991	5,518,612	5,400,919	5,489,875	4,788,703	5,999,241
2019	6,012,063	6,214,348	5,809,420	5,627,003	5,282,041	4,771,267	5,561,263	5,644,126	5,728,875	5,453,169	4,476,170	5,856,208
2020	5,712,421	5,959,484	4,729,831	5,478,206	5,118,635	4,992,372	4,727,688	5,327,794	5,471,536	5,384,384	4,733,894	5,703,406
2021	5,737,382	5,681,538	6,378,961	5,604,601	5,886,818	5,746,417	5,377,882	6,001,630	5,945,864	6,192,739	5,374,118	5,883,170

Figura 63 Niveli i arkëtimeve mujore në periudhën 2011-2021 (Burimi: FSHU sh.a.)

PERFORMANCA E OPERATOTRIT TE SHPERNDARJES 2009-2021 (%)

NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2021													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89	
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05	
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70	
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32	
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04	
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54	
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.50	
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99	
2017	33.50	27.63	28.66	25.81	25.88	28.31	24.69	23.29	19.79	23.76	23.55	27.90	26.41
2018	30.65	24.91	27.22	23.33	23.03	20.76	21.46	20.77	19.32	21.53	22.73	26.70	23.9
2019	29.25	23.21	26.5	21.36	22.10	19.92	20.42	19.81	17.54	20.40	21.58	24.76	21.79
2020	28.22	21.61	28.36	17.39	19.10	18.65	19.69	18.87	16.80	21.21	22.79	20.49	21.48
2021	27.87	20.1	25.92	21.08	17.92	18.34	18.75	17.93	16.22	18.56	19.88	20.25	20.62

Niveli i Arketimeve (%) 2009-2021													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01	
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48	
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30	
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00	
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00	
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00	
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70	
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70	
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10	96.6
2018	96.39	95.69	105.82	98.92	111.64	100.16	105.00	102.12	93.03	108.76	96.24	108.94	101.6
2019	90.7	92.6	99.8	102.4	102.50	94.00	104.40	99.30	93.90	104.70	89.60	110.70	98.4
2020	91.4	91.6	77.5	106.8	101.80	102.20	96.80	95.30	96.60	101.10	91.50	101.80	95.8
2021	86.4	88.9	102.1	91	101.20	110.70	96.90	94.10	90.70	114.70	96.90	101.50	97.4

Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2021													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2009	41.1%	54.1%	46.1%	58.1%	57.4%	52.9%	50.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%	
2010	34.0%	42.8%	54.7%	61.4%	56.2%	54.4%	54.7%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%	
2011	29.9%	35.7%	55.3%	55.1%	72.7%	57.5%	50.8%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%	
2012	38.4%	32.3%	35.1%	42.6%	57.9%	50.3%	49.9%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%	
2013	30.0%	32.7%	44.6%	48.7%	47.8%	41.5%	49.8%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%	
2014	45.0%	44.6%	49.2%	55.0%	51.7%	52.9%	55.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%	
2015	71.4%	82.2%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%	
2016	60.2%	61.8%	67.0%	66.6%	72.4%	69.6%	69.7%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%	
2017	56.7%	63.4%	75.4%	70.1%	78.3%	65.8%	78.9%	74.7%	75.9%	79.1%	70.9%	72.2%	71.1%
2018	66.8%	71.9%	77.0%	75.8%	85.9%	79.4%	82.5%	80.9%	75.1%	85.3%	74.4%	79.9%	77.3%
2019	64.2%	71.1%	73.4%	80.5%	79.8%	75.3%	83.1%	79.6%	77.4%	83.3%	70.3%	83.3%	77.0%
2020	65.6%	71.8%	55.5%	88.2%	82.4%	83.1%	77.7%	77.3%	80.4%	79.7%	70.6%	80.9%	75.2%
2021	62.3%	71.0%	75.6%	71.8%	83.1%	90.4%	78.7%	77.2%	76.0%	93.4%	77.6%	80.9%	77.3%

Figura 64 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (%) (Burimi: OSSH sh.a.)

Efektiviteti i shitjeve të FSHU sh.a. përfaqëson praktikisht përqindjen (%) e energjisë elektrike që është shitur dhe arkëtuar. Për vitin 2021, efektiviteti i shitjeve për FSHU sh.a. është 77.3%, ose 2.1% më i lartë se në vitin 2020.

Efektiviteti i shitjeve për periudhën 2009 - 2021 paraqitet dhe në grafikun në vijim:



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Arketimi	76.4	70.1	70.7	83	79.3	91.9	100.8	93.4	96.6	101.6	98.4	95.8	97.4
Humbja	34	30.38	37.58	46.38	45.04	37.81	31.34	28.04	26.41	23.9	21.79	21.48	20.62
Efektiviteti	50.424	48.80362	44.1309	44.5046	43.58328	57.15261	69.2092	67.21064	71.1	77.3	77	75.2	77.3

Figura 65 Efektiviteti i shitjeve të FSHU sh.a. / OSHEE Group sh.a., 2009-2021 (Burimi: FSHU sh.a. / OSHEE Group sh.a.)



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Konsumi Total Vendas	6,587	6,970	7,208	7,617	7,855	7,791	7,265	7,094	7,440	7,639	7,612	7,589	8,415
Humbje OSSH+OST	2,328	2,167	2,613	3,346	3,428	2,783	2,194	1,984	1,875	1,781	1,652	1,630	1,785

Figura 66 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik kundrejt konsumit

Në figurën e mësipërme paraqitet ecuria e humbjeve totale të energjisë elektrike, e cila përfshin humbjet në sistemin e shpërndarjes edhe ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2009 – 2021. Të dhënat tregojnë se humbjet e energjisë elektrike në vlera absolute kanë përgjithësisht trend zbritës. Për vitin 2021, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë 1,785 GWh. Krahasuar me vitin 2020, vihet re një rritje e humbjeve totale të energjisë elektrike me 155 GWh. Në të njëjtën kohë duhet evidentuar fakti se rritja e konsumit të energjisë elektrike për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, shkon në rreth 11%.

Në figurën më poshtë janë paraqitur të dhënat e faturim-arkëtimeve të energjisë elektrike përgjatë periudhës 2009 - 2021. Sikurse shihet dhe në figurë, deri në vitin 2014 diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit ka qenë e konsiderueshme. Diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit ka arritur nivelin maksimal në vitin 2011, në rreth 30%. Për vitin 2021, diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit është 3.8 miliardë lekë, ose 5% vlerës së energjisë elektrike të faturuar. Ulja e ndjeshme e diferencës ndërmjet energjisë elektrike të faturuar dhe asaj të arkëtuar ka filluar në vitin 2015 dhe ka vijuar të jetë një proces i konsoliduar në vitet në vijim.



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Faturimi Vjetor	42.8	52.2	56.9	48.1	48.4	53.2	61.8	62.9	63.5	64.6	67.1	66.4	72.6
Arketimi Vjetor	32.7	36.6	40.2	39.5	38.4	48.8	60.7	58.7	61.4	65.8	66.4	63.3	68.8

Figura 67 Faturimi/arkëtimi 2009-2021, me TVSH (Burimi: OSSH sh.a.)

1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna mbi asetet në administrim nga OSSH sh.a. për vitin 2021, si nënstacionet, linjat, kabinat dhe transformatorët në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Të dhënat mbi asetet e OSSH sh.a. përfshijnë të dhëna mbi elementet kryesor të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Numrin e nënstacioneve, numrin e transformatorëve, gjatësinë e linjave ajrore dhe kabllore si dhe numrin e kabinave elektrike. Numri total i kabinave elektrike në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021 është 26,593 nga të cilat 13,519 janë në pronësi të OSSH sh.a. dhe pjesa tjetër është në pronësi të subjekteve private.

Gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm në sistemin e shpërndarjes është 16.6826 km. Gjatësia totale e rrjetit të tensionit të ulët në sistemin e shpërndarjes është 56.566 km. Në mënyrë më të detajuar të dhënat jepen në tabelën më poshtë:

TE DHENAT E RRJETIT OSHEE PER VITIN 2021

NENSTACIONE, KABINA DHE TRANSFORMATORE	
Numri i Nenstacioneve	181
Numri i transformatoreve ne nenstacione	313
Numri i Kabinave total	25,955
Numri i Transformatoreve TM/TU	26,593

KABINAT	TIPI DHE NUMRI I KABINAVE												NUMRI TOTAL I KABINAVE	FUQIA E INSTALUAR (KVA)				NUMRI I TRANSFORMATOREVE TE FUQISE TMTU			
	METALIKE			MURATURE			BOX			SHTYLLORE											
	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV		6 kV	10kV	20kV	Total	6 kV	10kV	20kV	Total
Gjithsej (Total)	328	272	10	2611	3766	4011	59	87	1884	6888	5955	84	25,955	1,622,020	1,767,572	2,668,064	6,057,656	10,055	###	6,396	26,593
Pronesi OSHEE	270	178	2	1,907	2,388	2,074	42	54	1,811	2,278	2,154	52	13,208	786,209	1,067,552	1,653,217	3,486,978	4,002	5,369	4,148	13,519
Pronesi Jo e OSHEE	58	94	8	704	1,378	1,937	17	33	73	4,612	3,801	32	12,747	835,811	700,020	1,034,847	2,570,678	6,053	4,773	2,248	13,074

Gjatesia Totale e rrjetit TM (km)	17,447.2
Linja 35KV (km) Ajrore	124.46
Linja 35Kv (km) Kabllore	17.5
Linja 20Kv (km) Ajrore	194.7
Linja 20Kv (km) Kabllore	239.25
Linja 10Kv (km) Ajrore	752.95
Linja 10Kv (km) Kabllore	410.2
Linja 6Kv (km) Ajrore	489.67
Linja 6Kv (km) Kabllore	767.5

Gjatesia Totale e rrjetit TU (km)	56,566
Ajrore me percelles te shtetit (km)	17,717
Ajrore me kabel ABC (km)	5,222
Kabl for PVC, XLPE	15,500
Kabel Koaksial	18,117

KABINAT	SHPERNDARJA SIPAS TIPIT DHE PRONESISE SE KABINAVE (%)												TOTAL %
	METALIKE			MURATURE			BOX			SHTYLLORE			
	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	
Gjithsej	335	275	10	2647	3727	3942	56	87	1741	6943	5847	87	100
Pronesi OSHEE	256	200	2	1675	2620	2072	42	52	1676	2020	2387	51	50.9
Pronesi Jo e OSHEE	79	75	8	972	1107	1870	14	35	65	4923	3460	36	49.1
Pronesi OSHEE	1.1	0.8	0.0	7.2	10.7	7.4	0.0	0.2	4.4	7.9	8.9	0.2	48.7
Pronesi Jo e OSHEE	0.4	0.3	0.0	5.8	4.0	5.8	0.1	0.1	0.3	21.8	12.6	0.1	51.3

Figura 68 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH sh.a.

2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Tregu i Energjisë Elektrike edhe gjatë vitit 2021 ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016,e ndryshuar "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik", që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe me VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, "Për Shpalljen e Gjëndjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike", nëpërmjet të cilës u vendos shpallja e gjëndjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike për periudhën nga muaji tetor 2021 deri më 15 prill 2022.

VKM nr. 519, datë 13.07.2016 "Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike", nuk ka filluar të zbatohet pasi është përcaktuar të zbatohet me bërjen efektive dhe operative të tregut të një dite më parë dhe operimin e Bursës së Energjisë Elektrike.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar ka përcaktuar pjesëmarrësit e Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, duke shërbyer edhe si model i përkohshëm i tregut të energjisë elektrike.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndyshuar, Enti Rregullator i Energjisë, me qëllim reflektimin e kërkesave të këtij ligji, ka vijuar punën për të miratuar, rishikuar apo përmirësuar kuadrin rregullator dhe nënligjor në zbatim të tij.

Operimi i tregut të energjisë elektrike edhe për vitin 2021 ka vijuar bazuar në rregullat e përkohshme të tregut të energjisë elektrike, miratuar, me vendimin e ERE-s nr. 139, datë 15.08.2016, i ndryshuar.

Përgjatë vitit 2021 ka vijuar procesi për liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike për sa i përket krijimit të kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor e rregullator për daljen në treg të hapur edhe për klientët e lidhur në nivelin e tensionit e mesëm (35kV, 20kV, 10 kV, 6 kV) në zbatim të Ligjit nr.

43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse. Ky proces do të vijojë në vitet e ardhshme me daljen në treg të lirë të klientëve të lidhur në tensionin 20 kV, 10 kV, 6 kV. Me qëllim garantimin e të drejtave si të furnizuesve, ashtu edhe të klientëve të energjisë elektrike, ERE ka plotësuar kuadrin ligjor rregullator me bazën e nevojshme për të garantuar operimin e sigurtë, transparent dhe mbi baza jo diskriminuese të tregut. Për këtë qëllim janë miratuar një sërë aktesh nën ligjore ndër të cilat përmendim:

(i) Marrëveshjen e Shërbimit të Shpërndarjes mes OSSH sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike;

(ii) Rregulloren për kriteret standarte të cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

(iii) Rregulloren mbi procedurat për paraqitjen e një kërkese - shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike;

(iv) Rregulloren mbi Ndryshimin e Furnizuesit të Energjisë Elektrike;

(v) Rregulloren për profilet e standartizuara të ngarkesës.

Gjithashtu ERE ka udhëzuar FSHU sh.a. për të sensibilizuar klientët për daljen në treg të parregulluar nëpërmjet njoftimit të këtyre të fundit lidhur me detyrimet që lindin nnë zbatim të Ligjit të "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; udhëzimeve si dhe legjislacionit përkatës për këtë qëllim,

Numri i klientëve për të cilët është bërë e mundur krijimi i kushteve teknike për daljen në treg të parregulluar për vitin 2021 është mbi 100, në të njëtën kohë në janar të vitit 2022 OSSH sh.a. njoftoi krijimin e kushteve teknike nga ana e OSSH sh.a. për liberalizimin e mëtejshëm të tregut.

2.1 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 *"Për Sektorin e Energjisë Elektrike"i ndryshuar*, Neni 7, Neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), Neni 22, Neni 58, pika 9, Neni 62, pika 4 si dhe Neni 72, gërma dh); Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar *"Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*" , i ndryshuar, neni 13; si dhe kushtet e licencave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licencuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Në zbatim të sa më sipër, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit të sektorit por edhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimin nr. 134/2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Mbi miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik", ERE ka detyrimin të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me gjetjet gjatë ushtrimit të funksionit të vetë monitorues.

Në lidhje me sa më sipër, ERE, për të patur një pasqyrë të plotë të funksionimit dhe zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, përveç kontrollit të raportimeve peroidike që bëhen nga të licencuarit, gjatë vitit 2021 janë kryer monitorime me objekte specifike pranë të licencuarëve duke siguruar të dhëna dhe informacionet e nevojshme për t'i shërbyer qëllimit të sipërcituar. Rezultatet dhe analizat janë paraqitur në Pjesën e I-rë *"Gjendja Sektorit dhe Tregut të Energjisë Elektrike"* të këtij raporti, duke dhënë edhe mundësinë e krahasimit me vitet paraardhëse si dhe në mënyrë krahasuese me ecurinë e të dhënave, për të cilat janë vendosur targete në Kapitullin VI "Plani i zbatimit" të VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019, ndryshuar me VKM-në nr. 758, datë 09.12.2021 "Mbi miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik.

Në mënyrë që të sigurohen raportime sa më korrekte dhe në kohë nga të licencuarit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 12.12.2020, u miratuan

"Rregullat për monitorimin e tregut të energjisë elektrike". Në këto rregulla janë përcaktuar procedurat dhe formatet e raportimit dhe dërgimit të informacionit dhe të dhënave në ERE nga pjesëmarrësit e tregut.
ERE në bashkëpunim me donatorë të sektorit është duke parë mundësinë e zhvillimit të një platforme elektronike e cila do t'i mundësojë pjesëmarrësve në tregun e energjisë për të plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat dhe Rregulloret e KE-së si dhe Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, njëkohësisht do t'i shërbejë të gjithë të interesuarve për marrjen e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme në një kohë sa më të shpejtë. Gjthashtu kjo do të kontribuonte pozitivisht edhe në vijimin dhe përmirësimin e praktikave të publikimit të të dhënave nga ERE në zbatim të nenit 19, germa k) dhe Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar.
Nga analizimi i rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra nga ERE, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime në terren.

Gjithashtu është analizuar situata e raportimeve periodike të të licencuarve ku konstatohen vonesa apo mos dërgim në kohë nga ana e tyre në respektim të detyrimit për raportim periodik brenda afateve të përcaktuara nga subjektet, lidhur me sa konstatuar ERE ka vijuar me korrespondencat përkatëse në kuadër të përmirësimit të këtyre praktikave.

Përfaqësues të ERE-s janë anëtarë të grupeve të punës së organizmave ndërkombëtare me të cilat ERE ka vendosur tashmë marrëdhënie bashkëpunimi.

Në këtë kuadër ERE informacionin e siguruar nga raportimet periodike e dërgon në institucionet e organizatat e ndryshme bashkëpunuese metë, si dhe merr pjesë në takime, që janë në objektin e punës sësaj, këto të dhëna të monitoruara dhe të analizuara shërbejnë gjithashtu si kontribut në praktikat e këtyre institucioneve si dhe në plotësimin e pyetësorëve dhe korrespondencave.

Në mënyrë që të rritet transparenca në tregun e energjisë elektrike, ERE ka vijuar të monitorojë zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017, i cili ka miratuar "Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike".

Të dhënat kryesore katër mujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike kanë vijuar të publikohen dhe për vitin 2021 rregullisht në faqen e internetit të ERE-s, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndyshuar. Këto të dhëna japin informacione dhe raporte të dhënash të detajuara lidhur me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike dhe tregun e energjisë elektrike.

Për të siguruar zbatimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore të detyrimeve që lidhen me transparencën në tregun e energjisë, ERE ka monitoruar periodikisht faqet e internetit të operatorëve kryesorë në tregun e energjisë. Rezulton se për vitin 2021 këto detyrime zbatohen kryesisht nga operatorët në kuadër të rritjes së transparencës dhe për çdo rast nga ana e ERE-s janë bërë shkresat përkatëse ku i kërkohet operatorëve përmirësimi i këtij procesi duke i evidentuar detyrimet që duhet të përmbushin në zbatim të akteve përkatëse.

Nga ana e operatorëve është vënë re shtimi i informacionit që publikohet në kuadër të transparencës, kryesisht OST sh.a., në faqen e saj të internetit dhe nëpërmjet platformës së transparencës së ENTSO-E, kjo për faktin se OST sh.a. është anëtare e ENTSOE dhe ka detyrimin e publikimit të informacionit dhe në platformën e transparencës të kësaj organizate. Gjithësesi, përmirësime të këtij procesi duhet të vijojnë dhe do të jenë objekt i punës së ERE-s në vijimësi, kjo theksuar edhe përgjatë vitit 2021 e në vijim nëpërmjet komunikimeve zyrtare të ERE-s me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe OST sh.a.

Disa nga monitorimet specifike për të licensuarit dhe pjesëmarrësit e tregut paraqiten shkurtimisht si vijon:

2.1.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.

I. Alokimi i kapaciteteve në interkonjeksione

Në tabelën e mëposhtme paraqiten alokimet e kapaciteteve të interkonjeksionit sipas kufijve.

Tabela me te dhenat e Alokimit te ATC 2021

Ankandi	Periudha	Shqiperi - Mali Zi						Shqiperi - Greqi						Shqiperi - Kosove					
		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit	
		Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import
		[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]
Janar	01.01.2021-31.01.2021	100	100	100	100	0.15	4.77	150	150	150	150	0.84	1.28	200	200	200	200	0.30	0.77
Shkurt	01.02.2021-28.02.2021	100	100	100	100	0.66	0.89	250	250	250	250	0.69	0.4	200	200	200	200	0.28	0.11
Mars	01.03.2021-31.03.2021	113	100	113	100	6.01	0.68	250	259	250	257	4.75	0.15	82	55	82	55	4.88	0.21
Prill	01.04.2021-04.04.2021	100	100	100	100	1.69	0.63	250	250	250	250	2.568	0.05	50	50	50	50	2.11	0.33
	05.04.2021-07.04.2021	0	0	0	0			150		150		2.88							
	08.04.2021-09.04.2021	100	100	100	100	1.95	0.62												
	09.04.2021-30.04.2021							250		250		2.568							
Maj	01.05.2021-02.05.2021	100	100	100	100	1.77	0.57	250	250	250	250	1.71	0.16	50	50	50	50	0.72	0.37
	03.05.2021-04.05.2021							0	0	0	0								
	05.05.2021-07.05.2021							250	250	250	250	1.71	0.16	0	0	0	0		
	08.05.2021-16.05.2021													50	50	50	50	0.82	0.37
	17.05.2021-21.05.2021							350		350									
	22.05.2021-31.05.2021							250		250									
Qershor	01.06.2021-30.06.2021	100	100	100	100	2.55	0.44	250	250	250	250	2.2	0.25	50	50	50	50	0.72	0.51
Korrik	01.07.2021-31.07.2021	100	100	100	100	0.56	0.66	250	250	250	250	0.88	0.18	200	200	200	200	0.12	0.33
Gusht	01.08.2021-31.08.2021	100	100	100	100	0.4	1.8	250	250	250	250	1.2	0.47	200	200	200	199	0.03	0.69
Shtator	01.09.2021-06.09.2021	100	100	100	100	0.4	3.62	100	100	100	100	1.5	0.49	200	200	200	200	0.1	1.03
	07.09.2021-08.09.2021													100	100	98	99	0.1	1.03
	09.09.2021-19.09.2021							0	0	0	0	1.5	0.49	200	200	200	200	0.1	1.03
	20.09.2021-24.09.2021																		
	25.09.2021-26.09.2021							100	100	100	100	1.5	0.49						
	27.09.2021-30.09.2021							0	0	0	0	1.5	0.49						
	01.09.2021-30.09.2021							150	150	150	150	2.1	0.81						
Tetor	01.10.2021-31.10.2021	100	100	100	100	0.71	2.33	150	150	150	150	1.06	2.03	200	100	200	100	0.1	1.03
	1.10.2021-10.10.2021							0	0	0	0	0.5	1.55						
	11.10.2021-17.10.2021							100	100	100	99	0.5	1.55						
	18.10.2021-31.10.2021							0	0	0	0	0.5	1.55						
Nentor	01.11.2021-30.11.2021	100	100	100	100	1.1	0.8	150	250	150	250	1.19	2.19	200	200	200	200	0.08	0.83
	01.11.2021-14.11.2021							100		100		0.93							
	15.11.2021-21.11.2021							0		0		0.93							
	22.11.2021-30.11.2021							100		100		0.93							
Dhjetor	01.12.2021-30.12.2021	100	100	100	100	0.33	3.22	150	150	150	150	1.51	2.17	200	200	200	200	0.02	1.88

Figura 69 Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2021

(Burimi: OST sh.a.)

Sikurse shihet, në shumicën e rasteve ka patur konxhestion në alokimin e kapaciteteve në të dy drejtimet import/eksport.

Për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, gjatë vitit 2021 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të harmonizuara të Zyres se Koordinimit te Alikomit te Kapaciteteve të interkonjeksionit për Evropen Juglindore (SEE CAO-s).

Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, në Rregulloren e Ankandit për Alokimin e Kapaciteteve në SEE CAO.

- Vlen të theksojmë se nuk ka patur asnjë ankimim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, proçedurat, proçesin e zhvillimit të ankandit, proçesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.
- Implementimi i Tregut të energjisë është edhe një proçes bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjelltë ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut, sipas rolit përkatës të tyre në tregun e energjisë.

II. Disbalancat në tregun e energjisë elektrike

Në zbatim të "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë, 02.07.2020, OST sh.a. duke filluar nga 1 prilli 2021 ka operuar në tregun e balancimit të energjisë elektrike duke zbatuar këto rregulla me efekte financiare për pjestarët e tregut të energjisë elektrike duke bërë llogaritjet dhe faturimin e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu të cilët janë përgjegjës për disbalancat që shkaktojnë, në bazë orare. Këto

rregulla vendosin parime të qarta të një tregu konkurues dhe dinamik për sa i përket balancimit të energjisë elektrike.

Gjithsesi, gjatë zbatimit të plotë të këtyre rregullave janë ndeshur veshtirësi në zbatim kryesisht sa i takon trajtimit për Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike dhe FTL sh.a. Për eleminimin e këtyre vështirësive të krijuara në tregun e balancimit ERE është duke punuar me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë për të finalizuar procesin e nxjerrjes së VKM-së respektive bazuar në përcaktimet e nenit 99, pika 4 e Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar. Disbalancat e pjesëmarrësve të tregut gjatë vitit 2021 janë llogaritur dhe faturuar në bazë mujore. Operimi i tregut është objekt i monitorimit të vazhdueshëm të ERE-s.
Në tabelën në vijim paraqiten disbalancat për vitin 2021 për palët përgjegjëse balancuese.

DISBALLANCA 2021 (12 - MUJORI)

Palët Përgjegjëse Balancuese	JANAR		SHKURT		MARS		PRILL		MAJ		QERSHOR		KORRIK		GUSHT		SHTATOR		TETOR		NËNTOR		DHJETOR		Rezultati me eqenime nga Sistemi grid për rastet kur qendrat e Energjisë Balancuese janë Tregu i tanë ka rezultuar në QERSHOR-DHJETOR 2021		TOTALI 2021	
	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]
KOKUM NËRKOMBËTARE	1,917	773	1,835	3,292	446	445	1,035	695	963	1,251	879	772	755	1,302	798	1,371	1,018	861	935	917	1,001	597	651	249	550	439	12,861	12,633
DEVOLL HP	48	61	33	59	140	79	62	97	68	74	41	26	28	50	55	45	78	33	78	41	48	52	370	60	9	17	1,038	694
ENERGJIA GAS & PO WER ALBANIA	1,237	664	775	128	1,438	98	1,305	84	1,562	109	1,080	498	1,816	105	2,495	68	2,304	334	4,795	224	1,214	182	954	462	1,536	154	22,869	3,122
AFËN AS ENERGJI	1,326	335	552	196	123	95	88	128	156	163	104	24	66	17	49	23	45	16	101	6	71	62	86	74	31	13	2,792	1,153
CEA	627	1,648	195	742	1,198	751	1,034	1,016	1,122	1,663	1,355	2,001	2,018	1,511	2,149	1,283	1,000	1,312	1,136	1,406	1,323	235	877	1,427	1,126	910	15,161	16,095
Albanian Energy Supplier AES	1,906	52	2,850	151	2,431	141	1,198	160	1,494	476	1,586	113	2,115	117	2,189	118	2,043	94	1,623	248	1,647	154	1,668	343	1,407	63	24,097	2,235
Energji AS HTA	526	348	207	245	694	534																					1,427	1,127
KEK H (PPE)	4	197	5,167	69	2	97																					5,173	273
KEK H GRUP BALANCIMI (KEK H & AS HTA)							5,897	2,444	882	7,520	1,271	4,438	1,367	3,992	485	4,257	310	2,665							295	3,236	10,418	28,592
Furnitorët i Tregut të Lirë FTL (OSHEE Grup)	8,442	45,110	6,902	30,316	7,062	32,239	7,671	29,002	5,129	19,453	4,722	18,121	3,650	15,065	2,952	15,903	1,646	10,184	4,455	17,410	3,447	21,434	7,730	31,066	2,725	10,467	65,613	286,429
KL-5 ENERGJI	365	98	168	107	237	21	82	93	260	124	407	17	342	30	437	35	595	2							217	5	3,098	611
EYLLIB Tec Balkan (Palët ortakë furnitorët)	73		62		68		62	-	54	-	51	-	52	-	53	-	54	-	61	-	54	-	67	-	44	-	786	-
ENER TRADE sh.p.k.		3		72																							-	75
KOSTT	6,990	6,725	6,084	4,790	4,179	6,915	1,391	11,628	4,924	7,620	4,215	6,507	4,552	5,000	5,189	6,285	7,304	3,072	3,772	7,542	3,414	10,042	1,158	15,239	3,070	4,793	57,067	97,017
OST - HUMBET	7,477	826	7,591	469	1,015	4,124	10,002	-	7,027	33	594	4,087	2,401	460	2,084	1,109	636	1,949							1,303	717	41,081	13,722
Disbalancat mujore [MWh]	25,804		8,277		25,706		15,439		17,041		12,266		7,302		10,643		3,418		10,447		21,210		35,158		8,576		201,369	

O furnitorët i Shërbimit të Balancimit	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]	Ujë Gjenerimi [MWh]	Kriqë Gjenerimi [MWh]
KEK H sh.a. OSHB	39,180	20,968	25,929	8,493	23,015	8,926	40,133	53,776	10,228	10,586	13,222	3,180	9,757	5,334	7,955	4,614	7,407	2,879	8,036	5,508	12,196	6,370	11,561	1,495	235,797	132,138
DEVOLL HP OSHB							401	85	1,851	1,464	73	49	92	-	150	293	198	70			6			1,180	2,770	3,049
AFËN AS ENERGJI OSHB									27	23	-	19	-	-	-	-								7	27	49
KOKUM NËRKOMBËTARE OSHB																									-	-
Energji Balancuese mujore [MWh]	(18,211)		(17,456)		(24,689)		5,327		(8,112)		(10,147)		(4,515)		(2,796)		(4,737)		(3,248)		(5,824)		(9,953)		(103,538)	

Figura 70 Disbalancat totale për vitin 2021 (MWh)

Burimi OST sh.a.

2.1.3 Monitorime të tjera të lidhura me veprimtarinë e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike

- **Monitorimi periodik i treguesve dhe të dhënave kryesore të Sektorit të Energjisë Elektrike për vitin 2021**

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat kryesore të sektorit të energjisë elektrike për vitin 2021, ku pasqyrohen edhe vlerat e vendosura si target në Kapitullin VI "Plani i zbatimit" të VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019 ndryshuar me VKM-në Nr. 758, datë 09.12.2021 "Mbi miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik.

Tabela mundëson të krahasohen këto të dhëna pasi në kolonen"Fakt" jepen të dhënat e realizuara për vitin 2021 ndërsa në kolonen tjetër "Target" jepen të dhënat e përcaktuara në VKM nr. 253/2019 të ndryshuar me VKM nr. 758/2021. Sikurse evidentohet një pjesë e treguesve të vitit 2021 janë realizuar krahasuar me targetet e vendosura respektivisht, Mbledhja e të ardhurave, Gjenerim Neto i Brendshëm, Gjenerimi nga Hec-et Koncesionare dhe PPE, Gjenerimi Neto nga KESH, ndërsa pjesa tjetër e treguesve të vitit 2021 mbetet e pa realizuar.

Krahasim target-fakt i disa prej të dhënave të Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar për vitin 2021 (GWh)		
	Target	**Fakt**
Humbjet në shpëmdarje (import nga OSHEE)	**1 241**	1 557
Humbjet në transmetim (OST)	**162**	228
Klientë te kualifikuar Industri (të lidhur në OST)	**782**	1 049
Familjare	**2 910**	3 082
Kërkesa totale e energjisë	**7 150**	8 415
Gjenerimi Neto nga KESH	**3 950**	5 344
Koncesionare dhe PPE	**1 935**	3 619
Gjenerim Neto i Brendshem	**5 888**	8 963
Humbje totale në shpërndarje (%)	**20.5**	20.62
Mbledhja e të ardhurave (%)	**95**	97.4

Figura 71 Treguesit e SEE për vitin 2021 sipas targetit dhe faktit

2.1.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a., OST sh.a. dhe FTL sh.a. në Treg të hapur (parregulluar) gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021, ERE ka monitoruar përmes raportimit periodik blerjet e energjisë elektrike në treg të hapur nga shoqëritë e rregulluara FTL sh.a. dhe OST sh.a., ku rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë në treg të hapur nga këto dy shoqëri të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik është rreth 189.6 EUR/MWh.

FTL sh.a. ka blerë në treg të parregulluar me qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohshme të tregut si dhe Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr.103/2016, i ndryshuar.

KESH sh.a. gjatë vitit 2021 ka shitur/blerë dhe shkëmbyer energji elektrike në treg të parregulluar kryesisht për optimizim, në zbatim të "Rregullores së Tregtimit të Energjisë Elektrike nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a." miratuar me Vendimin nr. 2762/8, datë 06.06.2019, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a. dhe "Rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a." të miratuar me Vendimin nr. 5233/1, datë 12.06.2020, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit.

OST sh.a. ka blerë në treg të parregulluar me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohshme të tregut si dhe Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.103/2016, i ndryshuar.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna të transaksioneve të kryera gjatë vitit 2021

Transaksione të KESH sha gjatë vitit 2021													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTALI MWh
Transksione Hyrese ne Interkoneksion	0	-706	0	0	0	0	-268	-500	0	-1,033	0	-6,778	-9,285
Transksione Dalese ne Interkoneksion	21,682	46,465	55,262	63,476	75,997	27,950	0	2,100	285	1,100	0	9,684	304,001
Tansaksione Shitje ne tregun e brendëshëm	195,950	251,172	109,049	119,935	168,102	72,540	61,331	55,540	10,915	15,684	9,681	18,455	1,088,354
Tansaksione Blerje ne tregun e brendëshëm	0	0	0	0	-8,605	-16,705	-33,966	-33,713	-32,349	-17,001	-9,787	-16,768	-168,894

Sasia e blere ne treg te pa rregulluar nga OST sha dhe FTL sha (MWh) per vitin 2021, vlerat përkaëse të blerjes dhe cmimi mesatar i ponderuara në (Euro/MWh)			
	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar Euro/MWh	Vlera pa TVSH (Euro)
OST sha	187,750	99.7	18,716,803
FTL sha	1,092,642	205.1	224,103,426
OSTsha+FTL sha	1,280,392	189.6	242,820,229

Figura 72 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2021 nga KESH sh.a. ; FTL sh.a. (OSHEE Group sha) dhe OST sh.a.

Në këtë kontekst është monitoruar edhe trendi i ecurisë 10 vjeçare i sasive të energjisë elektrike dhe çmimeve mesatare të ponderuara për importet e energjisë elektrike në treg të parregulluar nga FTL sh.a/OSHEE Group sh.a., të cilat paraqiten grafikisht si vijon:



Figura 73 Sasia e energjisë elektrike të blerënë tregun e pa rregulluar dhe çmimi i mesatar i ponderuar

Në grafikun e Figurës më poshtë është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2021.

Për 10-vjeçarin e fundit, vendi ynë rezulton të jetë përgjithësisht një importues neto i energjisë elektrike me përjashtim të viteve 2010, 2016, 2018 dhe në 2021. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.



Figura 74 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite

(Burimi: OST sh.a.).

Regjistri i Pjesëmarrësve të regjistruar në tregun e energjisë elektrike gjatë vititi 2021

Regjistri Pjesmarresve te Tregut (fund viti 2021)				
			PRODHUES	P
			TREGTUES	T
			FURNIZUES	F
			FURNIZUES I SHËRBIMIT UNIVERSAL	FSHU
			SHPERNDARJE	SH
Nr	Emri i Subjektit	EIC Code	data e regjistrimit	Roli ne TEE
1	Albanian Energy Supplier	54X-AEG-02-1603G	26.05.2015	T; F
2	AXPO Albania	23X--150330-AA-K	28.1.2020	T
3	Ayen AS Energji	23X--150416-A---N	17.12.2014	P; T; F
4	Ayen Energy Trading	23X--140426-AY-W	04.05.2014	T; F
5	Devoll Hydropower	23X--150409-DHP5	11.06.2015	T; F
6	Energji Ashta	54X-HECASHTA-059	25.05.2012	P
7	Energy Supply-AL	54X-ES-AL 00012Y	15.05.2013	T; F
8	GEN-I Tirana	23X---120709GEN0	31.01.2011	T; F
9	Green Energy Trading Albania	23X--150702GE--3	01.07.2015	T
10	Grupi Sistemeve Automatike	22XGSA---------N	09.05.2011	T; F
11	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	23X--130918APC-M	25.04.2011	P; T
12	KURUM International	23X--131115KI--1	17.12.2013	P; T; F
13	NOA Energy Trade	23X--150630-NE-6	10.03.2015	T;
14	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - OSSH sh.a.	54X-1010101OSSOU	19.02.2020	SH
15	Stravaj Energy	54X-STRAVAJ-E086	25.04.2014	P; T
16	WENERG	54X-WENERG---10E	10.06.2015	P
17	Grid Energy	54X-GRID-ENERGYR	05.04.2017	T; F
18	Energy Financing Team Tirana	54X-EFT-TIRANA-V	24.08.2017	T; F
19	Alpiq Energy Albania	23X--141204AEA-T	29.04.2011	T; F
20	URADRIN	54X-100ID101218J	10.08.2018	F
21	Energia Gas and Power Albania shpk	23x-150309-LT-Y	22.10.2018	T; F
22	RENRGY Trading Group	54X-10IRN102618R	12.11.2018	T,F
23	Ener Trade shpk	54X-10 IET091118	21.12.2018	T; F
24	Power and Gas Operations	54X-10IPG2307196	23.07.2019	T
25	ENSCO Trading (Albania) sh.p.k	54X-110IESA1019G	02.12.2019	T
26	KESH sh.a	23X--130918APC-M	16.12.2019	F
27	Furnizuesi i Tregut të Lirë - FTL sh.a.	54X-1010IFT0220P	19.02.2020	T; F
28	Furnizuesi i Shërbimit Universal - FSHU sh.a.	54X-0101IFSH022Q	19.02.2020	F
29	EZ-5 Energy shpk	54X-11LKE250319U	25.03.2019	T;F
30	Hec Arsti shpk	54X-L-101H11A-IJ	27.03.2021	P
31	Hec Lengarica & Energy shpk	54X-L-1010H-LENU	09.07.2021	P
32	Info-Telecom	54X-1-1100-INFTI	06.08.2021	T
33	Tirana International Development	54X-1-0101-TID-F	06.08.2021	T
34	Teodori 2003	54X-110-TE-ALU	13.08.2021	P
35	Diteko shpk	54-L-10101DIT-Y	13.09.2021	T;P
36	S.P.E.Gjader shpk	54X-L-1010-GJADJ	18.102021	P
37	AlbESP Trading & Consulting shpk	54X-I-10101AESPF	17.12.2021	F;T
38	Hec Tervoli shpk	54X-1-210101HTEI	23.12.2021	P
39	Hec Bishnica 1,2 shpk	54X-1-10011HB12W	23.12.2021	P
40	NOA Energy Trade	23X--150630-NE-6	24.12.2021	F
41	Albanian Energy Supplier 2 shpk	54X-L-101AL-ES21	28.12.2021	T:F
42	Energal shpk	54X-I-1111EN-ALF	31.12.2021	T;P
43	Euron Energy shpk	54X-I-0111EU-ENB	31.12.2021	T;P
44	Hydro-Seta shpk	54X-I-1111HS-015	31.12.2021	T;P
45	Alb-Energy shpk	54X-I-0101AI-EN3	31.12.2021	T;P
46	Future Energy AL	23X--150301-FE-3	06.03.2015	F
47	Danske Comodities Albania	23X--121120DCALG	30.10.2012	T
48	Energji Ashta			

Figura 75 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2021. Burimi OST sh.a.

Për sa monitoruar periodikisht nga regjistri i pjesëmarrësve të regjistruar në tregun e energjisë elektrike përgjatë vitit 2021, konstatohet se nuk ka patur problematika në përditësimin e tij nga ana e OST/OT sa i takon reflektimit të azhornimeve për të licencuarit dhe pjesëmarrësit e tregut si në kuptim të afateve dhe në reflektimin e marrëveshjeve në tregun e energjisë elektrike.

- Gjithashtu përgjatë vitit 2021 në kuadër të përmirësimit të praktikave për funksionimin dhe monitorimin e tregut të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021 është miratuar "Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë" (REMIT), duke ndjekur edhe zbatimin e kësaj rregulloreje përfshirë edhe regjistrimin në kuadër të zbatimit të rregullores si dhe zbatimin e "Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126 datë 30.07.2020, nga operatorët përgjegjës.

2.1.5 Rekomandime për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut nga monitorimet

Përgjatë vitit 2021 në kuadër të vijimit të ushtrimit të funksionit monitorues nga ERE, për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut janë lënë rekomandime dhe detyra si vijon:

- Zbatimi i plotë i Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017, nga OST sh.a. dhe OSHEE Group sh.a. në kuadër të rritjes së shkallës së transparencës në tregun e energjisë elektrike;
- Zbatimin me rigorozitet të përcaktimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë, 02.07.2020 "Mbi miratimin e rregullave të tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", nga OST sh.a përfshirë dhe garantimin e neutralitetit të saj financiar siç është përcaktuar në këto rregulla;
- Zbatimin e kritereve të plota të ndarjes së OSHEE Group sh.a. në tre kompanitë e licencuara OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a., përfshirë dhe format e mënyrat e raportimit të të dhënave në ERE sipas ndarjes;
- Marrjen e masave nga OST sh.a., OSHEE GROUP sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e plotë të parashikimeve të Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126 datë 30.07.2020.

Evidentojmë se ERE, në zbatim të parashikimeve të pikës 5, gërma a) të Vendimit nr. 134/2018 "Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik", ka përgatitur dhe dërguar në Kuvendin e Shqipërisë raporte dhe informacione 6 mujore për gjetjet nga monitorimi, ku janë raportuar të dhënat kryesore të gjëndjes së sistemit elektroenergjitik Shqiptar si gjetjet nga raportimet dhe monitorimet e pjesëmarrësve si dhe operatorëve të energjisë.

2.2 Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)

Me vendimin e ERE nr. 126, datë 17.05.2021, është miratuar Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT). Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikat abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

2.2.1 Detyrime që lindin nga Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë, ndalon tregtimin e energjisë nga personat e brendshëm të kompanive. Kjo për faktin se këta persona posedojnë informacione të brendëshme në lidhje me produktet e energjisë që do të tregtohet për rrjedhojë përfshirja e këtyre personave në procesin e tregtimit të produkteve të energjisë dëmton konkurrencën, transparencën dhe deformon tregun e energjisë.

2.2.2 Monitorimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në treg në zbatim të rregullorës REMIT

ERE do të monitorojë aktivitetin tregtar të produkteve të energjisë me shumicë për të zbuluar dhe parandaluar tregtinë bazuar në rrjedhjen e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut vendas.

ERE do të bashkëpunojnë në nivel rajonal nëpërmjet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë në kryerjen e monitorimit të tregjeve të energjisë me shumicë. Për monitorim të tregut të energjisë me shumicë, ERE gjithashtu do të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës, apo ndonjë organ tjetër për monitorimin e tregut. Në kryerjen e monitorimit të tregut, Autoriteti i Konkurrencës ose organi i monitorimit të tregut do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ERE.

Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte të energjisë me shumicë në Shqipëri, ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes procedurave të tregtimit, duhet të regjistrohen pranë ERE.

Me qëllim realizimin e procesit të regjistrimit të pjesëmarrësve të tregut është krijuar një rubrikë e veçantë në faqen web të ERE. Në këtë rubrikë janë publikuar të gjitha dokumentacionet e nevojshme ku përfshihet dhe formulari i regjistrimit për të krijuar mundësi që pjesëmarrësit e tregut të regjistrohen në ERE. Aktualisht regjistrimi i pjestarëve të tregut është në proces dhe në përfundimin e tij do të krijohet regjistri kombëtar i pjestarëve të tregut në kuadër të rregullores REMIT.

3. BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE (ALPEX)

Bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave, respektivisht nr. 322, datë 15.05.2019 "Mbi themelimin dhe përcaktimin e formës ligjore të strukturës së pronësisë të kapitalit aksionar të operatorit të tregut" dhe atë nr.609, datë 11.09.2019 "Mbi përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në kapitalin aksionar të operatorit të tregut", në tetor të vitit 2020 u themelua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) si një Shoqëri Aksionare, në bashkëpronësi të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSTT).

Shqipëria dhe Kosova janë nënshkruese të Marrëveshjes së Traktatit të Komunitetit të Energjisë në tetor të vitit 2005, e cila mbetet ende në fuqi fillimisht për një periudhë 10-vjeçare nga Korriku i vitit 2006 deri në vitin 2026. Qëllimi kryesor i Komunitetit të Energjisë është që nëpërmjet një kornize detyrimesh ligjore të shtrijë standardet e rregullave dhe parimet e brendshme të tregut të energjisë së Bashkimit Evropian në vendet e Evropës Juglindore, në rajonin e Detit të Zi dhe më gjerë përmes një kornize të detyrueshme ligjore e krijuar nga një numër acquis në energji, ambient dhe konkurrencë.

Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, shfuqizon modelin e blerësit të vetëm në tregun me shumicë, duke paraqitur një treg të lirë dhe të multi-segmentuar. Modeli i ri i tregut siç është përcaktuar në VKM nr. 519 datë 13.7.2016 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", përfshin tregun e ditës në avancë, tregun brenda së njëjtës ditë, tregun balancues dhe shërbimet ndihmëse, si dhe tregun e kontratave dypalëshe, duke qenë kështu në përputhje me praktikat që ndiqen në shumë vënde të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, Ligji për sektorin e energjisë elektrike, siguron themelimin e Bursës së Energjisë Elektrike me qëllim operimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike në Shqipëri.

Në 27 Prill 2016, me qëllim përmbushjen e objektivave të paketës së tretë legjislative në fushën e energjisë elektrike të BE për themelimin e tregut të brendshëm evropian të energjisë elektrike dhe bazuar në vendimet e arritura në samitin e Ballkanit perëndimor, të mbajtur në Vienë në 27 Gusht 2015, Shqipëria dhe Kosova u angazhuan të krijojnë operatorët (bursat) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (DAM) dhe brenda të njëjtës ditë (IDM) në një treg rajonal.

Në Qershor 2018 operatorët e sistemeve të transmetimit OST, KOSTT, enteve rregullatore ERE dhe ZRrE nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit për bashkimin e tregut të energjisë elektrike për ditën në avancë.

Bazuar në Ligjin për sektorin e energjisë elektrike, Qeveria Shqiptare miratoi në korrik të vitit 2016 Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme të interesit në tregjet e organizuara të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, ndërsa në dhjetor të vitit 2017 Enti Rregullator i Energjisë (ERE) miratoi disa rregulla më specifike në lidhje me mënyrën sesi do të funksionojë tregu i organizuar.

Në dhjetor të vitit 2020 Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZReE) miratoi kërkesën e KOSTT për të deleguar tek ALPEX autoritetin për organizimin e tregut të ditës në avancë dhe atë brenda së njëjtës ditë për tregun e Kosovës. Ndërkohë, ALPEX ka hapur në datën 6 maj 2021 degën e saj në

Prishtinë e cila ka si fokus menaxhimin e pjesëmarrëseve të tregut për Kosovën, çështjet rregullatore etj.

Në linjë me Memorandumin e Mirëkuptimit të WB6, ne daten 21 tetor 2021 u nënshkrua një tjetër Marrëveshje Kornizë midis OST, KOSTT, ERE dhe ERO për bashkimin (coupling) e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike dhe brenda së njëjtës ditë. Shqipëria dhe Kosova nënshkruan Marrëveshjen Kornizë si dhe marrëveshje të tjera të suksesshme, të nevojshme për operimin e bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe atë brenda së njëjtës ditë.

Bazuar në sa më sipër, ALPEX pritet të operojë tregun e organizuar të energjisë elektrike (të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë) në Shqipëri dhe Kosovë, të organizojë bashkimin e tregut të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe të lehtësojë bashkimin me tregje të tjera të vendeve fqinje në përputhje me rregulloret e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Modelin e synuar Evropian.

3.1 Hapat e para drejt tregut të organizuar

Në zbatim të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë ECT, Shqipëria dhe Kosova janë zotuar të zbatojnë Paketën e Tretë të Energjisë të Komunitetit të Energjisë, e cila udhëzon palët në lidhje me krijimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike. Si rrjedhojë, modelet e tregut në të dyja vendet parashikojnë që nëpërmjet ALPEX të zbatohet Modeli i Synuar Evropian i Tregut, për tregjet e ditës në avancë (DAM) dhe brenda ditës (IDM), të karakterizuara ndryshe dhe si tregje me shumicë bazuar në transaksionet dypalëshe dhe kontratat e lidhura midis dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës së energjisë elektrike (Over the Counter -OTC) ose ndryshe si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe brenda të njëjtës ditës, i organizuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX. Modelet kanë gjithashtu si synim sigurimin e një strukture të qëndrueshme si dhe krijimin e kushteve për integrimin e mëtejshëm rajonal të Shqipërisë dhe Kosovës, me vendet fqinje, me qëllim përfundimtar atë të integrimit të tregjeve të energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës në tregun pan-Evropian.

Volumet e transaksioneve në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a. janë vendimtare për funksionimin e DAM dhe IDM. Si rrjedhojë, si Shqipëria ashtu edhe Kosova janë zotuar të mandatojnë pjesëmarrjen e palëve dominuese në tregjet e tyre të energjisë elektrike që të tregtojnë pjesë të energjisë së shitur ose të blerë, nëpërmjet DAM dhe IDM nëpërmjet masave rregullatorë.

Fillimisht tregu për DAM dhe IDM do të krijohet me minimalisht dy zona kontrolli (Shqipëri dhe Kosovë) duke zbatuar në të ardhmen projekte për bashkimin me tregje të tjera potenciale. ALPEX do fillojë me operimin e DAM në Shqipëri, dhe më pas, brenda një periudhë dy mujore do të operojë me bashkimin DAM të Shqipërisë me Kosovën. I njëjti parim do të zbatohet edhe për themelimin e IDM.

Gjithashtu, duhet të përmendet që objektivi i ALPEX është vënia në funksionim i tregut të organizuar në Shqipëri dhe Kosovë, duke vepruar si një shoqëri plotësisht e aftë dhe me kapacitetet e nevojshme, për të kryer pjesën më të madhe, ose (afërsisht) të gjitha shërbimet të lidhura me të. Kjo përfshin, ndër të tjera por pa u kufizuar në operacionet e tregut, vigjilencën ndaj tregut, menaxhimin e riskut, likuidimin financiar të transaksioneve, likuidimin financiar fizik, menaxhimin e të dhënave dhe publikimet, etj.

ALPEX me fillimin e vitit 2021 nisi punë për përgatitjen e termave të referencës për përzgjedhjen e Ofruesit të Shërbimit me asistencën e USAID.

Shqipëria dhe Kosova bien dakord të themelojnë një treg të integruar të energjisë elektrike, bazuar në modelin operacional të një Burse të Energjisë Elektrike (PX) për të dyja zonat e kontrollit. Në sistem të dyja zonat e kontrollit duhet të trajtohen si të ndara dhe të pavarura duke përdorur të njëjtin algoritëm për përcaktimin e çmimit, skedulimit dhe flukseve, të realizuara njëherësh si një proces i integruar i kryer nga ALPEX në një portal të vetëm. Tregtimi i energjisë elektrike për të dyja vendet

do të kryhet nga zyrat qendrore në Tiranë së bashku me proceset e rakordim-likuidim financiar dhe të menaxhimit të riskut,

Këto kërkesa kishin si synim ofrimin e një Ofruesi e Shërbimi që shërbimet e tij ndaj ALPEX t'i bazojnë në përdorimin e sistemit të ankandit të tregtimit për ditën në avancë dhe algoritmin e përshtatshëm korresponduese bazuar në një konfigurim të përshtatshëm të SDAC, i përshtatshëm me sistemin e tregtimit të vazhdueshëm brenda të njëjtës ditë SIDC/XBID dhe algoritmin e përputhjes korresponduese / tregtimin brenda të njëjtës ditë mbi një platformë të ankandit të tregtimit brenda të njëjtës ditë.

ALPEX bën me dije se procedurat e përzgjedhjes së këtij Ofruesi Shërbimi u zhvilluan sipas ligjit të prokurimeve publike, ku u kërkua që të sigurohej:

a) Sistemi i ankandit të tregtimit për ditën në avancë dhe algoritmin e përputhjes korresponduese;
b) Sistemi i tregtimit brenda të njëjtës ditë (të vazhdueshëm dhe me bazë ankandi) me algoritmin korresponduese të vazhdueshëm dhe me bazë ankandi;
c) Sistemi i rakordimit dhe likuidimit financiar;
d) Sistemi ose proçesi ose aplikacioni i menaxhimit të riskut;
e) Asistenca në ngritjen e strukturave dhe proçeseve të nevojshme të mirë funksionimit të ALPEX-it.

Gjithashtu ALPEX ka parashtruar se ka vendosur kritere të qenësishme të cilat garantojnë implementimin e modelit të synuar evropian të menaxhimit të një tregu të organizuar të energjisë elektrike për Shqipërinë dhe Kosovën si dhe bashkimin e tregjeve tona (siç njihet market coupling). Kriteret e vendosura sigurojnë integrimin e sigurtë të tregjeve tona në tregjet e energjisë të vendeve të BE. Procedurat e përzgjedhjes u zgjatën përtej afateve të synuara duke e shtyrë procesin e funksionimit të bursës.

Në fund të vitit 2021 u arrit përzgjedhja e këtij Ofruesi Shërbimit me fitues bashkimin e operatorëve të udhëhequr nga Bursa e Athinës "Hellenic Exchanges - Athens Stock ExchangE S.A.", Grupi i bursës së energjisë elektrike të Greqisë me dy kompanitë e saj "Hellenic Energy Exchange S.A." dhe "Enex Clearing House S.A.

Sipas kalendarit të tregjeve të parashikuara në termat e referencës , tregtimi i energjisë elektrike për tregun e ditës në avancë për tregun e Shqipërisë do të nisë në muajin Nëntor dhe në muajin janar 2023 do të kemi tregtimin për tregun e Kosovës dhe bashkimin e të dy tregjeve Shqipëri-Kosovë. Ndërkohë parashikohet që në dhjetor të vitit 2023 të nisi tregtimi i energjisë elektrike brenda të njëjtës dite për tregun e Shqipërisç dhe dy muaj mç pas të kemi bashkimin e tregjeve brenda të njëjtës ditë për të dy tregjet.

4. LICENSIMI, MBIKËQYRJA DHE DHËNIA E AUTORIZIMEVE PËR VEPRIMTARINË E TË LICENSUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË

4.1 Aplikimet për licencim të Trajtuara nga ERE gjatë Vitit 2021

ERE gjatë vitit 2021 ka vijuar të kryej veprimtarinë për licencimin e subjekteve në veprimtaritë/aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Për të gjitha aplikimet e paraqitura është respektuar transparenca e parashikuar në procedurat për licencim, në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", i ndryshuar, Ligjit nr.102/2015 "*Për sektorin e gazit natyror*", i ndryshuar si dhe të "*Rregullores për proçedurat dhe*

afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror". Në përputhje me kuadrin ligjor të cituar janë zbatuar afatet e publikimit në median e shkruar për marrjen e opinionit nga të interesuarit. Gjithashtu çdo aplikim për licencim i është nënshtruar vlerësimit të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me veprimtarinë që subjektet kanë kërkuar të licencohen. Në të njëtën kohë në zbatim të vendimeve të Licencimeve përgjatë vitit 2021 nga ana e ERE-s është vijuar me ndjekjen e zbatimit të kushteve dhe rishikimit të vendimeve respektive.

Për të gjitha subjektet e licencuara nga ERE, mbahet dhe arkivohet regjistri për secilën veprimtari/aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e licencës, të cilat pasqyrohen të përditësuara në faqen e internetit të ERE dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar.

Përgjatë vitit 2021 ERE ka trajtuar 22 kërkesa për licencim në veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, ku për 18 prej tyre janë marrë vendimet përkatëse për licencim nga ERE, siç pasqyruar në tabelat më poshtë, ndërsa për 4 kërkesa është vendosur mosfillimi i procedurës, për shkak të mangësive në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim.

4.2 Licensimi në aktivitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike

Në tabelën e mëposhtëme paraqiten subjektet e licensuara nga ERE përgjatë vitit 2021, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në të cilën evidentohet kapaciteti i instaluar i njësisë gjeneruese dhe numri i vendimit të ERE për licensimin e subjektit. Në vitin 2021 ERE ka licensuar pesë Subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Nr.	Subjekti	Prodhues i energjisëelektrike	Kapaciteti i instaluar	Vendimi i ERE-s
1.	"GREENTECH ENERGY SYSTEMS" sh.p.k	H/C "Pishat"	1911 kW	Nr. 21, Datë 25.01.2021
2.	"AGETA" sh.p.k	H/C "Borie – Lurë"	1800 kW	Nr. 27, date 29.01.2021
3.	"ARIS ALBANIA" sh.p.k	H/C "Gur i Zi" H/C "Daznjanë" H/C Shëlli	1719 kW 1518 kW 1518 kW	Nr. 55, Datë 22.02.2021
4.	" REI - ENERGJI" sh.p.k	H/C "Lingjaca 1" H/C "Lingjaca 2"	1897 kW 300 kW	Nr. 83, Datë 30.03.2021
5.	"GERTI "sh.p.k	H/C "Vardari"	1972 kW	Nr. 99, date 16.04.2021

Figura 76 Subjektet e licencuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2021

4.2.1 Licensimi në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

Përgjatë vitit 2021 ERE ka vijuar të licensojë subjektet në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Në tabelën më poshtë jepen subjektet e licensuara nga ERE në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sikurse evidentohet nga 18 licensime të kryera nga ERE për vitin 2021, rezultojnë që shumica, 8 prej tyre janë për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI i LICENCUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1	"ES 2019" sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 23, datë 25.01.2021
2.	"AGETA" sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 28, datë 29.01.2021
3.	"ERDY ENERGY" sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 30, datë 29.01.2021
4.	"GERTI" sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 54, datë 22.02.2021
5	"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" sh.p.k	Tregtim	Vendimi nr. 146, datë 24.06.2021
6	"INFO – TELECOM" sh.p.k	Tregtim	Vendimi nr. 147, datë 24.06.2021
7	"AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k	Tregtim	Vendimi nr. 242, datë 02.12.2021
8	"Albanian Energy Supplier 2"	Tregtim	Vendimi nr. 257, datë 21.12.2021

Figura 77 Të licensuarit në veprimtarinë e Tregëtimit të Energjisë Elektrike gjatë 2021

4.2.2 Licensimi në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike

Përgjatë vitit 2021 ERE ka vijuar të licensojë subjektet në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike. Në tabelën më poshtë jepen subjektet e licensuara nga ERE në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1	"DRAGOBIA ENERGY" sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 98, datë 16.04.2021
2	"AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k	Furnizim	Vendimi nr. 241, datë 02.12.2021
3	"NOA ENERGY TRADE"	Furnizim	Vendimi nr. 243, datë 02.12.2021
4	"Albanian Energy Supplier 2"	Furnizim	Vendimi nr. 258, datë 21.12.2021

Figura 78 Subjektet e licensuar në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike, gjatë vitit 2021

4.3. Licensimi në aktivitetet e Gazit Natyror

Për vitin 2021 ERE ka licensuar në aktivitetin e furnizimit me Gaz Natyror shoqërinë Albpetrol sh.a.

4.4 Modifikimet e licencave të trajtuara nga ERE gjatë 2021

ERE përgjatë vitit 2021 ka trajtuar 4 kërkesa për modifikim të licencave, ku për 3 prej tyre janë marrë vendimet përkatëse për modifikim, si më poshtë dhe është refuzuar një aplikim për shkak të mangësive nëdokumentacionin e përcjellë në ERE për modifikimin e licensës.

Me vendimin nr. 95, datë 06.04.2021, është miratuar modifikimi i licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "KROI MBRET" sh.p.k., duke miratuar reduktimin e numrit të HEC-eve si më poshtë:

Numri i HEC-eve: Ishte: 5 (pesë), me kapacitet total të instaluar 7320 MW

Bëhet: 3 (tre), me kapacitet total të instaluar 6632 MW

Ky modifikim erdhi për arsye se kishin ndodhur ndryshime në karakteristikat e HEC-eve, ndryshime të cilat janë miratuar dhe nga organet shtetërore përkatëse.

Me vendimin nr. 100, datë 16.04.2021 është miratuar modifikimi i licencës së shoqërisë "KURUM INTERNATIONAL" sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i "Ulëz" me kapacitet të instaluar 24 MW.

Kapaciteti i instaluar i HEC Ulëz: : Ishte: 24 MW

Bëhet: 33.2 MW

Ky modifikim erdhi për arsye se gjatë rehabilitimit të këtij HEC-i në lidhje me optimizimin e operimit të turbinave janë zëvendësuar disa pajisje kryesore të HEC-it me pajisje të reja, çka ka bërë edhe rritjen e kapacitetit të tij. Duke qenë se HEC Ulëz është një hidrocentral privat, nuk ka qenë e nevojshme marrja e miratimit nga organet shtetërore për modifikimin e parametrave.

Me vendimin nr. 154, datë 30.06.2021, është miratuar modifikimi i licencës së Trans Adriatic Pipeline AG Albania, afati i vlefshmërisë së licencës: Ishte: 25 vjet nga data e fillimit të operimit

Bëhet: 30 vjet nga data e fillimit të operimi

Ky modifikim erdhi për arsye se zgjatja e afatit të licencës së transmetimit nga 25 deri në 30 vjet, përtej afatit të përcktuar në kushtet e përjashtimit (nga kriteret për Aksesin e Palëve të Treta, Rregulloret e Tarifave dhe Ndarja e Pronësisë sipas Vendimit të Komisionit Europian të datës 16 maj 2013 për përjashtimin e gazsjellësit Trans Adriatic nga kërkesat e aksesit të palëve të treta, rregulloret e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, të përcaktuara në Nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/KE) do të siguronte harmonizimin e Licencës së Transmetimit me Lejen e Veçantë të dhënë TAP-it me VKM nr. 123, datë 13.03.2019. Gjithashtu, jetëgjatësia minimale operacionale teknike e sistemit të transmetimit të gazit natyror të TAP-it është 50 vjet.

4.5 Aplikimet për rinovim të licencave të trajtuara nga ERE gjatë vitit 2021

Përgjatë vitit 2021 ERE ka trajtuar 4 kërkesa për rinovim licencë, ku për 3 prej tyre është marrë vendim për miratimin e rinovimit, si më poshtë, ndërsa për 1 prej tyre është vendosur mosfillim i procedurës, pasi aplikimi ka qene i paplotë dhe jo në përputhje me rregulloren përkatëse të ERE-s.

Vendimi nr. 14, datë 20.01.2021, për rinovimin e licencës së shoqërisë "ENERGY SUPPLY-AL" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Vendimi nr. 13, datë 20.01.2021, për rinovimin e licencës së shoqërisë "ENERGY SUPPLY-AL" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Vendimi nr. 134, datë 07.06.2021, për rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

4.6 Transferimet e licencave të trajtuara nga ERE gjatë vitit 2021

Përgjatë vitit 2021 ERE ka trajtuar 2 kërkesa për transferim licence, ku për 1 prej tyre është marrë vendim për mosfillimin e procedurës pasi dokumentacioni i përcjellë në ERE ka qënë i pa plotë, dhe për kërkesën tjetër ka filluar procedura përkatëse për shqyrtim.

4.7 Kualifikimi dhe pajisja me Certifikatë të Garancisë së Origjinës gjatë vitit 2021

Përgjatë vitit 2021 ERE ka trajtuar 1 kërkesë dhe ka marrë vendim për kualifikimin dhe pajisjen me me Certifikatë të Garancisë së Origjinës për Impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC Banjë, të shoqërisë Devoll Hydropower sh.a." për energjinë elektrike neto të injektuar në rrjet për vitet 2019 dhe 2020. Pajisja me këtë garanci provon te konsumatori fundor se, një pjesë ose e gjithë sasia e energjisë elektrike të përdorur prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme. Pajisja me këtë garanci të origjinës, provon se HEC Banjë prodhon energji nga burim (hidro) tërësisht i rinovueshëm.

4.8 Dhënia e autorizimeve nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme, si dhe për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit

Përgjatë vitit 2021 ERE ka trajtuar 4 kërkesa për dhënie autorizimi për transferimin e aseteve të paluajtshme të të licencuarve, për të garantuar financimin e marrë nga institucionet financiare për ndërtimin e HEC-ve, ku për 3 prej tyre janë marrë vendimet përkatëse për dhënie autorizmi, ndërsa për 1 kërkesë është vendosur mosfillim procedure, për shkak të mangësive në dokumentacion.

Po ashtu, përgjatë vitit 2021, ERE ka trajtuar 5 kërkesa për dhënie autorizimi nga ERE për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, ku për të 5 kërkesat është vendosur dhënia e autorizimeve përkatëse.

4.9 Trajtimi i kërkesave të ALBGAZ sh.a. për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve të licencimit

Përgjatë vitit 2021, ERE ka trajtuar kërkesat e shoqërisë Albgaz sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes së ERE-s në lidhje me shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror si dhe shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit në aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes deri në datën 20.01.2022 për depozitimin e Lejeve dhe Autorizimeve Mjedisore dhe Certifikatës së Sigurimit. Shtyrjet e afateve procedurale për plotësimin e kushteve përkatëse kanë ardhur për shkak të pamundësisë së shoqërisë për të plotësuar në kohë dokumentacionin e kërkuar nga aktet nënligjore në fuqi, si pasojë e kushteve të vështira të krijuara edhe nga pandemia COVID-19 dhe kufizimeve që erdhën prej saj.

4.9.1 Mbikëqyrja e të licencuarve gjatë vitit 2021

Përgjatë vitit 2021, ERE ka vijuar punën për mbikëqyrjen e të licencuarve dhe vlerësimin e informacionit të siguruar nga raportimet në lidhje me veprimtarinë e licencuar për çdo subjekt. Bazuar në detyrimet që burojnë nga licencat në fushën e veprimtarisë së Energjisë Elektrike si dhe asaj të Gazit Natyror kanë vijuar raportime periodike referuar afatit mujor dhe atij 3-mujor.

Nga ana e ERE është kontrolluar, vlerësuar dhe analizuar informacioni i siguruar nga raportimet në lidhje me veprimtarinë e licencuar, duke nxjerrë gjetjet financiare përkatëse, të cilat gjatë vitit 2022 do të jenë në fokus të përmbushjes së kushteve të licencave.

Nga të dhënat e mbledhura janë përpunuar dhe analizuar treguesit tekniko-ekonomik dhe financiar për vitin 2021 ku sipas evidencave periodike rezulton se një pjesë e konsiderueshme e subjekteve kanë plotësuar parashikimet e tyre për prodhimin e energjisë elektrike, krahasuar kjo me normën vjetore të vendosur në kontratën me MIE-n. Po ashtu duke u bazuar edhe tek raportimi vjetor për

sasinë e energjisë elektrike të prodhuardhe bilanceve të të licencuarve, shumë prej tyre kanë rezultuar me fitim.

Sa rezulton nga të dhënat e mbledhura nga akt-rakordimet e Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL), ky i fundit përgjigjet në kohë ndaj çdo të licencuari që faturon energji elektrike të shitur, sipas kontratës me FTL sh.a.

Gjithashtu nga raportimi i subjekteve të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për qëllime të mbikëqyrjes ERE ka përpunuar të dhënat për të përcaktuar koeficentin e shfrytëzimit, për subjektet raportuese si dhe prodhimin mujor dhe tre-mujor, për të evidentuar ecurinë e tyre. Nga përpunimi i këtyre të dhënave përgjatë gjithë vitit rezulton se numri i të licencuarve që raportojnë rregullisht dhe në mënyrë sistematike është rritur në vijueshmëri.

Në funksion të mbikëqyrjes së të licencuarve është mbajtur dhe azhornuar në mënyrë të vazhdueshme informacioni i marrë nga raportimet për sigurimin e shëndetit të punonjësve si dhe të aseteve të paluajtshme që lidhen me veprimtarinë e licencuar. Konkluzionet e nxjerra tregojnë angazhim të kënaqshëm nga të licencuarit për të përmbushur më korrektësi detyrimet që burojnë nga licencat që mbajnë.

Në lidhje me sa më sipër, puna e nisur gjatë vitit 2020 ka vijuar dhe në vitin 2021, ku nga raportimet e këtij viti është konstatuar se të licencuarit në sektorin e energjisë janë në progres të vazhdueshëm me përpjekjet e tyre që nga koha e licencimit nga ERE, për të qënë të suksesshëm në këtë veprimtari.

Gjithashtu në kuadër të raportimit mujor dhe mbikëqyrjes janë evidentuar shoqëri të cilat kanë hasur problematika si rezultat i luhatjeve të tensionit si dhe shkëputjes së energjisë në zonën ku operojnë. Në lidhje me këto raste ERE në mbështetje të *"Marrëveshjes së Lidhjes së Re"* miratuar me endimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, "*Kodit të shpërndarjes*" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100, datë 26.08.2008 si dhe *"Rregullores për kriteret standarde së cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike"*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, rast pas rasti i është drejtuar me anë të shkresave respektive operatorëve të rrjetit duke i kujtuar përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga aktet e sipërcituara, si dhe duke kërkuar informacion mbi veprimet konkrete që janë ndërmarrë për zgjidhjen e problematikave të hasura nga të licencuarit. Nga ana e operatorit të rrjetit është bërë me dije se ka mbingarkesë rrjeti, gjë e cila duhet të adresohet në planin respektiv të investimit.

Për qëllime të verifikimeve të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e licencave përkatëse, për të njoftuar ERE-n në lidhje me ndryshimet e adresës, administratorit, statutit etj, apo për paraqitjen e kërkesës për marrjen e autorizimit ERE-s për ndryshimin e statusit ligjor, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar apo për vendosjen e kuotave e aksioneve të të licencuarave si mjete për garantimin e detyrimit/detyrimeve ndaj të tretëve, janë konsultuar ekstraktet historike të regjistrit tregtar të të licencuarve (në faqen zyrtare elektronike e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe më tej është vijuar me procedurat përkatëse.

4.9.2 Çertifikimet, ndjekja dhe zbatimi i kushteve respektive

Sikurse është raportuar edhe vitin 2020, OST sh.a. ka përmbushur të gjitha kushtet e çertifikimit dhe ERE me vendimin nr. 99, datë 24.06.2020, vendosi shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.03.2017 "*Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike "OST" sh.a.,. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC "Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë", i ndryshuar.*

Aktualisht në zbatim të vendimit të sipërcituar, "OST" sh.a. ka detyrimin të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

Për vitin 2021 OST sh.a. ka përmbushur këtë kusht periodik duke bërë me dije se Audituesit Ligjorë të caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit të OST sh.a., me shkresën nr. 22365 prot., datë 14.12.2021, për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të OST sh.a. për vitin 2021, rezulton se nuk janë caktuar për të ushtruar auditim në kompanitë shtetërore të prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Sa informuar nga OST sh.a. vërtetohet edhe nga dokumentacioni që shoqëria ka përcjellë në ERE.

Po ashtu, në zbatim të përcaktimeve të vendimit Nr. 43, datë 15.03.2017, *"Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë", si dhe në zbatim të përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a miratuar me vendimin e Bordit te ERE-s Nr. 103, datë 30.04.2018*, Zyrtari i Pajtueshmërisë së shoqërisë OST sh.a, në përmbushje të detyrave të tij, duhej të dërgonte në ERE Rapotin Vjetor të Pajtueshmërisë së OST sh.a për vitin 2020, brenda datës 31 mars të vitit 2021.

Me komunikimin elektronik të datës 26.03.2021, Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST sh.a., i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrje të afatit të dorëzimit të raportit të pajtueshmërisë së OST sh.a për vitin 2020, me 7 (shtatë) ditë pune nga data 31 Mars që ishte afati i fundit për dorëzimin e tij.

Në vijim të kërkesës së sipërcituar Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 88, datë 31.03.2021, vendosi të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, gërma c, pika 1, të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 103, datë 30.04.2018, deri në datën 20.04.2021.

Zyrtari i Pajtueshmërisë i OST sh.a. nëpërmjet komunikimit zyrtar në datën 07.04.2021, në përmbushje të detyrave të lëna me vendimin e ERE-s Nr. 43, datë 15.03.2017 "*Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike" OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe nenin 9 pika 6 të "Direktivës 2009/72/EC mbas marrjes së opinionit të Sektretariatit të Komunitetit të Energjisë"*, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë të OST sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr.103, datë 30.04.2018, përcolli në ERE raportin e pajtueshmërisë së OST sh.a. për vitin 2020.

Nga ky raport u konstatua se OST sh.a ka vijuar përmbushjen e detyrimeve të tij në kuadër të përmirësimit të punës në drejtim të zbatimit të parashikimeve të vendimit të çertifikimit, të programit të pajtueshmërisë dhe implementimin e rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Nga ana e ERE-s janë dhënë disa rekomandime në kuadër të përmirësimeve të përmbushjes së këtyre detyrimeve për të cilat i është kërkuar OST të marrë masa dhe në vijim ERE do të ndjekë nivelin e zbatimit të tyre.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 ERE ka ndjekur zbatimin e kushteve të vendimit Nr. 179, datë 08.11.2017, *"Mbi çertifikimin e "Operatori i kombinuar i gazit natyror" Albgaz sh.a,* duke qenë se për Albgaz sh.a mbeten ende kushte të paplotësuara nga ky vendim.

Bordi i ERE-s vendosi shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin e bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, *"Mbi çertifikimin e "Operatori i kombinuar i gazit natyror" Albgaz sh.a.* , deri në datën 20.01.2022, sipas kërkesës së shoqërisë që lidhej me paraqitjen në ERE çdo vit ushtrimor të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë dhe me bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor.

Shkak për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të sipërcituar, u bë pamundësia e shoqërisë ALBGAZ sh.a për ti plotësuar në kohë si rezultat i situatës së veshtirë të krijuar në vendin tonë nga pandemia COVID -19. Në lidhje me informacionin për pavarësinë e audituesve financiarë, shoqëria ka argumentuar se është në pritje të përfundimit të procesit të auditimit dhe në ERE do ta paraqesë dokumentin e plotë, në kuadër të plotësimit të këtij kushti periodik. Nga ana tjetër, kushti

për bashkëveprimin ndërinstitucional nuk varet nga vullneti i shoqërisë, por nga institucionet shtetërore.

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015, "*Për sektorin e gazit natyror*", i ndryshuar, në zbatim të kërkesave të nenit 73 dhe 74 të "Programit të Përputhshmërisë", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 77, datë 26.05.2017, "*Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror*"; në përmbushje të detyrave të lëna në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 78, datë 26.05.2017, "*Mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror*", Zyrtari i Përputhshmërisë së ALBGAZ sha, me shkresën zyrtare me datë 31.03.2021, ka dërguar Raportin Vjetor të Përputhshmërisë për Albgaz sh.a. për vitin 2020.

Referuar raportimit të zyrtarit në lidhje me zbatimin e programit të përputhshmërisë për vitin 2020, gjetjeve dhe rekomandimeve të tij, evidentohet se ky raportim është bërë kryesisht sipas kërkesave të programit tip, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017 dhe në vijim janë lënë disa detyra e rekomandime, për të cilat i është kërkuar ALBGAZ sha të marrë masa dhe në vijim ERE do të ndjekë nivelin e zbatimit të tyre.

Raportimi vjetor nga ana e Zyrtarit të Përputhshmërisë është bërë duke u bazuar në programin tip të përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e ERE Nr. 77/2017, por në vijim të depozitimit për miratim të Porgramit të Përputhshmërisë nga ALBGAZ sha, Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 171, datë 16.08.2021, ka vendosur:

1. *Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, "ALBGAZ" sh.a., me kushtin që shoqëria brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 77, datë 26.05.2017.*
2. *Mosplotësimi i kushtit sipas përcaktimeve të pikës 1, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.*

Me shkresën e datës 16.11.2021, shoqëria "ALBGAZ" sh.a., është shprehur se ka marrë të gjitha masat për të plotësuar kushtet e vendimit dhe aktualisht është në proces konsultimi me aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje. Sa më sipër, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimn e ERE-s për të shtyrë me 3 (tre) muaj afatin e përcaktuar në pikën 1 të vendimit të Bordit Nr. 171/2021.

Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 236, datë 26.11.2021, ka vendosur të zgjasë me 3 (tre) muaj, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, afatin e përcaktuar në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 171, datë 16.08.2021, "Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, "ALBGAZ" sh.a.".

5. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR

Në zbatim të neneve 19,20,79 dhe 83 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e EnergjisëElektrike",i ndryshuar, të Neneve 16,17,32,75 dhe 92 të Ligjit Nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror",i ndryshuar, si dhe Nenit 10 të Ligjit Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimi të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe ato që kanë detyrimine shërbimit publik në sektorin eenergjisë, bazuar në metodologjitë respektive në fuqi.

Në këtë kuadër, veprimtaritë kryesore të ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror gjatë vitit 2021 kanë qenë:

1. Shqyrtimi i aplikimeve, analiza e kostove dhe miratimi i tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:
   - Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;
   - Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike;
   - Aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike;
   - Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;
   - Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror;
   - Përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga burimet e vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020;
   - Përcaktimin e çmimit të mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW për vitin 2020;
   - Përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi;
   - Aktiviteti i prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike;
   - Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike;
2. Hartimi, rishikimi dhe miratimi i Metodologjive të llogaritjes së tarifave për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror:
   - Vijimi i procesit të miratimit të Metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike;
   - Vlersimi mbi nevojën për rishikimin e Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
   - Miratimi i Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për Operatorin e Sistemit të GNL-së;
3. Studimi dhe vlerësimi i të dhënave krahasimore lidhur me tarifat dhe çmimet e miratuara nga ERE ndër vite si dhe çmimet e energjisë elektrike të vendeve të rajonit.

Përgjatë vitit 2021, ERE ka shqyrtuar dhe vlerësuar kostot e aktiviteteve të shoqërive të rregulluara të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, sikurse vepruar për çdo vit ushtrimor në zbatim të legjislacionit në fuqi.

ERE ka zhvilluar proçeset e shqyrtimit të aplikimeve të tarifave dhe çmimeve të aktiviteteve të rregulluara dhe ka vendosur lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve duke analizuar dhe vlerësuar kostot e realizuara dhe ato të lejuara të këtyre aktiviteteve. Gjatë kësaj periudhe, ERE ka synuar mbajtjen e tarifave të qëndrueshme në kohë duke marrë në konsideratë se sektori i energjisë elektrike ka pësuar një sërë ndryshimesh thelbësore në kuadër të reformave të miratuara nga Qeveria Shqiptare, me qellim rimëkëmbjen financiare të tij.
Qeveria Shqiptare me anë të vendimit Nr. 253, datë 24.4.2019 e ndryshuar, shfuqizoi planin e rimëkëmbjes financiare dhe miratoi planin e konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjetik. Në mënyrë që aktivitetet e rregulluara të përmirësonin treguesit e tyre teknikë dhe ekonomiko – financiar, plani i rimëkëmbjes së sektorit të energjisë elektrike parashikoi ndër të tjera nivelin e synuar të humbjeve të lejuara në rrjet dhe arkëtimeve nga shitja e energjisë elektrike. Gjithashtu, plani parashikoi: mbajtjen e tarifave të brendshme të përshtatshme dhe kosto-reflektuese

për furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë për tregun e rregulluar të tarifave, ku tarifat e shpërndarjes do të bazoheshin në planin e rishikuar të reduktimit të humbjeve; si dhe Miratimin nga ERE të tre tarifave të aksesit në rrjet në nivelet e tensionit 35 kV, 20/10/6 kV dhe 0.4 kV përkatësisht për të mundësuar kalimin në treg të parregulluar, të klientëve të lidhur në tensionin e mesëm.

Nga analiza e aktiviteteve të rregulluara për vitin 2020 dhe 2021, kanë rezultuar ndryshime të theksuara kundrejt parashikimit të treguesve teknik, ekonomik dhe financiar për arsye të efekteve që shkaktoi në sektorin elektroenergjetik tërmeti i vitit 2019, pandemia COVID -19 e më tej efektet post-pandemi. Efekti i këtyre fenomenëve shkaktoi luhatje të mëdha në kërkesën për energji në total, nivelin e humbjeve në rrjet si dhe investimet e realizuara.

Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2021, tregu ndërkombëtar i energjisë u përball me një rritje të kërkesës, në kohën kur oferta për energji elektrike dhe gaz natyror nuk përmbushnin dot nevojat e tregut.

Këto efekte u ndjenë gjithashtu dhe në tregun shqiptar të energjisë elektrike, i cili pavarësisht se gjatë vitit 2021 pati një rritje të prodhimit vendas, përgjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2021 u bë e nevojshme importi i energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për qëllimet të furnizimit universal por dhe mbulimit të humbjeve, çështje të cilat janë përmendur në vijim në këtë raport.

Në grafikun në vijim paraqitet trendi i çmimeve të tregut të ditës në avancë në bursën HUPX sipas raportit vjetor HUPX Dam, krahasuar me çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga FTL sh.a. për qëllime të mbulimit të humbjeve të operatorit të rrjetit të shpërndarjes, furnizimit universal dhe furnizimit të mundësisë së fundit, si dhe çmimeve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të OST sh.a.:



Figura 79 Çmimi mesatar i tregut të ditës në avancë HUPX Dam, Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga FTL sh.a. për qëllime të mbulimit të humbjeve të operatorit të rrjetit të shpërndarjes, furnizimit universal dhe furnizimit të mundësisë së fundit, si dhe Çmimi i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

(Burimi: HUPX, FTL sh.a., OST sh.a.)

Sikurse vërehet në grafikun e mësipërm, që prej muajit korrik 2021 çmimi i energjisë elektrike i tregtuar në tregun e ditës në avancë në bursen Hungareze HUPX DAM ka vijuar të ketë një rritje të konsiderueshme duke arritur kulmin e tij në vlerën 245.81 Euro/MWh gjatë muajit dhjetor 2021. Ndërkohë në tregun shqiptar të energjisë ky efekt është ndjerë edhe më herët duke arritur kulmin e tij në tetor 2021 ku çmimi i blerjes nga tregu i lirë prej FTL sh.a. ka arritur në vlerën 280.46 Euro/MWh.

ERE në vijim të aplikimeve për përcaktimin e tarifave të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike të shoqërive OST sh.a. dhe OSSH sh.a. si dhe rritjes së kostos së blerjes së energjisë nga tregu i lirë, me qëllim rishikimin e mjaftueshmërisë së tarifave të këtyre aktiviteteve vijoi me procesin e shqyrtimit të tarifës mesatare të transmetimit dhe tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, te cilat janë objekt shqyrtimi gjatë vitit 2022.

5.1 Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorine energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2022 gjatë vitit 2021

5.1.1 Lidhur me aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin2022 dhe për periudhën 2022-2024

Bazuar në detyrimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërpërmendura, Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.,) paraqiti pranë ERE-s aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 si dhe për periudhën 2022-2024.

Në kërkesën e saj OST sh.a. kërkoi nga ERE miratimin e tarifës mesatare të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 3 vjeçare 2022 – 2024 në vlerën **1.47 lekë/kWh** nga tarifa në fuqi prej **0.75 lekë/kWh**.

Gjatë shqyrtimit të aplikimt të shoqërisë OST sh.a., ERE vlerësoi të nevojshme kryerjen e analizave për kostot e parashikuara ndaj atyre të realizuara, si dhe treguesve teknikë, ekonomik dhe financiar të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Sa më lart, u konsiderua e nevojshme për të vlerësuar nëse shoqëria gjendej në rrethanat që kërkonin rishikimin e nivelit të tarifës mesatare të transmetimit e si rrjedhojë komponentët e të ardhurave të kërkuara/lejuara në zbatim të përcaktimeve të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", si dhe në mbështetje të përcaktimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".

Në këtë kuadër, ERE me vendimin nr. 234, datë 19.11.2021, vendosi "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024".

ERE në zbatim të parashikimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" më datë 3.12.2021 organizoi një seancë dëgjimore teknike me përfaqësuesit e OST sh.a. për të diskutuar mbi çështjet dhe rrethanat që çuan OST sh.a. në propozimin e një tarife mesatare prej 1.47 lekë/kWh për periudhën e ardhshme rregullatore 2022 – 2024. Në mënyrë që ky proces të vlerësohej sa më drejtë dhe në transparencë të plotë si dhe të gjykohej mbi propozimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024, në zbatim të Rregullores së sipërcituar, ERE më datë 29.12.2021, organizoi një seancë dëgjimore publike me përfaqësuesit e shoqërisë OST sh.a. si dhe palët e interesit.

Gjatë këtij procesi ERE ka vijuar me një sërë korrespondencash me OST sh.a. për trajtimin e çështjeve të cilat kanë qënë të nevojshme të plotësoheshin me informacione, dokumentacion dhe argumenta të mëtejshme të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ERE.

Meqënëse ky proces nuk mundi të ezaurohej brenda vitit 2021 për arsye të dinamikave të shprehura më lart në këtë raport dhe në mënyrë që shoqëria OST sh.a. edhe për vitin 2022, të vijonte të realizonte aktivitetin për të cilin është licencuar, konform Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021 vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE nr. 212, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit

të aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.

5.1.2 Lidhur me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave për vitin 2022

Bazuar në detyrimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërpërmendura, Shoqëria OSSH sh.a., paraqiti aplikimin për tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2022, duke propozuar miratimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2022, si më poshtë vijon:

a) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 35 kV është kërkuar **2.61 Lekë/kWh** nga ajo në fuqi prej **1.5 Lekë/kWh**;

b) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 20-6 kV është kërkuar **3.99 Lekë/kWh** nga ajo në fuqi prej **3.9 lekë/kWh** për nivelin e tensionit 20 kV**;**

c) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 0.4 kV është kërkuar **6.63 Lekë/kWh** nga tarifa mesatare e shpërndarjes në fuqi prej **4.79 Lekë/kWh.**

Pas shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a., ERE vlerësoi të nevojshme kryerjen e analizave për kostot e parashikuara ndaj atyre të realizuara, si dhe treguesve teknikë, ekonomik dhe financiar të operatorit të shpërndarjes. Sa më lart, u konsiderua e nevojshme për të vlerësuar nëse shoqëria gjendej në rrethanat që kërkonin rishikimin e nivelit të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike e si rrjedhojë komponentëve të të ardhurave të kërkuara në zbatim të përcaktimeve të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes", si dhe në mbështetje të përcaktimeve të Rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".

Në këtë kuadër, ERE me vendimin nr. 233, datë 19.11.2021, vendosi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpëndarjes për vitin 2022.

ERE në zbatim të parashikimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" më datë 3.12.2021 organizoi një seancë dëgjimore teknike me përfaqësuesit e OSSH sh.a. për të diskutuar mbi çështjet dhe rrethanat që çuan OSSH sh.a. në propozimin e tarifave për nivelet e tensionit për vitin 2022.

Në zbatim të Rregullores së sipërcituar si dhe në mënyrë që ky proces të zhvillohej në transparencë të plotë e të gjykohej sa më drejtë propozimi i tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 prej shoqërisë OSSH sh.a., më datë 29.12.2021 u organizua një seancë dëgjimore publike me përfaqësuesit e shoqërisë OSSH sh.a., ERE si dhe palët e interesit.

Gjatë këtij procesi ERE ka vijuar me një sërë korrespondencash me OSSH sh.a. për trajtimin e çështjeve të cilat kanë qënë të nevojshme të plotësoheshin me informacione, dokumentacion dhe argumenta të mëtejshme të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ERE.

Meqënëse ky proces nuk mundi të ezaurohej brenda vitit 2021 për arsye të dinamikave të shprehura më lartë në këtë raport dhe në mënyrë që shoqëria OSSH sh.a. edhe për vitin 2022, të vijonte të realizonte aktivitetin për të cilin është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022.

5.1.3 Lidhur me miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal

Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për miratimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2022, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi.

ERE njoftoi shoqërinë FSHU sh.a. mbi aplikimet për tarifa të rrjetit nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes dhe kërkoi nga shoqëria FSHU sh.a. ndër të tjera, përcjelljen e parashikimeve të saj mbi transferimin e kostove të rrjetit të kërkuara nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike; kostove të blerjes së energjisë dhe kostot e tjera të aktivitetit të shoqërisë FSHU sh.a. për çdo kategori klientësh që do të furnizohen nga FSHU sh.a. dhe FMF sh.a. gjatë vitit 2022; si dhe strukturën e çmimeve që pritet të aplikohet për të përfituar të ardhurat e nevojshme për mbulimin e kostove të aktivitetit ushtrimor të parashikuara për vitin 2022.

Shoqëria FSHU sh.a. deklaroi se është në pritje të vendimeve të ERE-s për tarifat dhe çmimet lidhur me transferimin e kostove të rrjetit për klientët tariforë, si dhe mbështetur në vendimet dhe deklaratat e Qeverisë Shqiptare, FSHU sh.a pret mosndryshim të çmimeve të shitjes së energjisë për klientët në nivelin e tensionit 0.4 kV.

Për sa më sipër, në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a. edhe për vitin 2022, të vijojë të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, *"Për Sektorin e Energjisë Elektrike"*, i ndryshuar, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, vendosi shtyjen e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 214, datë 15.12.2020, deri në vlerësimin e ERE për transferimin e kostove të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike të çmimeve të shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në përfundim Bordi i ERE-s me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021 vendosi lënien në fuqi të vendimeve të bordit të ERE-s nr. 212, nr. 213 dhe nr. 214, datë 15.12.2020, duke mbajtur në konsideratë se efektet në të ardhurat e shoqërive të rregulluara, do të korrigjohen dhe do të bëhet kompensimi përkatës i tyre në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma "c", të Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe metodologjitë përkatëse,.

Proceset e shqyrtimit të aplikimeve dhe miratimit të tarifave të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe analiza e kostove të furnizimit të shërbimit universal do të trajtohen nga ERE në raportin vjetor të vitit 2022.

5.1.4 Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin2021

Në zbatim të Nenit 87, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike",i ndryshuar, si dhe "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me Vendimin nr.201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendime të Bordit të ERE nr.144, datë 25.06.2018 dhe nr.233, datë 20.12.2019, Enti Rregullator i Energjisë ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për secilin muaj të vitit 2021. Përllogaritje të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë kryer në zbatim të formulës së përcaktuar në metodologjinë e lart përmendur.

Në vijim paraqiten çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitet 2020-2021, sipas vendimeve respektive të Bordit të ERE-s, si dhe

çmimet mesatare të ponderuara të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji për vitin 2021, krahasuar me ato të vitit 2020.

Viti 2020	Vendimi	Cmimi i shitjes miratuar nga ERE (lekë / kWh) 2020	ÇBEt 2020
Janar	Nr. 23, Datë 10.02.2020	12.49	8.20
Shkurt	Nr. 47, Datë 20.03.2020	10.50	9.92
Mars	Nr. 60, Datë 08.04.2020	9.56	5.62
Prill	Nr. 84, Datë 12.05.2020	9.50	4.58
Maj	Nr. 95, Datë 08.06.2020	9.50	4.15
Qershor	Nr. 116, Datë 09.07.2020	9.50	4.15
Korrik	Nr. 130, Datë 10.08.2020	9.50	5.08
Gusht	Nr. 147 , Datë 10.09.2020	9.71	5.51
Shtator	Nr. 156, Datë 07.10.2020	11.75	7.49
Tetor	Nr. 182, Datë 06.11.2020	11.10	7.07
Nentor	Nr. 207, Datë 11.12.2020	11.32	7.07
Dhjetor	Nr. 01, datë 11.01.2021	14.82	10.47

Figura 80 Çmimet e shitjes dhe çmimi mesatar i ponderuar së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2020

(Burimi: ERE)

Viti 2021	Vendimi	Cmimi i shitjes miratuar nga ERE (lekë / kWh) 2021	ÇBEt 2021
Janar	Nr. 38, Datë 11.02.2021	10.80	6.56
Shkurt	Nr. 71, Datë 12.03.2021	10.79	6.55
Mars	Nr. 103, Datë 16.04.2021	10.54	6.31
Prill	Nr. 119, Datë 11.05.2021	10.57	6.34
Maj	Nr. 133, Datë 07.06.2021	10.48	6.26
Qershor	Nr. 161, Datë 12.07.2021	10.48	6.26
Korrik	Nr.179, Datë 23.08.2021	15.34	10.97
Gusht	Nr.182, Datë 10.09.2021	15.03	10.67
Shtator	Nr.213, Datë 15.10.2021	24.74	20.19
Tetor	Nr.229, Datë 09.11.2021	32.73	27.85
Nentor	Nr.246, Datë 13.12.2021	38.73	33.68
Dhjetor	Nr. 16, Datë 26.01.2022	35.41	26.88

Figura 81 Çmimet e shitjes dhe çmimi mesatar i ponderuar së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2021

(Burimi: ERE)

Sikurse vërehet në tabelat e mësipërme, çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë për qëllime të furnizimit të mundësisë së fundit, ka rezultuar me diferenca të theksuara duke sjellë si rrjedhojë dhe impakt në përllogaritjen e çmimit të shitjes i cili është miratuar nga ERE për periudhën 2020 - 2021. Në grafikun në vijim, paraqitet kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të mundësisë së fundit për vitin 2020 - 2021.



Figura 82 Kurba levizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët të cilët furnizohen nga FMF, për vitet 2020-2021

Sikurse vërehet në grafikun e mësipërm, kosto e blerjes për periudhën janar –qershor ka rezultuar me diferenca jo të theksuara, duke vijuar në një trend të ekuilibruar. Ndërkohë periudha korrik –dhjetor 2021 ka rezultuar me diferenca domethënëse krahasaur me të njëjtën periudhë të vitit 2020, për efekt të rritjes së çmimit të blerjes së energjisë në tregun e lirë.

Në tabelën në vijim, paraqesim ndryshimin dhe diferencat në rritje të çmimeve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e nevojës së klientëve FMF për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Muaji	ÇBEt 2020	ÇBEt 2021	Diferenca në përqindje 2021-2020
Janar	8.20	6.56	-20%
Shkurt	9.92	6.55	-34%
Mars	5.62	6.31	12%
Prill	4.58	6.34	39%
Maj	4.15	6.26	51%
Qershor	4.15	6.26	51%
Korrik	5.08	10.97	116%
Gusht	5.51	10.67	94%
Shtator	7.49	20.19	170%
Tetor	7.07	27.85	294%
Nentor	7.07	33.68	376%
Dhjetor	10.47	26.88	157%
Mesatare	**6.61**	**14.04**	**113%**

Figura 83 Çmimi blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e nevojës së klientëve FMF për periudhën 2020 – 2021

(Burimi: FSHU sh.a.)

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2021, krahas çmimeve të shitjes për vitin 2020:



Figura 84 Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuar nga ERE për vitet 2020-2021

Sikurse vërehet në grafikun e mësipërm, çmimet e miratuara nga Bordi i ERE-s për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV janë impaktuar nga çmimi i blerjes së energjisë elektrike i shprehur më lart, ku efekti për 6 mujorin e dytë të vitit 2021 ka ardhur në një rritje progresive mesatare prej rreth 62% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Nga analiza e raporteve periodike të vitit 2021, evidentohet se sasia e energjisë elektrike e shitur për klientët e FMF-së ka qënë 20 GWh, me një vlerë të faturuar prej 377 milion lekë, duke rezultuar në një çmim mesatar vjetor prej 18.01 lekë/kWh. Në tabelën në vijim paraqesim diferencat e këtyre treguesve për vitet 2021-2020.

Viti	Sasia (kWh)	Vlera (Lekë)	Çmimi mesatar i realizuar (Lekë/kWh)
2020	26,062,645	289,076,144	11.09
2021	20,938,063	377,010,344	18.01
Diferencë	-20%	30%	62%

Figura 85 Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2020 - 2021

(Burimi OSHEE Group sh.a, ERE)

Nga struktura e shitjes, evidentohet një ulje e konsiderueshme e energjisë së shitur për këta klientë në masën 20% gjatë vitit 2021 krahasuar me atë të vitit 2020. Kjo diferencë ka ardhur si pasojë e lidhjes së kontratave të furnizimit në tregun e lirë nga një pjesë e klientëve të cilët furnizoheshin në kushtet e mundësisë së fundit në vitin e mëparshëm. Ndërkohë, të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë për klientët FMF gjatë vitit 2021, rezultojnë në një rritje prej 30% krahasuar me vitin 2020.

5.1.5 Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2022

Nëzbatim të nenit 17, gërma"e",të Ligjit nr.102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, përcaktohet se "ERE ka të drejtë të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarje,

në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave".

Në mungesë të paraqitjes së një aplikimi për rishikimin e tarifës së transmetimit të shoqërisë Albgaz sh.a. për vitin 2022, paraqitjes së planit të investimeve për vitin 2022 si një komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2022, si dhe në zbatim të direktivave të Komunitetit të Energjisë, meqënëse aksesi në rrjet për përdoruesit e Sistemit të Transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE me vendimin nr. 254, datë 21.12.2021 vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit Nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2022, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., ku përditësimi dhe kompensimi i të ardhurave të kërkuara të shoqërisë Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme do të bëhet në mbështetje të përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror",i ndryshuar.

5.1.6 Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020 dhe 2021

5.1.6.1 Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2020

Në mbështetje të nenit 10, pika 3 të Ligjit Nr. 7/2017 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"* dhe përcaktimeve të VKM Nr. 369, datë 26.4.2017 "*Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla tërinovueshme nga dielli dhe era*" dhe VKM Nr. 27, datë 17.1.2018 "*Për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale*", ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale me fuqi të instaluar respektivisht 2 MW.

Në zbatim të legjislacionit sipërcituar si dhe orientimeve të MIE ku për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike të merret në konsideratë metodologjia e vlerësimit të kostove të energjisë nga burimet e rinovueshme, e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE, sipas VKM Nr. 369, datë 26.04.2017.

Bordi i ERE me Vendimin Nr. 271, datë 28.12.2020, miratoi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.

Bazuar në komunikimet me Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjisë, rezultoi se për vitin 2020 nuk është dhënë asnjë miratim përfundimtar për ndërtimin e veprave nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli apo nga gjeneratorë të vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

Në mungesë të subjekteve të pajisura me miratimin përfundimtar si dhe të dhënave mbi kostot reale të investimit, nuk gjente zbatim përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga centralet fotovoltaike si dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që

shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2020.

Në këto kushte, Bordi i ERE-s me vendimet Nr. 113, datë 26.04.2021 dhe Nr. 114, datë 26.04.2021, miratoi mbylljen e procedurës mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli si dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.

Lidhur me burimet e vogla të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale edhe gjatë vitit 2021 ERE ka vijuar të trajtojë problematikën e lindur për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane të shoqërisë Albtek Energy sh.p.k me fuqi të instaluar 2850 KW",

Nëpërmjet korrespondecave të mbajtura gjatë periudhës 2020-2021 me shoqërinë Albtek Energy sh.p.k dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE është shprehur se impianti për trajtimin e mbetjeve urbane dhe prodhimit të energjisë i shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k, nuk është objekt i rregullimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga ERE sipas përcaktimeve të nenit 10 të Ligjit Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme" dhe VKM Nr. 27, datë 17.01.2018 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale", sikurse kërkuar nga shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k.

Ky qëndrim është mbështetur në faktin se fuqia e instaluar prej 2850 kW e impiantit të shoqërisë "Albtek Energy"sh.p.k., referuar licencës së dhënë nga ERE, është mbi kufirin prej 2 MW, të përcaktuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme".

Në këtë kuadër, ERE ka adresuar ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nevojën për miratimin e metodologjisë, e cila do të vihet në zbatim për rastin specifik të impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, i cili vjen si një investim në kushtet e partneritetit publik-privat si dhe ndaj shoqërisë Albtek Energy shpk ka kërkuar vënien në dispozicion të kostove faktike të ndërtimit dhe operimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, të shoqërisë Albtek Energy sh.p.k, si të dhëna të cilat do të mund t'i shërbenin ERE-s për të vlerësuar dhe analizuar lidhur me përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga Albtek Energy sh.p.k.. pas miratimit të Metodologjisë sipërcituar.

Deri më tani, nuk janë paraqitur në ERE të dhëna faktike mbi kostot e ndërtimit dhe operimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, të shoqërisë Albtek Energy sh.p.k, si dhe ende nuk është miratuar një metodologji për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, e cila do të trajtonte rastin specifik të shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k.5.1.6.2 Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2020

Në zbatim të legjislacionit të lartpërmendur, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për përllogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhura nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3MW, për vitin 2020. Mbas shqyrtimit të

dokumentacionit të depozituar në MIE dhe në ERE të shoqërive të cilat ishin pajisur me miratimin përfundimtar për ndërtimin e impianteve eolike, në zbatim të Metodologjisë së miratuar me Vendimin Nr. 369, datë 26.04.2017, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 115, datë 26.04.2021 miratoi çmimin e mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW prej 75.64 Euro/MWh, për vitin 2020.

Në tabelën në vijim paraqiten çmimet e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era për vitin 2020 krahasuar me çmimet në fuqi të vendeve të tjera të rajonit:

Shteti	Parametrat	Çmimi Euro/MWh	Periudha e mbështetjes (Vite)
Shqipëri	< 3 MW	**75.64**	15
Kosovë	< 35 MW	**85.00**	12
Maqedoni	< 5 MW	**89.00**	15
Serbi	deri në 9000 orë pune	**92.00**	12
Mali i Zi	N/a	**96.10**	12

Figura 86 Çmime te blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era

Sikurse vërehet edhe nga tabela, për vitin 2020 çmimet e miratuara nga vendet e rajonit lidhur me teknologjitë eolike mbeten të qëndrueshme.

Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 222, datë 09.11.2021 vendosi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.

Procesi i miratimit të çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinoveshme nga dielli, era dhe nga pjesa biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale do të trajtohet përgjatë vitit 2022, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

5.1.7 Në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2021

Bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 7/2017 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi llogaritet nga ERE, në përputhje me *"Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi"*, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, e ndryshuar me VKM nr. 396, datë 13.5.2020 *"Për disa ndryshime në Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi"*.

Nisur nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilinbandë (baseload) për vitin 2020 rezultoi **39.00Euro/MWh**.

Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR për çdo ditë të vitit 2020, rezultoi që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2020 të jetë 123.77 Lekë/EUR.

Në vijim të grumbullimit të të dhënave të sipër cituara dhe në zbatim të përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 "Metodologjisë përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi" i ndryshuar, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2021, rezultoi 7.448 Lekë/kWh.

Përsa më sipër, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 16, datë 20.01.2021 miratoi çmimin vjetor prej **7.448 Lekë/kWh** që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me anë të Udhëzimit nr.5, datë 13.10.2020 ka miratuar "Procedurat për lëshimin, transferimin, modifikimin ose anulimin e certifikatës së pranimit të veprës" për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike nga impiantet që përdorin energjinë nga burime të rinovueshme". Në këtë udhëzim, parashikohet se Çertifikata e Pranimit të Veprës konsiderohet e lëshuar automatikisht për të gjitha impiantet e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të cilat janë në operim dhe kanë kryer testimin e veprës para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 7/2017 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*".

Në mënyrë që të vijohet me nisjen e diskutimit mbi trajtimin dhe më tej plotësimin e kudrit ligjor dhe nënligjor mbi përcaktimin e skemës së mbështetjes për prodhuesit me përparësi të cilët nuk janë pajisur me Çertifikatën e Pranimit të Veprës deri më 31.12.2020 mbështetur në parashikimet e Ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE ka adresuar ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për qartësimin dhe orientimin mbi mënyrën se si do të trajtohen në vazhdim këta prodhues të cilët nuk gëzojnë statusin e prodhuesve ekzistues.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve të miratura për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2008 - 2021.



Figura 87 Ecuria e çmimeve të miratuara nga ERE për Prodhuesit me Përparësi

Sikurse vërehet në grafikun e mësipërm, çmimi për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 ka patur një rënie prej rreth 5.5% ose 0.43 lekë/kWh, si rezultat i rënies së çmimit mesatar vjetor të tregut

të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) nga 50.36 Euro/MWh në 39 Euro/MWh.

5.1.8 Aktiviteti i prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike & HEC Ashta për vitin 2021

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC–et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2021, pati një rritje prej 61.8% krahasuar me prodhimin e vitit 2020. Gjithashtu edhe prodhimi i HEC Ashta për vitin 2021 ka patur një rritje prej 57.7%, krahasuar me prodhimin e vitit 2020.

Grafiku në vijim, paraqet ecurinë e energjisë së prodhuar në vite nga shitja e energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi dhe HEC Ashta.



Figura 88 Ecuria e prodhimit në vite nga Prodhuesit me Përparësi dhe HEC ASHTA

Grafiku në vijim, paraqet ecurinë e të ardhurave të realizuara nga shitja e energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi dhe HEC Ashta ndër vite.



Figura 89 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi

(Burimi OSHEE sh.a.)

Sikurse vërehet nga grafiku i mësipërm, niveli i të ardhurave të realizuara nga PPE dhe HEC Ashta për vitin 2021 ka patur një rritje krahasuar me vitin e mëparshëm. Rritja të ardhurave ka qënë respektivisht 52.93% për PPE dhe 63.91% për HEC Ashta.

5.1.9 Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2021

5.1.9.1 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a

FSHU sh.a., në zbatim të VKM nr. 244, datë 30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhefurnizimit me energji elektrike", e ndryshuar, ka për detyrim blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti (KESH sh.a.), si dhe blerjen e energjisë në tregun e parregulluar, nëpërmjet shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë (FTL) për sasinë e pasiguruar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë.

Gjendur në kushtet e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike, Këshilli Ministrave me vendimin nr.620, datë 22.10.2021 miratoi kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj dhe e rishikoi atë me anë të vendimit nr.758, datë 9.12.2021. Në këtë vendim parashikohet se Furnizuesi i Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Shoqëria e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Sasia e energjisë së blerë për qëllime të furnizimit univesal përbëhet nga:

- **72%** e sasisë është ofruar nga KESH sh.a.
- **28%** e sasisë është prokuruar në tregun e lirë (duke konsideruar dhe sasinë e tepricave të BRE pas mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes në zbatim të VKM 244/2016 e ndryshuar)

Në grafikun në vijim paraqesim sasinë e energjisë elektrike të blerë nga FSHU sh.a. sipas burimit, për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020:



Figura 90 Struktura e sasisë së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit univesal për vitin 2020-2021

(Burimi FSHU sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Sikurse evidentuar dhe më lart në këtë raport, viti 2021 krahasuar me vitin 2020 ka patur një rritje të prodhimit vëndas. Energjia e prodhuar dhe ofruar për qëllime të furnizimit universal nga KESH sh.a. për vitin 2021 ka rezultuar me një rritje prej 15%, ndërkohë që sasia e prokuruar nga tregu i lirë (përshirë dhe energjinë e prodhuar nga BRE në rastet e tepricave) ka rezultuar me një rënie prej 15% për të njëjtën periudhë.

Struktura e shpenzimeve të FSHU sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për qëllime të furnizimit universal, përbëhet nga:

- **16%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga KESH sh.a.
- **84%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga Tregu i lirë

Në grafikun në vijim paraqesim strukturën e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.



Figura 91 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2020-2021

(Burimi FSHU sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për vitin 2021 ka qënë i njëjtë me vitet e mëparshme në vlerën 1.5 lekë/kWh. Çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga Tregu i lirë për vitin 2021 ka rezultuar përafërsisht 164 Euro/MWh, ndërkohë që çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga Tregu i lirë për vitin 2020 ka qënë në rreth 71 Euro/MWh.

Sikurse evidentohet më lart gjatë vitit 2021, pavarësisht se sasia e prokuruar për mbulimin e kërkesës për furnizim të klientëve fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a. ka ardhur në rënie krahasuar me vitin 2020, kosto e blerjes së energjisë për këtë qëllim ka patur një rritje domethënëse prej rreth 132%, për arsye të rritjes së çmimit të blerjes së energjisë në tregun e lirë sikurse shpjeguar dhe më lart në këtë raport.

Ndërkohë, bazuar në raportimet e FSHU sh.a., viti 2021 ka rezultuar dhe me një ndryshim në të ardhurat e gjeneruara nga shitja e energjisë elektrike ndaj klientëve fundorë, respektivisht me një rritje prej 4% për klientët familjarë dhe me një rritje prej 18% për klientët jo familjarë. Në total të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. gjatë vitit 2021, kanë rezultuar me një rritje prej 10% krahasuar me të ardhurat e vitit 2020, sikurse reflektohet në tabelën nëvijim.

Përshkrimi	Sasia (kWh)		Diferenca në sasi	Diferenca në %
	2021	2020	2021-2020	2021-2020
Jo Familjarë	2,361,544,884	1,995,070,837	366,474,047	18%
Familjarë	3,081,617,068	2,956,700,850	124,916,218	4%
Total	5,443,161,952	4,951,773,707	491,388,245	10%
Përshkrimi	Të ardhurat (Lekë)		Diferenca në Lekë	Diferenca në %
	2021	2020	2021-2020	2021-2020
Jo Familjarë	30,247,533,596	25,936,767,031	4,310,766,565	17%
Familjarë	29,279,819,610	28,095,065,686	1,184,753,924	4%
Total	59,527,353,206	54,031,832,717	5,495,520,489	10%

Figura 92 Sasia e energjisë së shitur dhe të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike të FSHU sh.a. për periudhën 2020-2021

(Burimi FSHU sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme, pavarësisht rritjes së kostos së blerjes së energjisë për qëllim të furnizimit të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal është konstatuar një rritje e të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike si rrjedhojë e rritjes së konsumit nga klientët jo familjarë me rreth 17% dhe rritjes të konsumit nga klientët familjarë me 4%. Ndërkohë të ardhurat totale të realizuara për vitin 2021 kanë ardhur në një rritje prej 10% krahasuar me ato të realizuara për vitin 2020.

5.1.9.2 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021

Sasia e energjisë elektrike e blerë për qëllime të mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përbëhet nga:

- **81%** e sasisë është prokuruar nga HEC-et private
- **13%** e sasisë është prokuruar nga tregu i lirë
- **5%** e sasisë është prokuruar nga HEC Ashta
- **1%** e sasisë është prokuruar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme fotovoltaike

Në grafikun në vijim paraqesim sasinë e energjisë elektrike për qëllime të mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes, sipas burimit, për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.



Figura 93 Struktura e sasisë së blerë për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2020-2021

(Burimi OSSH sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Sikurse evidentuar dhe më lart në këtë raport, viti 2021 krahasuar me vitin 2020 ka patur një rritje të prodhimit vendas, ku energjia e blerë për mbulimin e humbjeve nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike ka rezultuar me një rritje prej 5%, ndërkohë që sasia e prokuruar nga tregu i lirë ka rezultuar me një rënie prej 5%.

Struktura e shpenzimeve të OSSH sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, për vitin 2021, paraqitet si vijon:

- **67%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga HEC-et private.
- **27%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga Tregu i lirë
- **4%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga HEC Ashta
- **2%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga BRE (Centrale fotovoltaike)

Në grafikun në vijim paraqesim strukturën e shpenzimve të blerjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.



Figura 94 Struktura e shpenzimve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2020 - 2021

(Burimi OSSH sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga Tregu i lirë për vitin 2021 ka rezultuar përafërsisht 152 Euro/MWh, ndërkohë që çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga Tregu i lirë për vitin 2020 ka qënë në rreth 55 Euro/MWh.

Sikurse evidentohet më lart viti 2021 krahasuar me vitin 2020, pavarësisht se sasia e prokuruar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes ka ardhur në rënie, kosto e blerjes së energjisë për këtë qëllim ka patur një rritje domethënëse prej rreth 179% për arsye të rritjes së çmimit të blerjes së energjisë në tregun e lirë sikurse shpjeguar dhe më lart në këtë raport.

Rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike evidentohet dhe në tregjet ndërkombëtare të energjisë, ku nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2021 ka rezultuar 113.86 Euro/MWh nga ai i vitit 2020 prej 39.00 Euro/MWh me një rritje prej 191%.

Kjo rritje vjen më domethënëse nëse do të krahasojmë 6-mujorin e dytë të vitit 2021, periudhë në të cilën janë kryer dhe importet e energjisë elektrike në vendin tonë, kur dhe çmimet në tregjet ndërkombëtare të energjisë kanë arritur nivelin e tyre më të lartë. Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për periudhën korrik – dhjetor

2021 ka rezultuar 166.35 Euro/MWh me një rritje prej 275% nga ai i periudhës korrik – dhjetor 2020 prej 44.4 Euro/MWh.

2021	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Çmimi Mesatar 6 mujori 2
Çmimi mesatar në profilin bandë HUPX Dam (EURO/MWh)	95.15	109.02	135.10	197.16	215.87	245.81	166.35

Figura 95 Çmimi mesatar i 6 mujorit të dytë të vitit 2021 të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM)

(Burimi HUPX)

5.2 Hartimi, Rishikimi dhe Miratimi i Metodologjive të llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror

5.2.1 Vijimi i proçesit të miratimit të Metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike

Në zbatim të nenit 11, pika 3, të Ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është autoriteti përgjegjës për miratimin e rregullores për detyrimin për energjinë e rinovueshme që do të paguhet nga ana e klientëve fundorë të energjisë elektrike në një bazë vjetore dhe metodologjinë për përcaktimin e këtij detyrimi, si dhe procedurën e kompensimit të diferencës për prodhuesit.

Bordi i ERE-s, me anë të vendimit, nr. 272, datë 28.12.2020, ka miratuar fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike". ERE në zbatim të parashikimeve të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", ka kërkuar opinionin e palëve të interesit, për të cilën vetëm Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është shprehur se është parimisht dakord.

Në kuadër të mbështetjes nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ekipi i konsulencës së BERZH ka paraqitur komente mbi draft-metodologjinë dhe në takimet virtuale të zhvilluara janë shprehur se po punojnë paralelisht për një draft të metodologjisë, i cili do të na vihej në dispozicion në përfundim të hartimit të tij.

Në vijim, ERE ka zhvilluar një sërë takimesh online me ekipin e konsulencës së BERZH për këtë draft-metodologji,e më tej ka adresuar komentet e tyre pranë MIE, duke kërkuar opinionin e kësaj të fundit mbi ndryshimet e ndodhura në draft metodologjinë për të cilën bordi i ERE-s ka filluar procedurën me vendimin sipërcituar.

5.2.2 Rishikimi i Metodologjive ekzistuese të përllogaritjes së tarifave të rrjeteve

ERE nisur nga nevoja për përditësimin dhe rishikimin e Metodologjive të përcaktimit të tarifave në kuadër të reformave dhe ndryshimeve të tregut të energjisë, nëpërmjet asistencës së Bankës Botërore dhe ne bashkëpunim me MIE, vijoi me konsultimin dhe analizën e ndryshimeve të mundshme të cilat duhet të implementohen në "Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike".

Konsultimi i nisur në bashkëpunim me Bankën Botërore u fokusua në analizën e problematikave të konstatuara në implementimin e metodologjisë ekzistuese të tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Ky proces u diskutua me MIE, OSSH, konsulentët e ngarkuar nga Banka Botërore por dhe me RIO (Reform Implementation Office) e Expertise France në kuadër të axhendës së miratuar lidhur me reformën në sektorin e energjisë elektrike me qëllim rishikimin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Pas përgatitjes së një drafti përfundimtar të Metodologjisë në fjalë, ku përfshihet edhe vlerësimi dhe opinioni përfundimtar i Bankës Boterore mbi draftin, do të vijohet me procesin e konsultimit publik dhe miratimit, ku do të vlerësohet impakti i metodave dhe parimeve të përllogaritjes së tarifave ndaj kostove të aktiviteteve të rregulluara të sektorit të energjisë elektrike dhe palëve të interesit në përputhje me "Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".

5.2.3 Mbi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për Operatorin e Sistemit të GNL-së

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 16 dhe pikës 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, ERE është autoriteti përgjegjës për miratimin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për Operatorin e Sistemit të GNL-së.

Në zbatim të sa më sipër, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 269, datë 28.12.2020, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e *"Metodologjisë së përcaktimit të tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së "*.

Metodologjia për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së është hartuar si dokument në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 *"Për sektorin e gazit natyror"*, i ndryshuar dhe do të zbatohet për subjektet e Sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE dhe që i përkasin sistemit kombëtar të gazit, kanë marrë miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, impiantet e GNL-së janë të lidhura me Sistemin e Transmetimit si dhe u nënshtrohen rregullave të përgjithshme për aksesin dhe sigurimin e shërbimit të rigazifikimit nga impiantet e GNL-së, sipas kontratave të nënshkruara., mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 102/2015 *"Për sektorin e gazit natyror"*, i ndryshuar.

Metodologjia e llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së, është përgatitur në këndvështrimin e unifikimit të saj me aktet e tjera rregullatore të miratuara si dhe praktikat e mëparshme të ndjekura nga ERE, ku janë reflektuar komentet e palëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Në vijim të procedurës së nisur me vendimin sipërcituar e në përmbushje të të gjithë hapave proceduriale të mbështetur në përcaktimet e "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE me Vendimin nr. 229, datë 15.11.2021, vendosi miratimin e "Metodologjisë së llogaritjes të tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së".

5.3 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE dhe çmimet e energjisë elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2021

5.3.1 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE

Në grafikun dhe tabelën në vijim paraqitet ecuria e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara ndër vite nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi.



Figura 96 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara nga ERE ndër vite

Tipi i Aktivitetit (leke/kWh)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Furnizuesi Publik me Shumicë	1.61	1.61	2.03	1.48	2.20	2.20	2.20	3.00	3.00					
Prodhimi	0.78	0.78	0.40	0.63	1.00	1.00	1.00	1.45	1.45	1.45				
Hec-et egzistuese deri në 15 MW	6.50	6.50	7.40	7.57	7.77	7.53	7.53	7.64	7.45	7.45	8.57	8.46	7.878	7.448
Hec-et e reja deri në 15 MW	9.37	9.37	6.00	6.89	9.30	9.73	7.95	7.64	7.45	7.45	8.57	8.46	7.878	7.448
Impiantet fotovoltaike 2MW										13.42	9.08	12.30		
Impiantet Eolike MW										10.20		9.30		9.30
Transmetimi	0.50	0.50	0.60	0.60	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75	0.75	0.75
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 35 kV								1.50	1.50	1.50	1.50	1.50	1.50	1.50
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 20 kV										3.90	3.90	3.90	3.90	3.90
Tarifa mesatare e Shpërndarjes	5.70	5.70	5.70	6.30	5.00	5.00	5.00	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79
Çmimi Mesatar për Klientet e Sherbimit Universal	8.45	8.45	9.53	9.53	9.53	9.53	9.53	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70

Figura 97 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike periudha 2008 - 2021.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a.



Figura 98 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2009 – 2021.

Nga analiza e strukturës së shitjes të shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2021, çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike i realizuar për klientët fundorë ka rezultuar 10.94 lekë/kWh. Tabela në vijim paraqet çmimet mesatare të realizuara të shitjes së energjisë elektrike për kategoritë e ndryshme të klientëve fundorë krahas çmimeve të miratuara nga ERE për vitin 2021.

Kategoria e Klienteve	Cmimi I Miratuar 2021		Cmimi mesatar i realizuar 2021	
	Aktive	Ne pik	Aktive	Ne pik
Kliente ne 20/10/6 kV	11.00	12.65	11.00	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli 10/6 kV	7.10	8.17	7.33	8.39
Kliente te Lidhur ne TM dhe me mates ne TU	12.40	14.30	12.40	14.20
Kliente ne 0.4kV	14.00	16.10	13.98	16.09
Furra buke dhe prodhim mielli ne 0.4 kV	7.60	8.74	7.60	8.74
Objekte kulti/Bashkesi fetare	9.50	10.93	9.50	10.92
Familjare	9.50		9.50	
Ambjente te perbashketa	9.50		9.50	
Cmimi mesatar	**10.70**		**10.94**	

Figura 99 Çmimi mesatar i realizuar i shitjes së energjisë elektrike për kategoritë e ndryshme të klientëve fundorë

Çmimi faktik prej 7.33 lekë/kWh për kategorinë "Furra buke e prodhim mielli" për nivelin e tensionit 20/10/6 kV ka rezultuar më i lartë se ai i miratuar nga ERE prej 7.10 lekë/kWh për shkak të aplikimit nga ana e FSHU sh.a. të tarifës 7.6 lekë/kWh, për ata klientë të kësaj kategorie të cilët janë të lidhur në tension te mesëm ndërsa matjen e kanë në tension të ulët.

5.3.2 Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2021

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët jofamiljarë për vitin 2021. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët jofamiljarë për vendet e rajonit për vitin 2021 ka rezultuar 11.61 lekë/kWh.



Figura 100 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jofamiljarë në vendet e rajonit për vitin 2021

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët familjarë për vitin 2021. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët familjarë për vendet e rajonit për vitin 2021 ka rezultuar 11.83 lekë/kWh.



Figura 101 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2021

6. RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

6.1 Korridori Jugor i Gazit (SGC) kriza e furnizimit me gaz në botë dhe pozicioni i strategjik i vendit tonë

Sipas publikimeve të kryera nga (i) World Gas Inteligence (WGI), (ii) International Gas Union (IGU), (iii) International Energy Agency (IEA), (iv) Enerdata, (v) Eurostat, (vi) Bankes Qendrore Evropiane, (vii) Grupit nderkombetar te importuesve te azit natyror (GIIGNL), Korridori Jugor i Gazit (SGC) është një nga zinxhirët më të ndërlikuar të gazit në botë, i cili sjellë Gaz nga rajoni Kaspikut nga një rajon me rezerva të konsiderueshme të cilat i kalojnë 120 triliard m^3 Gaz. Në të vërtetë rezervat janë disa here më të mëdha duke garantuar një siguri furnizimi për shumë vite dhe njëkohësisht duke diversifikuar furnizimin me gaz nga Rusia. Duke patur parasysh që nevojat e gazit për konsum të Europës janë rreth 545 miliard m^3 në vit dhe ku prodhimi i saj është afërsisht 204 miliard m^3/vit, kjo

nxjerrë domosdoshmërinë e eksportimit të pjesës tjetër të gazit nëpërmjet rrugëve të tjera. Një pjesë e sasisë së gazit të korridorit jugor ka filluar të vijë në drejtim të tregjeve Europiane kjo po ndodh aktualisht nëpërmjet projektit të madh TAP AG që u vendos në operim brenda vitit 2020. Gazi Natyror nga fusha e Shah Deniz tashmë po bënë një rrugë prej 3,500 km nga Deti Kaspik në Europë. Në kushtet e krizës energjitike që po ndodh sot në botë është padyshim emergjente përmirësimi i disa infrastrukturave ekzistuese dhe zhvillimi i një zinxhiri të tërë gazsjellësish të rinj, të cilët duhet ti përkasin rajonit dhe Europës .

- Eksportuesit kryesorë të gazit sot në botë janë:
    1. Rusia
    2. Shtetet e Bashkuara të Amerikës
    3. Katari

Konsumi i gazit në botë gjatë vitit 2021 pavarësisht krizës u rrit me 150 miliard m^3 nga ku 53 miliard m^3 kontribuojë Rusia. Sigurisht që jo e gjithë kjo sasi ishte prodhuar nga ajo, por kishte edhe kontrata me prodhues të tjerë.

Gazprom prodhoi 515 miliard m^3 gjatë vitit 2021 një sasi nga më të mëdhatë e 13-të viteve të fundit. Nga prodhimi kemi parasysh që vetë Rusia ka konsumuar më shumë se gjysma për nevojat e vendit të saj rreth 280 miliard m^3. Ajo eksporton në vëndet ish-Sovjetike rreth 70 miliard m^3. Rreth 215 miliard m^3/vit gjatë vitit 2021 ajo ka eksportuar por nga këto rreth 50 miliard m^3/vit nuk i ka nga prodhimi i saj, por nga kontratat me Turkmenistanin dhe Naftogaz. Eksportet e Rusisë u rritën rreth 20% kryesisht drejt Turqisë dhe Europës, ku një ndikim ka patur në këtë mes edhe kriza energjitike. Nga Rusia është mbuluar rreth 40% të nevojave të gazit në Europë.

	Demand					Production				
	2018	2019	2020	2021	2022	2018	2019	2020	2021	2022
Africa	157	162	160	164	169	244	248	240	247	249
Asia Pacific	824	850	854	910	954	627	654	648	675	691
of which China	*283*	*307*	*325*	*368*	*396*	*160*	*174*	*189*	*206*	*220*
Central and South America	153	152	137	143	141	167	167	152	158	157
Eurasia	666	658	633	668	665	932	941	884	968	976
of which Russia	*493*	*482*	*460*	*488*	*484*	*726*	*738*	*692*	*761*	*763*
Europe	536	537	522	545	534	246	227	211	204	202
Middle East	544	543	547	566	583	666	677	680	694	709
North America	1 061	1 097	1 070	1 066	1 078	1 062	1 166	1 145	1 148	1 177
of which United States	*854*	*888*	*869*	*862*	*870*	*868*	*968*	*953*	*958*	*985*
World	**3 940**	**3 998**	**3 923**	**4 063**	**4 125**	**3 944**	**4 080**	**3 960**	**4 094**	**4 161**

Figura 102 Të dhënat mbi konsumin dhe prodhimin e gazit natyror në botë sipas IEA

Pavarësisht prodhimit maksimal të saj Rusia nuk ka kapacitetin e duhur për eksport me Kinën. Gjatë vitit 2021 Gazprom ka eksportuar në Kinë 10 miliard m^3 nëpërmjet tubacionit ''Power of Siberia'' këtë sasi gazi e ka marë me kontratë nga Turkmenistani, po kjo sasi i ka munguar Europës. Ndërkohë, Gazprom ka marrëveshje me Naftogaz për një sasi gazi 40 miliard m^3/vit për vitet 2021-2024 sepse e ka domosdoshmëri të mbulojë të gjitha kontratat që ka lidhur më parë me kontraktorët afatmesëm dhe afatgjatë.

Turkmenistani i cili është prodhuesi i katërt në botë për gaz natyror, eksporton në Kinë 40 miliard m^3/vit, ndërkohë kërkon të eksportojë gaz në Indi dhe Pakistan nëpërmjet Afganistanit. Gazësjellësi Turkmenistan-Afganistan-Indi-Pakistan (TAPI) ka mbetur ende i papërfunduar për shumë kohë për efektet e gjeo-politikës, gjeo-ekonomisë.

- Gjatësia e këtij tubacioni është 1800 km dhe sasia që do të transportojë do të jetë 33 miliard m^3/vit. Ky tubacion një pjesë e madhe e tij është ndërtuar nga vetë Turkmenistani. Në këtë rajon një prodhues tjetër është edhe Uzbekistani i cili ka filluar integrimin e tij në rrjetet e tubacioneve të këtij korridori.
- Prodhuesi tjetër i madh i LNG (Gazit Natyral të Lëngëzuar) është Katari, i cili për vitin 2020 prodhoj 110 milion ton/vit dhe për vitin 2021 prodhoj 126 milion ton/vit
- Ndërsa Australia një tjetër prodhues i madh i LNG me rreth 81 milion ton/vit është një tjetër prodhues dhe ndikues në tregun botëror të gazit.
- Ndërsa importi nga SHBA me rreth 130 milion ton/vit (kryesisht gaz shistet argjilore) do të jetë një nga rrugët për zgjidhjen e krizës. Politikat e saj energjitike mbeten vendimtare, në kushtet kur kriza po rrit çmimet në mënyrë eksponenciale.
- Të tre këto vende: SHBA, Katar dhe Australi, po ndikojnë dhe janë një tjetër alternativë e besueshme, duke patur parasysh korridorin jugor, të cilat do të ndikojnë në zbutjen e krizës energjitike që ka kapur sot mbarë botën.

Në realitet, rrugët e tubacioneve TANAP, TAP dhe Trans-Kaspik, janë projekte me risk zero. Disa prej çështjeve të mundshme, lidhur me këto projekte, përfshijnë risqet që kanë të bëjnë më furnizimin, ndërtimin, statusin ligjor të Detit Kaspik dhe çështjet mjedisore, të cilat tashmë janë diskutuar nga ana e Moskës dhe Teheranit.

Në lidhje me Nord Stream 2. Është një tubacion i ri gazi me gjatësi 1,200 km që shkon nga Rusia perëndimore në Gjermaninë verilindore nën detin Baltik. Kapaciteti i transportimit të tij është 53 miliard m^3/vit.

Projekti prej 10 miliardë eurosh tashmë ka përfunduar për të dyfishuar sasinë e gazit natyror që rrjedh nga Rusia drejt në Gjermani. Pritet që Enti Rregullator i Energjisë i shtetit Gjerman ta çertifikojë atë, por situate aktuale pas luftës në Ukrainë ka ndryshuar qasjen ndaj këtij Projektit duke pezulluar certifikimin e këtij projekti.

Gazi aktualisht shkon në Gjermani përmes gazsjellësit Origjinal Nord Stream 1, i cili përfundoi në vitin 2012 me një kapacitet transportimi 53 miliard m^3/vit. Tubacion është i presionit të lartë mbasi gazi dërgohet nëpërmjet stacionit të kompresorave me 220 bar dhe arrin në Gjermani me presionin100 bar. Në total nëse do të vendoset Nord Stream 2 në punë atëherë në Gjermani do të shkoj rreth 106 miliard m^3/vit, sa gjysma e eksporteve që bën Rusia në Europë.



Figura 103 Tubacionet e gazit Nord stream 1 dhe Nord Stream 2 që lidhin Rusinë me Gjermaninë

Irani vendi i dytë në botë, që zotëron rezervat e gazit natyror (Jo prodhimi) pas Rusisë, po rishikon rrugët e ndryshme të eksportit për në Evropë nëpërmjet tubacionit të Turkish Stream. Teherani, gjithashtu, mund të shfrytëzojë tubacionin e Turkish Stream nëpërmjet njërës prej rrugëve të mundshme nga ku gazi i Iranit në të ardhmen mund të përçohet pranë konsumatorit Evropian. Për shkak të situatës në Turqi, ku infrastruktura mbi energjinë përfshirë këtu edhe tubacionin e gazit Iran-Turqi, ka pasur pasiguri, transportimi i gazit nga Irani për në tregun Evropian do të ishtë një zgjidhje afatmesme e kenaqshme per palet dhe situaten. Pasiguritë lidhur me Turkish Stream dhe Korridorin e Gazit Jugor, mund të vendosin mbi fatin e rrugëve, që do të ndjekin tubacionet në të ardhmen.



Figura 104 Projekti i Tubacionit Trans-Saharian.

(Burimi:Wikipedia.org.)

Nëpërmjet këtij projekti nëse do të investohet për ndërtimin e tij për një periudhë afat mesme, ky tubacion me gjatësi 3500 km me diametër 46-52 poliç gazi nga Nigeria nëpërmjet Algjerisë do të

arrijë në europë. Europa mund të marrë një sasi gazi prej nga 30 -50 bcm/vit duke ulur kështu varësinë nga gazi Rus.Për kushte emergjente që ndodhet furnizimi i europës, zgjidhja më e shpejtë do të jetë gazi i lëngët (LNG).

Megjithatë, mbetet për t'u parë nëse të dy projektet do të pësojnë fatin e South Stream Dzhubga (Federata Ruse)-Burgas (Bullgari) dhe Nabuccos Ankara (Turqi) – Sofie – Rumani - Hungari – Slloveni - Austri). Gjithësesi, një gjë është tashmë e qartë: gjithçka që ndodh sot me politikat mbi gazsjellësit në Euro - Azi varet nga kërkësa e BE-së për energji në të ardhmen dhe lëvizjet strategjike të Rusisë duke patur parasysh edhe qëndrimin e Europës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por, duke parë se kërkesa për konsum të gazit për Europën sot është rreth 545 miliard m^3/vit, dhe prodhimi i saj është 204 miliard m^3/vit, në vitin 2030-të kërkesat për konsum të Europës do të jetë të paktën 20% më të mëdha, ndërsa prodhimi i saj pritet të ulet. Kërkesa në botë për konsum për vitin 2021 ka qënë 4,063 miliard m^3 dhe prodhimi i gazit ka qënë 4094 miliard m^3. Në këto kushte, gjetja e rrugëve të reja të Europës duke përfshirë këtu edhe Mesdheun që së bashku formojnë **Europën Energjitike** do të jetë sfida e saj. Prandaj një punë e madhe po bëhet sot në botë për zhvillime intensive të energjive të rinovueshme (fotovoltaikët, energjia e erës, biogazi, biometani, hidrogjeni nëpërmjet procesit të elektrolizës etj.)

Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme, Azerbaixhani dhe Turkmenistani, nuk i përmbushin dot plotësisht kërkesat e BE-së, si dhe nuk ofrojnë alternativa të besueshme ndaj gazit Rus, në një afat të shkurtër kohor.



Figura 105 Tubacionet e gazit natyror: Kaukaziane, TANAP dhe TAP

Në planin afatgjatë, megjithëse rrugët e reja duke shmangur Rusinë janë duke u zhvilluar, kapacitetet e eksportit të këtyre dy vendeve bregdetare Kaspike, janë të pamjaftushme për t'u shndërruar në aktorë të fuqishëm loje, për garantimin e energjisë ndaj BE-së. Përveç kësaj, një gjë është e qartë: Korridori Jugor i Gazit mund të sjellë konkurrencë për të gjitha vendet e BE-së dhe të ulë rolin e Rusisë si potencial energjitik.

Figura 106 Rrjetet e tubacuineve TANAP – TAP - NABUKO

Në kushtet kur çmimet e gazit nga 80-100 $ për 1000 m^3 gaz në kushte normale arritën në 1000$ për 1000 m^3 gaz, përfundimi i tre projekte gazsjellësish në zhvillim të njëhershëm, (i) Gazsjellësi i Kaukazit të Jugut (SCPX) – Azerjxhan, Gjeorgji, (ii) Gazsjellësi Trans Anatolian (TANAP) – Turqi dhe (iii) Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) – Greqi, Shqipëri, Itali do të mundësonte zbutjen e efekteve të krizës.



Figura 107 Trendi i çmimeve te gazit natyral sipas IEA ne vite

Vendi jonë ka një pozicion strategjik dhe në këtë këndvështrim duhet të jemi të vëmëndshëm dhe duhet të punojmë që të tërheqin investimet e nevojshme në këto drejtime:

- ✓ Ndërtimin e Terminalit të LNG-së në Vlorë në prani të investimeve Exxon-Mobil dhe Exxelerate.
- ✓ Depozitimin e gazit në kripërat e Dumres, nëpërmjet pjesëmarrjes së këtyre kompanive të mësipërme së bashku me SNAM. Aktualisht ka mbaruar studimi i fizibilitetit dhe rezulton efektiv. Sipas këtij studimi rezulton se me 7 kaverna me një investim prej 500 milion Euro mund të depozitojmë dhe tërheqim 12 miliard m^3 gaz . Kjo do të ishte afersisht e njejtëme gjysmën e sasisë së depozituar në Ukranië në kushte normale, depozitimi i gazit për vitin 2021 në Rusi në periudhën e verës ka qënë 76 miliard m^3.
- ✓ Ndërtimin e tubacionit Fier-Vlorë, lidhja me tubacionin e TAP dhe terminalit të mundshëm që do të ndërtohet nga Exxelarete. Kjo do të shërbejë edhe për futjen e gazit metan në rrjetin e tubacioneve të TAP dhe IAP.
- ✓ Ndërtimi i tubacionit IAP (Ionian Adriatic Pipeline) nga pika e kontaktit me TAP në Fier deri në Kroaci. Faktikisht projekti i zbatimit ka përfunduar, pritet fillimi i ndërtimit të tij. Kjo do të bëjë që i gjithë rajoni jonë; Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Bosnja-Hercegovina që aktualisht nuk e kanë të zhvilluar tregun e gazit të integrohen në këtë rrjet.
- ✓ Ndërtimi i TEC-eve me gaz, duke u bërë një nyje energjitike për rajonin e më gjërë.
- ✓ Faktet tregojnë interesin që kanë vëndet rajonale për të investuar në vëndin tonë. Kjo verifikohet mjaft qartë në Market Testin (Testimin e Tregut) që është hapur nga TAP AG dhe se ky Market Test është quajtur si Market Testi për Shqipërinë, pasi kërkesat për sasi gazi dhe pika lidhje në territorin tonë me tubacionin e TAP janë shtuar. Kjo do të trajtohet më gjërë më poshtë.

Figura 108 Pika e daljes e tubacionit të gazit TAP në Fier

6.2 Aksionerët e Kompanisë

Gjatë vitit 2021 nuk kemi patur ndryshime aksionerësh, për këtë janë njoftuar të gjitha palët e interesuara përfshi edhe tre Autoritetet Kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Tashmë aksionerët e TAP AG janë: SOCAR (Azerbajxhan) me 20%, BP (Angli) me 20%, SNAM S.p.A (Itali) me 20%, Fluxys (Belgjikë) me 19%, Enagas (Spanja) me 16% dhe Axpo (Zvicerane) me 5%.

6.3 TAP një projekt strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore

TAP është pjesa Europiane dhe pjesa kryesore e Korridorit Jugor të Gazit, një projekt i rëndësishëm nga ana strategjike dhe ekonomike për BE dhe Komunitetin e Energjisë.

TAP është i domosdoshëm për të siguruar akses të besueshëm tek një burim i ri i gazit natyror nga Deti Kaspik dhe në një rrugë të re. TAP forcon diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit

dhe mundëson gazifikimin e Europës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, përfshirë gazifikimin e vendit tonë. TAP është prezent në mënyrë aktive në krijimin dhe funksionimin e tregut Shqiptar të gazit.

Ndër të tjera, TAP mbështet synimet e BE për t'u bërë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050 dhe nxit arritjen e synimeve të dekarbonizimit të BE dhe Komunitetit të Energjisë. Në mënyrë të veçantë TAP lejon përdorimin e mëtejshëm të gazit (natyror, të rinovueshëm, ose dekarbonizuar) duke zëvendësuar karburantet më të ndotura si qymyri, nafta/benzina dhe vajrave të rënda në transport, sektorët e ngrohjes dhe gjenerimit të energjisë, të përdorura më tepër në Europën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor.

Gazsjellësi TAP është projektuar për të dyfishuar kapacitetin e tij deri në 20 Miliard NM^3 në vit (deri në 20 bcm / në vit) dhe për t'i dhënë mundësi çdo pale të interesuar të paraqesë një kërkesë në lidhje me gazsjellësin TAP, për sa kohë përputhet me kushtet teknike dhe rregullatore nga Opinioni Përfundimtar i Përbashkët.

Gazsjellësi TAP është futur në periudhën e Market Testit për rritjen e kapacitetit në 20 miliard NM^3 /vit(bcm/vit) dhe tani është faza e konsultimit publik.

Në vijim të testimit të tregut të vitit 2021, gjatë fazës jodetyruese të shprehjes së interesit, TAP ka marrë një interes të konsiderueshëm për kërkesat për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri

TAP do të lehtësojë ndërlidhjen më të madhe midis vendeve në rajonin e Europës Juglindore dhe krijimin e një tregu rajonal të gazit plotësisht të integruar me tregun europian. Nëpërmjet këtij projekti, vendit tonë i jepet mundësia e krijimit të një nyje të domosdoshme për rajonin sepse jep mundësinë edhe të ruajtjes nëntokësore të gazit si dhe një terminal të gazit të lëngët LNG.

TAP – shpërndan në mënyrë të suksesshme gazin natyror për konsumatorët e tij që nga data e funksionimit komercial

TAP është pjesa Europiane dhe pjesa kryesore e Korridorit Jugor të Gazit, një projekt i rëndësishëm nga ana strategjike dhe ekonomike për BE dhe Komunitetin e Energjisë.

Në datën 15 Nëntor 2020, TAP ka filluar funksionimin komercial. Kjo ishte një arritje e rëndësishme historike pasi një burim i ri furnizimi me gaz dhe një linjë e qëndrueshme, e besueshme dhe me kosto efektive u vu në funksionim dhe filloi të kontribuonte materialisht në sigurinë e furnizimit të BE dhe Komunitetit të Energjisë, integrimin e tregut, konkurrencën dhe objektivat e dekarbonizimit. Për më tepër, nga data 15 nëntor 2020 e në vazhdim:

TAP u bë një Operator i Pavarur i Sistemit te Transmetimit (OST) me të drejta të plota.

Ka filluar funksionimin periudha e Përjashtimit 25-vjeçar nga aksesi i palëve të treta, rregullimi i tarifës dhe veçimi i pronësisë, që i është dhënë TAP nga Komisioni Europian dhe nga Autoriteti Rregullator Shqiptar – ERE së bashku me Autoritetet Rregullatore Greke dhe Italiane (respektivisht RAE dhe ARERA).

Filluan të hynë në fuqi Marrëveshjet e Transportit të Gazit me Transportuesit e TAP.

Që nga kjo datë dhe në vazhdim Transportuesit e TAP kanë qenë të detyruar të paguanin tarifën, sikurse është përcaktuar në përputhje me Kodin e Tarifës së TAP.

Filloi të funksionojë afati 30-vjeçar i licencës së transmetimit të TAP në Shqipëri.

Që nga fillimi i vendosjes në funksion më datë 15 nëntor 2020, falë bashkëpunimit të fortë ndërmjet Dispeçerimit Komercial dhe Fizik, nominimet e transportuesve për gazsjellësin TAP janë përpunuar menjëherë dhe dërgesat e gazit janë sjellë me sukses deri në pikat e interkonjeksionit me sistemin e transmetimit kombëtar në Itali dhe Greqi, deri tani (rrjetet SRG dhe DESFA).

Si rrjedhojë, TAP ka transportuar 8 miliardë metra kub gaz nga kufiri Greko-Turk në Kipoi, ku 6.8 miliardë metra kub gaz janë transportuar në Itali përmes Shqipërisë dhe 1.2 miliardë metra kub gaz duke dalë në Greqi:

Nga data komerciale e vendosjes në funksion (15/11/20) deri më 16/01/22	Total KWh	Total Nm^3	Total në miliardë metra kub
Pika e hyrjes e TAP (Kipoi)	95,463,459,713	8,132,942,013	8.13
Pika e daljes e TAP (Nea Mesimvria - Greqi)	13,953,718,774	1,216,437,633	1.22
Pika e daljes e TAP (Melendugno – Itali) duke kaluar përmes Shqipërisë	80,092,634,359	6,832,495,765	6.83

Figura 109 Volumet e Gazit që transportohen nëpërmjet TAP

Mund të vërehet se volumet që transportohen nëpërmjet TAP janë materiale dhe TAP po kontribuon në lehtësimin e presionit që ekziston në tregjet e energjisë aktualisht në nivel europian.

Për më tepër, vendosja në funksion e TAP bëri kryesisht të mundur shkallëzimin dhe ndonjëherë edhe anullimin e shpërndarjes historike prej rreth 10% që Italia përdorte për të rregulluar çmimin e shitjes me shumicë të gazit natyror në krahasim me vendet e tjera të Europës Qëndrore dhe Veriore.

TAP po udhëheq ankandet e kapaciteteve në përputhje me kalendarin e ankandeve ENTSO-G në platformën e rezervimit të kapaciteteve PRISMA. Midis datës së vendosjes në funksion të TAP dhe datës 16.01.2022, TAP prenotoi kapacitet të sigurt me drejtim përpara dhe kapacitet komercial me drejtim të kundërt në pikat e interkonjeksionit në Kipoi, Melendugno dhe Nea Mesimvria:

- 1877 ankande të ditës në avancë
- 63 ankande mujore;
- 47 ankande tremujore;
- 1 ankand vjetor (vetëm për kapacitetin komercial me drejtim të kundërt).

Për momentin, nga Shqipëria nuk del gaz, mbetet pezull rrjeti i transmetimit të gazit në Shqipëri dhe rezervimi i kapacitetit në Fier ose në Kuçovë i planifikuar për pikat e daljes. Mbetet detyrë emergjente infrastruktura për përdorimin e gazit natyral në kushtet kur kriza energjitike po thellohet tek ne, në rajon dhe Europë.

- **TAP ka 2 (dy) pika dalëse në Shqipëri, në Fier dhe në Kuçovë**.

Pika e daljes e Kuçovës përbëhet nga një linjë 24" në zonën e Kuçovës. Kjo pikë dalje është ndërtuar dhe është gati për tu lidhur me rrjetin e transmetimit të gazit natyror në Shqipëri. Në të njëjtën kohë pika e daljes në Fier përbëhet nga linja e deges 16" që është e instaluar brenda Stacionit të Kompresimit të TAP ACS03 në zonën e Fierit. Kjo pikë dalje është ndërtuar. Stacioni i lidhur i matjes dhe zvogëlimit të presionit (***Objekti i Seksionit Jugor në Fier)*** është aktualisht në fazën e tenderimit të kontraktorit për ndërtimin.

Në datën 6 Korrik 2021, TAP AG, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri dhe Albgaz sh.a nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Dorëzimi për Objektin e Seksionit Jugor në Fier. Sipas marrëveshjes, kur Objekti në Sesionin Jugor në Fier të përfundojë, ai do ti dorëzohet Shtetit Shqiptar dhe do të zotërohet, menaxhohet, dhe do të vendoset në funksion nga Qeveria Shqiptare (Albgaz).

Pika e daljes në Kuçovë është ndërtuar sipas detyrimit të TAP nga Opinioni Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi përjashtimin e TAP nga kërkesat e aksesit të palës së tretë, rregullimit të tarifës dhe veçimit të pronësisë përcaktuar në Nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës së Gazit 2009/73/EC (***FJO***) ndërkohë që detyrimi për të ndërtuar pikën e daljes në Fier përmendet tek Marrëveshja e Zhvillimit të Tregut të Gazit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 233, datë 21.03.2017.

Deri më tani, asnjë palë nuk ka rezervuar kapacitet në pikat shqiptare të daljes dhe si pasojë nuk është nënshkruar asnjë Marrëveshje për Transportin e Gazit. Prandaj, volumet e gazit natyror transportohen nga pika e hyrjes në Kipoi në kufirin Grek-Turk në Nea Mesimvria (në Greqi) dhe Italinë Jug-Lindore në Melendugno, pa asnje volum ekzistues në Shqipëri.

Volumi i gazit natyror që futet në Shqipëri matet për arsye fiskale në Stacionin e Matjes në Bilisht (ACS02). Aktualisht, gazi që ekziston në Shqipëri dhe futet në Itali matet në stacionin fiskal të matjes në Melendugno që zotërohet dhe operohet nga OST fqinje të TAP (Snam Rete Gas). Përveç kësaj, flukset aktuale fizike të gazit maten për qëllime operacionale (që do të thotë, balancimin fizik të sistemit) në Stacionin e Kompresimit në Fier (ACS03) dhe stacionin e matjes të TAP në Melendugno.

6.3.1 TAP është një OST plotësisht e ndërlidhur dhe transparente për tregun

TAP është një OST plotësisht e ndërlidhur me palët e tjera fqinje (TANAP, SRG, DESFA, IGB) dhe ofron suport të menjëhershëm për klientët e tij nëpërmjet telefonit dhe e-mailit në 24/7. Deri më 31 dhjetor 2021, TAP ka 16 klientë të regjistruar, sipas procesit të regjistrimit të Kodit të Rrjetit të TAP.

Në 28 Dhjetor 2018, TAP dhe AGSCo kanë lidhur një Marrëveshje Mirëmbajtjeje. Ekipi i operimit dhe mirëmbajtjes së TAP dhe AGSCo përbëhet nga pothuajse 50 persona, pa përfshirë personelin e nënkontraktorit. Nënkontraktorët janë përzgjedhur në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për prokurimin publik. Sfida kryesore e këtij bashkëpunimi ka qenë procesi i prokurimit publik që duhet të ndjekë AGSco, duke sjellë në këtë mënyrë kufizime dhe duke limituar llojin e aktiviteteve të posaçme (ad hoc) të mirëmbajtjes që AGSCo mund të ekzekutojë. TAP dhe AGSCo duhet të punojnë së bashku me autoritetet shqiptare për të përmirësuar dhe ndryshuar procesin e prokurimit publik.

Nga data 15 nëntor 2020, TAP ka publikuar informacion ditor/orar mbi kapacitetet teknike, të disponueshme dhe të rezervuara, si dhe çdo informacion tjetër operacional sikurse kërkohet nga rregullorja e BE-së dhe Ligji Shqiptar për Sektorin e Gazit Natyror nr. 102/2015. TAP bën pjesë në 3 nga OST-të kryesore të BE që publikojnë të dhënat në mënyrë korrekte, të plotë dhe në kohë.

TAP gjithashtu po publikon në faqen zyrtare të internetit dhe në Platformën e Transparencës ENTSO-G mesazhe urgjente të tregut, në mënyrë që të informojë tregun mbi çdo zhvillim të mundshëm që mund të ndikojë në aktivitetin e TAP.

TAP finalizoi dhe ngarkoi faqen zyrtare të internetit ku paraqitet i gjithë informacioni mbi aktivitetin operacional të TAP, duke përfshirë një platformë elektronike të të dhënave, ku tregu i gjerë dhe klientët e TAP kanë akses në të dhënat operacionale për çdo pikë ndërlidhjeje (d.m.th., rrjedhat fizike, kapacitetet e disponueshme, të rezervuara dhe teknike, të dhënat e matura). TAP ka zhvilluar dhe përditësuar një projektvendim të Këshillit të Ministrave mbi *"Përcaktimin e proçedurave të thjeshtuara të tranzitit, procedurave doganore për lëshimin në qarkullim të lirë dhe eksportit, procedurave tatimore për furnizimin brenda vendit me gazin natyror të transportuar nëpërmjet instalimit të transportit fiks dhe përcaktimin e humbjeve të gazit natyror të njohura për qëllime fiskale"*. Kjo VKM përfshin disa aspekte të lëvizjeve të gazit përmes gazsjellësit TAP dhe procedurat doganore e tatimore që do të ndiqen. Megjithatë, bazuar në përvojën tonë, ky projektvendim i Këshillit të Ministrave synon gjithashtu t'i shtojë vlerë kuadrit ligjor të përgjithshëm të zhvillimit të tregut të gazit në vend, duke adresuar edhe procedurat që lidhen me zhvillimet e ardhshme të pritura në Shqipëri.

6.3.2 TAP ka një rol strategjik dhe thelbësor për dekarbonizimin, sigurinë e furnizimit dhe ndërlidhjen në Shqipëri dhe Europën Juglindore

TAP luan një rol thelbësor në sigurimin e aksesit të besueshëm për një burim të ri të gazit natyror nga Deti Kaspik dhe për një linjë të re. TAP kontribuon në këtë mënyrë në diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit dhe mund të mundësojë gazifikimin dhe dekarbonizimin e Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Përveç kësaj, TAP lehtëson ndërlidhjen më të madhe midis vendeve në rajonin e Europës Juglindore dhe nxit krijimin e një tregu rajonal të gazit të integruar plotësisht me tregun Europian.

Ndër të tjera, TAP mbështet synimet e BE për tu bërë neutral ndaj klimës deri ne vitin 2050 dhe nxit arritjen e synimeve të dekarbonizimit të BE dhe Komunitetit të Energjisë. Në mënyrë të veçantë TAP lejon përdorimin e mëtejshëm të gazit (natyror, të rinovueshëm, ose dekarbonizuar) duke zëvendësuar karburantet më të ndotura si qymyri, nafta/benzina dhe vajërave të rënda në transport, sektorët e ngrohjes dhe gjenerimit të energjisë, të përdorura më tepër në Europën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor.

Kapaciteti fillestar i TAP prej 10 miliardë metra kub është pothuajse tërësisht i rezervuar për 25 vitet e ardhshme, përveç kapacitetit afatshkurtër që TAP tregton në platformën e rezervimit të kapaciteteve PRISMA, në përputhje me kuadrin rregullator specifik të TAP. Megjithatë, ajo që është ndërtuar mund të zgjerohet deri në 20 miliardë metër kub për ti shërbyer dekarbonizimit dhe diversifikimit të mëtejshëm si dhe sigurisë e furnizimeve me energji për Europën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor (veçanërisht Shqipërinë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut).

Në lidhje me këtë, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) po mbështet TAP-in si një zgjidhje për të siguruar akses në energjinë e Ballkanit Perëndimor.

<u>Në Testimin e Tregut të TAP për 2021 ka patur interes të shtuar për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri</u>

Tashmë ka filluar **Market Testi (Testimi i Tregut) për zgjerimin e kapacitetit**. Ai është harmonizuar me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, ('Opinioni Përfundimtar i Përbashkët') i Kodit të Tarifave të TAP [1] me Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit tek sistemet e transportit të gazit ("CAM NC").

Sipas Paragrafit 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzimet miratohen nga Autoritetet kompetente Rregullatore të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë. ('Autoritetet'), përkatësisht ARERA, RAE dhe ERE.

Mekanizmi për të zgjeruar dhe për t'i dhënë mundësinë çdo pale të interesuar për të paraqitur një kërkesë për lidhje me gazsjellësin TAP duke përfshirë edhe territorin e Shqipërisë është Testim Tregu. TAP ka organizuar Testimin e parë të Tregut në Korrik 2019 dhe ka filluar një tjetër Testim Tregu në korrik 2021.

Zgjerimi i TAP mund të realizohet duke shtuar njësi kompresimi në stacionet tashmë ekzistuese të kompresimit dhe duke ndërtuar stacione të reja kompresimi, sipas testimit të suksesshëm të tregut, të cilin TAP duhet ta organizojë të paktën çdo dy vjet, në përputhje me strukturën e tij rregullatore.

[1] Miratuar ne Nentor 2013 nga Autoritetet Rregullatore Italiane, Greke dhe Shqiptare. Po ashtu eshte miratuar nje ndryshim ne muajin Korrik 2018

Në vijim të testimit të tregut të vitit 2021, gjatë fazës jodetyruese të shprehjes së interesit, TAP ka marrë një interes të konsiderueshëm për kërkesat për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri. Më konkretisht, kërkesa totale për gaz në vit është si vijon:

Figura 110 Pikat e lidhjes se TAP sipas Market Testit të vitit 2021 në vëndin tonë

- **Në Pikën e Interkonjeksionit në Kuçovë**, TAP ka marrë kërkesa jo detyruese prej 7,500,000 KWh/d nga viti i gazit 2023/24 deri në vitin e gazit 2030/31.
- **Në Pikën e Interkonjeksionit në Fier,** TAP ka marrë kërkesa jo detyruese prej 7,500,000 KWh/d nga viti i gazit 2023/24 deri në vitin e gazit 2030/31.
- **Në pikën e daljes Relievi Roskovec**, (nuk është i përshtatshëm për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit) TAP ka marrë kërkesa jo detyruese prej 5,500,000 KWh/d nga viti gazit 2024/25 deri në vitin e gazit 2030/31.

Përveç kërkesave jodetyruese të kapacitetit, TAP ka marrë kërkesat e mëposhtme jodetyruese për lidhje:

- **Një pikë dalëse në Relievin Roskovec**, Shqipëri me një kapacitet teknik 7,500,000 KWh/d.
- **Një pikë dalëse në Kuçovë,** Shqipëri me një kapacitet teknik 7,500,000 KWh/d.
- **Dy (2) kërkesa për lidhje jo të detyrueshme që kanë të bëjnë me Fierin**, duke e bërë potencialisht pikën e ndërlidhjes me dy drejtime.

Zhvillimet në këto pika daljeje do të varen nga koordinimi midis TAP dhe palës kërkuese. Ky informacion është vënë në dispozicion të publikut në Raportin e Vlerësimit të Kërkesës të publikuar nga TAP më 25 tetor 2021.

Testimi i Tregut aktualisht është në fazën e konsultimit publik të propozimit të projekt-vendimit, një dokument i cili përmban rregullat tregtare dhe rregullatore për Testimin e Tregut të vitit 2021 të kryer nga TAP, në koordinim me SRG (OST italiane) dhe DESFA (OST greke). Konsultimi Publik është hapur më 18 janar dhe zgjat deri më 18 mars 2022.

6.4 Zbatim i programeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit të TAP

Plani Vjetor i Mirëmbajtjes duhet të publikohet për vitin e ardhshëm të gazit përpara datës 15 nëntor të çdo viti, në përputhje me Rregulloren e BE 715/2009, Shtojcën e Transparencës dhe dokumentet jodetyruese të lëshuara nga Rrjeti Europian i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (ENTSO-G). Për këtë arsye më 15 nëntor 2021 TAP ka publikuar planin vjetor të mirëmbajtjes së gazit për vitin 2021-2022.

TAP ka hartuar dhe miratuar një Plan të veçantë Mirëmbajtjeje për Shqipërinë dhe në bazë të tij ka kryer disa aktivitete mirëmbajtjeje brenda periudhës raportuese. Plani "Aktivitetet e Mirëmbajtjes Shqipëri 2021" është i detajuar mbi të gjitha këto aktivitete të kryera dhe të përfunduara gjatë periudhës raportuese.

6.5 Inspektimet, mbikqyrjet dhe kontrollet e kryera nga organet kompetente

Gjatë vitit raportues TAP është inspektuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial bazuar në shkresën nr. 3177 prot., datë 08.06.2021. Ky inspektim është kryer duke zbatuar dispozitat e ligjit nr.10433/2011, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.32/2016, datë 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", Ligji nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe është realizuar në Stacionin e Matjes së Gazit të TAP ACS02 në Bilisht, Devoll, më 14.06.2021 dhe në Stacionin e Kompresorit ACS03 në Seman, Fier, më datë 17.06.2021. Inspektimi konstatoi se TAP ishte në përputhje me qëllimin e inspektimit si dhe me kërkesat e legjislacionit të lartpërmendur.

6.6 Plotësimi i detyrimit për të informuar konsumatorët dhe masat e ndërmarra për të përmirësuar cilësinë e shërbimit

Në përputhje me Rregulloren e REMIT (Regulation on Wholesale Energy Market Integrity and Transparency) dhe Rregulloren që zbaton REMIT, në vitin 2021 TAP ka publikuar në faqen zyrtare si dhe në Platformën e Transparencës ENTSO-G (Shoqatën e Sistemit të Transmetimit Europian të Gazit), gjashtë mesazhe urgjente të tregut (UMM) që informojnë tregun mbi disponueshmërinë e kapaciteteve në gazsjellësin TAP, sasinë e kapaciteteve të ofruara në ankande, aktivitetet e mirëmbajtjes së Platformës Elektronike të të Dhënave të TAP (EDP), ftesë për një shprehje interesi për furnizim me gaz për qëllime operacionale dhe hapja e një ftese për tender për blerjen e gazit të kërkuar për aktivitetet operacionale, duke përfshirë furnizimin me karburant të stacioneve të kompresorit, mosdisponueshmërinë e sistemit të transportit të OST fqinje për një periudhë kohore, duke rezultuar që asnjë kapacitet nuk ishte i disponueshëm për t'u ofruar nga TAP si Kapacitet vjetor në Drejtimin Përpara të Pandërprerë në ankandet vjetore dhe aktivizimin e proçesit të shpërndarjes së kapaciteteve rezervë, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Rrjetit TAP, Neni 6.

Për më tepër TAP e ka plotësuar profilin e saj, tek Platforma e Transparencës së ENTSO-G, sipas detyrimeve të transparencës së Rregullores 715/2009 mbi kërkesat e Transparencës. TAP ka përditësuar informacionin operacional tek ENTSO-G TP, si atë për kapacitetet në dispozicion, të rezervuara dhe teknike, për ndërprerjet e planifikuara të kapacitetit të sigurt dhe të planifikuara të kapacitetit të ndërprerë, si dhe informacionin mbi tarifat. Po ashtu TAP ka publikuar planifikimin vjetor të mirëmbajtjes sipas afateve të vendosura nga Rregullorja 715/2009 e datës 15 nëntor. TAP vazhdon të dërgojë të dhëna të grumbulluara operacionale për ENTSO-G për arsye transparence, çdo ditë ose orë.

TAP siguron komunikim të vazhdueshëm dhe të besueshëm me palët dhe transportuesit e saj të regjistruar, në kohë, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të TAP, nëpërmjet sistemeve të dedikuara të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe aksesit në Platformën Elektronike të të Dhënave (EDP). Sipas paragrafit 3.1.e të Kodit të Rrjetit të TAP, nga të gjitha palët e regjistruara kërkohet që kur regjistrohen në TAP të kryejnë një provë komunikimi, si kusht kryesor për regjistrimin e tyre të suksesshëm në TAP dhe rezervimin e ardhshëm të kapaciteteve në sistemin e transmetimit të gazit natyror të TAP. Për më tepër, TAP publikon informacione përkatëse në lidhje me nominimet, rinominimet, ndërprerjet, shpërndarjet, flukset aktuale fizike, ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara në Platformën e Transparencës ENTSO-G, një platformë falas e aksesueshme gjerësisht dhe virtualisht.

Gjithashtu, transportuesit e TAP kanë akses në platformën elektronike të të dhënave të TAP, si ato publike dhe private. Ndërkohë që platforma publike jep informacion të përgjithshëm dhe të përmbledhur mbi emërimet, riemërimet, flukset fizike për çdo pikë interkonjeksioni, aksesi në platformën elektronike të të dhënave private mundësohet në bazë të regjistrimit të suksesshëm në TAP. Prandaj, çdo transportuesi i jepet një emër përdoruesi dhe fjalëkalim, sipas të cilit ai mund të aksesojë informacionin e ndjeshëm tregtar në lidhje me aktivitetin e tij të transportit me TAP. Informacioni në platformën elektronike të të dhënave private ndahet për çdo transportues.

Duke qenë se Pikat e Interkonjeksionit në Kuçovë dhe Fier në Shqipëri nuk janë bërë funksionale në vitin 2021 dhe nuk ka dalë gaz në territorin shqiptar, asnjë informacion i tillë transparence nuk është publikuar as në Platformën e Transparencës ENTSO-G TP dhe as në platformën elektronike të të dhënave të TAP. Megjithatë, sapo këto pika të hyjnë në funksion, do të publikohen informacionet përkatëse operacionale. Për momentin, TAP publikon në Platformën e Transparencës ENTSOG TP dhe në platformën elektronike të të dhënave të TAP konsumin e gazit të karburantit në Stacionin e Kompresorit Fier ASC03, në baza ditore.

6.7 Zgjerimi dhe kontributi i TAP në mënyrë aktive në kalimin/tranzicionin e energjisë

Zgjerimi i kapacitetit të TAP (TAPX) është e vetmja mënyrë që TAP të kontribuojë në lehtësimin e ofrimit të energjisë dhe ambicieve klimatike të Komunitetit Europian dhe të Energjisë. Vëllimet e reja të gazit, duke përfshirë një përzierje hidrogjeni dhe gazra të tjerë të rinovueshëm dhe/ose me karbon të ulët, mund të transportohen vetëm nëse/pasi të realizohet zgjerimi i kapacitetit të TAP. Mënyra për ta realizuar këtë në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Europiane qëndron si në ripërtëritjen e infrastrukturës së TAP për të akomoduar përzierjen e hidrogjenit dhe të mundësojë që vëllimet të mëtejshme të gazit që të rrjedhin përgjatë infrastrukturës për të dekarbonizuar ekonomitë e vendeve pritëse dhe fqinje.

Prandaj, faza e zgjerimit të TAP mund të jetë një mundësi unike për ta bërë këtë angazhim edhe më konkret dhe për të ndihmuar në përshpejtimin e rimëkëmbjes dhe rritjes ekonomike në Europë, duke i dhënë shtysë tjetër për ta kthyer tranzicionin/kalimin e energjisë në një realitet të prekshëm.

Përveç kësaj, TAP po ndërmerr hapa aktive drejt arritjes së objektivit të dekarbonizimit dhe krijoi një grup pune për tranzicionin/kalimin e energjisë, ngarkoi një studim për hidrogjenin për të vlerësuar implikimet teknike dhe financiare për pranimin e një% të caktuar të përzierjes në tubacionin TAP dhe vendosi një strukture për reduktimin e gjurmës së karbonit të kompanisë, të gjitha në përputhje me zhvillimet rregullatore.

Për më tepër, TAP përforcon kontributin e tij në objektivat e dekarbonizimit të BE dhe të Komunitetit të Energjisë nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme të rëndësishme me interes të përbashkët Europian (IPCEI) për nismat e hidrogjenit. Kështu, TAP propozon pjesëmarrjen me synimin për të siguruar transportin ndërkufitar nga Greqia në Shqipëri dhe Itali të hidrogjenit të rinovueshëm dhe me karbon të ulët të prodhuar në Greqi nga energjia elektrike e rinovueshme dhe mbetjet biologjike.

Kjo mbetet sfidë edhe për kontributin e vendit tonë, pasi vështirësitë nuk janë të mëdha për arritjen e këtyre objektivave.

6.8 TAP dhe synimi i mundësimit për vendosjen e kapacitetit të kabllove me fibra optike në Europën Juglindore dhe më gjerë

TAP po shqyrton mundësinë për të ofruar në treg kabllon rezervë me fibër optike, i cili sipas raportimeve të përcjella nga TAP nuk cënon aktivetin e e transmetimit të gazit natyror nga ana e TAP.

6.9 Ndryshimet në Licencën e Transmetimit

Ndryshimi i parë i miratuar nga ERE me Vendimin e Bordit nr. 120, datë 11.05.2021, përcaktoi detyrimin e TAP për të paraqitur certifikata sigurimi vjetore në vlerën e 10 000 000 dollarëve (USD).

Ndryshimi i dytë i bërë nga ERE ka të bëjë me kohëzgjatjen e Licencës së Transmetimit të TAP të dhënë fillimisht nga ERE për një periudhë 25-vjeçare, kjo kohëzgjatje u shty deri në 30 vjet me vendimin nr. 154 të Bordit të ERE, datë 30.06.2021.

ERE vlerëson se ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë një bashkëpunim të suksesshëm me TAP-in për çështjet rregullatore dhe do të sigurojë përputhjen e vazhdueshme me kushtet e vendosura në kuadrin rregullator të TAP.

TAP po vazhdon gjithashtu të përmbushë çdo detyrim tjetër që vjen si pasojë e vendimeve të miratuara nga ERE si dhe nga ligjet e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

6.10 Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2021 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror

Vendimmarrjet e mëposhtme lidhen me miratimin e kuadrit ligjor të ERE-s në funksion të zbatimit të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe përgatitja e kushteve të tregut me fillimin e operimit të gazit në vitin 2020, i cili përkon me startimin e projektit TAP.

Gjatë vitit 2021, për sektorin e gazit natyror, nga ana e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) janë miratur Vendimet si më poshtë:

1. **Me Vendimin nr. 6, datë 15.01.2021,** Bordi i ERE-s miratoi kërkesën e shoqërisë Albgaz sh.a., për ndryshimin e afateve të parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.100/2019 si më poshtë:

   "Jo më vonë se 21.06.2021, OSSh-G, OST-G dhe çdo i Licencuar tjetër përkatës do të ndërtojnë mjetet e përshtatshme duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni), të aftë për të regjistruar dhe për të mundësuar aksesin në të dhënat aktuale dhe ato historike të Treguesve mbi Standardet dhe Performancën".

2. **Me Vendimin nr. 59, datë 25.02.2021**, Bordi i ERE-s miratoi licencën tip për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror. Kjo vendimmarrje e ERE-s, mbështetet në përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe ka për qëllim të përcaktojë kushtet, të cilat duhet t'i përmbushë i licencuari në veprimtarinë e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

3. **Me Vendimin nr. 60, datë 25.02.2021**, Bordi i ERE-s miratoi standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit. Këto standarde përcaktojnë kushtet e përgjithshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të Licencuarit, si dhe kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve, në mënyre që të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit dhe të rritet besimi dhe kënaqësia e klientëve për këtë shërbim të ofruar nga të Licencuarit.

4. **Me Vendimin nr. 72, datë 12.03.2021**, Bordi i ERE-s miratoi rregullat operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror. Këto rregulla kanë për qëllim të përcaktojnë dhe të sigurojnë shërbimin publik të furnizimit me gaz natyror nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, në mbështetje të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

5. **Me Vendimin nr. 73, datë 12.03.2021**, Bordi i ERE-s miratoi rregulloren mbi proçedurat për dhënien e të drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror, e cila ka për qëllim të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jo-diskriminuese dhe të arsyetuar në përputhje me rregullat e Paketës së Tretë të Energjisë, si dhe synon të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, ndërkohë që siguron funksionimin si duhet të tregut të gazit natyror.

6. **Me Vendimet nr. 79, datë 23.03.2021 dhe nr. 195, datë 22.09.2021**, Bordi i ERE-s ka vendosur të pranojë kërkesat e shoqërisë "Albgaz" sh.a. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes për licencimin

e kësaj shoqërie në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror. Shoqëria "Albgaz" sh.a, në kërkesat e paraqitura, ka bërë me dije ERE-n se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë Covid-19, dhe si e tillë shoqëria, nuk ka disponuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE. Gjithashtu, ERE është informuar nga shoqëria "Albgaz" sh.a se është në proçes kryerja e një studimi për hapësirat e depozitimit të gazit natyror dhe përfundimi i këtij studimi do të mundësojë edhe plotësimin e dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror depozitimit të gazit natyror. Në vijim të sa më sipër, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjen e vendimmarrjes përgjatë vitit 2022, lidhur me licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

7. **Me Vendimin nr. 90, datë 06.04.2021**, Bordi i ERE-s ka miratuar licencimin me kusht të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë) për një afat 10-vjecar.

8. **Me Vendimin nr.120, datë 11.05.2021**, Bordi i ERE-s ka miratuar një ndryshim në Vendimin nr. 15, datë 31.01.2019 të bordit të ERE-s, "Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG". Bordi i ERE-s ka miratuar që në vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, pas pikës 2, të shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

   a. *Shoqëria TAP AG ALBANIA të përcjellë periodikisht në ERE certifikatën (policën) e sigurimit, pas rinovimit të saj, sipas kërkesave të nenit 9, pika 1, gërma "e", iv, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.*

9. **Me Vendimin nr.121, datë 11.05.2021**, Bordi i ERE-s miratoi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019. Kjo vendimmarrje erdhi pas kërkesës së paraqitur nga shoqëria Trans Adriatic Pipeline AG Albania për ndryshimin e kohëzgjatjes së licencës për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, nga 25 vjet në 30 vjet, duke e bazuar këtë kërkesë në nenin 23, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, nenin 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror". Në kërkesën e paraqitur, shoqëria TAP AG ALBANIA është shprehur se zgjatja e afatit të licencës së transmetimit nga 25 vjet deri në 30 vjet, do të siguronte harmonizimin e Licencës së transmetimit me lejen e veçantë të dhënë TAP-it me VKM nr. 123, datë 13.03.2019, duke theksuar se sipas nenit 5.2, të ligjit nr. 116/2013 *"Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)"*, i ndryshuar, leja e vecantë rinovohet automatikisht nga Autoritetet Shqiptare, në përfundim të periudhës 30 vjecare, konkretisht më 21.03.2049.

10. **Me Vendimin nr. 122, date 11.05.2022**, Bordi i ERE-s miratoi propozimin e projektit te TAP, SRG dhe DESFA për proçesin e rritjes të kapacitetit për vitin 2019", sic shprehet në vendimin e përbashkët me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

11. **Me Vendimin nr. 151, datë 29.06.2021**, Bordi i ERE-s miratoi udhëzuesin për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik Pipeline, ashtu si edhe shprehet në vendimin e përbashkët me Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

12. **Me Vendimin nr. 152, datë 30.06.2021**, Bordi i ERE-s miratoi disa ndryshime në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, "Mbi çertifikimin e shoqërisë "Operatori i kombinuar i gazit natyror" Albgaz sh.a.", i ndryshuar. Bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë pikën 5.1 dhe pikën 5.2 të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, "Mbi çertifikimin e shoqërisë "Operatori i kombinuar i gazit natyror" Albgaz sh.a.", i ndryshuar, duke i lënë detyrë shoqërisë "Albgaz" sh.a të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë dhe të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.01.2022 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

13. **Me Vendimet nr. 153, datë 30.06.2021; nr. 201, datë 01.10.2021 dhe nr. 202, datë 01.10.2021**, Bordi i ERE-s vendosi përkatësisht të miratojë një Ndryshim në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror", i ndryshuar dhe në Vendimin e bordit të ERE-s nr.188, datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror", i ndryshuar. Konkretisht, ndryshimet e miratuara në pikën 1 të vendimeve të Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017 dhe nr. 188, datë 10.11.2017, përcaktojnë afatet për depozitimin në ERE të lejeve dhe autorizimeve mjedisore dhe certifikatën e sigurimit, depozitimi i të cilave është i nevojshëm për plotësimin e kushteve respektive të licencave të shoqërisë "Albgaz" sh.a në veprimtarinë e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

14. **Me Vendimin nr. 154, datë 30.06.2021**, Bordi i ERE-s miratoi modifikimin e licencës për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019. Modifikimi i licencës konsiston në ndryshimin e afatit të licencimit për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, nga 25 vjet në 30 vjet, nga data e fillimit të operimit.

15. **Me Vendimin nr. 171, datë 16.08.2021**, Bordi i ERE-s miratoi programin e përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a. me kushtin që shoqëria brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.

16. **Me Vendimin nr. 172, datë 16.08.2021**, u rishikua Vendimi i bordit të ERE-s nr. 90, datë 06.04.2021, "Mbi licencimin e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)", duke miratuar disa ndryshime lidhur me kushtet e vendosura në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 06.04.2021.

17. **Me Vendimin nr.198, datë 01.10.2021**, Bordi i ERE-s miratoi kërkesën e subjektit GEK TERNA GROUP, për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në treg -testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec Fier. Kërkesa e GEK TERNA Group u miratua nga ERE, pasi u vlerësua se ishte në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzimet e Testit të Tregut, Kodi i Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.

18. **Me Vendimin nr. 212, datë 08.10.2021**, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e kërkesës së subjektit DEPA COMMERCIAL S.A. për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në treg testi i TAP AG për kapacitetin dhe lidhjen. Kërkesa e DEPA COMMERCIAL S.A. u miratua nga ERE, pasi u vlerësua se ishte në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, si të përcaktuara në paragrafin 4.7 të tij, Njoftimin e Fazës Jo-detyruese për Testin e Tregut TAP AG 2021, Udhëzimet

për Testin e Tregut të 2021, Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.

19. **Me Vendimin nr. 229, datë 15.11.2021**, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së. Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i kritereve, kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit të realizuar nga operatori i sistemit të GNL-së bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me parimet dhe rregullat e miratuara në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit natyror të miratura me vendimin e bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.05.2017 si dhe akteve të tjera rregullatore që parashikojnë aktivitetin e Operatorit të sistemit të GNL-së.

20. **Me Vendimin nr. 236, datë 26.11.2021**, Bordi i ERE-s miratoi zgjatjen e afateve të përcaktuara në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, "Për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.". Zgjatja me 3 muaj e afatit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, u miratua pas kërkesës së shoqërisë "Albgaz" sh.a, e cila u shpreh se ka marrë të gjitha masat për të plotësuar kushtet e vendimit dhe aktualisht është në proces konsultimi me aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.

21. **Vendim nr. 254, datë 21.12.2021.** Lënia në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, "mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a." për vitin 2022.

    Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, " Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar,të nenit 13, pika 1, nenit 16, pika 2, neni 17, gërma "e" dhe neni 33, të ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 178, datë 18.11.2017; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, shqyrtoi relacionin me nr. 156/10 prot., datë 17.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a., për vitin 2022".

22. **Me Vendimin nr. 256, datë 21.12.2021**, Bordi i ERE-s miratoi licencën tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së. Kjo vendimmarrje e ERE-s, mbështetet në përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe ka për qëllim të përcaktojë kushtet, të cilat duhet t'i përmbushë i licencuari në veprimtarinë e operimit të impianteve të gazit natyror të lëngët.

6.11 Performanca e ALBGAZ sh.a. për vitin 2021

1) Terminali Rajonal i Gazit-Vlore *(MOU MIE – Exon Mobile – Albgaz)*

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanive Amerikane, **Exxon Mobil dhe Excelerate Energy,** për vlerësimin e kuadrit rregullator teknik dhe komercial të futjes së Gazit Natyror të Lëngët (GNL) në Shqipëri.

Ky hap shënon një transformim të rëndësishëm, jo vetëm në importin e gazit natyror të lëngët me anije të vogla, por po studiohet mundësia e ndërtimit të një **Terminali Rajonal në Gjirin e Vlorës**, i cili do t'i shërbejë jo vetëm për vendosjen në punë të TEC Vlora (kapaciteti aktual plus kapacitet shtesë i cili është në fazë studimi fisibiliteti) por gjithashtu do të shërbejë potencialisht si një burim

alternativ furnizimi me gaz tubacionin Fier – Vlorë – Fier. Ky terminal do të shërbejë gjithashtu për zhvillimin e mëtjeshëm të tregut të gazit në Shqipëri nëpërmjet shpërndarjes në zonën e jugut.

Kjo marrëveshje përfshin zinxhirin e plotë, duke nisur nga konvertimi i TEC Vlorë me GNL, tek ndërtimi i një terminali të ri gazifikimi, duke shndërruar kështu Vlorën në pikë rajonale shpërndarëse. Mund të themi se nga kapaciteti i ngritjes së Terminalit të GNL-së do të varet edhe pozicioni strategjik që ka vendi ynë në kushtet e krizës energjitike që po kalon bota. Në një prespektivë afatmesme, vendi ynë po shkon drejt shndërrimit në një nyje energjitike (Hub), ku përveç Terminalit të GNL dhe projektit TAP, i cili aktualisht është në operim, theksojmë projektin e depozitimit nëntokësor të gazit në Dumre dhe mundësinë e kontributit me prodhim gazi metan të vendit tonë nëpërmjet kompanive të huaja(Shell).

Marrëveshja për TEC Vlora, ndër të tjera do të garantojë edhe sigurinë e furnizimit me energji, e cila është e nevojshme së paku për një burim të besueshëm për prodhimin e energjisë elektrike dhe termocentrali i Vlorës është konsideruar prej një kohe të gjatë si një burim i tillë. Ndërkohë që pala amerikane është në fazën e studimit të kërkesës dhe nevojës rajonale, nga ana tjetër, Albgaz ka nisur një analizë të thelluar si dhe një studim tregu lidhur me shpërndarjen në shkallë të vogël.

Terminali i Vlorës parashikohet të shërbejë si një investim strategjik jo vetëm për Shqipërinë, por ai do ti shërbejë gjithashtu edhe vendevë fqinje si Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova etj.,

Ndërkohë nga ana e Entit Rregullator të Energjisë janë marrë masat dhe po punohet me intensitet të lartë në lidhje me hartimin e rregulloreve, metodologjive dhe liçencave të nevojshme për këtë qëllim dhe konkretisht:

- Rregullore për Terminalin e GNL
- Metodologji për llogaritjen e tarifave të GNL
- Liçenca për GNL
- Rregullore për Depozitimin e gazit natyror
- Metodologji për llogaritjen e tarifave të depozitimit
- Liçencë për depozitimin e gazit natyror
- Rregullore për përdorimin e gazit natyror të lëngët me shkallë të vogël (GNL) dhe Gazit Natyror të Kompresuar (GNK)
- Metodologji për llogaritjen e tarifave të GNL dhe GNK
- Liçenca për përdorimin e GNL dhe GNK

Të gjitha këto do të mbulojnë kërkesat në kuadër të hartimit të legjislacionit sekondar dhe i paraprijnë zhvillimit të tregut të gazit në vendin tonë.

2) Linja e Transmetimit Fier-Vlore-Fier *(Marreveshja Excelerate Energy – Snam – Albgaz).*

Excelerate Energy LLC, Snam dhe Albgaz Sh.A kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MOU) në 15 korrik 2021, në Tiranë, i cili është mjaft i rëndësishëm për tregun e gazit në vëndin tonë. Marrëveshja përmban:

- Ndërtimin e tubacionit të gazit natyror nga Terminali Vlorës në pikën e lidhjes me Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP) në Fier;
- Ndërtimin e Terminalit të Gazit Natyror të Lëngët (GNL) në Vlorë;
- Mundësia e zhvillimit të depozitimit nëntokësor të Gazit në kripërat e rajonit Dumre.

Në lidhje me pikën e fundit, palët angazhohen të eksplorojnë mundësitë e shfrytëzimit të depozitës nëntokësore të gazit natyror në Dumre, duke vënë në eficencë një aset të rëndësishëm në këto kripëra sepse jo të gjitha vëndet e rajonit e kanë këtë mundësi, që do t'i shërbejë jo vetëm vendit tonë, por edhe sigurisë së furnizimit me gaz natyror të rajonit por edhe më gjerë në Evropë. Objektivi kryesor i projektit të DNG-së së Dumresë është të kontribuojë në zhvillimin e sistemit shqiptar të gazit. Depozitimi nëntokësor i gazit mundëson uljen e kostos së përgjithshme të furnizimit me gaz për konsumatorët fundorë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shtesë në tregjet e gazit, si fleksibiliteti i ofertës dhe kërkesës, dhe krijimi i mundësive përkatëse të tregtimit. Për depozitimin në vend ekziston mundësia për rritjen e kapacitetit, ndërsa për depozitimet rajonale kapaciteti maksimal i kërkuar i injektimit është 113,000 m^3/orë. Sasia maksimale e kërkuar e marrjes së gazit është 190,000 m^3/orë.

E gjitha kjo, do ti shërbejë realizimit të politikave dhe prioriteteve tashmë të vendosura, për diversifikim të burimeve të energjisë, nëpërmjet një burimi të ri dhe të besueshëm siç është gazi natyror, duke u bërë pjesë aktive e ndërlidhjes me rrjetet e furnizimit ndërkombëtar siç është ai i TAP.

Kjo përpjekje dhe ky angazhim nga palët, është në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, lidhur ndërmjet MIE dhe ExxonMobil LNG Market Development Inc si dhe Excelerate Global Operations, LLC" e nënshkruar në fillim të këtij viti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të kryer një studim të fizibilitetit për zhvillimin e mundshëm të një Projekti GNL në Portin e Vlorës në Shqipërinë e Jugut.

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruhet nga përfaqësues të secilës palë, respektivisht nga Albgaz Sh.a; Excelerate dhe Snam Global Solutions. Planifikimi pritet të fillojë menjëherë me përfaqësuesit nga secila kompani që formojnë një ekip koordinues.

Avancimi i këtyre projekteve do të ndikojë në uljen e krizës energjitike në rajonin tonë, europë dhe në botë.

6.12 Albania Gas Service Company

Albanian Gas Service Company (AGSCo) është konsorciumi i krijuar mes Albgaz dhe SNAM, dy kompanitë shtetërore të gazit në Shqipëri dhe Itali, me qëllim kryerjen e funksionimit, mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike të tubacionit të Gazsjellësit Trans Adriatic (TAP), për pjesën që kalon në territorin e Shqipërisë.

AGSCo ka një staf fillestar prej 52 punonjësish, 90% të të cilëve janë shqiptarë. Ata janë trajnuar dhe çertifikuar nga SNAM, në Itali dhe në Shqipëri, që prej vitit 2019 e në vazhdim. Kjo është në bazë të marrëveshjes, ku kompania italiane SNAM garanton kualifikimin e punonjësve të Joint Venture dhe transferimin e njohurive teknologjike sipas standardeve të sektorit.

6.13 Objektiva për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror

Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, për ecurinë normale të TAP. Koordinimi i të gjitha akteve nënligjore, rregulloreve dhe vendimeve të përbashkëta të nevojshme për të, në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, Komissionit të Rregullimit(EU) 2017/459 (CAM NC) dhe një sërë rregulloresh të tjera që kanë të bëjnë me transparencën, diskriminimin e palëve të treta si dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim.

Bashkëpunimi me TAP dhe entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë për përfundimin me sukses të Testimit të Tregut për zgjerimin e kapacitetit nga 10 miliard m3/vit në 20 miliard m3/vit. Ky testim është harmonizuar me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, ('Opinioni Përfundimtar i Përbashkët') i Kodit të Tarifave të TAP me

Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit te Kapacitetit tek sistemet e transportit te gazit ("CAM NC").

Bashkëpunimi me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për transpozimin e ndryshimeve që po kryhen në Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU si dhe akteve të tjera në lidhje me sektorin e gazit natyror, biogazit, biometanit, hidrogjenit, përdorimit të gazit të lëngët me shkallë të vogël (small scale), përdorimit të gazit metan të komprimuar(KGN) etj.

Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës (MIE) për rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe mundësinë për rezervim të kapacitetit në Fier dhe në Kuçovë i planifikuar për pikat e daljes.

Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz për ndërtimin e Terminalit të GNL-së në Vlorë në prani të investimeve Exxon-Mobil dhe Exxelerate.

Bashkëpunimi me MEI dhe Albgaz për depozitimin e gazit në kripërat e Dumres, nëpërmjet pjesëmarrjes së këtyre kompanive gjigande së bashku me SNAM. Faktikisht ka mbaruar studimi i fizibilitetit dhe rezulton efektiv. Sipas këtij studimi rezulton se me 7 kaverna që kanë një kosto 250 milion euro mund të tërheqim nga depozitimi rreth 6 miliard m3gaz dhe nëse e dyfishojmë tërheqja për nevoja shkon në 12 miliard m3gaz vetëm me një investim prej 500 milion euro. Kjo do të ishte pothuajse sasia që është depozituar në Europë gjatë vitit 2021, kryesisht ky depozitimi është bërë në Ukrainë.Ndërsa depozitimi i gazit për vitin 2021 në Rusi në periudhën e verës ka qënë 76 miliard m3 Pra, në varësi të investimeve do të varet edhe kapaciteti i depozitimit nëntokësor të gazit.

Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz për ndërtimin e tubacionit Fier-Vlorë, lidhja me tubacionin e TAP dhe terminalit të mundshëm që do të ndërtohet nga Excelerate. Kjo do të shërbejë edhe për futjen e gazit metan në rrjetin e tubacioneve të TAP dhe IAP.

Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz për ndërtimin e tubacionit IAP (Ionian Adriatik Pipeline) nga pika e kontaktit me TAP në Fier deri në Kroaci. Faktikisht projekti i zbatimit ka përfunduar, pritet fillimi i ndërtimit të tij. Kjo do të bëjë që i gjithë rajoni ynë: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Bosnje-Hercegovina që aktualisht nuk e kanë të zhvilluar tregun e gazit të integrohen në këtë rrjet.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Albgaz Sh.a. për Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Dorëzimi për Objektin e Seksionit Jugor në Fier. TAP do të projektojë, prokurojë dhe ndërtojë pikën e daljes së gazit në Fier, një investim disa milionë euro në vend, kjo do të bëjë që nëpërmjet kësaj pike të bëhet furnizimi i konsumatorëve të vendit tonë me gaz.

Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz për periudhën e Testimit të Tregut të vitit 2021 e në vazhdim sepse gjatë fazës jodetyruese të shprehjes së interesit, TAP ka marrë interes kërkesa për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri për: pikën e interkonjeksionit në Kuçovë, për pikën e interkonjeksionit në Fier dhe pikën e daljes Roskovec.

Gjithashtu bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz për kërkesat e mëposhtme jodetyruese për pikat e lidhjes: një pikë dalëse në relievin Roskovec, një pikë dalëse në Kuçovë dhe dy kërkesa për pikë lidhje në Fier. Zhvillimet në këto pika daljeje do të varen nga koordinimi midis TAP dhe palës kërkuese. MIE është vendimtare në dhënien e të drejtës sipas politikave energjitike që ajo ka. (Ky informacion është vënë në dispozicion të publikut në Raportin e Vlerësimit të Kërkesës të publikuar nga TAP më 25 tetor 2021).

Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës (MIE) për amendimin e ligjit nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar, për plotësimin e kushteve të çertifikimit të Operatorit të Transmetimit të Gazit Natyror, Albgaz sh.a.

Bashkëpunimi me Albgaz sh.a, në aspektin rregullator, për të gjitha problemet që hasen për hapjen e tregut të gazit natyror, kualifikimin, transparencën dhe përmirësimin e akteve të domosdoshme.

6.14 Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare ne fushen e Gazit Natyror

CEER (Këshilli Europian i Rregullatorëve të Energjisë) – ku ERE është vëzhgues si vend kandidat për në Bashkimin Europian dhe ka kontributin e saj si pjesëmarrëse në grupet e punës për ndryshimet ligjore, përmirësimin e direktivave dhe rregulloreve në sektorin e gazit, për ruajtjen afatgjatë të energjisë në kushtet e krizës, amendimin e direktivës së efiçensës së energjisë, të konsumatorit, strategjinë e energjisë fotovoltaike.

GRI SSE, SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE, (Iniciativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Juglindje). Pjesëmarrjet në grupet e punës për: tregun e gazit me shumicë, tregun me pakicë, zbatimi i kodit të rrjetit, kongjestione, tarifat në rrjetin e transmetimit, shpërndarjes dhe në kufij, planet 10-të vjeçare të zhvillimit etj.

MEDREG, Shoqata e Rregullarorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut. Pjesëmarja e ERE-s në studimet rajonale si: infrastruktura e rajonit të mesdheut, integrimi i infrastrukurës së mesdheut me atë europiane, çmimet me pakicë dhe shumicë, bashkëpunimi me studimet e ECRB në Vjenë.

ENTSO-G (Observer në Shoqatën e Sistemit të Transmetimit Europian të gazit).

IGU (Unioni Ndërkombëtar i Gazit).

OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë) me qendër në Francë, ku ERE është anëtare me të drejta të plota dhe pjesëmarrës në studime rajonale që organizohen prej saj.

UfM (Unioni për rajonin e Mesdheut) ERE është anëtare me të drejta të plota dhe pjesëmarrëse aktive. UfM është pjesë e OME me qendër në Paris.

ERRA (Shoqata Rajonale e Rregullatorëve të Energjisë) ERE është anëtare prej vitit 2000. Pjesëmarrja në NG COM Meeting, trajnime me qëllim përmirësimin e aktivitetit, për të bërë ndryshime pozitive në punën e përditshme të rregullatorëve, pasi njihet si një institucion i rëndësishëm ndërkombëtar, i cili mbulon Evropën, Azinë, Afrikën, Lindjen e Mesme, Amerikën Veriore dhe Jugore.

ECRB, Gas Working Group, Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë, ku vecohet pjesëmarrja në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vendin tonë.

7. MBI RAPORTIMIN E ERE NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË "REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2020"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me shkresën nr. 929/3 prot., datë 12.07.2021, ka përcjellë pranë ERE Rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2020". Në përputhje me vendimin nr. 134/2018 te Kuvendit te Shqipërisë "Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik" më poshtë po ju paraqesim një kopje të informacionit lidhur me zbatimin e detyrave të rezolutës së Kuvendit nga Enti Regullator iEnergjisë.

Me vendimin e Bordit nr. 181, datë 08.09.2021, ERE ka miratuar planin e masave për zbatimin dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit.

Në kuadër të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, ERE ka vijuar me përgatitjen e Kalendarit të Masave duke detajuar aktivitetet dhe Strukturat përgjegjëse për implementimin e këtyre rekomandimeve.

<u>Pika 1</u> Të kërkojë impenjim maksimal nga OSHEE sh.a. për implementimin në një kohë sa më të shkurtër të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për Ndarjen Funksionale të OSHEE sh.a., si një hap ngushtësisht të lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, hapjen e mëtejshme të tij dhe si një kërkesë e theksuar edhe në progresraportin e KE-së.

Në lidhje me këtë pikë, nëpërmjet korrespondencave me palët (OSSH dhe FSHU) apo dhe raportimeve të këtyre të fundit në kuadër të detyrave të lëna në kuadër të ndarjes, kjo pikë e ndarjes financiare, ligjore dhe organizative e të dy operatorëve rezulton e plotësuar. Me plotësimin e kushteve të cituara më sipër, ERE ka vendosur për shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, i cili kishte të bënte me transferimin e personelit nga shoqëria OSHEE sh.a. tek OSSH sh.a. për kryerjen e detyrave funksionale të kësaj të fundit në përputhje me kushtet e licencës. Gjithashtu në kuadër të funksionimit të ndarjes së shoqërive dhe proçesit të liberalizimit të tregut edhe për klientët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes ka vijuar komunikimi lidhur me statusin e vendosjes së matësave inteligjentë dhe njoftimin e klientëve të cilët dalin në treg të parregulluar pasi i janë plotësuar kushtet teknike për daljen në treg të lirë. ERE ka marrë pjesë në Komitetet drejtuese të përbëra nga MIE, MEF, KfW dhe AFD, të cilat lidhen ngushtësisht dhe me monitorimin e ndarjes funksionale të OSHEE sh.a. si një detyrë e vazhdueshme e ERE.

<u>Pika 2</u>: Në bashkëpunim me Rregullatorin e Kosovës, të marrë masa për hapjen e procesit të përzgjedhjes së NEMO (operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike) si dhe përafrimin e legjislacionit sekondar midis dy vendeve dhe hapave te tjerë të nevojshëm në funksion të bashkimit të tregjeve të dy vendeve tona.

Për qëllime të plotësimit të kësaj detyre, ERE ka realizuar tashmë:

- Më datë 21.10.2021, në Tiranë u nënshkrua marrëveshja kuadër midis Enteve Rregullatore të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit midis dy vendeve, e cila vendos bazat për krijimin e tregut të përbashkët. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje u parapri nga takimet e përbashkëta të grupeve të punës me përbërjen e rregullatorëve, ministrive dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të të dy vendeve për përgatitjen e kuadrit legjislativ, rregullator dhe teknik për krijimin e tregjeve të përbashkëta.
- Gjithashtu, në nëntor si vijim i detyrave që dalin nga kjo marrëveshje, rregullatorët e të dy vendeve nënshkruan memorandumin për operimin e tregjeve të përbashketa dhe detyrimet qe i lindin rregullatoreve, TSO-ve dhe bursës për realzimin e këtij operimi.
- Me ndihmën dhe të USAID u zhvillua po ashtu me pjesëmarrjen dhe promovimin e të dy rregullatorëve dhe pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë të tregut një seminar mbi efikasitetin e integrimit të tregjeve të energjisë elektrike të të dy vendeve si dhe masat që janë marrë dhe sfidat që dalin në vijim në këtë drejtim.
- Në datën 7 dhjetor 2021, ERE dhe ZRRE nënshkruan Memorandumin e mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave në veprimtarinë e tregëtimit dhe furnizimit, mes Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë Memorandum të dy rregullatorët dakordësuan mbi njohjen reciproke të licencave të tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, fakt i cili do të ulë kostot administrative dhe financiare të të licencuarve në të dy vendet për të operuar në të dy tregjet dhe do t'i hapë rrugë lehtësimeve në operimin e një tregu të përbashkët.

<u>Pika 3</u>: Të rrisë bashkëpunimin me Entin Rregullator të Italisë për të bërë të mundur njohjen e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në komitetet e bursave të vendeve të BE-së.

ERE ka realizuar këtë kërkesë të rezolutës duke marrë pjesë në grupet e punës të projektit KEP/AIMS për krijimin e tregut të përbashkët midis Shqipërisë, Italisë, Malit të Zi dhe Serbisë.

Sqarojmë gjithsesi se njohja e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në komitetet e bursave të vendeve të BE-së lidhet me bërjen operacionale të Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) që do krijonte kushtet dhe për përmbushjen e plotë të kësaj detyre, ku ALPEX do të aplikonte për njohjen si operator i tregut në Shqipëri dhe Kosovë.

Aktualisht sipas informacioneve të përcjella nga ana e ALPEX, është në përmbyllje tenderi për shërbimin e operimit të bursës nga një operator i mirënjohur ndërkombëtar, i cili do ti hapë rrugën dhe bashkimit të bursës shqiptare me atë të vendeve të Bashkimit Evropian në një të ardhme të afërt. Proçesi i tenderimit është në fazat përfundimtare dhe pritet lidhja e kontratës dhe më tej fillimi i operimit të bursës, e cila pritet të jetë operative gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022.

<u>Pika 4</u>: Përmes mundësive të reja në fushën e teknologjisë së informacionit duhet të punojë për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave, dhënies së informacionit të saktë e të shpejtë për konsumatorët, si dhe trajtimit në një kohë sa më të shkurtër te ankesave.

ERE ka plotësuar këtë rekomandim të rezolutës dhe ka zbatuar detyrat si vijon:

Përditësimi i një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave online, me qëllim trajtimin sa më të shpejtë dhe në mënyrë efektive të ankesave të konsumatorëve, është një detyrë që është realizuar me vëmendje të vëçantë nga ana e ERE. Përditësimi i regjistrit të ankesave sipas Programit të Transparencës është kryer brenda 24 orëve nga regjistrimi i ankesave të reja apo marrja e përgjigjes nga ana e të licencuarve me qëllim gjurmimin e ankesës në kohë sa më të shkurtër nga ana e Konsumatorëve. Informacioni në lidhje me ankesat përditësohet (dhe në rrjetet sociale) kohë pas kohe, me qëllim njoftimin e konsumatorit për ecurinë e procedurës së trajtimit të ankesave të adresuara në ERE për të rritur eficencën në dhënien e këtij shërbimi por edhe në frymën e masave të qeverisë shqiptare për shmangien e ekspozimit të konsumatorëve ndaj infektimit me virusin covid.

Për përmbushjen e kësaj detyre, mes të tjerave, ERE ka punuar për uljen e afateve faktike të trajtimit të ankesave nga ERE. Për 209 ankesat e regjistruara përgjatë vitit 2021 në ERE janë trajtuar brenda një afati prej 7 ditësh rreth 92% e tyre si dhe rreth 8% prej tyre janë trajtuar brenda afatit 15-ditor.

Afati ligjor 15-ditor për trajtimin e ankesave është përcaktuar qartë në "Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 114, datë 8.7.2016.

Vendosja e numrit të telefonit për rakordimin me konsumatorët, të ecurisë së procedurës së trajtimit të ankesave por edhe dhënies së informacionit të nevojshëm, ka ndihmuar në vendosjen e një kontakti të shpejtë dhe eficient me ta. Nëpërmjet këtij numri, vendoset rregullisht komunikim me konsumatorët për t'i njoftuar në lidhje me pyetje që kanë mbi statusin e ankesës së tyre por edhe njoftohen rast pas rasti konsumatorë të cilët për shkak të depozitimit të të dhënave të adresës jo të sakta si në FSHU sh.a., ashtu edhe në ERE, e kanë të pamundur të marrin dijeni në lidhje me ecurinë e ankesës së tyre.

Në përmbushjen e kësaj detyrë, ERE ka patur në konsideratë dhe ka marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me operatorët apo edhe institucionet që ofrojnë shërbime lidhur me konsumatorët përmes korrespondencave të vazhdueshme dhe zhvillimit të seancave dëgjimore. Bashkëpunimi i ngushtë me shoqatat e konsumatorit dhe përfaqësues të interesave të konsumatorit (Avokati i popullit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit etj, besojmë se ka rritur impaktin rregullator nëpërmjet informacionit dhe dhënies së zgjidhjeve eficiente në trajtimin e ankesave të drejtuara në këto institucione por edhe shkëmbimit të ekspertizës në konsultime publike me këto institucione për aktet nënligjore, objekt i miratimit nga ERE.

<u>Pika 5:</u> Të punojë për hartimin e treguesit të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim, për të bërë të mundur ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

ERE ka plotësuar këtë rekomandim të Rezolutës duke hartuar draftin e Rregullores mbi Masat e të Licencuarve në Aktivitetin e Furnizimit për Arritjen e Treguesve të Matjes dhe Vlerësimit nga ERE të Performancës së Shërbimit ndaj klientit. Me vendimin e bordit të ERE nr. 208/2021 ka filluar tashmë procedura për miratimin e kësaj rregulloreje dhe drafti është në konsultime me publikun. Në vijim të hartimit të Rregullores pas konsultimit me palët, pritet miratimi i saj nga ERE. Disa nga palët e interesit kanë përcjellë në ERE opinionet e tyre mbi këtë akt. Nga ana e ERE është planifikuar të organizohet nje seancë dëgjimore me palët e Interesit për të diskutuar propozimet e përcjella.

<u>Pika 6</u> - Përmes mjeteve dhe mënyrave të informacionit të mbështesë dhe promovojë kalimin nga një konsumator pasiv, subjekt i tarifave të rregulluara, akteve rregullatore, në një pjesëmarrës aktiv të tregut të energjisë.

Lidhur me plotësimin e këtij rekomandimi, bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 109, datë 22.04.2021, ka miratuar "Standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit",

Aktualisht në vijim të kësaj vendimmarrjeje pranë ERE-s u depozituan nga ana e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) propozimet përkatëse në lidhje me disa shtesa dhe ndryshime në "Rregulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit", propozime të cilat iu dërguan palëve të interesit me qëllim konsultimin e tyre. Pas këtij komunikimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka bërë me dije se: "pasi u njoh me përmbajtjen e Vendimit të Bordit të ERE me nr. 109, datë 22.04.2021, si dhe me propozimet e OSSH sh.a., shprehet parimisht dakord për vijimin e procedurës nga ana juaj, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij".

Me qëllim marrjen e një mendimi të plotë dhe konsultimin e propozimeve të ardhura nga ana e shoqërisë OSSH sh.a., ERE organizoi më datë 25 Tetor 2021, një seancë dëgjimore mes përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe OSSH sh.a. OSSH ka përcjellë në ERE propozimet e rishikuara të cilat pasi janë publikuar në faqen e ERE në zërin konsultime i japë përcjellë për opinion dhe palëve të interesit. Një pjesë e palëve të interesit kanë përcjellë qëndrimin/dakordësinë lidhur me sa propozuar. Me kryerjen e proçesit të konsultimeve publike ERE do të vijojë me finalizimin e proçesit në kuadër të rishikimit të Rregullores të sipërcituar në mbështetje të kërkesës së OSSH sh.a.

<u>Pika 7:</u> Duhet të vijojë mbikëqyrjen e performancës së operatorit sa i përket zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike.

ERE ka plotesuar këtë rekomandim, si më poshtë vijon:

Gjatë vitit 2021 në përputhje dhe me Kalendarin e monitorimeve, janë zhvilluar Monitorime pranë të licencuarve (OSSH sh.a., FSHU sh.a., FTL sh.a. dhe OST sh.a.).

1. Monitorimi i FSHU sh.a. lidhur me zbatimin e afateve dhe procedurave të trajtimit të ankesave të regjistruara në FSHU sh.a përgjatë 1 viti kalendarik.
2. Monitorimi i OSSH sh.a. gjatë periudhës 15.02.2021 deri më 05.03.2021, lidhur me zbatimin e afateve dhe procedurave për verifikimin e matësave në zbatim të Rregullores, mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës.

3. Monitorimi i Qendrave të Kujdesit të Klientit të shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me performancën e punonjësve sa i përket njohurive mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të licencuar FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a.
4. Monitorimi i shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me detyrimet dhe raportimet periodike si dhe mbi mbikëqyrjen e zbatimit të detyrave që rrjedhin për të licencuarin nga vendimi i Bordit të ERE nr. 201/2018, i rishikuar me vendimin nr. 217/2020 "Mbi Rishikimin e "Planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike "OSHEE sh.a.", për respektimin e të Drejtave të Klientëve të Furnizimit me Energji Elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 03.09.2018. Të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit janë duke u përpunuar nga ana e grupit të punës të ngritur për këtë qëllim dhe në përfundim do të dilet me një qëndrim nga ana e ERE-s për gjetjet e grupit të punës mbi zbatimin e planit të masave në fjalë apo dhe rekomandime për FSHU sha në rast se do të evidentohen të meta në implementimin e tij.
5. Monitorimi i afateve dhe procedurave të lidhjeve të reja në Rrjetin e Transmetimit. Gjatë muajit nëntor është ushtruar monitorim pranë OST sha dhe grupi i punës i ngritur për këtë qëllim është duke përpunuar të dhënat e mbledhura me qëllim përgatitjen e informacionit për Bord.

Për plotësimin e sa lënë detyrë nga Rezoluta në këtë pikë, ERE ka përgatitur dhe miratuar modelin e anketës së konsumatorit i cili shpërndahet rregullisht ne rrjetet sociale dhe ftohen konsumatorët që adresojnë ankesë në ERE ta plotësojnë atë me vullnetin e tyre të lirë, për të mbikëqyrur dhe evidentuar kështu, performancën e shërbimit nga ana e të licencuarve sa i përket shërbimit konsumator por edhe evidentuar problematika nga ana e ERE, nëse do të rezultojë.

<u>Pika 8</u> - Përmes miratimit të akteve rregullatore të punojë për nxitjen e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme, si: dielli, era, biomasë, etj., të cilat sjellin një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë në vend, një kërkesë e përsëritur edhe në raportet e progresit të BE-së.

Për plotësimin e këtij rekomandimi, ERE ka zhvilluar sa vijon:

Nëpërmjet një sërë korrespondencash me OSSH sh.a. është kërkuar informacion kryesisht me qëllim marrjen e një panorame më të gjerë në lidhje me impaktin pozitiv që ka futja e burimeve të vogla të rinovueshme si ato fotovoltaike (për vetëprodhuesit) në diversifikimin e prodhimit të energjisë por edhe në uljen e shpenzimeve konsumatore me qëllim garantimin e furnizimit me energji elektrike. Nga ana e OSSH sh.a., janë përcjellë të dhëna statistikore të detajuara në lidhje me sa më sipër, të cilat janë objekt i studimit nga ana e ERE-s. Të dhënat janë analizuar e ka vijuar edhe komunikimi me OSSH pasi të dhënat e përcjella kanë paqartësi në mënyrën e trajtimit të netimit nga ana e OSSH. Për këtë qëllim ERE ka kërkuar shpjegimet e nevojshme për të vijuar më tej me analizimin e të dhënave gjatë vitit 2022.

Përveç sa më sipër, ERE në mënyrë periodike ka mbledhur të dhëna në lidhje me impaktin që burimet e rinovueshme, veçanërisht ato fotovoltaike (vetëprodhuesit si një kategori në rritje vitin e fundit) kanë në bilancin energjitik dhe ka mbajtur kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor që do të lehtësojë rritjen e peshës së kësaj kategorie prodhuesish në prodhimin vendas e do të kontribuojë në uljen e shpenzimeve të konsumatorit sa i përket konsumit familjar të energjisë elektrike.

<u>Pika 9:</u> Të japë ndihmesën e nevojshme dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët në vend për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit. Ngritja e infrastrukturës së gazit është me rëndësi, pasi gazi jo vetëm sjell diversifikimin e burimeve në vend dhe është më ekonomik në përdorimin, por ka edhe emetim shumë herë më të vogël në ambient.

Në lidhje me realizimin e këtij rekomandimi ERE nëpërmjet korrespondencës drejtuar MIE dhe Albgaz, ka ofruar ndihmesën, bashkëpunimin dhe dhënien e asistencës së nevojshme për çështje të

kompetencës së saj, për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror si dhe është kërkuar informacion lidhur me parashikimet dhe planet e investimet strategjike për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Pas përcjelljes së përgjigjes nga ana e këtyre institucioneve do të vijohet puna për mbështetjen me ekspertizën teknike të ERE-s në këtë proces.

Pika 10: Lidhur me përdorimin e teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike, përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbimi, t'u referohet praktikave të rregullatorëve në vendet e BE-së duke propozuar opsionet dhe zgjidhjet përkatëse.

Për plotësimin e këtij rekomandimi në ERE është ngritur tashmë një Grup Pune për vlerësimin e kuadrit rregullator dhe ligjor me qëllim përdorimin e teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike, përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbimi.

Nga ana e këtij grupi pune është vijuar me hulumtimin dhe ndjekjen e trajnimeve dhe seminareve të organizuara nga organizata rajonale e më gjërë, lidhur me shqyrtimin e metodave të rregullimit të tarifimit të këtij shërbimi si dhe marrja e eksperiencave nga vendet e tjera për adresimin e kësaj problematike si dhe rolin e rregullatorit në të. Rezultatet e analizës së ERE, do të vlerësohen me qëllim shqyrtimin e kushteve dhe adresimin e rregullimit të kësaj kategorie konsumatorësh, duke marrë në konsideratë praktikat e rregullatorëve të vendeve të BE, ende në faze fillestare, por edhe përfitimet që mund të garantohen nëpërmjet rregullimit në varësi të peshës specifike që kjo kategori zë, në kushtet aktuale të Shqipërisë.

Pika 11: Mbështetur në parimin e hapjes së tregut, parimin e koherencës dhe atë të shpërndarjes së drejtë, të përqendrohet në punën e saj, në promovimin e konkurrencës dhe inovacionit me qëllim uljen e çmimeve për konsumatorin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

ERE ka plotësuar detyrat që dalin nga ky rekomandim si vijon:

1. Të gjithë furnizuesve ju është kërkuar marrja e masave për promovimin e çmimeve nëpërmjet faqeve të internetit. Një pjesë e furnizuesve të cilët kanë filluar të kenë aktivitet në treg të lirë kanë bërë me dije se kanë filluar punën me qëllim krijimin apo përditësimi e faqeve të interentit me qëllim promovimin e shërbimeve të tyre në to.
2. Furnizueseve të licensuar dhe që janë aktiv në treg iu është kërkuar informacion në lidhje me komponentet e çmimeve të ofruara për furnizimin e klientëve fundorë në treg të lirë. Sa më sipër do të japë një panoramë të niveleve të konkurrencës në çmimet e ofruara mes furnizuesve në treg të lirë.

Pika 12: Me qëllim zvogëlimin e barrierave rregullatore dhe shkurtimin e kohës së procedurave rregullatore, të kryejë një analize ex-post të rregulloreve përkatëse.

Për zbatimin e këtij rekomandimi, ERE ka punuar për përgatitjen e një metodologjie të vlerësimit ex-post të akteve rregullatore mbi kritere të mirëpërcaktuara të vlerësimit ex-post me qëllim që të vlerësohet nëse objektivat, efektet e ndërmarra, kostot dhe përfitimet e një pjese të një legjislacioni janë aktualizuar, si dhe të identifikojë çfarëdo vështirësie apo efekti që ka rezultuar nga legjislacioni.

Pika 13: Krahas ndjekjes së problematikave që mund të lindin nga implementimi i projektit pilot të sistemit të ri të faturimit të energjisë elektrike, të konsiderojë mundësinë e instalimit gradual të matësve inteligjentë, bazuar kjo në një analizë kosto-përfitim dhe duke caktuar nivelin e përshtatshëm për zbatimin sipas zonave të ndryshme (urbane, sub-urban dhe rurale) në varësi edhe të mbulimit me rrjetin e telekomunikacionit.

Siç parashtruar edhe më sipër në këtë informacion, ERE ka zbatuar këtë rekomandim si vijon:

ERE ka mbajtur korrespondenca në lidhje me statusin e vendosjes së matësve inteligjentë drejtuar operatorëve si OSSH sh.a. dhe OST sh.a.. Nga këto korrespondenca është marrë informacion i

detajuar në lidhje me numrin e matësve inteligjentë, zonat ku janë instaluar dhe periudha e gjenerimit të të dhënave për këto matësa dhe po përpilohet një raportim lidhur me sa më sipër. Ka vijuar korrespondenca me qëllim identifikimin e njësive (familjare) të cilave u është instaluar një matës inteligjent apo fiderave nëse matësit janë të vendosur në këto njësi teknike. Gjithashtu është vendosur komunikim me AKEP me qëllim identifikimin e hapësirave në të cilat është e shtrirë linja e telekomunikacionit.

8. AKTIVITETI I ERE NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE NDRYSHIME TE TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2021

8.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar

Gjatë vitit 2021, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar punën me plotësimin e kuadrit ligjor në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, përmes miratimit të një numri të konsiderueshëm aktesh të cilat e pasurojnë edhe më tepër legjislacionin sekondar.

Pavarësisht, vështirësive me të cilat organet publike u përballën edhe këtë vit nga pandemia COVID – 19, ERE gjatë 2021 ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për komunikimin me palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, duke krijuar mundësi njohje me përmbajtjen e dokumenteve, mundësinë e konsultimit dhe dëgjimit të palëve të interesuara. Bordi i ERE-s gjatë vitit të kaluar është shprehur me 262 vendimmarrje në 59 mbledhje të zhvilluara në mënyrë të kombinuar, si fizikisht ashtu edhe online.

Vendimet e bordit të ERE, edhe këtë vit, kanë pasur objekt të tyre rishikimin apo ndryshimin e akteve të miratuara me herët, shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendime apo akte, zgjatjen e afateve të vendimmarrjes së bordit të ERE, fillimin e procedurës apo licencimin/rinovimin e licencave të subjekteve në veprimtaritë e tregtimit, prodhimit, furnizimit të energjisë elektrike apo në veprimtaritë e tregtimit të gazit natyror, shqyrtimin e aplikimeve të shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni për vitin 2021 dhe FSHU sh.a., për miratimin e çmimit të shërbimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2021, fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022 dhe për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024 për të cilat ERE zhvilloi dhe një seancë zyrtare publike etj.

Gjatë vitit 2021, ERE ka shënuar disa vendimmarrje të rëndësishme në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

<u>Disa nga Vendimet e ERE-s për vitin 2021</u>

1. **Vendim nr. 51, datë 17.02.2021 "Mbi miratimin e Kontratës ndërmjet OST sh.a., dhe KESH sh.a., "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese"**

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) ka përcjellë për miratim në ERE Kontratën ndërmjet OST sh.a. dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a) "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese".

Bordi i ERE me vendimin nr.184, datë 20.08.2018, vendosi miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a., nga analiza e Kontratës së përcjellë nga ana e shoqërisë OST sh.a., u konstatua se ajo është e njëjtë me Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.184/2018.

Për sa më sipër, bordi i ERE-s vendosi të shtrijë efektet nga data 1 Janar 2021 deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të bordit të ERE, nr. 106, datë 02.07.2020, për "Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", të "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.

2. **Vendim nr. 97, datë 07.04.2021 "Mbi miratimin e Treguesve për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2021"**

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, miratoi "Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike". Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a.,/OSSH sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj Rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, për shkak të nevojës së kryerjes së investimeve të domosdoshme..

Bordi i ERE me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020, vendosi miratimin e treguesve të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021. Për rrjedhojë për t'i dhënë mundësi si Operatorit të rrjetit OSSH sh.a., si dhe përdoruesve/konsumatorëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të marrin masat e nevojshme operative për të operuar sistemet apo pajisjet e tyre me kushtet e reja të miratimit të standardeve të cilësisë së shërbimit te shpërndarjes u gjykua që këto standarde të hyjnë në fuqi menjëherë, por aplikimi i pikës 7.2 në nenin 7 te Rregullores së miratuar me vendimin e bordit nr. 181, datë 10.11.2017, të pezullohet për një afat nga miratimi i këtyre treguesve, deri në 31 Gusht 2021. Kjo pikë të ketë efekte të plota juridike për periudhën nga 1 Shtatori 2021 e në vijim. Periudha e mësipërme ka shërbyer për të akomoduar dhe njohur të gjitha palët, ku përfshihet Operatori i Rrjetit OSSH sh.a. dhe përdoruesit e tij, me këto tregues të miratuar, si dhe për të marrë masat e nevojshme operative me qëllim minimizimin e ndikimit të këtyre treguesve në operimin e sistemeve përkatëse.

3. **Vendim nr. 108, datë 22.04.2021 "Mbi miratimin e Rregullave të Përbashkëta të Shlyerjes për Shkëmbimin e Energjisë në përputhje me Nenet 50(3) Dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Europian 2017/2195"**

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 77, datë 19.03.2021, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a për miratimin e "Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195".

Dokumenti "Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195", të datës 23 Nëntor 2017, është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale (referuar si "TSO të CE") në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Këto Rregulla, përbëhen nga:

(I) Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike;

(II) Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me Nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

4. **Vendim nr. 126, datë 17.05.2021 "Mbi miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)"**

Bordi i ERE, me vendimin nr. 256, datë 21.12.2020, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë. Draft i Rregullores është përcjellë për opinione dhe komente në: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare, Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme (AREA) dhe Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë. Pas shqyrtimit të të gjithë opinioneve dhe rekomandimeve të ardhura nga palët e interesit, bordi i ERE-s me vendimin nr. 126, datë 17.05.2021, miratoi Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë.

Kjo Rregullore transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikat abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë, në të njëjtën kohë ajo ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike. Rregullorja REMIT, po ashtu parashikon monitorimin e tregjeve të energjisë me shumicë nga Enti Rregullator i Energjisë.

5. **Vendim nr. 141, datë 15.06.2021 "Mbi miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Vlerësimit dhe të Përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike"**

Ligjit nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 87, pika 2 të tij parashikon se: ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton furnizuesin e mundësisë së fundit. Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 449, datë 15.06.2016, ka vendosur "*Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike*". Në seksionin III, të VKM-së nr. 449, datë 15.06.2016, është vendosur se: deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.

Bordi i ERE-s me anë të vendimit nr. 131, datë 10.08.2020, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Vlerësimit dhe të Përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike. Kjo Rregullore përcakton: a. Procesin e përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit; b. Detyrimet në lidhje me kushtet që kualifikojnë një të licencuar për të aplikuar dhe për t'u emëruar si Furnizuesi i Mundësisë së Fundit; c. Kriteret e vlerësimit që do të përdoren për përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit pas një procesi konkurrimi; d. Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e aplikuesit si furnizues i mundësisë së fundit.

6. **Vendim nr. 235, datë 26.11.2021 "Mbi miratimin e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të**

licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve"

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 163, datë 12.07.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit".

Kjo Rregullore u hartua në përputhje me nenin 20, germa "g" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; "Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe kushtet e licencave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit, që paraqesin kërkesën për:

a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;

b) ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;

c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksioneri që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.

7. **Vendim nr. 244, datë 02.12.2021 "Mbi propozimin e OST sh.a., për Treguesit e Kritereve Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike për Vitin 2022"**

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka miratuar "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", e cila parashikon detyrimin e shërbimit publik të OST sh.a., që të përmbushë standardet e cilësisë së furnizimit të specifikuara nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe nga kjo Rregullore.

Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit, të paraqitur nga OST sh.a., janë të përcaktuar dhe në akte të tjera të miratuara nga bordi i ERE-s, respektivisht: parametrat teknikë të cilët lidhen me tensionin dhe frekuencën janë të përcaktuar në "Kodin e Rrjetit të Transmetimit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE nr. 129, datë 04.06.2018, si dhe në "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 87, datë 20.04.2018.

Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit, të paraqitur nga OST sh.a., janë: 1. Cilësia e Frekuencës (FQ), 2. Koha e Nevojshme për tu Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja, 3. Cilësia e Tensionit (VQ), 4. Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI).

Akte për të cilat ERE ka filluar procedurën dhe është në proces konsultimi me palët e interesit janë:

1) Rregullorja "Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar – nisur procedura për disa shtesa, me vendimin e Bordit të ERE nr. 247, datë 13.12.2021;

2) Rregullorja mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit - nisur procedura për miratim, me vendimin e Bordit të ERE nr. 208, datë 08.10.2021;

3) Kodi i Transmetimit - nisur procedura për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratim, me vendimin e Bordit të ERE nr. 160, datë 02.07.2021;

4) Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar - nisur procedura për rishikim me vendimin e Bordit të ERE nr. 138, datë 07.06.2021.

Gjatë vitit 2022, ERE do të vijojë punën me qëllim miratimin apo azhornimin e legjislacionit sekondar të miratuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

Proceset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2021

ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proceset gjyqësore

1. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse shoqëria Devy sh.p.k., dhe palë e paditur Enti Rregullator i Energjisë**

Çështja është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt gjykimi: 1. Shfuqizimin e vendimit nr. 37, datë 27.02.2020 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 10, datë 20.01.2020 të ERE; 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 187, datë 25.11.2019 të ERE.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë-padisë, vendim ky i cili është apeluar nga shoqëria Devy sh.p.k. Deri tani akoma nuk ka njoftim nga Gjykata Administrative e Apelit për seancë gjyqësore.

2. **Procesi gjyqësor me palë paditëse shoqëria "Wonder" sh.p.k dhe i paditur ERE/ Person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Shoqëria "Energo-Sas" sh.p.k.**

Çështja është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt gjykimi: Shfuqizimin si të paligjshëm të vendimit të bordit të Enti Rregullator të Energjisë (ERE) Nr. 171, datë 07.11.2019. 2. Njohjen e të drejtës së palës paditëse për t'u pajisur me licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike sa i përket hidrocentralit Sasaj. 3. Detyrimin e palës së paditur ERE të pajisë palën paditëse me licencën përkatëse.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi shoqëria "Wonder" sh.p.k., ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Për shkak të situatës kaotike në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuara nga pandemia Covid – 19, nga kjo Gjykatë nuk ka ende njoftim për caktimin e datës së procesit.

3. **Procesi gjyqësor me palë paditëse shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., dhe palë të paditura Enti Rregullator i Energjisë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, (OSSH sh.a).**

Çështja me nr. 34346 Akti, datë 17.09.2020 është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt gjykimi: 1.Ndryshimin e pikës 1 të Aktit Administrativ Vendim i Bordi të ERE Nr. 89, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.109/2020 në pikën 3 të tij; Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "MP – HEC" sh.p.k, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k" në pranimin pjesërisht të kërkesës së shoqërisë , "MP-

HEC" sh.p.k., me Nr. 656/1 prot., i ERE, datë 28.04.2020 "Rishikim i Vendimit Nr. 74 datë, 22.04.2020 të Bordit të ERE "Miratimin e disa ndryshimeve të Vendimit të Bordit të ERE nr. 187, datë 25.11.2019". Shfuqizimin e Pikës 1, germa "b". 2. Konstatimi i Pavlefshmërisë Absolute të ndryshimeve të Vendimit Nr. 187 datë 25.11.2019, të botuara në Fletoren Zyrtare Nr 176/2019. 3. Konstatimin e Pavlefshmërisë Absolute të Aktit Administrativ Urdhër nr.4057/2 datë 16.07.2020 të OSSH. 4. Pagimi solidar i dëmit të shkaktuar nga veprimet e palës së paditur në shumën 30 000 Euro deri në datën e ngritjes së padisë me detyrimin e të paditurve për të paguar edhe dëmin e pritshëm nëse do të rritet nga veprimet antiligjore të të paditurve.

Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë ka pranuar pjesërisht kërkesë-padinë dhe ERE ka ushtruar ankimin pranë Gjykatës Administrative të Apelit (nga kjo Gjykatë nuk rezulton të jetë caktuar ende një datë për shqyrtimin e çështjes).

4. Procesi gjyqësor me palë paditëse shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k., palë e paditur Enti Rregullator i Energjisë dhe person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Çështja me nr. 5731 Akti, datë 16.12.2019, është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt gjykimi: 1. Detyrimi i Entit Rregullator të Energjisë, të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të hedhur në rrjet, të shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k., nga fillimi i hedhjes në treg të kësaj energjie.

Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë.

ERE ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Për shkak të situatës kaotike në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuara nga pandemia Covid – 19, nga kjo Gjykatë nuk ka ende njoftim për shortin apo caktimin e datës së shqyrtimit të kësaj çështjeje.

5. Procesi Gjyqësor me palë paditëse A.XH dhe palë e paditur Enti Rregullator i Energjisë

Çështja me Nr. 1253 Akti, datë 18.01.2021 është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt gjykimi 1-Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr.10 datë, 20.01.2020 të Bordit të ERE dhe pasqyrimin e kësaj pavlefshmërie në Vendimin Nr.37 datë 27.02.2020 të Bordit të ERE duke bërë ndryshimet e mëposhtme në dispozitivin e Vendimit Nr.37 datë 27.02.2020 të Bordit të ERE.

- Pika 1 e Vendimit Nr. 37/2020 të Bordit të ERE duke u bërë; «Konstatimin e Pavlefshmërisë absolute të vendimit të ERE-s Nr.10/2020, "Mbi kërkesën për mos licencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr.187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Nicë".

- Shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit Nr.37/2020 të Bordit të ERE.

2-Pagimi i dëmit moral të shkaktuar nga publikimet e paligjshme, duke dëmtuar imazhin e paditëses nga publikimet e ERE në shumën 2 000 000 lekë.

Përfunduar si çështje me tërheqjen e palëve nga gjykimi i çështjes.

6. Procesi Gjyqësor me palë paditëse shoqëria "HERA" sh.p.k., dhe palë e paditur Enti Rregullator i Energjisë

Çështja është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt gjykimi 1. Kundërshtimin e vendimit të ERE nr. 34, datë 04.02.2021 "Mbi kërkesën e shoqërisë "Hera" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007", i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 29, viti 2021, për pranimin e kërkesës së Shoqërisë "Hera" sh.p.k.

Për këtë çështje gjyqësore, dy seanca përgatitore janë zhvilluar në dhomë këshillimi. Në seancën e fundit të zhvilluar Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi pushimin e gjykimit.

7. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse M. K, Z. A.E, Th.M, M.M.E, R.E, M.E dhe palë të paditura Znj. L.H, DH.Q, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, Shoqëria Amal sh.p.k., dhe Enti Rregullator i Energjisë (ERE)**

Çështja me nr. 523 Akti është paraqitur pranë Gjykatës së Apelit Durrës me objekt gjykimi:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave për shitjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë "AMAL" sh.p.k., sipas kontratave:

-kontratë nr.2056 rep. dhe nr.218 kol., datë 27.05.2004 redaktuar nga notere Dhimitra Qarri;

-kontratë nr.3041 rep. dhe nr.648 kol., datë 27.07.2006 redaktuar nga noter Mariglen Rrapi;

-kontratë nr.504 rep. dhe nr.142 kol. datë 23.01.2007 redaktuar nga notere Dhimitra Qarri.

2. Kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme në këtë mënyrë:

- të detyrohet pala e paditur Qëndra Kombëtare e Biznesit të kryejë regjistrimin e shoqërisë "Amal" sh.p.k., në regjistrin e Qëndrës Kombëtare të Biznesit në emër të pronarëve të ligjshëm të saj Manushaqe Elezi dhe Agim Elezi.

- Detyrimin e të paditurit Agim Elezi t'i kthejë të padituës Luljeta Hysolli shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kjo çështje gjyqësore nuk është shqyrtuar ende në seancë përgatitore për shkak të ndryshimit të trupit gjykues.

8. **Procesi Gjyqësor me palë paditës: B. P. etj., dhe palë të paditura Enti Rregullator i Energjisë, shoqëria "Seka Hydropower" sh.p.k.**

Çështja administrative me nr. 4266 Akti, datë, 02.11.2020 me **Objekt:** Shfuqizimi i Vendimit Nr.146, dt.10.09.2020, "Mbi licencimin e shoqërisë "Seka Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", ka përfunduar në dy shkallët e gjykimit përkatësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë – Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe është në fazën e Rekursit në Gjykatën e Lartë.

9. **Procesi gjyqësor me palë paditëse AREA - Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme, i Paditur: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë**

Çështja Administrative me objekt gjykimi: 1. Shfuqizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 13.05.2020, 2. Shfuqizimi i Vendimit Nr. 94 date 08.06.2020 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) 3. Marrja e masës së pezullimit të zbatimit të Vendimit Nr. 94 datë 08.06.2020 të Enti Rregullator i Energjisë është në fazën e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit.

10. **Procesi gjyqësor me palë paditëse: Shoqata "Albanian Renewable Energy Association" AREA, i paditur: Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST) sh.a.**

Çështja Administrative me objekt gjykimi: Shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ, Vendim nr.106, datë 02.07.2020 "Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", vetëm për sa i përket aplikueshmërisë së tij ndaj prodhueseve me përparësi, është në fazën e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit.

11. **Procesi gjyqësor me palë paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme "AREA", i paditur Enti Rregullator i Energjisë**

Çështja Gjyqësore në Gjykatën e Lartë me Nr. 01830/16 Akti datë 26.11.202, me objekt gjykimi: Deklarimin e pavlefshmërisë së vendimit të ERE-s, nr. 156. datë 24.12.2015 "Mbi lënien në fuqi të

vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147. nr.148 datë 26.12.2014 si dhe vendimit nr. 27, datë 16.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE për periudhën 1 janar - 30 qershor 2016. Detyrimin e palës së paditur për të nxjerrë një akt të ri që do të rregullojë pasojat e pavlefshmërisë së vendimit nr.156, datë 24.12.2015, etj, është në fazën e shqyrtimit në Gjykatën e lartë.

12. Procesi gjyqësor me palë paditëse: Z.S.G dhe i paditur: Enti Rregullator i Energjisë (ERE)

Çështja administrative me nr. Nr. Akti 2758, datë 04.06.2021, me objekt gjykimi: 1. Shfuqizimin si akt i paligjshëm i vendimit Nr.1, datë 23.04.2021, i Komisionit Disiplinor të ERE-s., 2. Detyrimin e palës së paditur për të rikthyer paditësin Servet Gaba, në pozicionin e mëparshëm që kishte para lirimit, 3. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit Nr.1, datë 23.04.2021, i Komisionit Disiplinor pranë ERE-s dhe urdhrit nr. 36, datë 30.04.2021... 4. Në rast se nuk pranohet kërkesa për sigurimin e padisë, kërkojmë që vendimi të jepet me ekzekutim të përkohshëm, 5. Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore duke përfshirë pagesën e avokatit, palës së paditur. Kjo çështje gjyqësore ka përfunduar në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë ndërkohë është Apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe ende nuk ka njoftim nga Gjykata për datën e zhvillimit të procesit gjyqësor.

13. Procesi gjyqësor me palë paditës K. I, i paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Drejtoria Rajonale Gjirokastër, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE GROUP) dhe palë e tretë Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Gjirokastër

Çështja Gjyqësore me objekt gjykimi: 1. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur Pezullimin e Titullit Ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje të Energjisë Elektrike për periudhën: Maj 2011, Qershor - Dhjetor 2014, lëshuar për Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike me Nr.GJOBO20134045339. 2. Pavlefshmëri të Titullit Ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje të Energjisë Elektrike për periudhën: Maj 2011.3 lëshuar për Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike me Nr.GJOBO20134045339. Pavlefshmëri të Titullit Ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje të Energjisë Elektrike për periudhën: Qershor-Dhjetor 2014, lëshuar për Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike me Nr.GJOBO20134045339. Kjo çështje është akoma në fazën përgatitore të saj dhe jemi në pritje të njoftimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me Fletë Thirrje në rrugë zyrtare.

14. Procesi gjyqësor me palë paditëse D.P, të paditur shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal, Enti Rregullator i Energjisë

Çështja Gjyqësore me objekt gjykimi: 1. Deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, faturave të energjisë elektrike, sipas faturimeve të bëra për periudhën Shkurt 2007 – Maj 2016, për kontratën e furnizimit me energji elektrike me nr. TR2P060048069338, në emër të paditësit. 2. Pavlefshmëria e kamatëvonesave për këto periudha faturimi, dhe çdo detyrim që rrjedh nga këto faturime, në emër të paditësit. Kjo çështje është akoma në fazën përgatitore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

15. Procesi gjyqësor me palë paditëse shoqëria "K-Aks" sh.p.k, dhe i paditur Enti Rregullator i Energjisë

Çështja Administrative me nr. 2758, datë 04.06.2021 me objekt gjykimi: Detyrimi i palës së paditur ERE të vërë në dispozicion të palës paditëse shoqërisë "K-Aks" sh.p.k., dokumentacionin që ka lidhje me lidhjen e energjisë elektrike nga ana e Drejtorisë Rajonale të OSHEE-së Durrës në linjën e ndërtuar nga vetë pala paditëse të shoqërive "Shega Trans" sh.p.k., "Bertino" sh.p.k. dhe objektit pulari është ende në fazën përgatitore në gjykim pranë Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë.

ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proceset gjyqësore në kuadër të zbatimit të kompetencave ligjore.

1. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse A.M, i paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë**

Çështja Administrative me nr. Akti 3109 me objekt gjykimi: Pavlefshmëri fature tatimore. Kjo çështje është shqyrtuar fillimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatë e cila ka shpallur moskompetencën. Kjo çështje është në fazën përgatitore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. **Procesi gjyqësor me palë paditëse A.R, i paditur OSHEE sh.a., dhe FSHU sh.a., dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë**

Çështja civile me Nr. Regj. Them. 13412 viti 2020, me objekt gjykimi: Pavlefshmëri e pjesshme e titujve ekzekutiv "Faturë Tatimore Shitje e energjisë elektrike" ka kaluar në seancë gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. **Procesi gjyqësor me palë paditëse shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., palë të paditura: 1. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman; 2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) Tiranë dhe palë të tretë Enti Rregullator i Energjisë (në këtë proces gjyqësor ERE ka kërkuar të bëhet pjesë si ndërhyrës dytësor).**

Çështja me nr. Akti 1101, është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, **me objekt gjykimi:** 1. Shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar deri në këtë moment në shumën prej 25 000 Eurosh, dhe dëmit që do të krijohet deri në marrjen e formës së prerë të Vendimit që zgjidh në themel çështjen. 2. Detyrimi i Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin Seman - Fier, të nxjerrë Aktin Administrativ "Konfirmim me shkrim për miratim në heshtje të "Miratimit përfundimtar të prurjes së ujit, të projektit të përmirësuar të HEC "NICE" për fuqinë e instaluar 2.27 MW". 3. Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke i vendosur palët në gjendjen para zgjidhjes së konfliktit. 4. Pezullimin e zbatimit të aktit procesverbal "Çmontim sistemi matje" datë 17.07.2020 ora 16:50 të dalë në zbatim të Urdhrit Nr.4057/2, datë 16.07.2020 të OSSH sh.a., duke e detyruar OSSH sh.a., të rilidhë impiantin HEC "NICE" me rrjetin shtetëror shpërndarës të Energjisë Elektrike, 35 KV Lozhan dhe montimin e matësit.

Kjo çështje ka mbetur në fazën e shqyrtimit në seancë përgatitore dhe momentalisht është në pritje të caktimit të gjyqtarit pas shkarkimit të gjyqtarit pararendës nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

ERE në këtë proces gjyqësor është përfshirë në cilësinë e ndërhyrësit dytësor.

4. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse shoqëria "Selishtë" sh.p.k., dhe i paditur "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" (KESH) sha.**

Çështja Gjyqësore me Nr. 890 Akti datë 03.07.2018 me Objekt gjykimi: 1. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmin kontraktor të shkaktuar nga vonesat në pagimin e detyrimeve monetare, të cilat përbëhen nga: Dëmi kontraktor në formën e penaliteteve për shkak të likuidimit të vonuar të detyrimeve të palës paditëse ndaj palëve të treta (bankave) në vlerën e *12.460.571* Lekë. 2.Shpalljen e pavlefshmërisë dhe anullimin e Nenit 4 të Marrëveshjes *(Për rakordimin dhe njohjen e Kamatëvonesave)* të datës 23.11.2015 të lidhur ndërmjet shoqërisë Selishtë sh.p.k dhe shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a. Gjykimi i kësaj çështje ka përfunduar në shkallën e parë me Vendimin Nr. 3055 datë 28.07.2020 dhe Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë Padisë. Kjo çështje është Apeluar nga Shoqëria Selishtë Sh.p.k dhe jemi në pritje nga Gjykata e Apelit Civil për përcaktimin e datës së procesit gjyqësor.

5. **Procesi Gjyqësor me palë paditës shoqëria "OSHEE" sh.a., i paditur shoqëria "OST" sh.a., dhe person i tretë: Enti Rregullator i Energjisë dhe shoqëria Ionian Refining & Trading Company (IRTC).**

Çështja Gjyqësore me objekt gjykimi: Shpërblim dëmi, është paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

6. **Procesi gjyqësor me palë paditëse A.R., të paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja gjyqësore me Objekt gjykimi: 1. Detyrimin e të paditurit, t'i japë paditësit informacion. 2. Dëmshpërblim për dëmin jo pasuror. 3. Dhënien e Vendimit me ekzekutim të përkohshëm është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Në këtë proces gjyqësor është ndryshuar trupa gjykuese dhe ERE është në pritje për vazhdimësinë e procesit gjyqësor nga Gjykata.

7. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse Shoqëria "Bell" sh.p.k., të paditur Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a) dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja Gjyqësore me Nr. Regj. Themeltar 13206/2020, me objekt gjykimi: Shpërblim dëmi, është paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është në fazën e vazhdimit të gjykimit dhe administrimit të provave.

8. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse S. L, i paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a, palë e interesuar Enti Rregullator të Energjisë.**

Çështja gjyqësore Nr. nr.2861 Akti me objekt gjykimi: Lëshim dublikate të urdhrit të ekzekutimit është e përfunduar në Gjykatën e Apelit Civil Tiranë duke pranuar Kërkesën dhe lëshuar duplikatin përkatës.

9. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse Shoqëria "MTC ENERGY" sh.p.k., të paditur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) sh.a., person i tretë ALBSIG sh.a., Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja gjyqësore Nr.21234-01666-41-2019, me objekt gjykimi: 1. Shpërblim dëmi jokontraktor, 2. Shpërblimi i dëmit kontraktor ka përfunduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, dhe ndërkohë është ushtruar Ankimim dhe jemi në pritje të shortit nga Gjykata e Apelit Korçë.

10. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse Z.A.N, i paditur Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja Gjyqësore me Nr. Regj. Themeltar 8774 datë 07.04.2021 dhe objekt gjykimi: Anulimin e Faturave Tatimore për muajin Janar 2007 –Tetor 2020, për numër Kontrate DU0A020319029681, me numër matësi 18813831, Kabina 6 , me Kontraktues Z.A.N është paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe aktualisht është në fazën përgatitore.

11. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse Z.K.Sh, i paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a, Drejtoria Rajonale Durrës dhe person i tretë: Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja Gjyqësore me Nr. Regj. Themeltar 1677, datë 06.04.2021 me objekt gjykimi: Pavlefshmëri e titullit Ekzekutiv, fatura e energjisë elektrike për muajin Shtator 2012 & Dhjetor 2012, Detyrimin e palës së Paditur të kthejë shumën prej 1.587,356.63 lekë të paguar nga paditësi për detyrimin që rrjedh nga mbi faturimet e bëra në muajt Shtator 2012 & Dhjetor 2012 si detyrim të pa detyruar, është paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe aktualisht është në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

12. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse Z.A.D, i paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Drejtoria Rajonale Durrës dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja Gjyqësore me Nr.1565 Akti, datë 04.02.2022, do të zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka Objekt gjykimi: 1. Detyrimin e palës së paditur për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga djegia e pasurisë së paluajtshme me Nr.14/160 , ZK 8511, Vol 51, ndodhur në lagjen

Nr.17 Durrës, në vlerën 3.000.000 (tre milion) lekë. 2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të palës paditëse kamatëvonesat nga momenti i lindjes së detyrimit deri në ekzekutimin e plotë të vendimit. 3. Shpenzimet gjyqësore, avokatore dhe të ekspertimeve në ngarkim të palës së paditur. Kjo çështje është akoma në fazën përgatitore të saj dhe jemi në pritje të njoftimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Fletë Thirrje në rrugë zyrtare.

13. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse shoqëria "Vëllezërit Kasmi" sh.p.k, i paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dhe person i tretë Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja gjyqësore me Nr. Akti 8938, datë 03.02.2022 do të zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka objekt gjykimi: 1. Sigurimin e padisë me marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të ekzekutimit të faturës së shitjes të energjisë elektrike nr. 417405172 Gusht 2021, **2**. Deklarimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv faturë shitje e energjisë elektrike me nr. 417405172 Gusht 2021 në vlerën prej 2,468,889.60 Lekë, **3**. Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzime gjyqësore.

Kjo çështje është akoma në fazën përgatitore të saj dhe jemi në pritje të njoftimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me Fletë Thirrje në rrugë zyrtare.

14. **Procesi gjyqësor me palë paditëse Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a, i paditur: Komisioneri i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe palë e tretë Enti Rregullator i Energjisë.**

Çështja gjyqësore me **objekt gjykimi:** shfuqizimin e Aktit Administrativ, të vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e zbatimit të vendimit, ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 14.12.2021.

<u>ERE në Cilësinë e Palës Paditëse në proceset gjyqësore</u>

1. **Procesi Gjyqësor me palë paditëse Enti Rregullator i Energjisë, i paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe person i tretë OSHEE sh.a., Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.**

Çështja administrative me Nr. 31159-01771- 80 Akti. Objekt: Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimeve të Komisonerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Nr. 33 datë 07.04.2020 dhe Nr. 34 datë 07.04.2020. Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë – Padisë. ERE ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Për shkak të situatës kaotike në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuara nga pandemia Covid-19, nga kjo Gjykatë nuk ka ende njoftim për shortin apo caktimin e datës së procesit.

Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE

Gjatë vitit 2021 për shkak të situatës kaotike në të gjithë sektorët publik dhe privatë si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuara nga pandemia Covid-19 seancat dëgjimore të organizuara nga ERE janë zhvilluar online për arsye sigurie, në bazë dhe të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19" dhe Urdhrit të Kryetarit të ERE nr. 53, datë 11.03.2020 "Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore", i ndryshuar. Seancat e zhvilluara gjatë vitit 2021 në total kanë qenë 32 (tridhjetë e dy) dhe janë zhvilluar në kuadër të diskutimeve me palët e interesuara lidhur me rishikimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 dhe atij nr. 102/2015 si dhe për ankesat/mosmarrëveshjet e konsumatorëve apo të licencuarve pranë ERE. Në çdo rast këto seanca janë ndjekur nga përfaqësues të ndryshëm të Drejtorive Teknike të ERE.

9. AKTIVITETI I ERE NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJES SË STANDARTEVE

ERE në zbatim të Ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ushtron aktivitetin e saj në drejtim të marrjes së masave sa më efektive për mbrojtjen e klientëve të energjisë elektrike.

Një pjesë e rëndësishme e punës së strukurës së ERE për zgjidhjen e ankesave të klientëve të energjisë ndaj të licencuarve, lidhet me trajtimin e ankesave të regjistruara në ERE për zgjidhje, apo orientim të ankesave dhe konflikteve direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klientëve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klienteve në aspektin individual dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

ERE mban statistika për numrin dhe natyrën e ankesave të konsumatorëve. Ankesat në ERE, adresohen nëpërmjet një sërë kanalesh, të krijuara për të rritur mundësitë për konsumatorët që të reklamojnë shkeljet e kushteve të furnizimit. Këto kanale përfshijnë paraqitjen fizikisht në zyrat e ERE, parashtrimin e një ankese me shkresë, ose edhe me email.

ERE merr përsipër zgjidhjen e një ankese, pasi konstaton se çështja që paraqitet për shqyrtim përfshin një shoqëri të licencuar, e më pas ERE e adreson ankesën tek i licencuari për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm që i shërben zgjidhjes së ankesës. ERE këshillon konsumatorët të ofrojnë dokumentacion që lidhet me natyrën e ankesës së paraqitur.

Një pjesë jo e vogël e ankesave që paraqiten në ERE, kanë si shkak kryesor mungesën e informacionit në lidhje me detyrimet e konsumatorëve ndaj shoqërive të licencuara por edhe për rolin e ERE-s. Për të shmangur sa më sipër, gjatë vitit 2021, ERE ka bërë një punë të konsiderueshme për të informuar konsumatorin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ndaj operatorëve të licencuar por edhe të drejtat e tyre në raport me ERE, me qëllim shmangien e konflikteve mes palëve.

Objekti i ankesave të paraqitura në ERE për vitin 2021, ka konsistuar kryesisht në shkeljen e kushteve të përgjithshme të "Kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientet fundorë", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018 në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve në kontratë. ERE në referencë të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore, si: "Kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë", "Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s, "Rregulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit", ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke kërkuar nga shoqëritë e licencuara informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm apo edhe me udhëzimet përkatëse për zgjidhje. Gjatë vitit 2021 nuk është rregjistruar asnjë ankesë me objekt zgjidhjen e një mosmarrëveshje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

9.1 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2021

Në ERE përgjatë vitit 2021 janë rregjistruar 209 ankesa/kërkesa të klientëve të Energjisë elektrike. Një pjesë e tyre janë rregjistruar të përsëritura, pasi ka rezultuar se nga ana e të licencuarit ndaj të cilit është adresuar ankesa, nuk është trajtuar në afat apo klienti ka qënë i pakënaqur me përgjigjen e tij që në më të shumtën e rasteve lidhet me mungesën e dokumentacionit nga ana e vetë konsumatorit por edhe të licencuarit. Janë një numër i konsiderueshëm ankesash që lidhen me kontrata mbi 10-15 vjeçare të cilat për shkak të praktikës së ndjekur në kohën e nënshkrimit të tyre (me KESH sha, CEZ sha apo OSHEE sha) përmbajnë të dhëna jo të plota të identitetit të konsumatorit apo mungojnë edhe

fizikisht dokumentat kontraktuale apo të krijuara prej kësaj marrëdhënie. Në ERE janë regjistruar 209 ankesa/kërkesa, por për 54 prej tyre, ERE, pasi ka konstatuar se informacioni apo dokumentacioni i përcjellë nga konsumatori, nuk ka qenë i plotë për shqyrtimin e ankesës nga ERE, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit apo saktësimin e objektit të ankesës nga konsumatori. Janë gjithashtu të shumta rastet kur konsumatorët adresohen menjëherë në ERE për zgjidhje të ankesës pa adresuar më parë ankesë për zgjidhje pranë Furnizuesit si parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi, apo dhe rrethana të tjera kur Konsumatori adreson një ankesë në ERE pa përfunduar afatet ligjore brenda të cilave furnziuesi ka detyrimin të trajtojë ankesën. Gjithashtu në shumë raste, konsumatori është adresuar me kërkesë për zgjidhje në ERE pasi kanë përfunduar të gjitha afatet ligjore për goditjen e një fature, e shqyrtimin e përputhshmërisë së saj me kuadrin ligjor në fuqi, qoftë në raport me afatet e parashikuara për furnizuesin ashtu edhe për ato të parashikuara për ERE-n.

Në total, janë 155 ankesa për të cilat ERE ka vijuar procedurën e shqyrtimit të ankesës, hapi i parë i së cilës është adresimi i kërkesës për informacion ose qëndrim nga i licencuari, ndaj të cilit është ushtruar ankim.



Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat me objekt "energji e pamatur/dëm ekonomik" dhe ankesat me objekt "mbifaturim të energjisë elektrike" zënë vendin kryesor në totalin e ankesave të rregjistruara në ERE. Nga analizimi i grafikut në krah, evidentohet sipas objektit të ankesës, pesha specifike që zënë sipas secilës kategori ankesat që janë adresuar nëpërmjet ERE, për vitin 2021 krahasuar me të njëjtat kategori të dhënash të rregjistruara për vitin 2020.

Ndërkohë që evidentohet një rritje e numrit të ankesave për energji të pamatur/dëm ekonomik dhe mbifaturim për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, shihet gjithashtu se numri i ankesave për matje jashtë kushtit teknik, keqtarifim, apo lidhje të reja, ka një rënie të dukshme.

Krahasuar me vitin 2020, një vit i prekur ndjeshëm nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid, ç'ka çoi konsumatorin drejt një izolimi e kujdesi të shtuar për ndërveprim e kontakt fizik, gjatë vitit 2021 ka patur një rritje të lehtë, nga 165 ankesa/kërkesa totale të rregjistruara për vitin 2020 në 209 ankesa/kërkesa për vitin 2021 , të adresuara drejtëpërdrejtë në ERE. Sa më sipër, besojmë se është gjithashtu një tregues i rritjes së ndërgjegjësimit të konsumatorit për adresimin e ankesave edhe në rrugë institucionale nëpërmjet ERE, edhe falë fushatave sensibilizuese që ERE ka ndërmarrë për këtë qëllim.

9.1.1 Ankesa sipas rrugëve të ndryshme të komunikimit

Rezulton se gjatë vitit 2021 ka patur një rritje të numrit të ankesave të adresuara nëpërmejt emailit si një praktikë relativisht e re punë për ERE-n, në kushtet e masave antiCovid, krahasuar me ankesat e rregjistruara fizikisht në Selinë e ERE. Rezulton në fakt se gjatë këtij viti, gjysma e ankesave/kërkesave të adresuara në ERE, rreth 100, janë adresuar nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit.

9.1.2 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.

Nga konstatimi i të dhënave statistikore të ERE-s, vërehet se një pjesë të madhe të ankesave e zënë ankesat me objekt "mbifaturim i energjisë elektrike", të cilat zënë një total prej 45 ankesash, ose rreth 29% e totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Ankesat në lidhje me mbifaturimin e energjisë

elektrike janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mos rakordimi i gjëndjes së hedhur në sistem me gjëndjen reale të matësit, gabime njerëzore nga ana e faturuesëve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem, etj.

ERE ka kërkuar nga shoqëria "FSHU" sh.a., dhe ajo OSSH sha përgjegjëse për të dhënat e matjes, verifikimin e procedurave të ndjekura lidhur me faturimet e kryera së bashku me rekomandimet për korrigjimet përkatëse, kur është konstatuar që duhen realizuar, në zbatim të afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për këtë qëllim. Nga këto 45 ankesa për "mbifaturim" të energjisë elektrike ERE ka vijuar procedurën e shqyrtimit të ankesës, hapi i parë i secilës është adresimi i kërkesës për informacion ose qëndrim nga i licencuari, ndaj të cilit është ushtruar ankim. Rezulton se nga ana e të licencuarve janë marrë masa për trajtimin e 37 nga 45 ankesat e adresuara nga ERE. Rezulton se vetëm për 10 prej tyre, FSHU sha pas verifikimeve ka konkluduar se ka patur gabime në rregjistrimin e të dhënave apo faturimin e klientit dhe për rrjedhojë ka bërë saktësimet e nevojshme në faturimin e muajit vijues, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi. Referuar këtyre të dhënave, sipas numrit të ankesave të adresuara për këtë objekt ankese, marzhi i gabimit në faturim të FSHU qëndron në masën rreth 22% të faturimeve të ankimuara.

9.1.3 Ankesat për Energji e pamatur /Dëm Ekonomik.

ERE ka trajtuar 45 ankesa me objekt "energji e pamatur/dëm ekonomik energjisë elektrike'' ose rreth 29%. Në lidhje me këtë kategori, konstatojmë se në më të shumtën bëhet fjalë për ankesa të dëmit ekonomik të faturuara në vitet 2011-1015 e vetëm një numër i vogël i tyre janë për faturime të konstatimit të dëmit ekonomik të vitit 2020 apo 2021, por që pas ndarjes së OSHEE sha në FSHU sha dhe OSSH sh.a., kjo e fundit ka filluar të mbledhë në mënyrë më konsistente debitë e vjetra. Nga ana tjetër, ky proces vështirësohet jo vetëm për OSSH sha por edhe për klientin dhe ERE-n në zgjidhjen e këtyre ankesave për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar që nga momenti i konstatimit të dëmit ekonomik, dhe mungesës së dokumentacionit që lidhet me praktikën e konstatimit të dëmit ekonomik.

Nga raportimet e FSHUsh.a./OSSH sha rezulton se klienti ka marrë përgjigje apo zgjidhje 37 prej 45 ankesave të adresuara nga ERE për këtë kategori.

9.1.4 Ankesat për faturim aforfe

Gjatë vitit 2021 konstatohet se në ERE janë paraqitur 5 ankesa me objekt "faturim afrofe", ose rreth 3.2% e ankesave lidhur me "faturim afrofe" të energjisë elektrike. Kryesisht bëhet fjalë për faturime aforfe të lëshuara gjatë viteve 2007-2014 për të cilat klientët ose kanë ushtruar ankim pranë furnizuesit e nuk kanë marrë zgjidhje apo përgjigje ose nuk kanë ushtruar ankim asnjëherë e paraqiten në ERE në tejkalim të afateve ligjore për të goditur një faturë. Nga raportimet e FSHU sh.a., rezulton se kanë marrë trajtim apo zgjidhje të gjitha.

9.1.5 Faturimi i energjisë elektrike për matje jashtë kushteve teknike

Përgjatë vitit 2021 është evidentuar një numër i vogel i ankesave me objekt "matje jashtë kushteve teknike", ku konstatohen 2 ankesa ose 1.3% e totalit të ankesave të adresuara nëpërmjet ERE. Ky faturim është bërë në rastet e evidentimit të matësave të energjisë elektrike, jashtë klasës së saktësisë në matje ose për shkak të dëmtimit të tyre. Rezulton se në të tilla raste, referuar të dhënave të konstatuara nga ana e OSSH sh.a., është bërë korrigjimi i faturimit bazuar në metodologjinë e vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritëshme. Rezulton se nga ana e shoqërisë FSHU sh.a. janë marrë masa për trajtimin e tyre, duke dokumentuar në ERE përputhshmërinë me ligjin të hapave të ndërmarrë për zgjidhjen e ankesës.

9.1.6 Ankesat për keqtarifim

Përgjatë vitit 2021, është rregjistruar 1 ankesë për keqtarifim ose rreth 0.65% e totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Kryesisht bëhet fjalë për keqtarifim gjatë viteve 2011-2018.

9.1.7 Ankesa të ndryshme

Në grupin e ankesave të klasifikuara "të ndryshme" janë futur ankesat me objekt: faturim fiktiv, ndërprerje e energjisë elektrike, kërkesë informacioni, dëmshpërblim, kryqëzim matësi, kërkesë për kthim përgjigje nga FSHU sh.a etj, apo vijim komunikimi me FSHU sh.a nëpërmjet ERE. Në grupin e ankesave të ndryshme konstatohen rreth 57 ankesa të cilat zënë 36.77% të totalit të ankesave të regjistruara në ERE, e rezulton se përgjithësisht kjo kategori ankesash gjenerohet për shkak të vonesave nga ana e FSHU sh.a në trajtimin e kërkesave të adresuara kryesisht në FSHU sh.a,(apo ish OSHEE sha/CEZ sha) apo mungesës së informacionit nga ana e klientëve të energjisë elektrike, por në disa raste edhe adresimi paralelisht të zgjidhjes së tyre gjyqësisht ç'ka pezullon procedurën e shqyrtimit administrativ në ERE të këtyre ankesave.

Puna e ERE në kuadër të mbikëqyrjes së trajtimit të drejtë e në zbatim të afateve dhe procedurave të miratuara nga ERE, të ankesave që konsuamtoret adresojnë drejtëpërdrejtë tek të licencuarit, gjatë vitit 2021 është shtrirë edhe në monitorimin e vazhdueshëm e kërkimin e informacionit të nevojshëm perdiodik në lidhje me këto ankesa pranë të licencuarve.

Figura 111 Ankesat e regjistruara dhe te Zgjidhura

Për sa i përket ankesave të regjistruara në FSHU nga të gjitha burimet, qoftë drejtëpërdrejtë në qëndrat e kujdesit të klientit, nga ERE, platforma e-albania, apo nëpërmjet institucioneve të tjera, ERE ka kërkuar informacion në FSHU në lidhje jo vetëm me numrin total të këtyre ankesave të regjistruara por edhe numrin e ankesave të trajtuara në afat.

Nga të dhënat e mbledhura, gjatë vitit 2021 rezultoi se, totali i ankesave të paraqitura në FSHU nga të gjitha burimet ishte 141,809, nga të cilat 128,361 prej tyre kishin marrë zgjidhje, duke rezultuar niveli i zgjidhshmërisë së ankesave totale në masën 90.5%.

9.2 Dhënia zë e konsumatorit

Gjatë vitit 2021, struktura e ERE përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit dhe zgjidhjen e ankesave ka zhvilluar 25 seanca dëgjimore të cilat kanë synuar të marrin qëndrimin e palëve në një mosmarrëveshje me qëllim zgjidhjen përfundimtare apo adresimin e zgjidhjes së ankesës kryesisht nga i licencuari duke i dhënë rekomandime këtyre të fundit. Gjithashtu nëpërmjet seancave dëgjimore ERE është investuar me qëllim përfshirjen e përfaqësuesve të konsumatorit në cilësinë e palës së interesit me qëllim dhënien zë këtyre të fundit në hartimin e politikave rregullatore që adresojnë çështje të konsumatorit siç janë rregulloret e miratuara në zbatim të ligjit në fuqi.

Viti 2021, falë edhe rrethanave të veçanta në të cilat u vendos mbarë bota për shkak të pandemisë, bëri që ERE të fokusohet me shumë drejt metodave alternative të komunikimit me konsumatorin nëpërmjet mjeteve të komunikimit online.

Kështu për këtë qëllim, janë përgatitur broshura informative të cilat adresojnë çështjet me ndjeshmëri më të lartë për konsumatorin, si kushtet e lidhjes, pezullimit apo ndërprerjes së një kontrate furnizimi, e drejta për të zgjedhur apo ndryshuar furnizuesin, kushtet për sigurimin e një lidhje me rrjetin e shpërndarjes, standardet e cilësisë së shërbimit, e drejta për t'u ankuar etj.

Broshurat e sipërcituara gjenden të publikuara në ambjentet e ERE por edhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të ERE, me qëllim arritjen në një numër sa më të madh konsumatorësh të informacionit të nevojshëm.

Disa nga pyetjet më të shpejta që gjejnë përgjigje sintetike, janë paraqitur më poshtë.

1. Çfarë të drejtash kanë konsumatorët?
2. Çfarë kushtesh duhet të plotësojnë për të lidhur një kontrate energjie?
3. Si duhet të bëjnë një lidhje me rrjetin e shpërndarjes?
4. Si të lidhen me rrjetin e shpërndarjes për tensionin e ulët ?
5. Cilat janë tarifat në tensionin e ulët?
6. Si mund të lidhin një kontratë të energjisë elektrike?
7. Si të bëni një lidhje në tensionin 21 -50 kW?
8. Cilat janë tarifat e lidhjes në tensionin 21 – 50 kW?
9. Cfarë procedurash duhen ndjekur për ndryshimin e furnizuesit?
10. Çfarë duhet të përmbajë fatura e energjisë elektrike?
11. Si të bëni një lidhje me rrjetin e shpërndarjes 50-100 kwh në tension të ulët?
12. Ku ndryshon ndërpreja e furnizimit nga furnizuesi dhe rilidhja?
13. Çfarë duhet të bëni për të qënë vetëprodhues?
14. Si të beni një lidhje me rrjetin e shpërndarjes në tension të mesëm?
15. Çfarë është matësi inteligjent dhe si funksionon ai?
16. Në cilat raste bëhet përfundimi i kontratës me kërkesë të klientit?
17. Kur ndërpritet energjia elektrike?
18. Kur dhe si duhet të paguani faturën e energjisë elektrike?
19. Çfarë rregullon kontrata e furnizimit?
20. Cilat janë metodat e pagesës së energjisë elektrike?
21. Cilat janë tarifat për lidhje me rrjetin për konsumatorë jo familjarë në tension të mesëm?



Gjatë vitit 2021, ERE është angazhuar në realizimin e një rubrike të dedikuar mbrojtjes së konsumatorit publikuar në faqen e ERE https://ere.gov.al/sq/ nën zërin Shërbime Konsumatori. Rubrika jep një informacion të detajuar për konsumatorin dhe vendos në dispozicion të tij legjislacionin në fuqi dhe mekanizmat e ankesës që konsumatori disponon. Për të marrë një vlerësim më të mirë të punës që kryen apo mund të përmirësojë në shërbimet e saj, ERE ka organizuar dhe një anketë mbi nivelin e kënaqësisë së konsumatorit. Konsumatorët e kanë plotësuar anketën, nëpërmjet së cilës kanë shprehur kënaqësitë dhe opinionet e tyre në lidhje me shërbimet e marra apo që duan të marrin. Disa nga pyetjet e anketës lidhen me shërbimet e marra në ERE dhe sa i plotë ka qënë informacioni i marrë në faqen zyrtare të ERE. Disa nga pyetjet e anketës janë: Si keni mësuar rreth ERE? Rreth 40% e konsumatorëve që e kanë plotësuar janë përgjigjur nëpërmjet miqëve; Sa i kënaqur jeni me shërbimin që keni marrë në ERE? Mbi 58% janë përgjigjur të kënaqur, 32% janë përgjigjur shumë të kënaqur dhe vetëm 6.5% janë shprehur të pakënaqur; Sa i efektshëm është informacioni që merrni nëpërmjet faqes së ERE? Këtu konsumatorët janë përgjigjur më të qartë dhe shumë të qartë. Pyetja e rradhës ngre diskutim si duhet tè jetë Informacioni për konsumatorin në web- faqen e ERE?

Një pjesë e madhe e tyre, 67% janë përgjigjur sic është, pa ndryshime. Më tej konsumatorët u pyetën për platformën e marrjes më shumë informacion mbi të drejtat e tyre, ku shumica i është përgjigjur nëpërmjet rrjeteve sociale dhe llojin e informacionit që dëshirojnë të marrin nëpërmjet ERE. Masa i është përgjigjur me Mbi të drejtat e tyre për cilesinë e shërbimit. 45% e konsumatoreve mendojnë se legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit është i plotë, ndërsa 32% mendojnë se është i plotë por nuk aplikohet. Së fundi, rreth 61% e totalit që kanë plotësuar anketën mendojnë se ankesën për furnizuesin e energjisë elektrike duhet ta adresojnë në ERE, para FSHU sh.a.



9.3 Mbikëqyrja e shërbimit konsumator të furnizuesve në treg të lirë.

ERE ka zhvilluar korrespondencë periodike me 26 shoqëritë e licensuara në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, dhe 2 në aktivitetin e furnizimit me gaz natyror, duke ju kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e zbatimit të detyrimeve të parashikuara në rregulloren e "Standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit", përfshirë edhe miratimin e procedurave të brendëshme për trajtimin e ankesave, të konsumatorëve.

Rezulton se një pjesë e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit nuk kanë ushtruar aktivitetin e furnzimit me energji elektrike për klientë fundorë e për këtë shkak nuk kanë ndërmarrë ende asnjë veprim në lidhje me përmbushjen e parashikimeve të mësipërme.

Sipas informacionit të disponuar rezulton se vetëm 10 prej të licencuarve në aktivitetin e furnizmit, kanë ushtruar veprimtarinë e furnizimit të konsumatorëve në treg të lirë gjatë vitit 2021.

Nga të licencuarit në furnizim 7 prej tyre janë shoqëri që kanë ushtruar aktivitet gjatë vitit 2020-2021 të cilët kanë bërë me dije që nuk kanë patur asnjë ankesë të depozituar nga konsumatorët në lidhje me aktivitetet e ushtruara nga këto shoqëri. Gjithashtu në ERE nuk rezulton të jetë rregjistruar asnjë ankesë nga konsumatorë të furnizuar në treg të lirë gjatë vitit 2021.
Që nga viti 2020 e deri më sot regjistrohen një numër relativisht i vogël (rreth 400) kontrata të lidhura mes furnizuesve në treg të lirë dhe klientëve fundorë, me qëllim sigurimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike në treg të parregulluar, e përgjithësisht me kontrata që përfshijnë periudha të shkurtëra 1, 2 deri 6 mujore.

9.4 Konsumatorët/Vetëprodhues

Kalimi në një të ardhme me karbon të ulët, të mbështetur në burimet e rinovueshme të energjisë, po i kthen konsumatorët pasivë të energjisë në qytetarë aktivë që prodhojnë energji, sic njohur ndryshe Vetëprodhuesit. Marrja e këtij roli të ri nga ana e konsumatorit është një mundësi jo vetëm për një sistem energjie më të qëndrueshëm dhe me pak karbon/neto zero, por edhe për një sistem më demokratik dhe gjithëpërfshirës, e mbi të gjitha me kosto më të ulëta për konsumatorët. Pas iniciativave të Qeverisë Shqipëtare për të incentivuar këtë kategori prodhuesi/konsumator nëpërmjet procedurave lehtësuese për të garantuar lidhjen me rrjetin në cilësinë e prodhuesit e jo vetëm konsumatorit të Energjisë, interesi në vend në lidhje me këtë praktikë është rritur.

Nga ana e ERE është punuar për mbledhjen e të dhënave të nevojshme në lidhje me integrimin e kësaj kategorie prodhuesish në tregun e energjisë elektrike. ERE me qëllim analizimin e të dhënave që lidhen me interesin apo edhe impaktin që kjo kategori prodhuesish të energjisë elektrike kanë në Shqipëri, ka kërkuar informacion periodik nga OSSH sh.a. në lidhje me numrin e klientëve të cilët kanë aplikuar për lidhje të re në cilësinë e vetëprodhuesit të energjisë elektrike të cilët mund të instalojnë një kapacitet total deri në 500 kWp nga dielli, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 7/2017 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*, numrin e klientëve aplikues që e kanë këtë status aktualisht, si dhe sasinë mesatare dhe atë totale të energjisë të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish.

Gjatë vitit 2021 ka patur rreth 206 aplikime për ushtrimin e aktivitetit të vetëprodhuesit nga ana e konsumatorëve fundorë dhe 113 prej tyre u është miratuar aplikimi për ushtrimin e këtij aktiviteti dhe lidhjen me rrjetin nga ana e OSSH sh.a.

Aktualisht Durrësi Tirana dhe Elbasani rrezultojnë se janë zonat në të cilat ka patur më shumë njësi fotovoltaike për vetëprodhuesit të instaluara, lidhur kjo edhe me potencialin më të madh të këtyre zonave për të grantuar rendiment të njësive prodhuese fotovoltaike për shkak të numrit të ditëve me diell, të domosdoshme për këtë lloj teknologjie.



Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se në total gjatë vitit 2021, *Vetëprodhuesit kanë prodhuar nje sasi prej rreth 2,674,615 KW gjatë 8 mujorit të parë të 2021. Energjia që është furnizuar nga FSHU për këta vetëprodhues, për të njëjtën periudhë është në masën 7,738,233 KW.*

Sic shihet raporti i energjisë së prodhuar nga vetëprodhuesit është rreth 1/4 e totalit të energjisë që kanë marrë nga rrjeti për qëllime të furnizimit me energji elektrike.

9.5 Legjislacioni sekondar për konsumatorin

Gjatë vitit 2021 janë miratuar gjithashtu një sërë aktesh që synojnë të rregullojnë posaçërisht spektrin e të drejtave dhe detyrimeve të klientëve të energjisë elektrike, si më poshtë

1. Vendim nr. 24, datë 25.01.2021 "Mbi kërkesën e OSSH Sh.a. lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj covid-19". Ky akt rregulloi modalitetet e faturimit dhe të leximit të energjisë elektrike, me vlera referuese, për një periudhë 6 mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Vendimi nuk rezultoi të këtë prodhuar efekte negative sa i përket rritjes së numrit të ankesave për vlerë referuese apo keqfaturimit.

2. Rregullorja e Standarteve të trajtimit të ankesave të klientit të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licensuarit në aktivitetin e furnizimit miratuar me vendimin 60, datë 25.02.2021. Ky akt synon të sigurojë një proces të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë, nga ana e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike apo gaz natyror, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit me energji dhe të rritet besimi dhe kënaqësia e klientëve për këtë shërbim të ofruar nga të Licencuarit.

3. Me vendimin e bordit nr. 74, datë 12.03.2021 u miratuan Objektivat Strategjikë të ERE-s për vitet 2021-2023.Ky dokument i rëndësishëm vendosi objektiva strategjikë afatgjatë të cilat ERE synon të realizojë në 3 vjeçarin në vijim, me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore sipas kompetencës që Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe Ligji nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, i ka vendosur ERE-s.

4. Me vendimin Nr. 97, Datë 07.04.2021 "Mbi Miratimin e Treguesve për Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2021" Bordi iERE ka miratuar Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes. Kjo rregullore specifikon treguesit dhe kërkesat e operimit dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe perfomancën në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sipas kërkesave të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

5. Me vendimin nr. 217, datë 27.10.2021 Bordi i ERE vendosi "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së bërë nga OSSH sh.a. për disa ndryshime të pikës 2, gërma "a" dhe gërma "b", të vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.06.2016, të Bordit të ERE, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013". Në muajt e parë të vitit 2022, ERE miratoi këtë kërkesë të OSSH sh.a., duke rregulluar kësisoj me një vendim të përkohshëm aplikimin e vlerave referuese të propozuara nga OSSH sh.a., të cilat konsistonin kryesisht në ndryshimin e metodologjisë së vlerave referuese. Përgjatë shtrirjes së efekteve të këtij vendimit, deri në 31.12.2022, ndryshe nga metodologjia e miratuar më herët nga ERE që parashikonte se në mungesë të të dhënave të matjes, vlera referuese e aplikueshme ishte e barabartë me mesataren e të njëjtit muaj të 3 viteteve të fundit, ERE pranoi kërkesën e OSSH sha që vlera referuese në mungesë të të dhënave të matjes të aplikohej sipas konsumit të energjisë së të njëjtit muaj të vititi të fundit, për të njëjtin konsumator.

6. Me vendimin nr. 244, datë 02.12.2021, bordi i ERE vendosi, miratimin e Treguesve të Kritereve Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2022. Kjo rregullore specifikon treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe perfomancën në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), sipas Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

7. Në zbatim të Objektivave Strategjike 3 vjeçare të ERE por edhe detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2021, ERE ka miratura gjithashtu edhe "Regulloren mbi masat e të të liçensuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit". Kjo rregullore, e para e këtij lloji, së cilës do t'i nënshtrohen të gjithë furnizuesit e licencuar, përfshirë shoqërinë publike të furnizimit, ka në fokus arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit. Çdo furnizues do të ketë detyrimin të informojë klientët për të drejtat dhe kushtet me të cilat do të furnizohet, mbi çmimet e furnizimit me energji elektrike për periudhën e ofruar apo mbi të drejtën që klientët kanë për të përzgjedhur një furnizues tjetër. Përveç vendosjes së standardeve që furnizuesit duhet të përmbushin për një shërbim cilësor, rregullorja parashikon edhe të drejtën e monitorimit të këtyre treguesve, nga Enti Rregullator i Energjisë.

9.6 Standardet për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike

Me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, të bordit të ERE ka hyrë në fuqi "Rregullorja për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike". Pas kërkesave të përsëritura të OST sh.a. për shtyrje të afatit të përcaktimit të treguesve, për shkaqe të arsyeshme e të vlerësuara edhe nga ERE si të tilla, me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020 Bordi i ERE-s ka miratuar "Treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për, vitin 2021". Nga ana e OST sha, janë përcjellë me korrektësi të dhëna në bazë 3 mujore mbi ecurinë e këtyre treguesve në përputhje me vendimet sipërcituar. Sipas raportimeve të OST dhe verifikimeve të kryera shohim se këto tregues për vitin 2021 gjenden të ëprmirësuar dhe në përputhje me standardet e miratuara nga ERE me vendimin nr. 255/2020.
Tabela më poshtë: *Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit gjatë 4 tremujorëve të 2021, Performanca e Vitit 2021 në vështrim të Standrdeve te miratuara nga ERE për vitin 2021.*

Parametrat e Cilesisë Furnizimit	*Performanca në 3 mujorin e parë 2021*	*Performanca në 3 mujorin e dytë 2021*	*Performanca në 3 mujorin e tretë 2021*	*Performanca në 3 mujorin e katërt 2021*	*Performanca për vitin 2021*	*Standardet e miratuara nga ERE për vitin 2021*
Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT)	15 min	3.7 min	3.04 min	6.26 min	**28.76 min**	**35 min**
Energjia e pa Furnizuar	247 MWh	48.414 MWh	44.128 MWh	93.493 MWh	**433.035 MWh**	**467 MWh**
Cilësia e frekuencës (FQ)	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	**Brenda diapazonit +/- 200mHz**	**Brenda diapazonit +/- 200mHz**
Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Transmetimit	72 orë	72 orë	72 orë	72 orë	**72 orë**	**72 orë**
Koha e Nevojshme për t'ju Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja	30 ditë	47 ditë	30 ditë	22 ditë	**32 ditë**	**60 ditë**
Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)	32 min	14.4 min	4.6 min	19.31 min	**70.31 min**	**104 min**
Cilësia e Tensionit (VQ)	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.
Perqindja e ankesave për cilësinë e tensionit	Nuk ka ankesa	Nuk ka ankesa	Nuk ka ankesa	Nuk ka ankesa	Nuk ka ankesa	0%

Figura 112 Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit

Më poshtë paraqitet në formë grafike analitike Performanca e OST sh.a. për vitin 2021 krahasuar me Standardet e miratuara nga ERE për OST sh.a. për vitin 2021 me vendimin e Bordit nr. 255/2020.



Këto tregues sikurse vërejmë edhe më sipër janë konform Vendimit të ERE nr. 255/2020, e disa prej tyre, rezultojnë të përmirësuar. Vërejmë se parametrat me lart si *Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike është ulur në 28.76 min nga 35* të përcaktuara në vendim, ashtu dhe Energjia e pafurnizuar duket shumë e përmiresuar në vlerat 433 MWh nga 467 MWh të miratuar. Gjithashtu tregues të rendësishëm si SAIDI **(Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve)** ka qëndruar në vlera të ulta 70.3 min nga 104 të miratuara në vendimin e ERE, si dhe Koha e Nevojshme për t'ju Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja është ulur në 32 ditë faktike, apo gjysma e kohës së miratuar nga ERE.

KPI 2020	KPI 2019	KPI 2018	KPI 2017
35 min	**35 min**	**32 min**	**40 min**
463.53 MWh Brenda diapazonit +/- 200mHz	**467.87 MWh** Brenda diapazonit +/- 200mHz	**420.22 MWh** Brenda diapazonit +/- 200mHz	**527,79 MWh** Brenda diapazonit +/- 200mHz
72	**72**	**72**	**72**
60 ditë	**60 ditë**	**60 ditë**	**60 ditë**
71 min	**104 min.**	**83.5 min**	**92 min.**
brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%
nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka

Nga ana e OST është përcjellë raporti i cili është paraqitur si më sipër në mënyrë tabelare, duke reflektuar Parametrat e Cilësisë së furnizimit nga viti 2017 deri në 2020.

Gjithashtu, evidentojmë se këto tregues gjatë vitit 2021 janë përmirësuar ndjeshëm krahas viteve të mëparshme.



Në krah është paraqitur një grafik-analitik i treguesve të cilësisë gjatë 5 viteve të fundit. Nga ajo cfarë vërejmë, për vitin 2021 parametrat e cilësisë që lidhen me kohëzgjatjen mesatare të ndërprerjes, energjinë e pafurnizuar janë përmirëusar ndjeshëm me vitet e kaluara, ndërkohë që rezulton me ulje të lehtë indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes (SAIDI) nga 71 min në 70.31 min, çka rezulton në një përmirësim në masë të lehtë siç paraqitet në grafikun në të majtë.

Bordi i ERE me anë të vendimit nr. 244, datë 02.12.2021 ka miratuar, gjithashtu Treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022, pas aplikimit të OST sh.a. dhe verifikimit që këto standarde vijnë të përmirësuara.

Standardet e Cilësisë të vitit 2022 për OST sh.a.

Parametrat e Cilësisë Furnizimit	Propozimi për vitin 2022
Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT)	35 min
Energjia e pa Furnizuar (ENS)	467 MWh
Cilësia e frekuencës (FQ)	Brenda diapazonit +/- 200mHz
Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Transmetimit	72 orë
Koha e Nevojshme për t'iu Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja	Brenda 60 ditëve
Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)	100 min
Cilësia e Tensionit (VQ)	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.
Përqindja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit	0%

9.7 Standartet e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97/2021 ka vendosur të miratojë Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes për vitin 2021. Nga ana e OSSH sh.a. janë përcjellë në ERE raportet periodike në lidhje me treguesit për cilësinë e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të cilat rezultojnë si në vijim.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e treguesve të vazhdimësisë së furnizimit me energji të rrjetit të shpërndarjes gjatë vitit 2021 krahasuar me Treguesit e miratuar nga ERE me vendimin nr. 97/2021.

Parametrat e Cilesisë Furnizimit	*Performanca për vitin 2021*	*Standardet e miratuara nga ERE për vitin 2021*
Energjia e pa Furnizuar	**52, 308 MWh**	**51, 246. 00 MWh**
Cilesia e Frekuences(FQ)	• Kufiri normal i operimit: 49.8 deri 50.2 Hz. • Gjatë çrregullimeve të sistemit: 48.0 deri 52.0 Hz.	• Kufiri normal i operimit: 49.8 deri 50.2 Hz. • Gjate çrregullimeve të sistemit: 48.0 deri 52.0 Hz.
Cilësia e Tensioni (VQ)	Nominal I Ulët I Lartë 230 V - 10% + 5% 400 V - 10% +5% 6 000 V - 5% + 5% 10 000 V - 5% + 5% 20 000 V - 5% + 5% 35 000 V - 5% + 5% 110 000 V - 5% + 5%	Nominal I Ulët I Lartë 230 V - 10% + 5% 400 V - 10% +5% 6 000 V - 5% + 5% 10 000 V - 5% + 5% 20 000 V - 5% + 5% 35 000 V - 5% + 5% 110 000 V - 5% + 5%
	• Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kW ne TU. • Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 kW ne TU. • Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 21-50 kW në TU. • Jo më shumë se 60 ditë pune për fuqi të	• Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kV ne TU. • Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 kV ne TU. • Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 21-50 kV në TU. • Jo më shumë se 60 ditë pune për fuqi të

Koha e Nevojshme për Kërkesat për Lidhjet e Reja	instaluar 50- 100 kW në TU. • Jo më shumë se 60 ditë pune për lidhje në TM.	instaluar 50- 100 kV në TU. • Jo më shumë se 60 ditë pune për lidhje në TM.
Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Shpërndarjes	**72 orë**	**72 orë**
Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)	**53.95 orë**	**47.17 orë**
Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve (SAIFI)	**28.50**	**25.08.**
Koha e Nevojshme për Rikthimin e Shërbimit të Furnizimit me Energji Elektrike pas një Defekti në Sistemin e Shpërndarjes	**TM + TU 2.78**	TM + TU 1.99
Koha e Nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkese të klientit	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së Kërkesës	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së Kërkesës
Koha e Nevojshme për tu Përgjigjur Ankesave, që kanë lidhje me matjen	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së Ankeses	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së Ankesës
Koha e Nevojshme për të Rilidhur Klienteve të cilëve u është Ndërprerë Energjia Elektrike	Brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit.	Brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit
Zgjidhja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit	30 ditë kalendarike	30 ditë kalendarike
Përqindja e Klienteve Aktualisht me Matës	Përqindja e Klienteve Aktualisht me Matës është100%, e numërit të klientëve	Përqindja e Klientëve Aktualisht me Matës është100%, e numërit të klientve

Figura 113 Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes për vitin 2021

Këto tregues merren në shqyrtim të ndarë sipas zonave urbane dhe rurale. Referuar treguesve të performancës së OSSH sh.a., konstatohet se rrjeti i shpërndarjes për këtë periudhë nuk është përmirësuar, ashtu si dhe numri dhe kohëzgjatja e difekteve në zonat rurale vazhdon të jetë akoma i lartë.

Pra, siç vërehet edhe më lart, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar bazuar në të dhënat e SAIDI, SAIFI dhe CAIDI rezultojnë se këto tregues janë përkeqësuar, e sipas raportimeve të OSSH sh.a. ndër shkaqet që kanë ndikuar në këtë përkeqësim janë: ndikimi i Covid-19, 11 emergjenca nga koha e keqe (periudha janar-mars), Emergjenca Energjitike VKM nr. 584, dhe ndryshimet klimaterike të muajve të fundit.

Qeveria Shqiptare me VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, "Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike", vendosi shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, efektet e së cilës shtrihen deri më 15 prill 2022.

Krahasim i Performancës së OSSH në TL+TM+TU 2020-2021 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI, CAIDI						
	SAIFI		SAIDI		CAIDI	
	Nr. i Konsumatorëve të prekur nga nderprerjet/Nr. Konsumatorëve Gjithsej		Nr. i orëve të ndërprerjeve gjithsej/Nr. Konsumatorëve Gjithsej		Nr. i orëve të ndërprerjeve gjithsej /Nr. Kons. Të prekur nga ndëprejet	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Janar	3.42	1.7	7.4	3.75	2.18	2.2
Shkurt	2.76	2.44	5.6	5.6	2.04	2.32
Mars	1.98	1.63	4.27	2.8	2.16	1.76
Prill	1.65	1.91	2.73	3.6	1.65	1.88
Maj	1.7	1.93	2.89	3.1	1.7	1.64
Qershor	2.22	1.94	3.52	3.2	1.59	1.64
Korrik	2.3	2.02	4.02	3	1.75	1.59
Gusht	2.0	2.32	3.28	4	1.64	1.74
Shtator	1.92	2.03	3.15	4.3	1.64	2.13
Tetor	2.67	2.68	5.15	5.07	1.9	1.8
Nëntor	2.65	1.44	5.32	2.3	2.01	1.6
Dhjetor	3.31	2.9	6.69	6.08	2.02	2.1
GRAND TOTAL	**28.25**	**25.07**	**53.95**	**47.17**	**1.89**	**1.88**

Figura 114 Krahasim i Performances se OSSH ne TL+TM+TU 2020-2021 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI, CAIDI

Vendimmarrja e mësipërme, veç të tjerash mbështetet edhe në parashikimet e pikës 4, të nenit 90, të Ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, ku citohet se: "*Të licencuarit nuk janë përgjegjës për sanksionet e ardhura si rezultat i ndërprerjes ose kufizimit të energjisë elektrike, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur situata e emergjencës vjen si rezultat direkt i fajit të të licencuarit*". Për sa më lart, duke qenë se OSSH sh.a., ne pikën 3 të VKM i është kërkuar *të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë, çka do të*

ndikonte në arritjen e treguesve të cilësisë të përcaktuar nga ERE, mungesa e performancës së OSSH sh.a. sa i përket arritjes së këtyre treguesve shihet e justifikuar.

Sikurse raportohet nga vetë OSSH sh.a., realizimi i treguesve për cdo muaj ndikohet drejtpërdrejtë edhe nga kushtet atmosferike. Gjatë 3 mujorit të parë të vitit ka patur kushte ekstreme të motit dhe treguesit kanë qënë në vlera mjaft të larta, duke përkeqësuar treguesit e performancës. Ndërkohë trendi në ulje gjatë muajve prill- shtator të treguesve SAIFI dhe SAIDI është një tregues shtesë i ndikimit të kushteve atmosferike në cilesinë e furnizimit. Gjithashtu sikurse raportuar nga OSSH, një rritje e treguesve evidentohet edhe në muajt e verës qershor-korrik-gusht, kjo për shkak të rritjes së ngarkesës nga ngritja e temperaturave. Ndërkohë edhe në muajin dhjetor shihet përkeqësim i treguesve të performancës si pasojë e motit të keq, shirërave dhe erërave. Sidoqoftë, ka disa parametra të mujave në 2021 të cilat evidentohen të përmirësuara, sikurse janë vlerat për SAIDI dhe SAIFI për muajit prill-maj. Vlera këto që janë ulur krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Tabela në krah, paraqet një grafik krahasues së totalit të treguesve kryesorë të cilësisë së shërbimit nga operatori i sistemit të shpërndarjes për vitin 2021 krahas vitit 2020. Në grafik janë listuar treguesit (SAIDI, SAIFI, CAIDI). Koeficienti i ndërprerjes së energjisë elektrike për klient gjatë një viti apo SAIFI ka patur një rritje në total nga 25 gjatë 2020 në 28 në vitin 2021 apo ndryshe 9% më shumë, ky index është përkeqësuar. Koeficienti i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes për klient apo SAIDI ka pësuar nje rritje rreth 8.7% krahasuar me 2020, do të thotë që këto ndërpreje janë në rritje dhe janë më të paqëndrueshme se një vit më parë. Ndonëse CAIDI, nuk ka pësuar ndonjë luhatje të madhe, shifrat e tjera duken të rritura, do të thotë se shoqëria OSSH sh.a. duhet të bëjë një punë më të mirë me qëllim që të mbajë këto tregues të qëndrueshëm dhe nën kontroll, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 97/2021.



OSSH sh.a. bën me dije se si shkak që impakton cilësinë e rrjetit të shpërndarjes, mes të tjerave është edhe fakti që 51% e kabinave janë në pronësi të privatëve e këta të fundit nuk binden të garantojnë aksesin e OSSH me qëllim remontin e tyre, si dhe Përdoruesit e rrjetit nuk zbatojnë standardet në pikën e lidhjes duke operuar me pajisje të cilat nuk i nënshtrohen remontit. ERE ka orientuar shoqërinë OSSH sh.a. që të marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e pengesave të krijuara si rrjedhojë e fenomeneve të mësipërme që cënojnë sigurinë dhe perfomancën e rrjetit. Në kuadrin ligjor (neni 69, pika b/1 e Ligjit nr. 43/2015) është detyrë e OSSH, që në rastin e kufizimit të aksesit në kabinat në pronësi nga të tretët, të marrë masat e nevojshme ligjore për përfshirjen e organeve ligj zbatuese me qëllim sigurimin e cilësisë së rrjetit duke garantuar aksesin dhe remontin e tyre. Ne lidhje me pjesën e dytë, ruajtja e standardeve të rrjetit është detyrë e Operatorit të rrjetit ashtu si dhe miratimi i pikës së lidhjes dhe konstatimi i përputhshmërisë së lidhjes me kriteret ligjore dhe teknike sipas "Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".

Të licensuarit përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, i është kërkuar marrja e masave të domosdoshme, duke patur parasysh që ruatja e standardeve të cilësisë së rrjetit, garanton jo vetëm shërbimin cilësor të furnizimit me energji elektrike ndaj konsumatorit por edhe mbron OSSH sh.a. nga efektet financiare që kësaj të fundit mund t'i shkaktohen si pasojë e mospërmbushjes së standardeve. Arritja dhe ruajtja e këtyre standardeve duhet të jetë detyrë parësore e OSSH sh.a., e për këtë qëllim duhet të merret cdo masë e nevojshme brenda kufijve të ligjit, e në përputhje edhe me praktikat më të mira ndërkombëtare.

OSHEE kryen regjistrimin e ndërprerjeve, të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave që disponon, nëpërmjet sistemit të regjistrimit të vazhdueshmërisë së shërbimit, duke funksionuar për të gjitha linjat TL dhe TM të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe OSHEE mban regjistrin e ndërprerjeve për të gjitha llojet e ndëprerjeve të përmendura më sipër, i cili përmban a- Origjinën e ndërprerjes; Shkakun e ndërprerjes; c- Numrin e klientëve në TL të përfshirë në ndërprerje; d- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje; e- Numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive; f- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive; g- Numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive; h- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rilidhjes, të ndarë sipas kategorive; i-Datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndëprerjes, për të gjithë klientët të përfshirë në ndërprerje. J - Çdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë, e cila regjistrohet dhe përdoret në llogaritjen e treguesve të performancës SAIDI dhe SAIFI.

Në rritjen dhe ruajtjen e standardeve të cilësisë, një rol jo të vogël luan edhë instalimi i një sistemi të sigurt matje. Nga ana e OSSH sh.a. bëhet me dije se sistemi i matjes është implementuar në masën 100% në rang vendi. Ndërkohë sa i përket instalimit të sistemeve inteligjente të matjes, hapat e hedhur në këtë drejtim, kanë ecur me ritëm të ulët, edhe për shkak të investimeve masive që kërkojnë nga ana e Operatorit të rrjetit. Matësat inteligjentë, regjistrojnë sasinë e energjisë së konsumuar në çdo shtëpi, në mënyrë që furnizuesi të mund të sigurojë faturimin për klientët e tij.

Tradicionalisht, për të marrë informacion të saktë për konsumin, operatori i rrjetit duhet të dërgojë lexues të matësit në shtëpinë e konsumatorëve për të konfirmuar konsumin e energjisë çdo muaj. Një matës inteligjent është shumë i ngjashëm me matësin tradicional në atë që mat dhe regjistron të dhënat e konsumit të energjisë. Megjithatë, matësi inteligjent ndryshon sepse është një pajisje dixhitale që mund të komunikojë nga distanca. Ai dërgon të dhëna mbi konsumin çdo 15 minuta deri në një orë dhe eleminon nevojën për një lexues të matësit. Matësi inteligjent mund të informojë menjëherë operatorin e Rrjetit nëse ka një ndërprerje të energjisë në një zonë të caktuar çka bën që operatori i rrjetit të mund të reagojë në një kohë më të shpejtë në rikthimin e shërbimit apo korrigjimin e defektit.

Aktualisht rezulton se Operatori i rrejtit të Shpërndarjes, ka instaluar në rang vendi 5760 matësa inteligjentë, një pjesë e të cilëve të lidhur me konsumatorët, e disa prej tyre të lidhur me fiderat kryesorë të furnizimit në zona të caktuara.

9.8 Aksesi në Rrjetin e shpërndarjes dhe Rrjetin e Transmetimit



Operatorët e Rrjetit janë përgjegjës për garantimin e aksesit në rrjet dhe miratimin e lidhjeve të reja konform rregullave teknike e ligjore e në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor rregullator në fuqi.

Sa i përket aksesit në rrejtin e shpërndarjes, gjatë vitit 2021, rezulton se ka patur një total prej 17,008 aplikime për lidhje të reja apo shtesë fuqie në rrjetin e shpërndarjes, prej të cilave 14,108 janë aplikime për Lidhje të Re ndërsa 2,900 aplikime për Shtesë Fuqie.

Si evidentohet edhe nga grafiku në krahë 82% të aplikimeve e zënë aplikimet për Lidhjet e Reja dhe 18% aplikimet për Shtesë Fuqie.

Sikurse edhe në vitin 2020, Tirana, Durrësi dhe Shkodra, vazhdojnë të zënë pjesën më të madhe të aplikimeve për lidhje të reja, për çdo kategori. Kukësi vazhdon të mbetet rajoni me më pak aplikime për lidhje të reja në rrjet.

Një pjesë e rëndësishme e ushtrimit të aktivitetit nga ana e OST sh.a sa i përket detyrimeve për zbatimin e Kushteve të Licencës për shërbimin e Transmetimit është edhe zbatimi i kushteve dhe afateve të parashikuara në "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", të miratuar më vendimin e Bordit të ERE, nr. 87, datë 20.04.2018. Për këtë qëllim ERE ka kërkuar nga OST informacion të detajuar lidhur me aplikimet e rregjistruara në OST sh.a. për Lidhje të Reja në Sistemin e Transmetimit, afatet proceduriale të ndjekura për miratimin apo refuzimin e secilit aplikim si edhe në rastet e refuzimit arsyet e këtij refuzimi, numrin e njësive gjeneruese që janë vënë në operim.

Sa i përket aksesit në Rrjetin e Transmetimit, vërejmë se në krahasim me vitin 2020, kemi rritje të numrit të aplikimeve nga 18 në 27 aplikime për lidhje të reja. Ndërsa lidhur me afatet kohore vërejmë se janë përmbushur 100% në vitin 2020. Sa për çështjen e njësive gjeneruese janë vënë në operim 2 burime më shumë në vitin 2021.

Gjatë 2021 ka patur 1 aplikim të miratuar për "Gjenerues Hidrik"; 14 aplikime për "Gjenerues Solar"; 12 aplikime për "Gjenerues Eolik"; dhe asnjë aplikim për "Gjenerues Termik".



Për sa i përket afatit ligjor për kthim-përgjigje (60 ditë kalendarike) sipas "Rregullores të Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", OST sh.a ka finalizuar praktikat në afatet kohore në masën 83% të rasteve të shqyrtuara.

Sa i përket aplikimeve të miratuara në tejkalim të afateve ligjore apo të pa miratuara, sipas raportimeve të OST sha rezulton se këto fenomene janë si më poshtë: 10% vlerësuar si "Miratim në parim", 16.7% si "Drejtuar në OSHEE për shkak të fuqisë", 63.3% si "Opinion paraprak, 7% si "Marrëveshje e lidhjes", 3% si "Rivlerësim i pikës së lidhjes".

9.9 Monitorime të licencuarve në aktivitetet e shërbimit publik.

Përgjatë vitit 2021 ERE ka zhvilluar 5 monitorime pranë të licencuarve, me qëllim mbikqyrjen e përmbushjes së detyrimeve këtyre të fundit sa i përket zbatimit të parashikimeve të akteve rregullatore që lidhen me cilësinë e shërbimit ndaj klientit.

1.**Monitorimi i FSHU për afatet dhe procedurat e trajtimit të ankesave** i cili u realizua lidhur me zbatimin e afateve dhe procedurave të trajtimit të ankesave të regjistruara në FSHU sh.a, gjatë periudhës 25.01.2021 deri më 29.01.2021, me objekt zbatimit të afateve dhe procedurave të trajtimit të ankesave të regjistruara në FSHU sha, gjatë viti 2020 nga të gjitha burimet.

Grupi i punës pasi ushtroi kontrollin në facilitetet e FSHU sh.a., dhe pasi analizoi të dhënat e mbledhura e të vëzhguara, ka konkluduar e rekomanduar për të licencuarin, që të marrë masa për azhornimin e platformës së kujdesit ndaj klientit, e përveç kësaj të bëjë një punë të mire për trajtimin në afat të ankesave për të gjithë klientët e energjisë elektrike, duke respektuar standardet e vendosura në "Rregulloren e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike".

2.**Monitorimi i OSSH mbi verifikimin e zbatimit të afateve dhe procedurave për verifikimin e matësave** në zbatim të rregullores "Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.145, datë 18.09.2017 për aplikimet e regjistruara në OSSH sh.a. gjatë muajit dhjetor 2020- janar 2021.

Grupi i punës pasi analizoi të dhënat e disponuara, mbështetur në gjetjet e problematikave që lidhen me zbatimin e procedurave të njoftimit të klientit për verfikimin e matësit, rekomandoi që OSSH sh.a. të marrë masa konkrete për ndryshime në aktet rregullatore të brendshme si dhe marrëdhënien me Furnizuesit, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore në mbrojtje të të drejtave të klientëve të energjisë elektrike për një shërbim cilësor, sipas procedurave të miratuara dhe në afate, të verifikimit të matësave.

3.**Monitorim i Qëndrave të kujdesit të klientit (QNK) të shoqërisë FSHU sh.a.**-i cili është realizuar lidhur me performancën e punonjësve për sa i përket njohurive mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të licencuar FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. gjatë periudhës 01.04.2021,02.04.2021, 06.04.2021 dhe 07.04.2021.

Grupi i punës pasi vëzhgoi ambjentet e qendrave të kujdesit të klientit (QNK) të shoqërisë FSHU konstatoi se stafi i shërbimit të klientëve të KNK-ve kishte përgjithësisht njohuri për proceduat, rregullat si dhe detyrimet e operatorëve (OSSH/FSHU) dhe se informacioni i kërkuar nga klientët sipas tipologjisë së kërkesës ofrohej nga punonjësit e shërbimit në mënyrë të kuptueshme.

Në parashikim të ligjit të sektorit të energjisë elektrike dhe rregulloreve të miratuara në ERE, gjithashtu dhe në referencë të gjetjeve gjatë këtij monitorimit, Furnizuesit të shërbimit universal ju rekomandua për të patur lehtësi në shërbim të klientit dhe për të ndikuar sa më mire në performancën e punonjësit. Operatori duhet të tregojë një vëmendje më të madhe në sigurimin e aksesit në ambjentet e KNK-ve, për personat më aftësi të kufizuara. Nga ERE, në përfundim të monitorimit, u rekomandua që FSHU të përcjellë në ERE raport të detajuar në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të KNK-ve; Të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme dhe pa pagesë për palët e interesuara, informacion të detajuar, transparent,-nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit; Të realizojë një raport më të detajuar ku të evidentojë vlerësimin e punonjësve të KNK sipas metodave, kritereve. Gjatë këtij monitorimi, u konstatua po ashtu se gjatë procesit të rregjistrimit të ankesës apo kërkesës klientit nuk i bëhej e ditur se në rast se Furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën e tij brënda afatit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, apo nëse Klienti nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej Furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë ankesën në ERE, e për këtë qëllim ERE rekomandoi përmirësimin e sa më sipër.

4. **Monitorimi i planit të masave-** Monitorimin i shoqërisë FSHU sh.a. u realizua lidhur me detyrimet dhe raportimet periodike si dhe mbi mbikqyrjen e zbatimit të detyrave që rrjedhin për të licencuarin nga vendimi i Bordit të ERE nr. 201/2018, "Plani i masave për Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike 'OSHEE' sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike", i rishikuar.

Lidhur me këtë monitorim është konkluduar se përgjithësisht shoqëria ka zbatuar detyrimet e parashikuara në lidhje me zbatimin e "Planit të Masave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 03.09.2018, i ndryshuar.

Në vijim ERE parashtroi rekomandimet, mbi gjetjet e grupit të punës gjatë analizimit të dokumentacionit të cilat përfshinin masat jo vetëm për zgjidhjen e ankesës por edhe informimin e klientit për zgjidhjen e dhënë. Po ashtu Furnizuesi duhet të sigurojë që, punonjësit e Call Center të kishin akses të plotë në informacion për të bërë me dije klientët në lidhje me statusin e ankesës (pranuar/refuzuar), nëpërmjet shërbimit telefonik Call center dhe sistemit të gjurmimit të ankesës.

Më tej ERE rekomandoi masa për të përmbushur detyrimin për afishimin dhe publikimin e të dhënave të domosdoshme për klientët si detyrim i shërbimit universal, nëpërmjet broshurave informative të përgatitura për këtë qëllim por edhe ato për reflektimin në faturë të të dhënave që ligji i energjisë, apo edhe aktet e nxjerra në zbatim të tij, kanë parashikur si detyrim për të gjithë furnziuesit.

5. Monitorimi i O.S.T sh.a.- i realizuar pranë OST sh.a. pati si objekt "Sigurimin e aksesit të palëve të treta në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe akteve të miratuara nga ERE procedurat e ndjekura si dhe afatet brenda të cilave OST sh.a., shqyrton aplikimet, miraton dhe realizon lidhjen e re."

ERE pasi analizoi të dhënat e disponuara dhe pas inspektimit në OST konkludoi se, nuk vërejti ndonjë parregullsi apo shmangie nga dispozitat ligjore apo nënligjore që administrojnë modalitete të lidhjeve të reja dhe modifikimin e atyre egzsituese në sistemin e transmetimit.

9.10 Informacion lidhur me verifikimin e matësave

ERE i ka kushtuar dhe vazhdon ti kushtojë një vëmendje të veçantë mbikëqyrjes së aktivitetit të të licensuarve sa i përket garantimit të të drejtave të klientëve të energjisë elektrike, e veçanërisht sigurimit të një shërbimi të furnizimit me energji elektrike të pa ndërprerë dhe brenda standarteve të cilësisë së shërbimit. Për të arritur një informacion sa më të saktë, ERE ka kërkuar nga OSSH sh.a. që në zbatim të "Rregullores mbi proçedurat për paraqitjen e një kërkese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike të paraqesë informacion 4-mujor perdioik në ERE në lidhje me kërkesat e klientëve për verifikimin e saktësisë së aparatit matës të energjisë elektrike". Rezulton se gjatë vitit 2021 janë bërë 1,871 verifikime të aparatit matës, me kërkesë të klienteve të Energjisë, duke shënuar numrin më të madh të kërkesave për verifikim muajt Mars – Maj. (*Tabela ne vijim*).



Siç shihet dhe në tabelën bashkëlidhur, gjatë muajve Mars, Maj ka pasur një rritje të ndjeshme të numrit të kërkesave të klienteve të energjisë elektrike për verifikimin e matësave. Shoqëria OSSH sh.a shprehet lidhur me procedurat e ndjekura për trajtimin e këtyre kërkesave, të cilat administrohen nga Kujdesi i Klientit të FSHU sh.a dhe përpunohen në të njëjtin sistem online CRM. OSSH-së i delegohen nga sistemi të gjitha llojet e kërkesave të tjera, objekti i veprimtarisë së saj të cilat filtrohen sipas llojit dhe delegohen në grupet e punës në rajone për të kryer veprimet fizike në terren. Lidhur me analizën e rezultateve gjatë kësaj periudhe janë ndryshuar 228 matësa, rreth 12% e rasteve. Qëllimi i një analize mbi të dhënat e sa më sipër, është vlerësimi i një panorame më të qartë në lidhje me ndryshimet cilësore të shërbimit të furnizimit te energjisë elektrike në mënyrë të pandërprerë dhe uljes së numrit të ndërprerjeve të paplanifikuara.

ERE me qëllim mbikqyrjen e përmbushjes së detyrimeve të proceduarave për verifikim e matësave, ka zhvilluar një Monitorim pranë OSSH sh.a. mbi verifikimin e zbatimit të afateve dhe procedurave për verifikimin e matësave në zbatim të rregullores "Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.145, datë 18.09.2017 për aplikimet e regjistruara në OSSH gjatë periudhës dhjetor 2020- janar 2021.

Grupi i punës pasi analizoi të dhënat e disponuara rekomandoi që OSSH sha të paraqiste propozime konkrete për ndryshime në aktet rregullatore të brendshme, marrëdhenien me FSHU, apo aktet nënligjore të miratuara nga ERE, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore në mbrojtje të të drejtave të klientëve të energjisë elektrike për një shërbim cilësor, sipas procedurave të miratuara dhe në afate, të verifikimit të matësave.

10. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE

10.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Ndër prioritetet e ERE-s është dhe mbetet përfaqësimi sa më dinjitoz dhe aktiv i punës së Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ato ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të rajonit dhe BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit dhe bashkëpunimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj.

Për vitin 2021, me kufizimet e shtrira nga pandemia ERE ka punuar me një intensitet të lartë nëpërmjet platformave online. Duke vendosur këto prioritete, ERE ka vijuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës nëpërmjet ECRB, MEDREG, ERRA, NARUC, CEER, IGU etj. Gjatë vitit të kaluar ERE i ka kushtuar

një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në trajnime, seminare, takime, workshop dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Interesi i stafit të institucionit tonë në këto aktivitete ka qenë i lartë për t'u njohur me eksperiencat më të mira ndërkombëtare si dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjitik duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare si dhe për të prezantuar denjësisht Rregullatorin në këto aktivitete me anë të fjalimeve, kryesimeve të takimeve, grupeve të punës apo dhe prezantimeve të ndryshme.

10.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare

- ERE është anëtare e ECRB Bordit Drejtues të Regullatorëve të Vendeve të Traktatit të Energjisë dhe merr pjesë aktive në grupet e punës të ngritura prej kësaj të fundit duke kryesur njërin prej 4 grupeve te punës.
- ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e Komiteteve të përhershme të ERRA-s, si dhe grupeve të punës si atij të Energjisë elektrike, atij të gazit, apo dhe atij të Tarifave e Çmimeve.
- ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike, ku edhe përgjatë vitit 2021 Kryetari i ERE ka mbajtur postin e Presidentit të MEDREG, post në të cilin u zgjodh në asamblenë e nëntorit 2020 për një mandat dy vjeçar. Gjithashtu, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës përfshirë dhe drejtimin e tyre për konsumatorin si dhe takimet e grupeve të punës për marrëdhëniet institucionale, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, elektricitetit.
- ERE ka statusin e vëzhguesit pranë CEER (Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë), status i cili mundëson fuqizimin dhe marrjen e njohurive të stafit të ERE-s gjatë pjesëmarrjes në grupet e punës dhe takimeve .
- ERE është pjesëmarrëse në takimet e UfM (Unioni për Mesdheun), i cili përbëhet nga 43 shtete anëtare pjesë e Mesdheut dhe ka për qëllim të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin rajonal si dhe implementimin e projekteve dhe iniciativave që do ti shërbenin rajonit. Në kuadër të bashkëpunimit në sektorin energjitik, UfM-së ka të hartuar platformën për sektorin e gazit natyror si dhe dy platforma të tjera në sektorin e energjisë elektrike, lidhur me burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë.
- ERE është anëtare me të drejta të plota në South – South-East Gas Regional Initiative (GRI SSE), e cila është Iniciativa e Rregullatorëve për Gazin në Rajonin Jug-Juglindje.
- Po, ashtu ERE është pjesëmarrëse me të drejta të plota në OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë) forum mjaft i rëndësishëm i Mesdheut.
- Si anëtare me të drejta të plota e Forumit të Këshillimit të Ballkanit në përbërje të së cilës janë Regullatorët e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Serbisë, Bosnjes dhe Bullgarisë, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në takimet e grupeve të punës së këtij Forumi si dhe ka ndihmuar në përpilimin e raportimeve që i shërbejnë rregullatorit dhe palëve të interesit. Forumi shërben për shkëmbimin e eksperiencave midis këtyre rregullatorëve nëpërmjet krijimit të grupeve të punës në fusha me interes të përbashkët.
- Për vitin 2021 ERE ka vazhduar të mbajë një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët, të përkrahur nga USAID dhe NARUC në lidhje me hartimin e strategjisë kibernietike apo dhe planit të masave për zbatimin e standarteve të cilesisë të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

  Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në projektin e USAID & NARUC lidhur me hartimin e planit 10-

vjeçar të zhvillimit të rrjeteve të transmetimit në Europën Juglindore si dhe workshop-in e organizuar lidhur me çështjet e sigurisë kibernetike.

- ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit të kaluar ka marrë pjesë në Forumin e Athinës, Forumin e Gazit dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës si dhe grupeve të punës së këtij organizmi.

Po ashtu ERE ka marrë pjesë në aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatin e Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Në këtë kuadër draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jonë i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës ose janë realizuar takime me to për të patur një kuptim sa më të mirë të çështjes, gjithashtu kemi marrë ndihmën e nevojshme nga Sekretariati i Vjenës në draftimin e akteve sekondare në kuadër të ligjeve të reja. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, burimeve të rinovueshme, statistikave, elektricitetit, eficensës, sigurisë së furnizimit, REMIT, gazit natyror, platformën e gazit. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatin e Vjenës për sa i përket implementimit të paketës së tretë legjislative në kuadër të legjislacionin sekondar i cili ka qënë në proces draftimi dhe miratimi nga Bordi, si dhe për sa i përket implementimit të Kodeve të Rrjetit, miratimi i të cilave vjen si detyrim që rrjedh nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E.

10.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s

Gjatë vitit 2021 janë intensifikuar në mënyrë të mëtejshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (ARERA) si dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimeve të përbashkëta të tre rregullatorëve në lidhje me projektin TAP i cili filloi operimin në fund tëvitit 2020.

Një tjetër iniciativë rajonale është ndërmarrë gjatë vitit 2021, me mbështetjen e CEI (Central European Initiative) dhe të rregullatorit Italian ARERA, duke vijuar fazën e trete të Projektit KEP (Know-How Exchange Program) "Suporti i CEI për forcimin e autoriteteve rregullatore të energjisë në Ballkanin Perëndimor", i cili ka si objekt shtrirjen e praktikave të njohurive për iniciativat e bashkimit të tregjeve të energjisë ndërmjet anëtarëve të BE në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Përgjatë vitit 2022 është duke u biseduar me rregullatorët pjesë e KEP për zhvillimin e mëtejshëm të trajnimit nëpërmjet krijimit të Shkollës Regullatore Ballkanike (BES). Shkolla në fjalë do të jetë një iniciativë e rregullatorëve dhe do të ketë mbështetjen financiare të CEI-t apo dhe rregullatorit Italian si pjesë e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis palëve. Shkolla është menduar të shërbejë si një vend ku punonjësit e rregullatorëve të vendeve të Ballkanit perëndimor do të shkëmbejnë eksperiencat e tyre apo dhe do të trajnohen nga kolegët e tyre të rregullatorëve Evropiane lidhur me sfidat që i dalin përpara rregullatorit në kuadër të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike apo dhe të situatave aktuale të krizës së çmimeve në tregjet e energjisë.

11. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERE DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neni 9 pika 1, përcakton se ERE është institucioni Rregullator i sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit në Shqipëri që drejtohet nëpërmjet Bordit të Komisionerëve. Bordi i Komisionerëve të ERE përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë të cilët përzgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Me Vendimin nr. 78, datë 29.04.2020, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë strukturën organizative dhe organigramën e Entit Rregullator të Energjisë, duke përcaktuar se numri maksimal i punonjësve të ERE është 63, të cilët organizohen si më poshtë vijon:



Figura 115 Struktura Organizative e Entit Rregullator të Energjisë

Përveç Bordit të Komisionerëve, i cili është organi vendimmarrës, ERE organizohet në Sekretarin e Përgjithshëm, 7 drejtori dhe sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve.

Struktura e re e ERE-s bazohet në një ndarje të qartë, me kapacitetet e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me fushat e rregullimit nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi, të tilla si: Mbrojtja e Konsumatorit, Hartimi dhe miratimi i Akteve Nënligjore, Zhvillimit të Tregut të Gazit Natyror, Monitorimi i Tregut, Standarteve të Cilësisë, Vendosja e Tarifave dhe Çmimeve në Segmentet e Rregulluara të Tregut, Licensimi, Modifikimi, Rinovimi dhe dhënia e Autorizimeve për operimet në aktivitetet e identifikuara në ligjet respektive, Marrëdhënia institucionale brenda dhe jashtë vendit, Planifikimi e Hartimit i Buxhetit, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.

Kjo strukturë gjithashtu merr në konsideratë edhe zhvillimet më të fundit në sektorin e energjisë elektrike si janë:

- Zbatimi i rregullores së integritetit dhe transparencës së tregjeve me shumicë të energjisë elektrike (REMIT), në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, përsa i takon hartimit të rregullores ashtu dhe monitorimit të zbatimit të saj nga ana e operatorëve të tregut, duke filluar që nga regjistrimi i paleve deri tek ruajtja e të dhënave apo marrja e indicieve për kryerjen e investigimeve të ndryshme për rastet e moszbatimit të kësaj rregullore.
- Certifikimi dhe mbikqyrja e Operatorit të Nominuar të Energjisë Elektrike, sipas rregullores të miratuar nga ERE me Vendimin e Bordit nr. 40, datë 06.03.2020.
- Miratimi dhe monitorimi i implementimit nga operatorët e rrjetit të strategjisë së infrastrukturave kritike, i cili kërkon angazhimin dhe përfshirjen e një stafi të dedikuar me eksperiencë në sistemet e informimit për të përballuar këtë detyrë.
- Transpozimi i rregulloreve dhe kodeve për përafrimin e akteve nënligjore, objekt miratimi nga ERE si dhe përpunimi i të dhënave personale të të licensuarve, në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Mbikqyrja e standarteve të cilësisë së operimit të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes dhe rolit të ri të klientëve në përputhje me parashikimet e paketës së re legjislative si vetëprodhues.
- Digjitalizimi i arkivës së Entit Rregullator të Energjisë, duke patur në konsideratë se digjitalizimi nuk është kryer prej krijimit të Entit Rregullator dhe do t'i sherbejë krijimit të një arkive digjitale, e cila mund të jetë e aksesueshme në çdo moment dhe do ti shërbejë dhe më tepër rritjes së transparencës së ERE.

Përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2021 është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005" Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 datë 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr. 44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr.45, datë 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 datë 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga zyrtarët që janë subjekt i këtij detyrimi, sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu është mbajtur komunikim i rregullt me ILDKPKI në zbatim të njoftimeve të dërguara prej këtij institucioni.

Në zbatim të Vendimit nr.52 date 02.04.2019 të bordit të ERE është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, "Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", si dhe Vendimi nr. 187, datë 08.03.2017 "Për

miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit" si dhe Vendimin nr. 202, datë 15.03.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore " të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, mbi përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të punonjësve të ERE-s, janë zbatuar procedurat e ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" si dhe janë realizuar tashmë procedurat sipas këtij ligji të përzgjedhjes dhe emërimin e nëpunësve të ERE-s si pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm apo dhe ai i Drejtorëve të Drejtorive. Përgjatë vitit 2022 do të vijohet më tej me procedurat e konkursit për pozicionet e tjera të Entit në përputhje me aktet ligjore të sipërcituara.

12. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE GJATË VITIT 2021

Administrimi i burimeve të financës është realizuar duke zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Urdhërit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre".

Në të gjitha rastet janë zbatuar proçedurat dhe afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve të tjera nënligjore.

Gjithashtu, ka vijuar inventarizimi i aseteve që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen në përputhje me ligjet respektive të sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, dhe përbëhen nga pagesat e aplikimeve për licencime/modifikime/rinovime dhe nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të licencuarit.

Ndër zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE mund të përmendim:

- Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nga sistemi elektronik " Detyrimet në kohë reale " nuk rezulton debitor apo me gjoba.
- Publikimet për informim të opinionit publik janë realizuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe Ligjit nr.102/2015 ''Për sektorin e gazit natyror''.
- Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.
- Pagesat me qëllim përmbushjen e angazhimeve në cilësinë e vendit anëtar në një sërë organizatash të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit të energjisë të tillë si MEDREG, ERRA, IGU, CEER.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s për vitin 2021, në zbatim të parashikimeve të nenit 17 të ligjit nr.43/2015 është audituar nga një grup ekspertësh kontabël të regjistruar dhe të licensuar për këtë aktivitet bazuar në Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar". Në Shtojcën 1 të këtij

raporti paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël që lidhet me ecurinë financiare të ERE-s gjatë vitit 2021 si dhe Shtojcën 2 raporti i performancës.

Buxheti i ERE u miratua me vendim të Bordit nr. 50/2022 datë 24.03.2022. Ky buxhet merr në konsideratë kërkesat për funksionimin e ERE-s përgjatë vitit 2022. Në mënyrë të detajuar ky buxhet paraqitet në tabelën e më poshtme.

BUXHETI PËR VITIN 2022

Nr,	Emërtimi	Vlera
I	**SHPENZIME OPERATIVE**	**251,731,883**
	Paga personeli	154,200,000
	Shpenzime për sigurime Shoqërore dhe shëndetësore	19,000,000
	Shpenzime të tjera Operative dhe Sherbime me të tretë	68,301,200
	Shpenzime Amortizim	11,430,680
II	**INVESTIME ***	**46,000,000**
	- Pajisje elektronike si dhe - Software për mundësinë e hapjes së tregut dhe monitorimit të të Licensuarve	23,000,000
	Totali i shpenzime të pritëshme të vitit 2022	**275,731,830**

- Për efekt të llogaritjes së pagesës rregullatore të vitit 2022 shpenzimi i investimit do të llogaritet me vlerën 50% të totalit të shpenzimit të investimit.

SHTOJCA 1. RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

ERE-ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
PREZANTIMI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2021 (ML)

QËLLIMI I AUDITIMIT PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021

Qëllimi auditimit	Pasqyrat financiare
Auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Pasqyrave Financiare.	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, pasqyrat janë përgatitur nga ERE në përputhje me"Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuar) (SKKP), Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT

Përgjegjësitë e audituesit	▪ Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)dhe auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-të. Ne kemi shqyrtuar mbi bazën e testimeve të transaksioneve dhe të ekzistencës të zotërimit dhe vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve të cilat audituesit i konsiderojnë të nevojshme në shqyrtimin e evidencave që mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. ▪ Audituesi është përgjegjës për formimin dhe shprehjen e një opinioni mbi pasqyrat financiare që janë përgatitur nga menaxhimi i kompanisë. Për të arritur këtë, ne kemi planifikuar dhe kryer auditimin për të siguruar një siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale. ▪ Ne kemi marrë një kuptim të sistemeve të kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm financiar në masën e nevojshme për të konsideruar përshtatshmërinë e tyre si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

2

Përgjegjësitë e menaxhimit	▪ **Pasqyrat financiare** • Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. ▪ **Kontrolli i brendshëm:** • Kontrollet e brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare. ▪ **Asistimi grupit të auditimit:** • Dhënia e informacioneve dhe aksesit për audituesit: • Qasja në të gjitha informacionet që menaxhimi është i vetëdijshëm se është i rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare. • Informacione shtesë që audituesit mund të kërkojnë nga menaxhimi për qëllime të auditimit. • Akses i pakufizuar për personat brenda njësisë nga të cilët ne e përcaktojmë të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Për Menaxhimin dhe palët e interesuara	Opinion dhe raporte të pavarura që shtojnë besueshmërinë e informacionit financiar të paraqitur.
Për menaxhimin	Vëzhgime dhe këshilla për raportimin financiar, çështje të tatimeve dhe biznesit nga profesionistë të lartë që kanë një kuptim të thellë të biznesit tuaj dhe të industrisë. Ne gjithashtu ndajmë përvojën e praktikave më të mira të industrisë.

QASJA E AUDITIMIT

Shkurt Mars 2022	Kryerja dhe finalizimi i punës pranë zyrave të klientit, kryerja e proçedurave thelbësore. Procedurat finale të auditimit, konkluzionet dhe raportimi.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	1	56.240.725	114.450.199
Investime		-	-
Te drejta te arketueshme		-	-
Nga aktiviteti i shfrytezimit	2	11.426.152	27.104.405
Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te tjera		436.857	68.014
Kapital i nenshkruar i papaguar		-	-
Inventaret		-	-
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	3	3.107.381	2.657.246
Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte		-	-
Produkte te gatshme		-	-
Mallra		-	-
Shpenzime te shtyra		-	-
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		**71.211.116**	**144.279.864**
Aktive afatgjate			
Aktive financiare			
Aktive materiale			
Toka dhe ndertesa		-	-
Makineri e Paisje		-	-
Mjete Transporti	4	5.941.168	7.426.460
Paisje Zyrash	4	7.031.192	1.946.065
Te tjera paisje dhe Informatike	4	95.124.324	27.946.324
Aktivet biologjike		-	-
Aktive jo materiale		-	-
Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te naiashme	4	7.355.406	9.246.847
Emri i mire		-	-
Parapagime per AAJM		-	-
Aktivet tatimore te shtyra		-	-
Totali i aktiveve afatgjata		**115.452.089**	**46.565.696**
Totali i Aktiveve		**186.663.205**	**190.845.561**
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Titujt e huamarrjes		-	-
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		-	-
Aktetime ne avance per porosi		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	5	1.169.444	20.939.124
Deftesa te pagueshme		-	-
*Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit **		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa		-	-
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve	5	2.005.067	2.128.908
Te pagueshme per detyrime tatimore	5	2.964.373	1.246.474
Te tjera te pagueshme	5	67.169	60.195
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurta		**6.206.053**	**24.374.701**
Detyrime afatgjata			
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra AGJ		-	-
Provizione		-	-
Provizione per pensione		-	-
Provizione te tjera		-	-
Detyrime tatimore te shtyra		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		**-**	**-**
Detyrime Totale		**6.206.053**	**24.374.701**
Fondet Të Akumuar - ERE		166.470.859	106.054.620
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	11	13.986.292	60.416.239
Shuma		**180.457.152**	**166.470.859**
Totali i Detyrimeve dhe i Fondeve		**186.663.205**	**190.845.560**

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

		31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Te ardhura te shfrytezimit			
Te ardhurat nga Faturimi I Operatoreve	6	207.671.534	213.502.681
Te ardhurat nga Licensimi	6	10.796.150	2.857.000
Te tjera te ardhura nga organizma mbulim shpenzimesh		-	-
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Te tjera shpenzime		-	-
Shpenzime te personelit		-	-
Paga dhe shperblime	7	(149.503.066)	(122.775.775)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	7	(16.129.562)	(13.390.205)
Shpenzimet per pensionet		-	-
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(14.389.798)	(6.512.211)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	9	(24.411.287)	(14.060.326)
Te ardhura te tjera		-	-
*Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit**		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme		(84.594)	(73.342)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek		-	-
Shpenzime te tjera financiare	10	36.916	868.418
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet		-	
		-	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	11	**13.986.292**	**60.416.239**
Tatimi mbi fitimin			
Tatimi mbi fitimin e periudhes		-	
Tatim fitimi i shtyre			
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve			
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve		**13.986.292**	**60.416.239**

5

Entit Rregullator të Energjisë (ERE)
Letra e manaxhimit për periudhën
Janar-Dhjetor 2021

Të nderuar zotërinj,

Grupi ynë i auditimit ka ekzaminuar kontrollin e brendshëm dhe pasqyrat financiare të Entit Rregullator të Energjisë. Sistemet e kontabilitetit dhe ato të kontrollit janë verifikuar deri në masën e nevojshme që lejon përcaktimi i proçedurave të auditimit për raportim në pasqyrat financiare.

Gjatë auditimit kemi evidentuar disa problematika për të cilat kemi bashkëngjitur rekomandimet tona, në mënyrë për të ndihmuar në përmirësimin e proçeseve dhe për të arritur efiçensë operacionale.

Komentet dhe rekomandimet e bashkangjitura kanë si qëllim të vetëm informimin dhe përdorimin e drejtuesve të insitucionit dhe palëve të interesuara.

Faleminderit juve dhe stafit tuaj për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme gjatë proçesit të auditimit.

Auditues Ligjor

Bujar Bendo

RSM Albania sh.p.k
License: Nr.73; 12.04.2000
Adresa: Rruga Sami Frashëri, Ndërtesa 19, Hyrja8, Kat 5, Ap.14, Tirane
e-mail: bujar.bendo@rsm.al

Auditues Ligjor

Kondor Çeka

License: Nr. 480; 16.09.2021
Adresa: Nj.8, nr.2, Rruga Asllani Gurakuqi, P.18, Hyrja 4, Ap.21, Tirane
e-mail: dori.ceka@viar.al

KONDOR ÇEKA
NUIS : M12030034N
TIRANE - ALBANIA

Tiranë, më 24.03.2021

6

Aneks 1. Letra e menaxhimit

Gjetje	Rekomandime	Komentet e drejtimit
Përgatitja e Pasqyrave Financiare		
Pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2021 janë përgatitur në një platformë excel të cilat në gjykim e audituesit ligjor mund të mbartin pasiguri mbi interpretimin kronologjik dhe logjik për të kuptuar skemat kontabile të aktivitetit. Për rrjedhojë, përgatitja në formate excel mbart një pasiguri materiale që mund të supozojmë dyshime për gabime njerzore.	Entiteti duhet të sigurojë menjëherë softëare kontabilitetit për gjenerimin e pasqyrave financiare të vitit ushtrimorë.	Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.
Audituesit Ligjor konstatojnë se ERE nuk ka një metodologji të miratuar për mënyrën e trajtimit të llogarive të arkëtueshme të cilat arktohen me vonëse ose nuk arrijnë të arkëtohen. Më dhjetor 2021 shuma e debitoreve të parkëtuar mbi 360 ditë është 5,653 mijë lekë.	Në fund të çdo periudhe raportimi, Entiteti në bazë të një metodologjie duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar dhe nëse ekziston një evidencë objektive të zhvlerësimit, Entiteti duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.	Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.
Struktura e Teknologjise e Informacionit (IT)		
Entiteti nuk ka në strukturë staf efiçent për mbulimin e sistemit të IT.	Entiteti duhen të investojë për funksionimin e një strukturë të IT-e efektive për aktivitetin e tij në mënyrë efiçente.	Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.

Aneks 1. Letra e menaxhimit

Shtojcë

Kërkesat e Ligjit nr. 43/2015, Nenin 11 pika 7

Audituesit kanë konstatuar se ERE ka përcaktuar pagën dhe strukturën në përputhje me keto kerkesa. Me anë të vendimit nr. 46, nr. 47 dhe nr. 61 të vitit 2016 janë miratuar Rregullorja për trajtimet financiare bazë të punonjësve të ERE, trajtimi financiar bazë me karakter të përkohshem si edhe përcaktimi i nivelit të trajtimit financiar bazë për kushtet e tregut të punës.

Përgjegjësia e Drejtimit për Objektivat dhe Kufizimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Komentet e mëposhtene u referohen përgjegjesisë së Drejtimit për sistemin e brendshem të kontrolleve, ku objektivat dhe kufizimet e qenësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm janë marrë nga Standardet Nderkombetare të Auditimit të Federates Ndërkombëtare të Kontabilisteve.

Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshme. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Drejtimi duhet të vlerësojë përfitimet dhe kostot e pritura përkatëse të politikave dhe procedurave për kontrollet e brendshme.

Objektivat

Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshem janë qe të japin siguri drejtimi, sa më shumë të jetë e mundur, që asetet të jenë të mbrojtura nga perdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi, dhe se transaksionet janë ekzekutuar në përputhje me politikat e drejtimit dhe të regjistrohen saktë, në mënyrë që të mundësohet përgatitja në kohë e informacionit të besueshem financiar në perputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

Kufizimet

Për shkak të kufizirneve të qenësishme në çdo sistem të kontrollit të brendshëm, gabimet apo parregullsitë, mund të ndodhin dhe të mbeten të pazbuluara. Gjithashtu, parashikimi i çdo vlerësimi të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme është subjekt i rrezikut që politikat dhe procedurat mund të bëhen të papërshtatshme për shkak të ndryshimeve të kushteve ose efektiviteti i hartimit dhe i zbatimit të politikave dhe procedurave mund të përkeqësohet.

PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)

NIPT: K517170241
Adresa: Blv. "Bajram Curri",
Rruga "Viktor Eftimiu" 1023
e-mail: erealb@ere.gov.al
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 15/03/2022

Përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar 1
Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet) 2
Pasqyra e ndryshimit të Fodeve 3
Pasqyra e flukseve monetare 4
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 5
A. Informacion i përgjithshëm 5
B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare 5
C. Politikat kontabile 6
1. Transaksionet në monedhë të huaj 6
2. Instrumentat financiare 6
3. Inventaret 8
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t) 8
5. Qiratë 9
6. Transaksionet me palët e lidhura 9
7. Grantet qeveritare 9
8. Të Ardhurat dhe shpenzimet 9
9. Përfitimet e punonjësve 10
10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara 10
11. Korrigjimi i gabimeve 10
12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare 10
D. Shënimet për Pozicionet Finaniare 10
1. Mjetet monetare 10
2. Të arkëtueshme 11
3. Inventarët 11
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM) 11
5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit 12
6. Të ardhurat nga aktiviteti 12
7. Shpenzimet për personelin 13
8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi 13
9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi 13
10. Shpenzime financiare 13
11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve 13
12. Teprica e Fondeve më 31.12.2021 14
13. Palet e lidhura 14
14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara 14
15. Kontrolle tatimore 14
16. Ngjarje pas datës së bilancit 14

Pasqyra e pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	1	56.240.725	114.450.199
Investime		-	-
Te drejta te arketueshme		-	-
Nga aktiviteti i shfrytezimit	2	11.426.152	27.104.405
Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te tjera		436.857	68.014
Kapital i nenshkruar i papaguar		-	-
Inventaret		-	-
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	3	3.107.381	2.657.246
Prodhime ne proces dhe gjysmprodukte		-	-
Produkte te gatshme		-	-
Malira		-	-
Shpenzime te shtyra		-	-
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		71.211.116	144.279.864
Aktive afatgjata			
Aktive financiare			
Aktive materiale			
Toka dhe ndertesa		-	-
Makineri e Paisje		-	-
Mjete Transporti	4	5.941.168	7.426.460
Paisje Zyrash	4	7.031.192	1.946.065
Te tjera paisje dhe Informatike	4	95.124.324	27.946.324
Aktivet biologjike		-	-
Aktive jo materiale		-	-
Koncenzione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te njiashme	4	7.355.406	9.246.847
Emri i mire		-	-
Paraqepjime per AAJM		-	-
Aktivet tatimore te shtyra		-	-
Totali i aktiveve afatgjata		115.452.089	46.565.696
Totali i Aktiveve		186.663.205	190.845.561
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Titujt e huamarrjes		-	-
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		-	-
Akteptime ne avance per porosi		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	5	1.169.444	20.939.124
Deflesa te pagueshme		-	-
*Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit **		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa		-	-
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve	5	2.005.067	2.128.908
Te pagueshme per detyrime tatimore	5	2.964.373	1.246.474
Te tjera te pagueshme	5	67.169	60.195
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurta		6.206.053	24.374.701
Detyrime afatgjata			
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra AGJ		-	-
Provizione		-	-
Provizione per pensione		-	-
Provizione te tjera		-	-
Detyrime tatimore te shtyra		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Detyrime Totale		6.206.053	24.374.701
Fondet Të Akumuar - ERE		166.470.859	106.054.620
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	11	13.986.292	60.416.239
Shuma		180.457.152	166.470.859
Totali i Detyrimeve dhe i Fondeve		186.663.205	190.845.560

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi

Kryetar
Petrit Ahmati

Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet)

		31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Te ardhura te shfrytezimit			
Te ardhurat nga Faturimi I Operatoreve	6	207.671.534	213.502.681
Te ardhurat nga Licensimi	6	10.796.150	2.857.000
Te tjera te ardhura nga organizma mbulim shpenzimesh		-	-
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Te tjera shpenzime		-	-
Shpenzime te personelit		-	-
Paga dhe shperblime	7	(149.503.066)	(122.775.775)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	7	(16.129.562)	(13.390.205)
Shpenzimet per pensionet		-	-
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(14.389.798)	(6.512.211)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	9	(24.411.287)	(14.060.326)
Te ardhura te tjera		-	-
*Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit**		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme		(84.594)	(73.342)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek		-	-
Shpenzime te tjera financiare	10	36.916	868.418
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet		-	
		-	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	11	**13.986.292**	**60.416.239**
Tatimi mbi fitimin			
Tatimi mbi fitimin e periudhes		-	
Tatim fitimi i shtyre			
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve			
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve		**13.986.292**	**60.416.239**

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi

Kryetar
Petrit Ahmeti

Pasqyra e ndryshimit të Fodeve

	Fondet Të Akumuar - ERE	Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	Totali
Pozicioni financiar ne fillim 01.01.2020	**88.957.416**	**17.097.204**	**106.054.620**
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile			-
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	**88.957.416**	**17.097.204**	**106.054.620**
Rezultati viti paraardhes	17.097.204	(17.097.204)	-
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit		60.416.239	60.416.239
Pozicioni financiar ne fund 31.12.2020	**106.054.620**	**60.416.239**	**166.470.859**
			-
Rezultati viti paraardhes	60.416.239	(60.416.239)	-
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	-	13.986.292	13.986.292
Pozicioni financiar ne fund 31.12.2021	**166.470.859**	**13.986.292**	**180.457.152**

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi

Kryetar
Petrit Ahmeti

Pasqyra e flukseve monetare

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	13.986.292	60.416.239
Rregullime per shpenzimet jo-monetare:		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14.389.798	6.512.211
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme		
Ulje ne vleren neto te realizueshme per inventaret		
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	15.309.410	47.522.188
Renie/(Rritje) ne inventar	450.135	353.348
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme	18.168.648	10.581.197
Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit		
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	**25.066.717**	**125.385.183**
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	83.276.191	21.479.123
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	**- 83.276.191**	**- 21.479.123**
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	**- 58.209.473**	**103.906.060**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	114.450.199	10.544.139
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	**56.240.726**	**114.450.199**

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi

Kryetar
Petrit Ahmeti

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

A. Informacion i përgjithshëm

ERE është person juridik publik, i pavarur nga interesat e industrise së energjisë dhe nga organet shtetërore. ERE eshte krijuar ne vitin 1995 dhe aktualisht funksionon ne baze te ligjit nr. 43/2015, date 30.04.2015 "Për sektorin e energjise elektrike" dhe ligjit nr.102/2015 "Per sektorin e gazit natyror".

Misioni i Entit Rregullator të Sektorit të Energjise është:

- Garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
- Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, I cili vendos rregullat lidhur me:
  - a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
  - b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
  - c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
  - ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
  - d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike..

Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë është Z. **Petrit Ahmeti**

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2021-31.12.2021.

B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKKP) dhe Ligjin Nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

Pasqyrat financiare të datës 31 Dhjetor 2021 janë përgatitur në një platformë excel.

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqerise ne 31 Dhjetor 2020.

Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Biznesi në vijimesi

Pasqyrat financiare të përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar gjatë.

Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e .

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

- ***Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme***

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve apo debitorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve apo debitorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së tyre. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël nëse ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

- **Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

C. Politikat kontabile

Shoqëria ka aplikuar politikat e mëposhtme kontabël për periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare individuale.

1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni.Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të perdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

	31.12.2021	31.12.2020
Kurset e këmbimit		
Euro/Lekë	120.76	123.7
USD/ Lekë	106.54	100.84

2. Instrumentat financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër.Instrumentat financiarë të shoqërise përbëhen nga:mjetet monetare; depozita pa afat dhe depozita me afat fiks ku njësia ekonomike është depozituesi [psh llogaritë bankare]; letra tregtare dhe kambiale tregtare;llogari, dëftesa dhe hua të arkëtueshme dhe të pagueshme; obligacione dhe instrumenta të ngjashme borxhi;zotim për të marrë një hua nëse zotimi nuk mund të paguhet në mjete monetare mjetet monetare.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të Instrumentave financiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë

Instrumentin financiar. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje,kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Vlerësimi i mëpasshëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

Llogaritë e arkëtueshme, tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen apo përfundojnë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Shoqëria përgjithësisht huatë e marra dhe të dhëna i ka me palët e lidhura për të financuar fazën paraprake të zhvillimit të projekteve energjetike. Për këto aktive apo detyrime nuk është aplikuar interes.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël, Shoqëria nuk ka aplikuar vlerë të drejtë.

Netimi i instrumentave financiare

Aktivet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia per të shlyer në shumen neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njëkohësisht.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale.Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvlerësime të aktiveve jo - financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo- financiare të , rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Ç'regjistrimi instrumentave financiare

Aktivet financiare se bashku me fondin rezerve të zhvlerësimit ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit.Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise perfundojne, skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

3. Inventaret

Inventaret regjistrohen ne konatbilitet me kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjellijen e inventarit ne vendin e percaktuar. Për përcaktimin e kostos së inventareve është zgjedhur metoda e kostos mesatare.

4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t)

*Njohja dhe Matja:*Vlerësimi fillestar i një elementi te AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre.Kosto e marrjes përfshin te gjitha shpenzimet e kryera për sjellijen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

*Njohja Mepashsme:*AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet kostos së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe në se ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete.Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të kostos aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

*Amortizimi:*Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësia jone ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të AAM-ve metodën e amortizimit mbi bazën e vlefës se mbetur ndësa normat e amortizimit janë përdorur normat menaxherial si më poshtë:

Llojet e Aktiveve Afatgjata	Normat e aplikuara	Metoda e aplikuar
Materiale		
Makineri dhe pajisje	20%	Me vlerë të mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlerë të mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vlerë të mbetur
Të tjera	20%	Me vlerë të mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me vlerë të mbetur
Ndërtesa	5%	Me vlerë të mbetur
Jo materiale		
Koncensione, patenta, licenca	15%	Lineare

Tokat dhe Investimet në proçes nuk amortizohen.

Ç'regjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jasht' përdorimit apo ateherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit

të aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivet afatgjata jomateriale perfshijne liçensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

Njohja dhe Matja: Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të patrupëzuara që nga data që jane të disponueshme për përdorim.

*Zhvlerësimi (Rënia në vlerë):*Shoqëria e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

5. Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillimin e qirasë.Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria nuk ka qira financiare.

6. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influence të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

7. Grantet qeveritare

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe shoqëria do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të , njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të , njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

8. Të Ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë të sherbimit të shitur pa TVSH. Dy burimet e të ardhurave janë pagesat e të liçensuarve për tarifën e licensës për ushtrimin e aktivitetit në tregun e energjisë dhe Tarifën vjetore për rregullatorin bazuar në vendimet e bordit të ERE-s.

Shpenzimet

Shoqëria njeh shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në daten e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshem nga drejtimi i .

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

9. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit.Qeveria shqiptare është pergjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute.
Kontributet e në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove te çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar ne këmbim te shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare.Ato paraqiten vetëm në shënimet shpjeguese, për sa kohë që mundësia e një daljeje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Vlera e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që, një detyrim ka lindur në datën e raportimit financiar, dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

11. Korrigjimi i gabimeve

Gabimet mund të shfaqen në njohjen, matjen, prezantimin ose paraqitjen e zërave të pasqyrave financiare. Paraqitjet e gabuara materiale në pasqyrën e pozicionit financiar janë materiale nëse ato, individualisht ose të grupuara, mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që përdoruesit marrin bazuar në pasqyrat financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e konstatimit të gabuar ose të gjykimit të gabuar për shkak të rrethanave. Madhësia ose natyra e zërit financiar, ose një kombinim i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues.

12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare

Ngjarjet pas datës se bilancit që përmbajnë informacion shtesë të , në datën e bilancit kontabel (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

D. Shënimet për Pozicionet Finaniare

1. Mjetet monetare

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Banka Kombetare Tregtare Lek	50.475.872	112.634.291
Banka Kombetare Tregtare Euro	2.608.908	166.578
Raiffaisen Bank Lek	240.508	148.758
Union Bank	1.286.585	770.440
Union Bank Euro	76.746	234.615
Union Bank Card	1.552.107	495.517
Banka Kombetare Tregtare USD	-	-
Shuma	**56.240.725**	**114.450.199**

Veprimet e lëvizjeve monetare në librat e arkës dhe bankës, janë veprime të autorizuara, mbështeten në dokumenta që justifikojnë pagesat dhe arkëtimet, regjistrimet janë kronologjike.

Për gjëndjen në valutë është bërë rivlerësimi me kursin fiks të bankës Shqipërisë në datën 31.12.2021 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë.

2. Të arkëtueshme

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Klinete pa arketuar viti	5.772.318	22.463.562
Debitor ndër vite më shumë se 360 ditë	5.653.834	4.640.843
Shuma	**11.426.152**	**27.104.405**

Të tjera të arkëtueshme

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Te tjera te arketueshme	437.552	68.014
Shuma	**437.552**	**68.014**

3. Inventarët

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	3.107.381	2.657.246
Shuma	**3.107.381**	**2.657.246**

4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM)

Aktive Afatgjata Materiale

Vlera bruto e AAM me 31.12.2019		27.592.000	11.620.051	19.749.546	58.961.597
Shtesa gjate 2020				21.479.124	21.479.124
Pakesime					-
Vlera bruto e AAM me 31.12.2020	-	27.592.000	11.620.051	41.228.670	80.440.721
Shtesa gjate 2021			5.822.160	77.434.700	83.256.860
Pakesime					-
Vlera bruto e AAM me 31.12.2021	-	27.592.000	17.442.211	118.663.370	163.697.581
Amortizimi i akumuluar 31.12.2019		18.308.924	9.971.053	10.221.124	38.501.102
Pakesime					-
Amortizimi i vitit 2020		1.856.615	329.799	2.434.355	4.620.770
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2020	-	20.165.540	10.300.852	12.655.480	43.121.871
Shtesa gjate 2021		1.485.292	737.033	10.256.700	12.479.026
Pakesime					-
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2021	-	21.650.832	11.037.885	22.912.180	55.600.897
Vlera neto e AAM 2021	-	5.941.168	6.404.325	95.751.190	108.096.684
Vlera neto e AAM 2020	-	7.426.460	1.319.199	28.573.190	37.318.849

Aktive Afatgjata Jomateriale

AAJM	Studime zhvillimi
Gjendje me 01.01.2020	**12.609.610**
Shtesa investime 2020	
Pakesime	
Gjendje me 31.12.2020	**12.609.610**
Shtesa investime 2021	
Pakesime	
Gjendje me 31.12.2021	**12.609.610**
Amortizini Akumuluar	
Gjendje me 01.01.2020	**1.471.321**
Shtesa 2020	1.891.442
Pakesime	
Gjendje me 31.12.2020	**3.362.763**
Shtesa 2021	1.891.442
Pakesime	
Gjendje me 31.12.2021	**5.254.204**
Gjendje me 31.12.2021	**9.246.847**
Gjendje me 31.12.2020	**7.355.406**

5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	1.169.444	20.939.124
Shuma	**1.169.444**	**20.939.124**

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqer	2.005.067	2.128.908
Shuma	**2.005.067**	**2.128.908**

Të pagueshme për detyrime tatimore dhe të tjera

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Tatim mbi te ardhurat personale	2.964.373	1.246.474
Te tjera te pagueshme	67.169	60.195
Shuma	**3.031.542**	**1.306.669**

6. Të ardhurat nga aktiviteti

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Te ardhurat nga Faturimi I Operatoreve	207.671.534	213.502.681
Te ardhurat nga Licensimi	10.796.150	2.857.000
Te tjera te ardhura nga organizma mbulim shpenzimesh	-	-
Shuma	**218.467.684**	**216.359.681**

7. Shpenzimet për personelin

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Paga dhe shperblime	- 149.503.066	- 122.775.775
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	- 16.129.562	- 13.390.205
Shuma	**- 165.632.628**	**-136.165.979**

Shpenzimet e personelit janë përllogaritur konform nenit 11 te ligjit 43/2015.

8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	- 14.389.798	- 6.512.211
Shuma	**- 14.389.798**	**- 6.512.211**

9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Shpenzime te lende e pare e konsumi	- 3.052.193	- 2.476.690
Sherbime te ndryshme nga te trete	- 11.387.478	- 5.222.172
Qera	- 1.041.600	-
Shpenzime uje energji	- 584.133	- 406.769
Mirmbajtje automjete e taksa te lidhura me to	- 721.892	- 614.409
Publikime ne media	- 574.690	- 883.200
Udhetime dieta J.vendit; kuotizacion	- 5.756.973	- 3.609.543
Poste telefon etj	- 872.734	- 747.544
Taksa dhe tarifa vendore	- 99.875	- 100.000
Te tjera	- 319.720	0
Shuma	**- 24.411.287**	**- 14.060.326**

10. Shpenzime financiare

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	(84.594)	(73.342)
Shpenzime te tjera financiare	36.916	868.418
Shuma	**- 47.678**	**795.075**

11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve

	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2020
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	13.986.292	60.416.239
Shuma	**13.986.292**	**60.416.239**

12. Teprica e Fondeve më 31.12.2021

	31 dhjetor 2021
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve	13.986.292
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14.389.798
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve - e korrigjuar (pa amortizimin)	**28.376.090**
Gjendje Mjete Monetare 31.12.2021	**56.240.725**
Kliente te paarketuar me 31.12.2021	**11.426.152**
Teprice e fondeve nga 2021 transferuar per buxhetin 2022	**67.666.877**

13. Palet e lidhura

Palët quhen të lidhura kur njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloje palët e tjera ose të ushtroje ndikim domethënës në vendim-marrjen financiare dhe operacionale të tyre.

14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkoje rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

15. Kontrolle tatimore

Librat e Shoqërise nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 31.12.2020. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

16. Ngjarje pas datës së bilancit

Me 31 Dhjetor 2021 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi

Kryetar
Petrit Ahmeti

Tiranë, më 15/03/2022

Nexia AL
Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

STUDIO "VIAR" CONSULTING

RAPORT I SIGURISË SË PROFESIONISTIT TË PAVARUR

Drejtuar: Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Enti Rregullator i Energjise ("ERE" ose "Enti") angazhoi audituesit e pavarur Znj. Fatime Alliu me License Nr.166 dhe Znj. Orjana Kalaja me License Nr.284 (referuar më tej si "Audituesit"), për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 ("të dhëna të zgjedhura"), me qëllim dhënien e sigurisë së kufizuar sipas kritereve të përshkruara më poshtë (Qëllimi i punës). Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat e zgjedhura kanë të bëjnë me veprimtarinë e Entit në Shqipëri dhe nuk përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me palë të tjera bashkëpunuese ose aktivitete / performanca të palëve të treta.

Qëllimi i punës

Angazhimi i dhënies së sigurisë është planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar SNAS 3000, "Angazhimet e Dhënies së Sigurise ("SNAS 3000") që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", me qëllim që të japim një opinion për dhënie sigurie të nivelit të kufizuar për:

- Verifikimin e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore të paraqitura në Raportin Vjetor 2021 në mënyrë specifike për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në krahasim me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Përformances", të ilustruara në Raportin Vjetor), mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.

Nexia AL
Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

STUDIO "VIAR" CONSULTING

Përgjegjësitë e drejtimit

Drejtimi i të Entit Rregullator të Energjisë është përgjegjës për përgatitjen, prezantimin, tërësinë dhe saktësinë e të dhënave jofinanciare të dhëna për ne, siç paraqiten në Raportin Vjetor 2021. Për më tepër, drejtimi i ERE është përgjegjës për regjistrimet e mbajtura dhe kontrollet e brendshme të përshtatshme që janë krijuar për të mbështetur procesin e raportimit dhe të përputhshmerisë ligjore. Në mënyrë të veçantë, drejtimi është përgjegjës për hartimin e kontrolleve të brendshme dhe zbatimin e tyre për të parandaluar që Raporti të këtë anomali materiale.

Përgjegjësitë e Audituesve

Ne kemi kryer një shërbim dhënie sigurie të kufizuar. Përgjegjësia jonë është të shprehim konkluzionin tonë bazuar në procedurat e kryera, për të dhënat e zgjedhura, siç përshkruhet më sipër në seksionin "Qëllimi i punës".

Përgjegjësia jonë është e kufizuar në informacionin shpjegues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, të prezantuara në Raportin Vjetor për vitin 2021.

Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, ne nuk pranojmë dhe nuk marrim asnjë përgjegjësi për angazhimin tonë, ndaj kujtdo tjetër përveç ERE, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar, me pëlqimin tonë paraprak.

Ne kemi kryer punën tonë duke mbledhur gjithë të dhënat, dokumentacionin përkates, informacionin dhe shpjegimet qe ne i konsideruam të nevojshme për të dhënat e zgjedhura të përshkruara, në seksionin "Qëllimi i punës". Procedurat e ndjekura në lidhje me të dhënat e zgjedhura përfshijnë:

- Intervistat me drejtimin dhe personelin përgjegjës për informacionin dhe supozimet përkatese.
- Vizita në ambientet e Entit Rregullator të Energjisë.

- Rishikimit dhe vlerësimit të proceseve dhe kontrolleve të përdorura për mbledhjen, grumbullimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave;
- Teste me zgjedhje mbi të dhënat e mbledhura dhe formulat, kur kërkohen.

Niveli i Dhënies së Sigurisë

Procedurat që kemi kryer janë hartuar për të ofruar siguri te kufizuar, sic specifikohet në SNAS 3000, mbi të cilat ne u bazuam për të arritur në konkluzione për angazhimin tonë. Këto procedura nuk jane aq të zgjeruara sa ato që kërkohen për dhënien e sigurisë së arsyeshme, për pasojë, merret një nivel më i ulet i sigurisë.

Kufizimet

Për të kryer punën tonë, ne u mbështetem ekskluzivisht në informacionin e dhënë nga drejtuesit e Drejtorive të Entit Rregullator të Energjisë, të cilin ne e pranuam me mirëbesim si informacion të plotë, të saktë, të vërtetë dhe jo mashtrues.

- Si rrjedhim, ne nuk kemi kryer procedura verifikimi shtesë, përveç procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë në Raportin tonë në seksionin, Përgjegjësitë e Audituesve, të cilat rrjedhin nga metodologjia e rënë dakort reciprokisht.
- Asnjë punë nuk është kryer për të dhënat të periudhave të raportimeve të mëparshme, si dhe mbi të dhënat në lidhje me objektivat dhe parashikimet.
- Asnje punë nuk është kryer për asgjë tjetër përveç qëllimit të rënë dakord dhe për rrjedhojë, konkluzioni ynë është i kufizuar për këtë qëllim.

Pavarësia

Audituesit zbatojnë kërkesat e Standardit Ndërkombetar për Kontrollin e Cilesise nr.1. Bazuar në këtë, mbajmë një sistem të kontrollit të integruar të cilësisë që përfshin politikat dhe procedurat për respektimin e parimeve morale, standardeve profesionale dhe kërkesave

Nexia AL
Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

STUDIO "VIAR" CONSULTING

përkatese ligjore dhe rregullatore. Ne jemi në përputhje me kerkesat e pavarësisë dhe standardet e tjera etike të Kodit Etikes së IFAC për profesionistët të Bordit të Standardeve Ndërkombetare të Etikes për Audituesit (IESBA), i cili bazohet në parimet themelore të integritetit, paanshmerisë, përshtatshmerisë profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Në këtë kontekst, ekipi Audituesve për dhënien e sigurisë është i pavarur nga Enti Rregullator të Energjise dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2021.

Konkluzione

Bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e marrë, asgjë nuk na ka tërhequr vëmendjen tonë që të na bëjë të besojmë se ka ndonjë gabim ose anomali që do të ndikonte materialisht në dhënien e informacioneve rreth përputhsherisë ligjore të aktivitetit (përfshire shënimet shpjeguese dhe referencat përkatese) sic paraqiten në Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021. Për më tepër, asgje nuk ka tërhequr vëmendjen tonë që të bëjë të besojme se të dhënat e paraqitura, nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përmendura më lart, në seksionin "Qëllimi i punës".

Nexia-AL sh.p.k
Orjana Kalaja

Auditues Ligjor
License Nr.284

Studio" Viar"Consulting
Fatime Alliu

Auditues Ligjor
License Nr.166

Tiranë, 17/03/2022